



ECONOMICUS

NR. 2 / Verë 2008

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANES

REVISTË SHKENÇORE E FAKULTETIT

TË SHKENÇAVE EKONOMIKE

KRYEREDAKTOR

Prof. Asc. Dr. Adrian CIVICI

REDAKTOR

Gladiola BENDAJ

DIZENJIMI / GRAFIKA

Gersi MIRASHI

KONSULENTE

Dr. Selami XHEPA

Prof. Asc. Dr. Luljeta MINXHOZI

Prof. Asc. Dr. ARBEN MALAJ

Msc. Mimi KODHELI

Dr. Gjergji FILIPI

Dr. Fatmir GURI

Prof. Asc. Dr. Flutura KALEMI

Msc. Shkëlzen MARKU

Prof. Asc. Entela SHEHU

Msc. Neritan SEJAMINI

Dërgoni shkrime, reçensa librash, përbledhje
punimesh shkencore, monografi, studime në
redaksinë e revistës ECONOMICUS

Ato do të shqyrtohen nga redaksia me rigorozitet
shkencor

Dërgoni në format Word në adresën e mëposhtme:
economicus@universiteteuropian.com



PERMBAJTJA

Krizë financiare apo krizë shumë-dimensionale botërore? A. CIVICI	f 5 - 14
Analiza dhe qëndrimi i Bankës Botërore për krizen ndërkombëtare	f 15 - 23
Pasojat e krisës ekonomiko - financiare botërore në Shqipëri A. ANGJELI	f 24 - 29
Analiza e bilancit tregtar në Shqipëri - pse kaq negativ ? S. BELORTAJA	f 30 - 36
Tendencat në industrinë e sigurimeve në Shqipëri B. MINXHOZI	f 37 - 42

DOSIER “Bankat, si po reagojnë ?”

Banka Qëndrore në fokus A. CIVICI	f 45 - 48
Hapja e sektorit bankar. Depërtimi i tij në Shqipëri dhe rajon F. IBRAHIMI	f 49 - 57
Politika monetare si instrument për kontrollin e inflacionit G. KOLASI	f 58 - 68
Roli i sistemit bankar shqiptar në financimin e ekonomisë D. SALKO	f 69 - 74
“Bankat dhe Globalizimi” J. C. TRICHET	f 75 - 81

ANALIZA DHE KERKIME

Amerika dhe Kina në Gjeoekonominë globale F. TARIFAJ	f 82 - 100
Integrimi finansiar i anëtarëve të rinj A. KADARE	f 101 - 115
Llogaritja e prob.. të zbulimit dhe ndëshkimit të korruptionit F. KOLANECI	f 116- 126

HISTORIK


Banka e Shqipërisë - nga krijimi deri në fund të luftës së II botërore K. KRISAFI f 127- 139	
Banka Qëndrore Evropiane, (me rastin e 10 vjetorit të krijimit)	f 140 - 150

EKONOMISTE TE SHQUAR

Joseph Stiglitz: “Globalizimi duhet menaxhuar”	f 151 - 159
--	-------------

LIBRA EKONOMIKE

“Misteri i gjashtë”, nga Besnik ALIAJ H. ÇILI	f 160 - 162
---	-------------



KRIZE FINANCIARE APO KRIZE GLOBALE ?... KONJUKTURORE APO STRUKTURORE?

Prof. Asc. Dr. ADRIAN CIVICI

Rektor në Universitetin European të Tiranës (UET)

Bulevardi Gjergj Fishta, (ish npv nr 2)

adriancivici@gmail.com
<http://universiteteuropian.com>

Krizë financiare apo krije globale? Krije ushqimesh... krije çmimesh apo krije energjetike? Është hera e parë në historinë tonë moderne të shekujve të fundit, ose më saktë në "periudhën e kapitalizmit" dhe revolucioneve industriale, që bota përballet me kaq shumë çështje shqetësuese njëherësh. Situata nuk pritet të përmirësohet deri para vitit 2015. Por, duke analizuar shkaqet që po e shkaktojnë një situatë të tillë, ekspertët mendojnë se receta për daljen nga kjo situatë, është më e vështirë dhe e gjatë nga sa mendohej, me gjithë optimizmin e moderuar të OECD-së. Si po reagon Europa, SHBA, vendet në zhvillim dhe ato emergjente? Ekspertët, politikanët, shkencëtarët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile janë të bindur se, këtë radhë përgjigjja dhe dalja nga kriza nuk mund të jetë as individuale për shtete apo rajone të ndryshme të botës, as pjesore për elemente të veçanta të saj. Duhet hyrë, pranuar dhe shpjeguar, thelli i vërtetë i saj: është krije e modelit të zhvillimit?.., e vetë kapitalizmit?.., e menaxhimit të globalizmit?.., apo thjesht pjesë e ciklit të zhvillimit?.. Kapitalizmi ndodhet në një pikë kritike që kërkon zgjidhje radikale në mënyrat e kompozimit dhe menaxhimit të tij. Pyetjet që kërkojnë zgjidhje të reja janë: A duhet të vazhdojë të jetë modeli amerikan apo perëndimor i zhvillimit dhe konsumit i vetmi model dominues në shekullin e XXI-të?; A mundet që vetëm një grup vendesh apo institucionesh ndërkombëtare të vendosin për gjithçka në zhvillimin ekonomik-social të botës?; A kanë limit burimet natyrore të planetit?; A duhet që zhvillimi i qëndrueshëm të bëhet kryeffjala e çdo modeli zhvillimi?; etj.

► Krizat që po tronditit botën

Tashmë, të gjithë janë të bindur se planeti ynë ka hyrë në një krije globale që në vetvete përbledh ose përbëhet nga gjashtë kriza specifike: kriza financiare, monetare, ekonomike, ushqimore, energjetike, ekologjike. Është hera e parë në historinë tonë moderne të shekujve të fundit, apo më saktë në "periudhën e kapitalizmit" dhe revolucioneve industriale që bota përballet me kaq shumë çështje shqetësuese njëherësh. Ekspertët, politikanët, shkencëtarët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile janë të bindur se këtë radhë përgjigjja dhe dalja nga kriza nuk mund të jetë as individuale për shtete apo rajone të ndryshme të botës, as pjesore për elemente të veçanta të saj. Duhet

hyrë, pranuar dhe shpjeguar thelli i vërtetë i saj: është krije e modelit të zhvillimit?.., e vetë kapitalizmit?.., e menaxhimit të globalizmit?.., apo thjesht produkt i historisë, koncepteve dhe institucioneve ndërkombëtare. Gjithçka filloj të shfaqej gjatë vitit 2007, thjesht si një krije financiare që e kishte origjinën nga kreditë e këqija në tregun imobiliar amerikan.

U shtruan shumë pyetje që kërkonin përgjigje. Do mbetej e lokalizuar vetëm në SHBA? Do përhapej në Europë? Do prekte gjithashtu edhe vendet emergjente dhe ato në zhvillim? Ishte një krije konjukturore apo strukturore?, etj. Personalitete nga më të spikaturit e botës ekonomike e financiare botërore, si Alain Greenspen, Dominique Strauss Kahn, Ben Bernanke, Jean Claude

Trichet, etj., në atë periudhë e trajtuan me shumë prudencë këtë krizë duke e ciliësuar si "një turbulencë e tregjeve financiare amerikane", që duhej menaxhuar me kujdes në intensitetin dhe përhapjen e saj në Europë dhe në vende të tjera të botës. Por, shumë shpejt "turbulencat" e tregjeve financiare goditën rëndë dollarin amerikan, i cili filloj të zhvleftësohej me shpejtësi në raport me euron, duke nxjerrë në evidencë edhe një situatë alarmante të ekonomisë amerikane. Krizë konjukturore, stanjacion, recession, apo stagflacion? Barometri i pesimizmit të ekonomisë, financave, biznesit dhe konsumatorëve amerikanë vazhdon të ulet për ditë. Ndërkohë, në tremujorin e parë të 2008 kriza financiare filloj të shfaqej dhe në Europë. Fillimisht në Angli, pastaj në bankat zvicerane, franceze, gjermane, etj. FMN i vlerësonë në rrëth 1000 miliard dollarë humbjet nga kjo krizë, ndërkohë që bën parashikime aspak optimiste për nivelin e rritjes ekonomike dhe inflacionin në ekonomitë kryesore të planetit.

Paralelisht me këtë fenomen, tregjet dhe ekonomitë e shumë vendeve të botës u tronditën nga çmimi i naftës që arriti frikshëm nivelin e 140 USD/baril, duke mbjellë panik ndërkombëtar për të ardhmen e zgjidhjes së problemeve energetike në shumë vende të botës. Është mungesë e ofertës nga vendet e OPEC-ut; është pasojë e fondeve spekulative; u shkaktua nga rënia e dollarit; kërkesa botërore është mjaft më e lartë se oferta e mundshme...etj. Janë këto disa nga pikëpyetjet që vazhdojnë të mos kenë të njëjtën përgjigje nga ekspertët, politika apo institucionet ndërkombëtare. Por nga ana tjetër, çmimet e produkteve ushqimore bazë si orizi, gruri, misri, mielli, vajrat e ndryshëm, etj., pothuajse u dyfishuan në 18 muajt e fundit, duke risjellë në vëmendjen e të gjithëve rrezikun e urisë për qindra milionë njerëz, sidomos për vendet e varfra dhe ato në zhvillim, frikën e krizave të bukës apo orizit dhe luftërave civile "me shkak kryesor luftën përmes mbijetesës së përditshme", ndërkohë që vendet e pasura e të zhvilluara po i përdorin gjithnjë e më shumë këto produkte për prodhimin e bio-karburanteve. Vetëm SHBA tërroqi nga tregu ushqimor dhe përdori për bioetanol mbi 140 milion ton misët, ndërkohë që edhe BE planifikon që mbi 10% të nevojave të tij energetike t'i plotësojë në të njëjtën mënyrë. Në këtë "luftë të pandershme përmes bukës", u arrit deri aty, sa OKB dhe Programi Botëror i Ushqimit të

bënин thirrje për një moratorium ndërkombëtar 5-vjeçar për ndërprerjen e prodhimit të bio-karburanteve duke i akuzuar vendet e pasura për "krim kundër njerëzimit".

Ky alarm po jepet tashmë nga të gjithë: nga institucionet ndërkombëtare më të mëdha të botës si OKB-ja, Banka Botërore, FMN, IFAD, PNUD, etj.; nga vendet më të zhvilluara të botës si SHBA, vendet e BE, Kanadaja, Rusia, Japonia, Australja, Tajlanda, Brazili, Zelanda e Re, etj.; nga liderët më të mëdhenj botërorë, nga OJQ-të më të mëdha e prestigjioze ndërkombëtare, etj. Kriza e çmimeve mund të zhysë në krizë disa qindra milionë njerëz, ku pritet të përfshihen si shtresat e varfra të vendeve të zhvilluara e atyre në zhvillim, ashtu dhe vende të tëra të konsideruara të varfra. Mbi 36 vende rrezikojnë të bien në luftë civile si pasojë e krizës së ushqimeve. Kina, Vietnami, Rusia, Argjentina, Tajlanda kanë vendosur ose t'i taksojnë rëndë eksportet ushqimore të tyre, ose t'i bllokojnë fare ato. Sipas një raporti të fundit të Bankës Botërore, e cila ka marrë në studim reagimin dhe sjelljen e 58 qeverive, të cilat futen në grupin e "vendeve me të ardhura të pakta" për të përballuar krisjen globale të ushqimeve dhe çmimeve të tyre; rrëth 42% e qeverive kanë privilegjuar politikat e uljes së taksave të importeve të produkteve agro-ushqimore e veçanërisht taksat e drithërave; 32% e qeverive kanë aplikuar politikën e "dorës së forte" nëpërmjet një kontrolli direkt të çmimeve në treg; rrëth 25% të tjera kanë zgjedhur rrugën e ndërhyrjes në treg, duke blerë me fonde publike drithë dhe ushqime në tregun botëror dhe duke i shitur ato në tregjet e brendshme me çmime më të ulëta, duke kontribuar kështu në kontrollin e spirales së rritjes së çmimeve në tregjet e tyre. Ndërkohë, vetëm 16% e qeverive kanë adoptuar një qëndrim pasiv, duke mos marrë pothuajse asnjë masë për përballimin e kësaj gjendjeje. Në këtë kuadër, Banka Botërore i bën apel gjithë qeverive të vendeve të botës, veçanërisht atyre që rrezikohen akoma më shumë nga kjo situatë, që të tregohen sa më aktive në ndërhyrjet dhe politikat e tyre për ti bërë ballë kësaj krize të pritshme disa vjeçare. Në mënyrë më specifike, rekomandohen masa të tillë, që fillojnë që nga subvencionet direkte financiare për shtresat që preken direktë e më shumë nga rritja e çmimeve, tek adoptimi i politikave fiskale e buxhetore me efekte direkte në uljen e çmimeve, te politikat afat-gjata të rritjes së prodhimit agro-ushqimor, stimulimin e

përdorimit të metodave e teknologjive të reja në bujqësi e agro-industri, etj., për të përfunduar te tërheqja e vëmendjes së qeverive për prioritetin që duhet t'i jepin sot dhe në perspektivë sektorit të bujqësisë dhe agro-industrisë.

Jashtë shqetësimeve dhe pikëpyetjeve nuk po mbeten as problemet e mjedisit dhe ekologjisë. Vazhdimi i shkatërrimit të pyjeve, ndotja alarmante e ajrit në shumë vende të botës, shpërdorimi dhe humbja në mënyrë të pakthyeshme e tokave bujqësore, betonimi dhe asfaltimi i pandalshëm i planetit, zvogëlimi i rezervave të ujit, ndotja e deteve dhe lumenjve, dëmtimi i brezave koralarë, rënia e rezervave botërore të peshqve, shkrirja e akullnajave mijëra-vjeçare në të dy polet e tokës por dhe në shumë majë malesh, prishja e biodiversitetit dhe zhdukja e mjaft bimëve apo kafshëve, etj., janë po kaq shqetësuese sa krizat e mësipërme. Gjithashtu, tashmë të gjithë po binden se fenomeni i "ngrohjes globale" nuk është thjesht një "science fiction" apo fantazi e lëvizjeve ekologiste. Pasojat e saj po ndjehen përditë dhe nga të gjithë. Zjarre në pyje, përmbytje masive, temperatura të pazakonshme për stinët, sëmundje të reja të panjohura, efekte në ciklin jetësor të mjaft bimëve dhe kafshëve, etj., janë tashmë objekt i mjaft konferencave dhe samiteve botërore të niveleve nga më të lartat.

Cfarë po ndodh në këtë dhjetëvjeçar të parë të këtij shekulli të ri? Natyrisht, duhet thënë që në fillim se ky nuk duhet perceptuar e konsideruar si një skenar apokaliptik katastrofik. Problemi qëndron tek përkufizimi i kësaj krize globale, tek gjetja e shkaqeve strukturore të saj dhe masat më efektive të tejkalimit të shpejtë të saj. Përpjekja e parë është një analizë krasuese. Me cilën nga krizat e mëparshme mund të krasoheret kjo krizë, simptomat e së cilës janë njëkohësisht financiare, monetare, ekonomike, ushqimore, energjetike dhe ekologjike? Cila do pritet të jetë "amplituda në shkallën Richter" e tërmetit ekonomik, financiar e social të saj? Më e fortë apo më e dobët se "depresioni i madh" i viteve 1929-1932?; e ngjashme me krizën e viteve 70-të të shekullit të kaluar; e provokuar nga "kriza e naftës" e vitit 1973 dhe e shoqëruar me efektet të rënda ekonomike e financiare për shumë vende të botës?... Krasoheret ajo me thirrjen e themeluesve të "Klubit të Romës" në vitin 1972 për "të stopuar rritjen e shfrenuar ekonomike në mënyrë që të evitohet konsumi

pa kthim i burimeve të planetit", që do të bëhej real në fund të shekullit të XXI-të në qoftë se vazhdohet me këtë model konsumi e zhvillimi që sot konsiderohet simbol i zhvillimit dhe mirëqenies?...apo me krizën "e internetit" të vitit 2000? Ekspertët mendojnë se këtë radhë problemi duhet vlerësuar nën një kënd-vështrim tjetër, shumë më kompleks. Zgjidhjet e ofruara deri tani për daljen nga krizat e mëparshme nuk po konsiderohen "receta" të vlefshme për krizën aktuale.

Debati i parë në kërkim të zgjidhjes ka të bëjë me raportet e saj me kapitalizmin. Sipas mendimit të tre ekonomistëve të shquar, R.Boyer, M.Debove dhe D.Plihon "krizat financiare ritmojnë dhe kompozojnë vetë historinë e kapitalizmit", duke marrë shpesh "formën e krizave binjake apo trinjake", d.m.th., një përzierje të problemeve të bursës me ato financiare dhe ekonomike bashkë. Në këtë mënyrë, këta autorë evidentojnë "karakterin tashmë të vjetër të ndërtlidhjes së tregjeve të natyrave të ndryshme" në kapitalizëm. Sipas tyre, "krizat kanë ardhur duke u shtuar, sidomos mbas zhdukjes së marrëveshjes së Bretton-Woods në vitin 1971, që shënoi fundin e sistemit të përqindjes fikse të këmbimit, e vendosur menjëherë pas luftës së dytë botërore". Por, Hautcoeur, profesor i ekonomisë në EEP (Paris) e relativizon problemin, kur thotë se "kur bëhet fjalë për gjerësinë dhe shtrirjen e krizës aktuale, ne duhet të ndajmë qartë mekanizmat që e shkaktuan nga efektet e prodluara prej tyre"... "me gjithë retë e zeza në horizont, FMN dhe OCDE vlerësojnë se rritja ekonomike botërore për 2-3 vitet e ardhshme do të jetë në nivelet 3.5-4%, sidomos falë motorit të ekonomisë kineze e indiane, por me kusht që ato të mos mbinxehen". Pra, konklidon Hautcoeur, "në këtë moment nuk mund të jemi të sigurt se bota po kalon një krizë ekonomike e financiare radikale". Të njëjtin opinion ndan dhe ekonomisti tjetër Ph. Chalmin kur shprehet se "problemi duhet të relativizohet akoma më shumë....intensiteti i krizës aktuale është i fortë, por të gjithë ne duhet të kujtojmë se gjatë krizës së viteve 1970, të gjithë u trembën aq shumë sa lajmëruan lindjen e një rregulli të ri botëror, gjë që nuk u vërtetua".

Por, përtej këtyre analizave më pak alarmiste, ka edhe një grup tjetër ekonomistësh, financierësh, sociologësh e historianësh të cilët, krizën aktuale e cilësojnë si "të jashtëzakonshme

dhe të shumëfishtë". Ata konfirmojnë se "deri më sot, në ekominë botërore nuk është parë asnjëherë një volatilitet kaq i madh në tregjet financiare dhe ato të lëndëve të para". Sipas tyre, "referencat në krizën e viti 1974 nuk vlejnë". Sipas JP. Betbeze, kjo vërtetohet më së miri nga fakti se "në 2 janar 2008, nafta kushtonte 100 USD/baril, gjë që u konsiderua si rekord historik; në 25 prill 2008, nafta arriti në 117.6 USD/baril; në ditët e para të majit iu afrua frikshëm çmimit prej 120 USD/baril"; ndërkokë që në fillim të qershorit 2008 tregjet u përballën me çmimin 140 USD/baril. Parashikimet janë akoma edhe më të zymta përfundin e vitit, ndërkokë që ekspertët e tregjeve të naftës dhe një studim i kompanisë gjigande SHELL flasin përfundim prej 200 USD/baril në muajt në vazhdim. Sipas tyre, këtë radhë "ne po përballojmë krizën më të madhe të fund shekullit të XX-të dhe fillimit të shekullit të XXI-të". Në këtë rast nuk bëhet fjalë për një skemë klasike të një krize amerikane, europiane, japoneze apo të një rajoni tjetër të botës, që mbasi është prodhuar vetë po vazhdon të ndotë rajonet e tjera të globit. Këtë herë "kemi të bëjmë me një skemë të panjohur deri tani, me një skemë që ndërlidh ngushtë kriza të veçanta e deri tani të vlerësuara si të shkëputura nga njëratjetra.

Duke ju referuar konkluzioneve të një grapi tjetër autorësh, "në SHBA ne kemi aktualisht krizën e një vendi "mbetur në borxhe të brendshme e të jashtme"; në Europë kemi të bëjmë me krizën e një rajoni, shtetet anëtarë të të cilit nuk po e zgjidhin dot qeverisjen politike të BE-së duke penguar kështu hartimin e një strategjive ekonomike efektive; në vendete quajtura emergjente, ne po asistojmë në shfaqjen e mjaft elementeve të një krize klasike të mbinxehjes ekonomike dhe ritmit të pakontrolluar të tritjes; ndërsa në vendet e varfra kemi një përkëqësim të vazhdueshëm të situatës ekonomike, politike e sociale duke u ndjerë të përjashtuar e mëdhenj të globalizimit". "Aq më tepër - insiston Betbeze, loja aktuale ndërmjet aktorëve të kësaj krize nuk është një lojë kooperuese, por individuale. Kështu, p.sh., rënia e dollarit nuk rregullon asgjë në Europë, e cila po shqetësohet përshtrenjtimin e eksporteve të saj; nga ana e tyre, kinezët refuzojnë me forcë e vendosmëri çdo kërkesë përfundim të rivlerësim të monedhës së tyre, duke mos iu krijuar mundësi vendeve perëndimore që të përmirësojnë kompetititetin e mallrave dhe

shërbimeve të tyre, etj.".

Në përfundim të këtyre analizave, mund të konkludohet me komentin e njërit nga ekonomistët më të shquar në historinë e krizave botërore, P. Bezbakh, i cili e konfirmon plotësisht këtë kompleksitet e ndërvavarje të interesave në botën e sotme. Sipas tij, "vendet në zhvillim ose të quajtura ndryshe "të jugut" nuk janë më në pozicionin e të dominuarve, ato janë tashmë të integrarë në konkurrencën botërore. Për sa i përket grupit të vendeve të Europës Qendrore e Lindore, edhe ato janë tashmë të konvertuara me rregullat e ekonomisë së tregut dhe tregut botëror. Pra, ne ndodhemi tashmë përparrë një shumëlojshmëri aktorësh, interesat e të cilëve janë shumë divergjente me njëri-tjetrin". Nga ana e tij, P. Artus (Natixis) e shikon thelbin e problemit tek "natyra e vetë kapitalizmit dhe stadi i zhvillimit aktual të tij". "Fuqitë perëndimore nuk kanë tashmë mundësi që t'ia pasojnë apo shkarkojnë të tjerëve koston e krizës së bënë në vitet 1929-1932 duke ulur çmimet e lëndëve të para". "Faji nuk është tek globalizimi por tek mënyrat dhe filozofia e menaxhimit të tij".

Aktualisht, kapitalizmi ka ardhur në një pikë kritike që kërkon zgjidhje radikale në mënyrat e kompozimit dhe menaxhimit të tij. Dhe brenda këtyre mënyrave, pyetjet që kërkojnë zgjidhje të reja janë: A duhet të vazhdojë të jetë modeli amerikan apo perëndimor i zhvillimit dhe konsumit i vetmi model dominues në shekullin e XXI-të? A mundet që vetëm një grup vendesh apo institucionesh ndërkombëtare të vendosin përfundim të zhvillimin ekonomik-social të botës? A kanë limit burimet natyrore të planetit dhe a duhet që zhvillimi i qëndrueshmët bëhet kryefjala e çdo modeli zhvillimi?. Kriza aktuale po i kërkon më shumë se kurrë përgjigjet e duhura.

Inflacioni kërcënçon ekominë evropiane

Megjithëse të gjithë diskutojnë shumë përfundim të problemet që duhet të kenë evropianët përfundim të tregut dëshmojnë se edhe ekonomia evropiane, ashtu si ajo amerikane, nuk po i shmanget dot efekteve të krizes së përgjithshme të çmimeve, inflacionit

dhe ngadalësimit të rritjes ekonomike. Në fund të vitit 2007, besohej se shkaku i lindjes dhe pasojat kryesore të krizës, e cilësuar fillimi si financiare, do të mbeteshin në ekonominë amerikane dhe SHBA. Shumë ekspertë të ekonomisë dhe financave, si dhe politikanë, vlerësonin se pasojat e kësaj krize do të ndiheshin shumë më pak në Evropë, e cila kishte një monedhë të fortë, një ekonomi të stabilizuar, një rritje ekonomike konstante, etj. Por, 2008-ta po dëshmon të kundërtën e këtyre parashikimeve. Globalizimi dhe ndërthurja e fortë e ekonomive nacionale me ekonominë globale nuk po kurjen askënd. "Gogoli" i radhës për ekonominë evropiane quhet inflacion.

Në fund të muajit maj 2008, sipas eurostat-it, inflacioni mesatar vjetor arriti në shifrat prej 3.6%, një rekord ky i pa-verifikuar që nga viti 1999, që korrespondon edhe më lindjen e zonës së euros. Shkaku kryesor i rritjes së çmimeve në Evropë, sipas ekspertëve është para së gjithash rritja e çmimit të ushqimeve dhe naftës, e cila javën e fundit u shit me 135 USD/fuçi. Çmimet me pakicë të naftës, gazit, benzinës, transportit urban, etj., vetëm 2-3 muajt e fundit janë rritur me 5-8 % në muaj. Në shumë vende evropiane inflacioni po i kalon gjithashtu rekordet historike. Në Belgjikë është tashmë në shifrat 5.1%, më i larti i 23 viteve të fundit; në Spanjë 4.7%, më i larti që prej vitit 1997; 5.1% në Gjermani; mbi 6% në Rumani, Bullgari, Hungari, vendet baltike, etj. Edhe në Itali inflacioni e ka kaluar tashmë nivelin e 3.6%, nivel ky i pa provuar që nga viti 1996. Walter Veltroni, aktualisht kryetari i opozitës italiane, shprehet se "të dhënët e fundit për inflacionin shënojnë një alarm maksimal. Këtë nivel Italia nuk e njeh që prej 12 vitesh. Të ardhurat, troqat apo pensionet, po e humbin përditë e më tepër fuqinë e tyre blerëse". Në të njëjtën linjë janë dhe grekët, francezët, portugezët e polakët. Greqat e shpeshta të shoferëve, peshkatare, fermerëve, punonjësve të shumë degëve të industrisë e shërbimeve apo kategorive të ndryshme sociale dëshmojnë për një situatë ekonomike problematike.

Kjo rritje e re çmimesh, deri diku e parashikuar nga ekonomistët, është ndjeshëm më e lartë se limiti i toleruar i Bankës Qendrore Evropiane, objektivi afat-mesëm i së cilës është mbajtja e një inflacioni më të ulët se 2 % në zonën euro. Çfarë pritet nga BQE në këto

momente? A mundet që, nëpërmjet politikës së saj monetare, BQE të veprojë menjëherë dhe të ndikojë në zbutjen e këtij fenomeni? Vendimet e BQE janë më shumë se kurrë në vëmendjen e të gjithëve. Debatet mbi lidhjet ndërmjet normës së inflacionit dhe rritjes ekonomike, apo frika nga rënia në rrethin vicioz "paga-çmim-inflacion" po zënë vend gjithnjë e më shumë ne analizat dhe debatet e çdo nivelit të politikës, akademikëve dhe institucioneve evropiane. Edhe vetë Presidenti i BQE, Jean-Claude Trichet, në një intervistë përgazetën gjermane Bild, shprehet i shqetësuar për tendencën e inflacionit në zonën euro duke nënizuar se "unë e kam thënë shpesh, në emër të BQE, se duhet të kemi shumë kujdes që efektet goditëse të çmimit të naftës dhe ushqimeve të mos na tërheqin drejt një shtrenjtimi të mallrave të tjera dhe rritje pagash". Trichet vlerëson se "euro nuk është përgjegjëse për çmimet e larta" dhe njëkohësisht paralajmëron se "kriza financiare ndërkombëtare është larg zbutjes apo përfundimit të saj".

Por, sipas mendimit të Holger Schmieding, përgjegjës për ekonominë evropiane në "Bank of America", "BQE mund ta ruajë status quo-në e normës së saj bazë të interesit deri në fillim të vitit të ardhshëm, por ajo pritet të ashpersojë tonin dhe qëndrimin e saj ndaj politikave e masave që nxisin inflacionin". Këtë qëndrim e konfirmon dhe Axel Weber, anëtar i Këshillit të Guvernatorëve të BQE, që deklaron "se nuk ka mundësi që të ulet norma bazë e interesit në zonën euro gjatë gjithë vitit 2008..., ndërkohë që opsioni i një rritjeje të mëtejshme të saj është gjithnjë mbi tavolinë". Ky qëndrim kristalizohet dhe nga komenti i Howard Archer, ekonomist tek "Global Insight", i cili nënizon se "është shumë e mundur që BQE të mos e ulë normën bazë të interesit para vitit 2009, sepse ajo do të ketë prova të forta dhe dëshiron të sigurohet qartë, se një rritje ekonomike në rënje, mund të shërohet me një tolerim të nivelit të inflacionit".

Ajo që aktualisht kërkohet e sugjerohet nga shumë kryetarë shtetesh e qeverish, por dhe nga mjafteconomistë evropianë në këtë momente, është ndërhyrja me politika aktive e inteligjente, për të kontrolluar e mos lejuar spekulimet me çmimet e naftës, si dhe minimizuar ato që quhen "efekte të raundit të dyte", d.m.th., transmetimi i çmimeve të larta të naftës e ushqimeve në koston dhe çmimet e produkteve të tjera apo

shërbimeve që përdorin si lëndë të para bazë. I pari që propozoi një masë të konsideruar deri tani si tabu nga vendet e UE, ishte Presidenti i Francës, Sarkozy, i cili kërkoi që vendet evropiane “duhet të kufizionin dhe të vendosnin një kufi të pakapercyeshëm për TVSH e karburanteve”, në mënyrë që të mbahej i kontrolluar çmimi i tyre dhe të stopoheshin efektet e raundit të dytë. Këtij qëndrimi iu bashkëngjit menjëherë dhe Presidenti i Eurogrup-it dhe Kryeministër i Luksemburgut, Jean-Claude Juncker, sipas së cilit “ky propozim meriton një reflektim të thelle”. Nga ana e tij, edhe Andrej Vizjak, ministri sloven i ekonomisë, vend që ka aktualisht presidencën europiane, vlerësonë para dy ditësh se “çështja e rritjes së çmimit të naftës ishte problemi më serioz për ekonominë evropiane, dhe kërkonte një reaksion dhe angazhim serioz nga të gjithë shtetet dhe instancat evropiane”.

Megjithë disa shenja pozitive të dhëna nga treguesit e rritjes ekonomike në Gjermani, vendi që cilësohet si “lokomotiva e Europës”, përsëri ekspertët vlerësojnë se ekonomia europiane po fillon t'i ndjejë me efekt të plotë efektet e krizës globale ekonomiko-financiare. Dobësia e ekonomisë amerikane dhe euro e fortë po fillojnë të prekin elementët kryesorë që kushtëzojnë tritjen ekonomike në Europë. Treguesi më sinjifikativ i kësaj është “ulja e investimeve dhe eksporteve evropiane, kryesisht atyre teknologjike dhe makinave drejt Europës Qendrore e Lindore, Kinës dhe vendeve të Azisë në përgjithësi”. Nga janari deri në maj 2008, eksportet kryesore evropiane kanë ecur me një ritëm më të ngadalë se importet, duke cenuar kështu bilancin tregtar dhe të pagesave në shumë vende europiane. Shumë ekonomi të zonës euro po japid shenjat e para të një situate, që ekspertët e konsiderojnë “serioze”.

Analizat dhe anketat mbi ecurinë e aktivitetit ekonomik dhe shërbimeve, ose të quajturat ndryshe “barometri i shëndetit të ekonomisë dhe biznesit europian” po evidentojnë shifra në nivele nga më të ulëtat e 6-7 viteve të fundit. Indeksi i besimit të biznesit për shënderin e ekonomisë europiane është më i ulëti i këtyre 3 viteve të fundit. Sipas gazetës franceze “Le monde”, “në Spanjë, rënia e vlerës së pasurive imobiliare po kthehet në një katastrofë, në Irlandë kjo është shumë serioze, në Francë akoma më shqetësuese”. Në vija më të përgjithshme, pesë muajt e parë të 2008 po

evidentojnë një rënje të rritjes ekonomike mjaft të dukshme në Spanjë, Irlandë, Holandë, Letoni, Lituani e Estoni; një stanacion ekonomik në Hungari, Itali, Slloveni, Danimarkë, Portugali dhe vendet baltike, si dhe një krizë të fortë imobiliare në Spanjë, Angli, etj.

Europa po e ndjen se kriza e çmimeve dhe inflacionit i ka trokitur fuqishëm në derë. Politikat dhe masat për ta përballuar atë në nivel europian janë në kulmin e tyre. Por, edhe për vendet e tjera në proces integrimi europian e partnere ekonomike me Europën, siç është edhe Shqipëria, kjo situatë nuk duhet të konsiderohet “thjesht si europiane”. Fakti që mbi 80% të shkëmbimeve tregtare i kemi me BE-në, që pjesa dërrmuuese e rreth 1 miliard euro remitancave që përbëjnë një shtysë të fuqishme për ekonominë dhe konsumin tonë, si dhe mjaft lidhje të tjera direkte e indirekte ekonomiko-financiare, duhet të na bëjë më të vëmendshëm ndaj këtyre zhvillimeve.

► OECD-ja e moderon pesimizmin: kriza drejt fundit?

Pas shumë lajmeve dhe komenteve pesimiste mbi krizën financiare globale, mbi pasojat dhe efektet negative të saj në ekonomitë dhe tregjet financiare kryesore të botës, më në fund një sinjal shprese. Në raportin e saj të fundit (qershor 2008) të titulluar “Perspektivat ekonomike-pas furtunës”, OECD-ja, organizata që grupon 32 vendet më të zhvilluara e të industrializuara të botës, jep një lajm të shumëpritur sipas së cilit “situata ekonomiko-financiare e vendeve anëtare të saj është më pak pesimiste se ajo e 2-3 muajve më parë”. Ekzistojnë mjaft elemente për të filluar të mendohet se “kriza e lindur në verën e vitit 2007 në SHBA, si pasojë e fundosjes së sektorit imobiliar dhe kredive të këqija hipotekore me risk të lartë, të famshmet subprimes”, dhe e përhapur pastaj në Europë dhe vende të tjera të botës”, ka filluar të zbutet. Sipas drejtorit të çështjeve ekonomike të OCDESë, Jorgen Elmeskov, “aktualisht ka shumë shanse që mjaft nga simptomat negativë të çorientimit të tregjeve të vlerësohen si të tejkluara”. Edhe vetë fraza e parë e raportit të OECD-së e konfirmon këtë situatë optimiste kur konfirmon se “gjithnjë e më tepër po duket se turbulanca e tregjeve financiare ka filluar të qetësohet”, megjithëse

një pjesë e faktorëve të rrezikut vazhdojnë të janë prezentë në ekonominë botërore. Në mënyrë të veçantë çmimi i produkteve ushqimore, naftës dhe energjisë në tërësi. Presidenti i Bankës Qendrore Europiane, Jean-Claude Trichet u shpreh "se kjo krizë është globale, dhe të tilla duhet të janë edhe masat për ta përballuar atë".

Për ekonomitë kryesore të botës, treguesit ekonomikë të tremujorit të parë nuk janë aq të zyrtë sa priteshin. SHBA, jo vetëm që nuk hyri në recessjon ashtu siç parashikohej nga shumë ekspertë, por arriti madje që të reduktonte edhe deficitin e bilancit të pagesave. Shifra më inkurajuese është ajo e sektorit privat amerikan, që vetëm gjatë muajit maj 2008 krijoj 40 mijë vende të reja pune. Ekonomia gjermane po jep shenja të mira të përballimit të krizës, ndërkohë që ekonomia franceze po tregon një rezistencë të admirueshme muajt e fundit, çka dëshmon për një qëndrueshmëri strukturore të saj ndaj situatave të krizës. Megjithatë, OECD-ja tregohet e matur në optimizmin e saj kur vlerëson se "viti 2008 pritet të jetë gjithsesi një vit mediokër" për sa i përket rritjes ekonomike. Duke parashikuar një nivel rritjeje ekonomike prej 0.5% për tremujorin e dytë, OECD-ja nënvízon se në vendet anëtare të saj, rritja ekonomike për 2008 nuk pritet të kalojë nivelin e vjetor prej 1.8%.

SHBA do vazhdojnë të janë edhe për një kohë relativisht të gjatë të shokuara nga tronditja e sektorit finanziar dhe dollarit, megjithë shenjat pozitive që po jep normalizimi i kushteve të kreditit dhe politika monetare zbutëse; në përgjithësi vendet e BE-së do vazhdojnë të ndjejnë efektin e politikës rigorozë me kreditin, reduktimin e disa tregjeve të rëndësishme eksportesh dhe presioneve inflacioniste aktuale; Britania e Madhe vazhdon të ndjejë kundërgoditjet e vështirësive të saj financiare; Islanda ndodhet nën presionin e një krize këmbimi; Spanja dhe Irlanda po përballojnë një shfryrje brutale të flluskës së tyre imobiliare; Kanadaja dhe Meksika po ndjejnë "ftohtësinë e thikës financiare amerikane"; Italia "vegjeton" në një rritje ekonomike afér zeros; Greqia po reflekton një deficit buxhetor dhe nivel inflacioni mbi mesataren europiane të zonës euro çka po ndikon negativisht në aftësinë konkurruese të mallrave dhe shërbimeve greke; Turqia gjithashtu po evidenton shenja të një ngadalësimi të ritmit të rritjes ekonomike dhe mos konsistencë në reformat strukturore; Japonia duket më pak

e prekur nga kriza aktuale, por megjithatë ekonomia e saj duket se po vuan uljen e ritmit të eksporteve, hezitimini e shumë bizneseve vendase për të investuar, dhe uljen e fuqisë blerëse të familjeve japoneze; bile edhe vende si Kina dhe India, që mendohej se do ta ruani dinamikën e rritjes ekonomike, po shfaqin shenja ngadalësimi dhe po i modifikojnë objektivat e tyre të rritjes për këtë vit. Makineria ekonomike e këtyre 32 vendave pritet të fillojë një ngritje të lehtë vetëm në vitin 2009.

Raporti i OECD-së e shpjegon qartë se, pamundësia e daljes më shpejtë se viti 2009 nga kriza, është i lidhur me faktin se "ekonomitë e OECD-së gjenden aktualisht të konfrontuara me tre probleme negative, të cilat si efekt kryesor kanë reduktimin e kërkesës: krizën financiare, ngadalësimin e ciklit të pasurive të patundshme dhe tkurrjen e të ardhurave reale si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë dhe produkteve agro-ushqimore".

Më pak alarmiste se FMN-ja, OECD vlerëson se humbjet financiare së bashku me zhvlefësimin e aktiveve bankare mund të arrijnë një nivel prej 380 miliard dollarësh (246 miliard euro) dhe jo rrëth 950 miliard siç kanë qenë parashikimet e FMN-së dhe mjafit institucioneve të tjera ndërkombëtare për këtë çështje. Ndërsa përsa i përket çmimeve në tregun amerikan të banesave, OECD parashikon se ai do të vazhdojë akoma të ulet me rrëth 8% gjatë vitit 2008.

Shqetësimi kryesor i OECD-së në këtë fazë është i përqendruar tek inflacioni dhe masat e mundshme që mund të merren për zbutjen e efekteve të tij nga qeveri e vende të ndryshme. Si pasojë e fenomenit të globalizimit dhe tregjeve botërore, politikave ekonomike e financiare të ndërmarrë nga vendet jashtë OECD-së, presionet inflacioniste po shfaqin një tendencë rritjeje në pothuajse gjithë vendet e OECD-së. Rritja e pandalshme dhe shumë e shpeshtë e çmimit të naftës që tashmë ka arritur dhe nivelin e paimagjinuar disa muaj më parë, atë të 130 USD/baril, rritja e çmimit të arit dhe metaleve të tjera të çmuara, rritja e çmimit të drithërave, misrit dhe orizit, etj.; kanë bërë që rritja e përgjithshme e çmimeve në zonën OECD, për vitin 2008 të parashikohet në shifrat 3% ndërkohë që në 2007 kjo ishte vetëm 2.2%.

Sipas Jean-Luc Schneider të Drejtorisë të Çështjeve Ekonomike të OECD-së, "trajektorja e inflacionit që ne kemi llogaritur tregon për një

rritje të moderuar të tij, çka do të thotë se në mungesë të inflacionit të importuar, ne mund të shpresojmë edhe në një ulje relative të tij". Por, ajo që na shqetëson është fakti se "në qoftë se për momentin në vendet tona konstatohet një rritje pagash në përgjigje të përballimit të efekteve të inflacionit, kjo mund të na i komprometojë përpjekjet për tu rikthyer në një nivel inflacioni prej 2.1% për vitin 2009". OECD-ja i bën thirrje autoriteteve publike në vendet anëtare të saj "që t'i rezistojnë sa më shumë që të jetë e mundur kërkesave për masa kompensuese direkte ndaj efekteve të rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve". Ajo rekomandon që këto masa të jenë të kujdeshshme e të diferencuara kryesisht në funksion të grupeve sociale, degëve të ekonomisë apo territoreve më të prekura nga kjo rritje çmimesh dhe jo një reagim në bllok e në mënyrë lineare. Jorgen Elmeskov përkëtë çështje thekson se "është më mirë t'i përgjigjemi direkt vetëm personave me të ardhura të pakta që ju cenohet niveli i jetesës duke aplikuar instrumentet e transfertave fiskale dhe sociale".

Por, në raportin e saj të fundit, OECD nën vizon në mënyrë shumë të dukshme faktin se "në qoftë se efektet e krizës aktuale, apo kësaj furtune të paparashikuar, nuk rezultojnë aq të rënda sa mendoheshin, kjo ka ndodhur falë reformave të vazhdueshme strukturore që vendet anëtare kanë ndërmarrë vazhdimisht e me konsistencë si dhe falë politikave makroekonomike perfekte. Ekonomia botërore është në ndryshim të vazhdueshëm dhe dalja në skenë e vendeve me zhvillim të shpejtë, apo siç quhen ndryshe "ekonomitë emergjente" po i ndryshon rregullat e lojës. Kjo kërkon para së gjithash reforma të vazhdueshme strukturore sa më efektive. Rekomandimi dhe këshilla kryesore është "vazhdimi në këtë rrugë" edhe për të ardhmen. Ky rekomandim jepet dhe për ekonomitë e shumë vendeve në zhvillim. ●

Pas stuhisë¹

Për shumicën e ekonomive të OCDE priten tremujorë me rritje të dobët ekonomike. Në të njëjtën kohë, inflacioni global ka mundësi të qëndrojë i fortë për një farë kohe. Ky skenar është rezultat i përbashkët i stuhisë që përfshiu

tregjet e kapitaleve, të ndrydhjes së tregjeve të strehimit dhe të rritjes së fortë të çmimeve të lëndëve të para. Projekcionet që do të gjemë në këtë shkrim lidhur me Perspektivat ekonomike të OCDE janë mbartëse si të mrezqeve në ngritje, ashtu edhe të atyre në rënje dhe karakterizohen nga këto prirje :

Veprimtaria në SH. B. A do të pësojë një stanacion që do të zgjasë gjatë gjithë vitit 2008, dhe do të ringrihet kur të përfundojë rregullimi në sektorin e strehimit, normalizimi i kushteve të kreditit dhe efektet e elasticitetit monetar të mëparshëm. Në këtë kontekst ku ka një nënprerdorim të theksuar të kapaciteteve dhe duke supozuar se çmimi i lëndëve të para është i pandryshueshëm, inflacioni do të dobësohet ndjeshëm. Rritja e fortë e eksporteve e favorizuar nga dobësimi i dollarit, do të ndihmojë në sjelljen e deficitit të jashtëm në rreth 4.5 të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) për vitin e ardhshëm.

Veprimtaria në zonën Euro do të frenohet gjatë gjithë vitit nga shtrëngimi i kushteve të kreditit, ndrydhja e të ardhurave reale, pikasjes së rritjes së tregjeve të eksportit dhe të humbjeve të pjesëve të tregut. Rritja do ta marrë veten në mënyrë progresive, pas largimit të këtyre faktorëve, edhe pse dobësimi i investimit për banesa do të rëndoje negativisht mbi veprimtarinë për gjatë gjithë vitit. Me gjithë vlerësimin e kursit të këmbimit, tensionet inflacioniste do të jenë të fortë, dhe me një përdorim kapacitetesh që pritet të vendoset pak më poshtë se niveli normal, duhet pritur fundi i periudhës së projektimit, që inflacioni të arrinë në 2 %.

Japonia është më pak e prekur drejt përdrejt nga stuhia financiare, por zhvillimi i saj është frenuar për momentin, nga ngadalësimi i rritjes së eksporteve, nivelit të ulët të të ardhurave për çift si edhe të një lloj mëdyshjeje të ndërmarrjeve për të investuar. Ndërsa rritja do të gjejë përsëri dinamizmin e saj, inflacioni do të përshtojhet progresivisht për të arritur një nivel prej rreth 0.5 %.

Situata ekonomike aktuale është veçanërisht e paqëndrueshme dhe këto parashikime përbajnjë një shkallë të madhe rishku. Në këtë kushte, politika ekonomike e vendeve të OCDE duhet të mbajë parasysh rëndësinë në rritje të ekonomive jashtë OCDE, shtrenjtësimin e energjisë dhe të kredisë mbi ofertën në ekonomitë e OCDE, mundësinë e një përplasjeje të parashikimeve të inflacionit dhe të pasigurive që lidhen me efektet e evolucionit të tregjeve të kapitaleve mbi rritjen e inflacionit.

¹ Marrë nga: OCDE, qershor 2008, "Perspektivat ekonomike pas furtunës".

Deri këtu, mondializimi ka qenë një motor i rëndësishëm i ciklit të veprimitarës ekonomike, duke qenë se ekonomitë jo anëtare të OCDE eksportojnë në të njëjtën kohë produktet e tyre manifakturorë me çmim të lirë dhe tepricat mbi kursimin, kjo kontribuoi në mbajtjen e interesave në nivel të ulët, duke stimuluar kërkesën dhe çmimet e aktivëve. Aktualisht, rritja e fortë e vëzguar jashtë zonës së OCDE, shpjegon në një masë të madhe shtrenjtësinë e lëndëve të para.

Në vendet e OCDE, politika makroekonomike dhe më veçanërisht politika monetare, duhet të marrin parasysh faktin se vendet jo anëtare do të janë një burim i rëndësishëm i kërkesës, duke mos qenë dhe aq burimi i deflacionit, sa në të shkuarën.

Politika makro-ekonomike, ndër të tjera, po përballet me një vlerësim më të vagullt se më parë të kapaciteteve të ofertës të ekonomive të OCDE. Mondializimi, ashtu edhe reformat strukturore, kanë favorizuar në të kaluarën një rritje të përqindjeve të rritjes potenciale dhe shpresojmë se do të vazhdojnë në këtë drejtim. Por rritja e fortë e çmimeve të energjisë dhe e çmimit të kapitaleve si pasojë e asaj çka ka ndodhur me tregjet e kapitaleve, mund ta pengojnë këtë rritje potenciale. Kapitulli Perspektivat ekonomike kushtuar pasigurive që rrethojnë ofertën, përmban disa llogaritje që illostrojnë këtë efekt. Por edhe nëse llogaritje të tillë së brendshmi përbajnjë shumë pasiguri, politika makroekonomike duhet të jetë e vetëdijshme se shtrëngesat e kapaciteteve mund të jenë më të forta se sa mendohet.

Shenjat që priren të tregojnë se inflacioni i parakohshëm mund të ketë tendencë të rritet, bëjnë gjithash tu rrirje përmes kujdes të madh. Një kontroll i mirë i këtyre para-kohshmërive të inflacionit, përbën një përparrësi të madhe përmes veprimin e pushtetit publik, të arritur në shumicën e rasteve me çmimin e një procesi të dhimbshëm deflacioni gjatë dekadave të mëparshme. Besimi në stabilitetin e çmimeve mund të përforcohet duke përdorur mekanizma të ndryshëm institucionalë së bashku me një komunikim të mirë, por mjeti më i mirë përmes konsoliduar këtë besim, është sigurimi konkret i këtij stabiliteti.

Ndikimi i tregjeve të kapitaleve mbi rritjen, mbetet i vështirë përmes t'u vlerësuar. Aktualisht, ka të ngjarë që paroksizmi i çregullimeve të tregut, të jetë tejkaluar, por amë nuk mund të merret si përfundim i arritur. Edhe sikur të ishte ky rast, efektet e kësaj faze mbi rritjen, mund të zgjasin. Pasiguria përforcohet më tepër nga efekti i mundshëm i përkqësimit të kushteve të rritjes mbi tregjet e kapitaleve, dhe nga fakti që problemet mund të zgjidhen në mënyrë të ndryshme

nga institucionet financiare. Në lidhje me këtë, do të ishte e para-pëlgjeshme që t'i jepej fund mungesës së fondeve me anë të futjes së parasë së freskët dhe të likuidimit të aktivëve, se sa me një kompresion krediti. Edhe pse nuk përjashtohet një normalizim më i ngadalë se ç'parashikohet i tregjeve të kapitaleve, po ashtu nuk mund të përjashtohet një ringritje më e shpejtë, sidomos nëse një përmirësim i besimit do të krijonte një ndërveprim pozitiv midis çmimeve të aktivëve financiarë dhe bilanceve të institucioneve financiarë. Bankat qendrore duhet të përgatiten për të dyja këto gjasa.

Përveç trajtimit të efekteve të krisës aktuale së tregjeve të kapitaleve mbi kërkesën, do të ishte me vend të rishqyrtohej regjimi i kontrollit të kujdeshëm mbi këto tregje. Forumi i stabilitetit financiar ka përcaktuar kohët e fundit akset e ndryshimit në këto fusha dhe progreset në zbatimin e tyre, janë në rrugë e sipër. Zbatimi i reformave të nevojshme, do të jetë i rëndësishëm, madje edhe kur të jetë larguar kujtimi i stuhisë së tanishme dhe ata që do të pësojnë ashpërsimin e rregullave ka të ngjarë të rezistojnë më shumë. Duke qenë kështu, duhet shmangur të shkuarit më larg në këtë ashpërsim. Shumë inovacione të kohëve të fundit mbi tregjet e kapitaleve mund të përmirësojnë suksesin nëse shfrytëzojen si duhet.

Duhet shtruar edhe pyetja nëse është e nevojshme t'i përgjigjesh prirjes së tregjeve të kapitaleve përmes prodhuar cikle dhe në cilën mënyrë. Kjo mund të kryhet me anë të iniciativave rregulluese që kanë përgjithësisht karakterit ciklik, ashtu edhe nëpërmjet rishqyrtimit të drejimit të politikës monetare. Furnizimi dinamik dhe rezervat e detyrueshme bëjnë pjesë ndër instrumentet që mund të ndihmojnë në zhdukjen e ciklevës të kredisë dhe në rritjen e aftësisë përmes rezistuarit të sektorit financiar, por nuk janë patlashe. Përmes përkohshëm, përforcimi i simetrijeve rreaguese lart dhe poshtë ciklevës të kreditit, mund të jetë i dobishëm.

Përmes përkohshëm, përfundim i taksash që duket i goditur dhe i vënë në përdorim në momentin e duhur dhe si të tillë, kanë të gjithë mundësitet të sigurojnë mbështetjen e nevojshme përmes aktivitetit. Gëshja e stimulimit buxhetor është trajtuar gjithash tu rrirje së përfundim të tregjeve të kapitaleve mbi rritjen, më tepër nga efekti i mundshëm i përkqësimit të kushteve të rritjes mbi tregjet e kapitaleve, dhe nga fakti që problemet mund të zgjidhen në mënyrë të ndryshme

të drejtë, stabilizuesit automatikë atje janë më të fortë se në SH.B.A. Në Japoni, situata buxhetore nuk lejon asnjë masë buxhetore ekspansioniste dhe ekonomia është më pak e prekur nga stuhia financiare se në vende të tjera të OCDE.

Shtrenjtësimi shumë i ndjeshëm i ushqimeve dhe energjisë nxit marrjen e masave kompensuese nga autoritetet publike. U duhet rezistuar këtyre nxitjeve. Vetëm duke u lejuar sinjaleve të mbarë të çmimeve të ndikojnë mbi ofertën dhe kërkesën, mund të arrihet në një ekuilibër më të mirë në këto tregje. E mira është t'u përgjigjesh shqetësimeve

në lidhje me nivelin e jetesës së njerëzve me të ardhura të ulëta, me anë të një sistemi të menduar mirë të transfertave fiskale dhe sociale.

Në tërësi, ekonomitë e OCDE kanë pësuar shumë goditje kohët e fundit, dhe do t'u duhet kohë dhe politika të zgjaura për të marrë veten. Megjithatë, nëse pasojat e kësaj stuhie pothuaj të përkryer nuk kanë qenë më të rënda, kjo ndodhi falë reformave strukturore të mëparshme dhe kuadrove të politikës makroekonomike plotësisht të përvetësuar. Kjo nënvisoron domosdoshmërinë e vazhdimit në këtë rrugë. ●


Përktheu Blerta HYSKA

RRITJA E ÇMIMIT TE USHQIMEVE, ZGJIDHJET POLITIKE DHE PERGJIGJJA E BANKES BOTERORE *

* www.worldbank.org/news

Rritja e çmimit të ushqimeve: prirje dhe përcaktues

Prirja drejt rritjes e çmimeve ndërkombejtare të ushqimeve vazhdoi, madje dhe u përshtypet, në vitin 2008. Çmimi i eksportit të grurit në SHBA u rrit nga 375 USD/ton në janar, në 440 USD/ton në Mars, dhe çmimi i eksportit të orizit tajlandez u rrit nga 365 USD/ton në 562 USD/ton. Kjo shifër qëndron mbi rritjen prej 181% të çmimit global të grurit në 36 muajt e fundit deri në shkurt 2008 dhe një rritje prej 83% në totalin e çmimit të ushqimeve në të gjithë globin gjatë të njëjtës periudhë. (shih figurën 1)



Rritja e prodhimit të lëndëve djegëse bio ka ndikuar në rritjen e çmimeve të ushqimeve. Çështjet që kanë të bëjë me çmimet e vajrave, sigurimit me energji dhe ndryshimet klimatike kanë nxitur qeveritë të marrin një qëndrim më proaktiv për nxitjen e prodhimit dhe përdorimin të lëndëve djegëse bio!. Kjo ka çuar në rritjen e kërkesës për lëndë të para djegëse bio, si gruri,

misri, soja, dhe vaji i palmave dhe rritje të konkurrencës për tokë për t'u mbjellë. Pothuaj e gjithë rritja e prodhimit global të misrit nga 2004 në 2007, (periudhë kur çmimi i drithit u rrit dukshëm) shkoi për prodhimin e lëndëve djegëse bio në SH. B. A, ndërsa stoqet ekzistuese u harxhuan nga një rritje e konsumit global për përdorime të tjera². Zhvillime të tjera, si p.sh. thatësira në Australi dhe prodhime të varfra në BE dhe Ukrainë në vitin 2006 dhe 2007, u kompensuan nga një prodhim i mbarë dhe rritje eksportesh në vende të tjera dhe që përndryshe nuk do kishte pasur një ndikim domethënës në çmime. Vetëm një pjesë relativisht e vogël e rritjes së çmimeve të ushqimeve (rreth 15%) i detyrohet kostos më të lartë të energjisë dhe të fertilitzimit³.

Rritja e çmimeve të ushqimeve nuk është një dukuri e përkohshme, por ka të ngjarë të vazhdojë në një periudhë afat mesme. Çmimet e produkteve bujqësorë priten të qëndrojnë të larta në vitet 2008 dhe 2009 dhe prej këtij momenti do të fillojnë të ulen, meqë kërkesë-oferta do t'i përgjigjen çmimeve të larta. Megjithatë, ato ka të ngjarë të qëndrojnë sipër niveleve të 2004 deri në vitin 2015 për shumicën e produkteve. Parashikimet e organizatave të tjera të rëndësishme si FAO, OECD dhe USDA që monitorojnë rregullisht dhe projektojnë çmimet e produkteve ushqimore bazë, bien në një mendje për sa i përket këtyre konstatimeve. Parashikimet e çmimeve të larta në afat mesëm përforcohen edhe më shumë kur përfshijnë edhe ndikimin e politikave për arritjen e sigurisë së energjisë dhe pakësimin e emetimeve të dyoksidit të karbonit, gjë që mund të paraqesë një baraspeshim të fortë me qëllimet e sigurisë së ushqimit.

1 Shumë vende kanë vendosur standarde ose targete për përdorimin e lëndëve djegëse. BE ka vendosur një standard prej 5,75% përdorimit të lëndëve djegëse të motorit të jetë bio duke nisur nga viti 2010. SHBA kanë vendosur përdorimin e 28.4 litra lëndësh djegëse bio për transport duke nisur nga viti 2012. Brazil do të kërkojë që të gjithë vajrat diesel të përbahjnë 2 % bio-diesel në vitin 2008 dhe 5% duke nisur nga vitit 2013. Tailanda do të kërkojë 10% etanol në të gjithë gazolet duke filluar nga viti 2007. India vendosi 5% nivel etanolit në nëntë shtete kurse Kina një 10% etanol në pesë provinca.

2 Nga 2004-2006 prodhimi i përgjithshëm i misrit u rrit me 51 milion, lëndët djegëse bio në SHBA u rritën me 50 milionë tonë dhe konsumi global për të gjithë përdorimet u rrit me 33 milionë tonë, gjë që shkaktoi një rënje të stoqeve me 30 milionë tonë. (Mitchell)

3 Mitchell (2008) (Një-artikull për rritjen e çmimeve).

► Impakti në vendet dhe në ekonomitë familjare

Rritja e çmimit global të ushqimeve po shkakton një inflacion të madh ushqimesh në shumë vende. Pasojë e rritjes së çmimeve të ushqimeve nuk përkthehet menjëherë në rritje të menjëherëshme dhe proporcionale të nivelit të çmimeve të brendshme, si pasojë e faktorëve të tillë si dobësimi i dollarit, infrastruktura e brendshme dhe politikat e stabilitetit të çmimeve. Ndërsa shtrirja e transmetimit të çmimeve të ushqimeve varion, gjatë tre viteve të fundit ka pasur rritje të rëndësishme të inflacionit të brendshëm rëtë çmimit të ushqimeve në vende si Sri Lanka (34%), Kosta Rika (21%) dhe Egjipt (13.5%). Në shumë vende dhe rajone inflacioni i çmimit të ushqimeve është më i lartë se inflacioni agregat dhe ndihmon këshru në imposhtjen e presioneve inflacioniste. Për shembull, në Europë dhe në Azinë Qendrore, inflacioni i përgjithshëm në vitin 2007 ishte mesatarisht 10%, inflacioni i ushqimeve ishte 15% dhe ai i bukës dhe drithërave ishte 23%⁴. Kjo krahasuar me inflacionin e përgjithshëm prej 6% dhe inflacionin e ushqimeve prej 6.4% në vitin 2006.

Pasojat mbi kushtet e biznesit të çmimeve të larta përgjithësisht zbuten nga rritja e çmimeve e mallrave shtëpiakë jo ushqimorë, edhe pse këto mesatare mbulojnë në mënyrë domethënëse impaktin e balancës së pagesave për disa vende. Kur merren parasysh të gjitha ndryshimet në çmimet e mallrave shtëpiakë, efektet mbi kushtet e biznesit janë më të mëdha dhe pozitive për vendet e pasura me burime, si ekporti i vajit dhe produkte të tjera, më tepër se si kompensim për çmimet e larta të ushqimeve. Vendet ku impakti në kushtet e tregut është më negativi janë Lesoto, Eritrea dhe Gambia.

Impakti i shpërndarjes të rritjes së çmimeve të ushqimeve mund të jetë serioz edhe në vende ku balanca e pagesave nuk është prekur ndjeshëm. Ndërsa disa familje përfitojnë nga çmimi më të larta, të tjerë dëmtohen nga ato, në varësi të faktit nëse ata janë prodhues ose konsumatorë të shportës së ushqimeve bazë dhe nga shkalla me të cilën pagat përshtaten me rritjen e inflacionit

⁴ Alam Kathuria and Vybornia (2008) Rising Food Grains and energy prices in ECA: some economic and Poverty Implications and Policy Responses.

të çmimit të ushqimeve. Në përgjithësi, njerëz të varfér, sidomos në zonat urbane, vuajnë nga rritja e çmimeve. Një studim⁵ i kohëve të fundit bazuar në të dhëna mbi familjet, në tetë vende me të ardhura të ulëta, analizon efektin e çmimeve të larta të ushqimeve bazë mbi varférinë, duke marrë parasysh impaktin e drejtëpërdrejtë të ndryshimit të çmimeve të ushqimeve bazë dhe impaktin e ndryshimeve në nivelin e pagave për punën e pakualifikuar. Rezultatet treguan se në gjashtë nga tetë vendet e studiuar, çmimet për shportën e ushqimeve shoqërohen me një rritje të ndjeshme të varférise. Duke marrë mesataren e këtyre vendeve, rritja në çmimit e ushqimeve në vitet 2005-2007 vlerësohet të ketë shkaktuar një rritje me 3% të varférise. Një vlerësim i kohëve të fundit në Indonezi tregon se më tepër se $\frac{1}{4}$ e të varférve janë blerës orizi dhe një rritje prej 10% në çmimin relativ të ushqimit do të shkaktojë edhe dy milionë më shumë njerëz të varfér (ose 1% të popullsisë). Analizat që përdorin një indeks çmimi alternativ, duke iu referuar tipit të konsumatorit të varfér në Amerikën Latine, sugjerojnë se në shumë vende të zonës, niveli real i inflacionit i ndeshur nga të varfrit është më i lartë se niveli zyrtar prej 3%⁶.

Për shumë vende dhe zona ku ka pasur një progres të ngadalte në uljen e varférise, impakti negativ mbi varférinë që ka rritja e çmimeve trezikon të minojë atë çka është fituar mbi varférinë gjatë 5 - 10 viteve të fundit, të paktën në afat shkurtër. Për shembull, në rastin e Jemenit, vlerësimet tregojnë se dyfishimi i çmimit të grurit gjatë vitit të kaluar mund të përbysë të gjithë arritet në uljen e varférise gjatë viteve 1998 - 2005. Në afat gjatë, impakti mbi varférinë i çmimeve të larta të ushqimeve dhe të produkteve të tjera shtëpiakë është më pak i qartë dhe varet nga mënyra se si do përgjigjet rritja e përgjithshme ekonomike rritjes së grumbullimit të pasurisë dhe investimit nga shitësit fshatarë të ushqimeve.

► Çfarë mund të bëjnë qeveritë?

Ndërhyrjet politike mund të ndahen në tre grupe të mëdha: ndërhyrja për të siguruar ushqimin për familjet duke përforcuar rrjete sigurie⁷ të piketuara

⁵ Ivanic and Martin (2008) Implication of Higher Global Food Prices for poverty in low-income countries

⁶ Rising Global Food Prices – The World Bank's LAC region positiv paper' (2008)

⁷ Tip kontrate për tu siguruar kundër fatkeqësive

mirë, ndërhyrje për të ulur çmimet e brendshme të ushqimeve nëpërmjet politikave afat shkurtër të tregut ose veprimeve administrative, dhe ndërhyrjeje për të rritur ofertën afat gjatë të ushqimeve. Brenda tre kategorive të politikave, të parat janë më të preferuarat si zgjidhje, konsiderohen më të drejta dhe më efikase, dhe shkaktojnë më pak mosmarrëveshje. Shtojca 1 përbledh zgjidhjet politike kryesore dhe i radhit ato sipas shkallës në të cilën ato përputhen me këto kriterie dhe kritere të tjerë të dëshirueshëm.

► Sigurimi i ushqimit për familjet nëpërmjet rrjeteve të sigurisë të targetuara.

Rruja e parë më e mirë për të zgjidhur pasigurinë e ushqimeve përfshin transferat kesh të targetuara te grupet më të prekshme. Këto mbështesin fuqinë blerëse të të varfërve pa dëmtuar nxitjet e brendshme për të prodhuar më shumë ushqim, dhe pa pakësuar të ardhurat e shitesve të varfër të ushqimeve. Shembujt përfshijnë transfertat në kesh ose në pothuaj kesh⁸ që kushtëzohen nga plotësimi i kushteve (të tilla si e ardhura e ulët, vendi ose profesioni) ose nga angazhimi në një sjellje të mandatuar (si për shembull dërgimi i fëmijëve në shkollë). Shkalla, eficiencia e targetimit dhe vlera e programeve të tilla transferte priret të lidhet drejtëpërdrejt me të gjithë nivelet e zhvillimit, duke pasur parasysh kompleksitetin e administratës dhe kostot fiskale që përmban. Në vendet me të ardhura të ulëta dhe me kapacitete administrative të dobëta, nuk ka gjithmonë zgjidhje të realizueshme. Programe të ndryshme të transfertave kesh po përdoren aktualisht në Brazil, Kinë, Etiopi, Egjipt, Indonezi, Meksikë, Mozambik, Afrikë Jugut, Sri Lankë dhe Tunizi. Disa nga këto vende po i përshtatin programet aktuale për t'iu përgjigjur rritjes së çmimeve të ushqimeve. Për shembull, në Etiopi, ku inflacioni i çmimit të ushqimeve në shkurt 2008 ishte 23%, qeveria rriti nivelin e pagës kesh të programit më të madh «cash for work» me 33%.

Disa vende, si Bangladeshi, Madagaskari, Kamboxhia, dhe India, po përdorin programet «ushqim për punë» të vetë targetuara⁹,

ndërsa të tjerë, ku futen Afganistani dhe Angola, përdorin shpërndarjen e ndihmës së ushqimit emergjent për të siguruar ushqim për grupet më në nevojë. Programi «ushqim për punë» në Bangladesh është përhapur kohët e fundit për shkak të katastrofave natyrore dhe rritjes së çmimeve të ushqimit. Ndërsa vetë-targetimi ul koston e përfshirjes në targetimin administrativ, transporti fizik i ushqimit është e kushtueshme dhe mund të çojë në humbje gjatë rrugës. Ndihma ushqimore mund të ketë efekte penguese për prodhimin lokal nëse zbatohet përtëj fazës së emergjencës fillestare ose nuk është e lidhur me kërkuesat e punës. Vende të tjera, ku futen Burkina Faso, Brazili, Kina, Kenia, Honduras, Meksiko dhe Mozambiku, përdorin në mënyrë efektive programet «ushqim në shkollë» për të përmirësuar konsumimin e ushqimit të fëmijëve të shkollave dhe të familjeve të tyre. Afrika e Jugut po shpërndan ndihmë sociale për programet e ushqimit në shkollë për të mbajtur të njëjtin ritëm me nivelin e inflacionit të ushqimeve.

Në anën tjetër, programet e bazuara në shkollë, nuk përqendrohen patjetër në kequshqyerjen e fëmijëve në pikën e tij më kritike - kur fëmijët janë foshnje. Rritja e çmimit të ushqimeve trezikon gjithashtu të fshijë disa arritje në uljen e kequshqyerjes. Midis viteve 1990 dhe 2005, përqindja e fëmijëve nën pesë vjeç me zhvillim të vonë të moderuar dhe të fortë ra nga 33.5 % në shkallë botërore, në 24.1 %¹⁰. Edhe pse çmimet e ushqimeve nuk janë i vetmi shkaktar i kequshqyerjes, ata ndikojnë rezultatet e ushqimit nëpërmjet impaktit të tyre në të ardhurat reale dhe fuqinë blerëse të familjarëve. Për të kompensuar rritjen e çmimit të ushqimeve, familjet më të dobëta mund të përdorin më pak ushqim ose të përdorin zëvendësues më të lirë, por më pak të ushqyeshëm të ushqimeve përditshmë.

► Realizimi i sigurisë së ushqimeve përfshin uljen e tarifave dhe targetuara.

Zgjidhja e parë më e mirë për të ulur çmimet e brendshme përfshin uljen e tarifave dhe

⁸ Programet pullat ushqimore janë format më të përdorshme të pothuaj transfertave cash

⁹ Programet e vetë targetuara janë ndërtuar për të ulur nxitjen e atyre që nuk janë të varfër par të marrë pjesë në program. Kjo arrihet kryesisht nëpërmjet përzierjes së përfitimive racionalizuese (për shembull duke minimizuar sasitë u ushqimit) dhe kërkesa fizike (si për shembull punë me dorë për ushqim).

¹⁰ Banka Botërore 'Global Monitoring Report : MDGs and the environment - an Agenda for Inclusive and Sustainable Development'

taksave të tjera për ushqimet bazë. Shumë vende vendosin tarifa në ushqimet e importit, si për të inkurajuar prodhimin vendas, ashtu edhe për të rritur të ardhurat e brendshme. Kur çmimet rriten ndjeshëm, ulja e tarifave dhe taksave mund të sigurojë pak lehtësim për konsumatorët, përkundrejt një kostojë fiskale. Humbja në të ardhura për shkak të uljes së tarifave mund të jetë e rëndësishme, dhe pasojat fiskale të kombinimit të kësaj më shpenzime shtesë të mbrojtjes sociale mund të kërkojë shkurttime fondesh në fusha me prioritet më të ulët. 24 nga 28 vendet e studiuar kohët e fundit kanë ulur taksa të rëndësishme dhe TVSH- në të detyruar nga rritja e inflacionit të çmimeve. Të tjerë, si Filipinet, vazhdojnë të mbajnë tarifa të larta për të mbrojtur prodhuesit vendas - edhe pse këto tarifa të larta prekin shumicën e të varfërve të cilët janë konsumatorë të thjeshtë. Disavende (kryesisht zona Lindje Mesme - Afrika e Veriut) kanë një traditë të gjatë të përdorimit të subvencioneve, sidomos të vendosura ndaj të varfërve, për të përballuar pasigurinë e ushqimit të familjeve. Të tjerë kanë futur subvencione të konsumatorit për ushqimet bazë, fill pas rritjes së çmimit të ushqimeve. Për shembull, qeveria e Jemenit po ofron grurë në tregje të përgjedhur sipas niveleve të subvencionimeve, fill pas rritjes së çmimeve të ushqimeve. Në fillim të vitit 2008, qeveria e Pakistanit, shpalli se ajo ishte duke rivënë në funksionim një sistem racionomi për të shpërndarë grurë të subvencionuar. Rreziku i masave të tilla është se ato mund të vazhdojnë për një kohë të gjatë, duke shkaktuar kosto të lartë fiskale. Për më tepër, nëse subvencionet e konsumatorit ndeshen me masat për të mbajtur të ulëta çmimet e prodhuesve, kjo mund të krijojë pengesa për prodhuesit vendas të ushqimeve, dhe si përfundim të shkaktojë efektin e kundërt. Përjashtimi i vetëm, është kur kontrolllet e çmimeve, përdoren hapur si një masë e përkohshme dhe duket sikur justifikohen me arritten e një qëllimi të madh social. Në raste të tilla, rreziku i vazhdimit për një kohë të gjatë, do të minimizohet, ashtu si është vënë re në ndërhyrjet e kohëve të fundit për të kufizuar rritjen e ushqimeve bazë gjatë muajit të ramazanit në Marok. Për vendet që janë eksportues të drithërave, mund të ketë një presion politik për të penguar ose taksuar këto eksporte me çmime të larta vjetore. Për fat të keq, disa vende kanë zbatuar

tashmë masa të tilla. Këto politika priren të kenë impakt të kufizuar në nivelin e çmimeve të brendshme dhe një efekt negativ të rëndësishëm në fitimet për prodhuesit vendas dhe eksportuesit. Ato mund gjithashtu të çojnë në luhatje të fortë të çmimeve në vende që varen nga importet, duke dëmtuar të gjithë sistemin global. Në vitet 1970 dhe 1980, shumë vende zbatuan një politikë «stok mbrojtës të drithërave» për ta ruajtur tepricën (e brendshme ose e importuar) nga luhatja e çmimeve nga një vit në tjetrin. Në praktikë, këto politika priren të shkaktojnë kostot të lartë fiskale me menaxhim të vështirë, ndërsa përfitimi që sjellin për sigurimin e ushqimit të familjeve, është i paqartë. Për më tepër, tregjet botërore mund të kenë detyrë të sigurojnë një ofertë të qëndrueshme të importeve relativisht të lirë të drithërave kur të jetë e nevojshme. Kohët e fundit, politikat e mbajtjes së stokut të disa prodhuesve të mëdhenj si SHBA, BE, dhe Kina, kanë ndryshuar, duke kontribuar në situatën e tanishme ku ka një stok global shumë të ulët drithëtrash dhe një rritje të luhatjes të përgjithshme të çmimeve. Si pasojë, një sërë vendesh në zhvillim, si Indonezia, po mendojnë të kalojnë të kjo formë e menaxhimit, sidomos pasi provuan impaktin e pengesave të eksporteve në vendet kryesorë importues.

► Masa për të stimuluar një përgjigje afat mesme të ofertës për ushqim drithi.

Ndërsa çmimet e larta të drithërave janë një problem i madh për blerësit e varfër, ata gjithashtu përbëjnë një mundësi për të nxitur prodhimin e drithërave dhe për të rritur kontributin në bujqësi të rritjes afat mesme. Për shembull, çmime më të larta, dobësojnë logjikën e vendosjes së çmimeve të kushtueshme dysheme ose importe të tarifave të drithërave, dhe mund të lehtësojnë zbatimin e reformave të tregut politikisht të vështira. Çmime më të larta të drithërave, mund gjithashtu të ndihmojnë në përmbysjen e një prirjeje drejt rënies të investimeve të qeverisë, sektorit privat, dhe donatorëve në sektorin e bujqësisë. Prodhuar bujqësorë si Brazili, Malajzia, dhe Tajlanda, kainë bërë progrese të dukshme në komercializimin e bujqësisë vitet e fundit dhe kanë ndërmarrë investime në kërkim dhe shtrirjen e domosdoshme, për të nxitur produktivitetin bujqësor dhe për të ulur risqet në bujqësi.

Megjithatë, disa nga zgjedhjet e politikave afat shkurtra të diskutuara më lart, mund të kufizojnë fushën e veprimit për zgjidhje me afat më të gjatë. Për shembull, përgjigjet politike që kërkojnë të kontrollojnë tregun nëpërmjet fiksimit të çmimeve të drithërave, shkurtimit të eksporteve, prokurimit të detyruar, ose përfshirjes së drejtpërdrejtë të qeverisë në veprimitari tregu, ka të ngjarë të ulin përgjigjen e ofertës së ushqimit në afat mesëm. Në kontrast me këtë, masa alternative si pilotimi i injeteve të menaxhiimit të risqeve të bazuar në treg në Malajzi, dhe përmirësimi i aksosit për publikun në informacionin mbi tregun në Indi dhe Mali, ka mundësi të mobilizojnë burime të tjera të rëndësishme në sektorin privat, për të shkurtuar kostot e marketingut dhe përmirësuar eficencën e tregjeve të drithit në afat mesëm.

Për shumë vende me të ardhura të ulëta, kostot e transportit dhe të logistikës, janë një përbërës kyç i çmimeve të tregut dhe në përgjithësi janë shumë më të lartë se standardi i OECD me rrëth 9 %. Ndërsa vendet nuk mund të bëjnë pothuaj asgjë për të ulur kostot e lundrimit në oqean, ata mund të veprojnë për të ulur kostot e përgjithshme të shpërndarjes së brendshme. Rëndësia e forcimit të lidhjeve të transportit tokësor për të kundërpeshuar në rritjen e çmimeve është vërtetuar kohët e fundit në Kongo. Përmirësimet në kapacitetet e transportit e penguan rritjen e inflacionit të çmimit të ushqimeve që kishte ndodhur në vitin 2006, dhe investime të tjera në lidhjet e transportit me Brazzaville pritet të jenë një pjesë e rëndësishme e kontrollit të pikut të çmimit. Investimet në infrastrukturën e transportit kanë luajtur rol në uljen e çmimeve, sidomos në lokalitete të prapambetura të vendeve të tilla si Nepal. Për më tepër, përmirësimet në lehtësitet doganore, performancën logjistike dhe stokimin efikas të drithit, mund të kenë përfitime të rëndësishme për konsumatorët, ndërsa janë duke prodhuar një përgjigje të favorshme të ofertës.

► **Masat për të përballuar efektin shpërndarës (spillover) të përgjigjeve politike të sipërpërmendura.**

Shumë nga përgjigjet politike të diskutuara në pjesët e mësipërme kanë pasoja të rëndësishme fiskale. Në rastin e Etiopisë për shembull, kostoja

totale shtesë e masave të kombinuara për të rritur pagat sipas programit «cash for work» triti TVSH-në e drithërave dhe u shpërndau grurë me çminim të subvencionuar, ka mundësi të tejkalojnë 1% të GDP-së. Pasojat makroekonomike të një shpenzimi më të lartë varen në një masë të madhe nga mënyra e financimit. Kur kostot buxhetore shtesë financohen nëpërmjet huave të brendshme, kjo mund të çojë në një inflacion të përgjithshëm më të lartë. Një alternativë është të transferohen kostot tek tak sapaguesit jo të varfér, gjë që mund të jetë ose jo e mundshme në varësi të aftësive specifike për të rritur të ardhurat dhe konsideratave të politikave ekonomike. Ndryshimi i drejtimit të burimeve nga shpenzimet në sektorë socialë ose nga investime të tjera të rëndësishme publike për të finansuar përgjigje afat shkurtër mund të ketë kosto oportune afat gjatë ose afat mesëm. Në anën tjetër, të trajtosh me prioritet çështjen e sigurisë të ushqimit mund të krijojë mundësinë e zvogëlimit të shpenzimeve me prioritet të ulët dhe të rishpërndajë këto burime. Duke pasur parasysh koston e lartë politike dhe ekonomike të mostrajtimit së sigurisë së ushqimit, mund të pritet një rritje e përkohshme e deficitit buxhetor.

Jo të gjithë vendet kanë të njëjtën aftësi për të rregulluar dhe zbatuar shpenzimet shtesë për rrjetet e sigurisë dhe politikat e ushqimit. Duke përdorur të dhënat krahasuese nga Banka Botërore dhe treguesit e Vlerësimit Institucional, vendet në zhvillim mund të klasifikohen në katër kategori, në varësi të shtrirjes së fiskut dhe balancës së ç'ekuilibrave të pagesave: 1) vendet ku në fillim financa të dobëta publike dhe aftësia e menaxhimit fiskal është shkatërruar nga goditje të ashpra mbi kushtet e biznesit. (Burundi, Eritrea, Grénada, Haiti, Xhamajka dhe Nepali) 2) vende ku një pozicion fillestar, deri diku i fortë, u dobësua nga goditjet e kushteve të biznesit. (për shembull Burkina Faso, Etiopia dhe Honduras) dhe/ose u dëmtua nga kriza politike (Kenia dhe Pakistani) 3) vende në të cilat kanë një kapacitet të dobët fiskal për të zbatuar në mënyrë efikase shpenzimet shtesë në politikat e ushqimit, edhe në rastin kur lëvizjet e kushteve të tregut janë të favorshme. (Mongolia dhe Zambia) 4) vende me tregues më të fortë fiskalë dhe të balancës së pagesave, në të cilët ka një hapësirë më të madhe për të zbutur

efektin e ashpër të rritjes së çmimeve të ushqimeve. (Indonezia, Meksika, dhe Tunizia)

Skicimi i politikave publike për të trajtuar rritjen e çmimeve të ushqimit kushtëzohet nga faktorët e ekonomisë politike. Forca e grupeve të ndryshme të interesit është një faktor kritik që ndikon zgjidhjet politike dhe përcaktimin se cilat zgjidhje janë të mundshme. Edhe në rastet kur vendet janë furnizues të tregjeve botërore të ushqimit, qeveritë mund të nxiten të zbatojnë masa mbrojtëse. Zgjidhjet politike inteligjente mund të kërkijnë zbatimin e atyre zgjidhjeve që janë më eficiente nga ana ekonomike, por që edhe në këtë rast reflektojnë konsideratat e ekonomisë politike dhe janë në një linjë me hapësirën fiskale dhe kapacitete institucionale të çdo vendi. Në disa raste, politikat e para ose të dyta më të mira, mund të mos jenë të zbatueshme, ose mund të kërkijnë zgjedhje politike të vështira. Në përgjithësi, zgjedhjet politike të qeverisë, mund të pranohen dhe kuptohen më mirë nëse shoqërohen me një strategji transparente komunikimi mbi shkaqet e çmimeve të larta të ushqimeve dhe kur janë të shoqëruara me masa politike.

► Si mund të ndihmojë Banka Botërore dhe donatorët

Banka Botërore është në pozicionin e duhur përtë ndihmuar vendet në identifikimin e kombinimit të përshtatshëm dhe renditjes së politikave afat shkurtër dhe afat mesme që duhen për të mbështetur grupet në nevojë, duke lejuar në të njëjtën kohë rregullime përritjet strukture të çmimeve të ushqimeve. Elementët kryesorë të përgjigjes së Bankës do të janë këshillimi politik, mbështetje financiare dhe lidership global.

► Mbështetja për përgjigje të shpejtë politike

Për momentin, kërkohet nga Banka që të angazhohet më shumë në ndihmën përvendet gjatë procesit të vlerësimit të pasojave sociale dhe ekonomike të rritjes së çmimeve të ushqimeve, si edhe të përgjigjes së mundshme politike. Qëkurse shumë qeveri janë ndeshur me presionin e ekonomisë politike përtë

zbatuar politika nën-optimale dhe madje edhe kundër-produktive, Banka mund të sigurojë inpute analitike për të treguar drejtimet më pak problematike të veprimit, dhe të ndihmojnë vendet në dhënen e një përgjigjeje efektive dhe të plotë. Një mbështetje e rritur financiare, mund gjithashtu të jetë e përshtatshme në një numër vendesh dhe kontekstesh.

Politika e quajtur just in – time (pikërisht tan) këshillonsesitë trajtohen çështjet e mënjëherëshme. Ka një kërkësë të madhe për këshilla të Bankës në modelimin dhe zgjerimin e programeve rrjet sigurie dhe ndërhyrjet në tregun e ushqimeve përtë ndihmuar në mbrojtjen e grupeve në nevojë. Në Indonezi, Banka Botërore ka luajtur një rol të rëndësishëm në informimin mbi impaktin e rritjes së çmimit të orizit përvafërinë dhe mbi pa-dobishmërinë e instrumenteve të ndryshëm politikë, për shembull transfertat në kesh¹¹. Në Egjipt, Banka Botërore ndihmoi në bashkimin e zyrtarëve meksikanë me eksperiençë në programet e trasfertave kesh të kushtëzuara përtë ndarë eksperiencën me qeveritarët. Në Etiopi, analiza e nivelit të pagave e kryer nga Banka ishte baza për rregullimin e elementit transfertë kesh të programit rrjet sigurie më të gjerë në vend. Gjithashtu, ka pasur kërkesa për këshilla në ndërhyrjet mbi tregun, përtë zbutur ofertën dhe ulur çmimet e ushqimeve. Një dialog i intensifikuar në lidhje me stoqet e ushqimeve (i cili prek çështje të tillë si sasitë optimale të stoqeve, kompromise fiskale dhe sfida të zbatimit) është duke u mbajtur në vende të ndryshme, ku përfshihen Indonezia dhe Burkina Faso. Në Filipine, Banka po këshillon qeverinë për strategjinë më të mirë në uljen e tarifave të importit të orizit. Një forum i nivelit të lartë është organizuar në Marok përtë diskutuar mundësitet e ndryshme për reforma në programet e subvencionimit të ushqimeve dhe karburanteve. Disa vende kanë kërkuar nga Banka këshilla përtë përballuar pasojat makroekonomike të rritjes së çmimit të ushqimeve. Për disa vende partnere janë përgatitur studime për shkaqet e inflacionit të lartë të çmimit të ushqimeve (Bangladesh dhe Kinë) dhe zgjidhje përtë menaxhuar rritjen e nivelit të inflacionit (Marok). Me kërkësë të disa vendeve të Amerikës Latine, Banka Botërore organizoi në maj 2008 një seminar në Peru përtë

11 'Recent Developments in Food policy in Indonesia' February 2008, East Asia and Pacific Memo

diskutuar në lidhje me reagimin ndaj inflacionit. Disa qeveri po kërkojnë informacion në lidhje me prirjet globale dhe parashikimet për të kuptuar më mirë natyrën strukturore dhe rritjen e çmimit të ushqimeve, si edhe në lidhje me përgjigjet që kanë gjetur vende të ndryshme. Stafi i Bankës do të takohet me Ministrat e Financës të vendeve të Amerikës Qendrore, me qëllim që këta të fundit të marrin nga Banka njohuri përfundimtare e çmimit të ushqimeve dhe politikat.

► Plotësimi i nevojave afat-shkurtra të financimit

Pasojat e menjëherësime fiskale të rritjes së çmimit të ushqimeve janë të ndryshme nga njëri vend te tjetri, duke qenë se shumë importues janë kompensuar duke rritur çmimet e eksportit të produkteve shtëpiake. Ende është shumë herët përfundimtare që janë në dalje e sipër. Megjithatë, vetëm pak vende po mendojnë aktivisht të rritin masën e (kredi të politikës së zhvillimit) Development Policy Loans të ardhme. Në afat shkurtër, Banka Botërore mund të rrisë financimet në programet ekzistuese dhe në investimet që janë duke u kryer në programet e bujqësisë dhe të rrjetit të sigurisë. Në Amerikën Latine, ku shumë vende programe rrjet sigurie që siguron mbështetje përgjithësish për grupet e dobët, Banka është gati të rrisë mbështetje financiare përfundimtare që janë duke u kryer në programet e bujqësisë dhe të rrjetit të sigurisë. Mbështetja shtesë nga Banka mund të ndihmojë në zgjerimin dhe përmirësimin e programeve aktualë duke siguruar asistencë teknike në përmirësimin e targetimit dhe të mbulimit, financimit të programuar përfundimtare, forcuar sistemin e mbrojtjes sociale dhe financimin me kuota përfundimtare. Ndërsa shumica e programeve po ndryshohen përfundimtare efikasitetin e programeve rrjet sigurie. Përfundimtare, në zonën Lindje e Mesme - Afrikë Veriore, një numër Development Policy Loan po mbështesin reformat përfundimtare subvencionimin e ushqimeve. Ndërsa shumica e programeve agro-ushqimorë

janë orientuar drejt politikave afat mesme dhe reformave institucionale përfundimtare, duke përcaktuar ndërryrjet përfundimtare të prodhimit afat shkurtër të ushqimeve bazë, ruajtjen dhe shpërndarjen e tyre. Përfundimtare, një kredit shkurtër prej 15 milion USD përfundimtare projekte ekzistuese në Burundi, po përgatitet përfundimtare financiar shpërndarjen e prodhimeve bujqësore përfundimtare sezonal e ardhshëm bujqësore.

► Rritje e mundshme e mbështetjes së Bankës Botërore përfundimtare sociale në Xhamajkë

Xhamajkë ka një sërë programesh rrjet sigurie përfundimtare më të dobët, duke përfshirë këtu punë publike të vetë-targetuara, ushqimi me shkollë, transferta kesh të kushtëzuara dhe programe që drejtohen tek më të moshuarit, të varfrit dhe personat me aftësi të kufizuar. Ndërsa këto programe të ndryshme, programi përfundimtare përparrimin në përmjet shëndetit dhe edukimit, një program transferte kesh të kushtëzuar, përfaqëson mundësitë më premtuese përfundimtare t'u rritur, duke pasur parasysh aftësitë e tij të forta institucionale dhe mekanizma targetimi të fuqishme. Në fillim të vitit 2008, qeveria miratoi një rritje prej 9 % të nivelit të përfitimit të programit të sipërpërmendur, përfundimtare, përfundimtare ndihmuar në balancimin e pasojave te inflacionit. Përfundimtare përgjigjur shokut të shkaktuar nga rritja e çmimit të ushqimeve, programi mund të sigurojë transferta kesh shtesë përfundimtare familjet e varfra përfundimtare kundërpeshuar rrezikun e keqësimit të kushteve të ushqimit, pakësimit të përkujdesit shëndetësor dhe rritjes së përqindjes së braktisjes së shkollave. Kostoja shtesë duhet të jetë e përkohshme dhe e ndarë qartë nga thelbi i këtij programi. Banka është në fazën e fundit të përgatitjes së projektit të mbrojtjes sociale me të cilin do të sigurojë mbështetje financiare përfundimtare këtë program të bazuar në performancë. Ky projekt mund të zgjerohet e të mbulojë më shumë familje nëse qeveria e kërkon një gjë të tillë.

Përfundimtare vendet që të plotësojnë nevojat e financimit afat shkurtër, Banka po bashkëpunon shumë ngushtë me FMN dhe donatorë të tjera, duke futur këtu edhe World Food Program, (WFP) i cili ka një ekspertizë të rëndësishme

12 'Rising Global Food Price: the World Bank's LAC Region Position Paper (2008)

në vlerësimin e gjendjeve të ushqimit dhe përgjigjes ndaj nevojave të kritës afat shkurtër. Bashkëpunimi me WFP dhe BE, dhe partnerë të tjerë të zhvillimit është veçanërisht i rëndësishëm për vendet ku donatorët nuk janë në gjendje të shpërndajnë mbështetje ose janë duke pakësuar programet e shpërndarjes së ushqimeve (për shembull Mozambik).

Mbështetje për axhendën afat mesme

Një rol i rëndësishëm i Bankës është të ndihmojë qeveritë që të interpretojnë dhe kontekstualizojnë pasojat afat mesme të rritje së çmimit të ushqimeve për strategjinë e tyre të zhvillimit kombëtar dhe programet e investimit. Për të bërë këtë, ajo ka nevojë të bashkëpunojë ngushtësisht me donatorë të tjerë për të ndërtuar një dialog të përbashkët dhe për të koordinuar përgjigjen financiare. Duke qenë se vendet e kanë të vështirë të kenë një skenar të qartë, punime analitike për të kuptuar pasojat ekonomike, sociale dhe mbi varférinë, që ka rritja e çmimeve, mund të ndihmojnë për të ndërtuar strategji të veçanta dhe elastike për çdo vend. Kjo nënkupton një shtrirje të mbështetjes dhe diagnostikimit të Bankës në zona kritike, ku futen kufizimet në agrikulturë, analiza shpërndarëse e rritjes së çmimit të ushqimeve dhe programet rrjet sigurie, vlerësimet për klimën e investimeve në zonat rurale, dhe rishikimi i shpenzimeve publike. Fleksibiliteti do të jetë shumë i rëndësishëm, që kur Banka po përpinqet të përshtatë programin e saj CAS, duke përfshirë lending pipeline dhe front-loading të programeve huadhnës. Nëpërgjithësi, një përgjigje afatmesëm e balancuar ndaj rritjes strukturelle të çmimit të ushqimeve kërkon më shumë investime në bujqësi si edhe përmirësim të instrumenteve për menaxhimin e rreziqeve, duke futur këtu rrjetet e sigurimit social dhe instrumente të tjera të menaxhimit të risqeve. Rritja e investimeve në bujqësi duhet të përqendrohet në rritjen e prodhimit dhe jo vetëm në vetë-mjaftueshmërinë në ushqim dhe sigurinë e ushqimit. Kjo e fundit është arritur më mirë nëpërmjet tregut ndërkombëtar, tregjeve vendas efikasë dhe rrjeteve të sigurisë të përcaktuara mirë. Çështjet kryesore për Bankën në këto dy fusha, janë përshkruar shkurt më poshtë.

Konsiderimi i bujqësisë si parësore. Në vitin 1980 30% e huasë së Bankës Botërore shkoi

në projekte bujqësore, por kjo shifër ra në 12% në vitin 2007. Pjesa e përgjithshme e të gjithë Asistencës së Zhvillimit Zyrtar që shkon për bujqësinë është aktualisht 4%. Rënia dhe më pas stabiliteti i çmimit të drithërave në vitet 80 dhe 90, ndikoi në një lloj zemërgjerësie ndaj çështjes së bujqësisë në vendet në zhvillim që nga fundi i viteve '70 e deri tanë. Rritja e çmimit të ushqimeve si edhe një përpjekje më e madhe për të përshtypet rritjen në vendet e Afrikës Sub-Saharanë që varen nga bujqësia, çoi në një vëmendje të re për këtë sektor. Banka kohët e fundit duket e bindur të dyfishojë huatë për bujqësinë në Afrikë, nga një mesatare prej 450 milion dollarë në vit gjatë periudhës IDA 14, në 800 milion dollarë në vit për FY 10. WDR e kohëve të fundit për bujqësinë, identifikoi katër elementë kyç për një qasje kuptimore të rritjes bujqësore, e cila do të drejtë vëmendjen e rinnovuar të Bankës në këtë sektor. Këto janë: rritja e motivimit të prodhuesve (duke hequr subvencionet prej të cilave përfitojnë më shumë fermerët e pasur), duke siguruar të mira kryesore publike cilësore, - shkenca, infrastruktura dhe kapitali njerëzor, dhe institucionet më të forta për të mbështetur një klimë tërheqëse investimesh në zonat rurale, ku përfshihet më shumë akses në institucionet financiare rurale dhe të menaxhimit të risqeve, të drejta pronësie të përmirësuara dhe mundësi më të mëdha për veprime kolektive nga fermerët, sigurimi i përdorimit të vazhdueshëm të burimeve natyrore.

Shtrirja dhe përmirësimi i aksesit në rrjetet e sigurisë dhe instrumente të menaxhimit të riskut. Përmirësimi dhe aksesi në rrjet sigurie do të jetë një nga priorititetet për të mbrojtur familjet më të rrezikuara përballë pasigurive të tregjeve botërorë të ushqimeve. - të paktën për aq sa mund të parashikohet e ardhmjë. Banka mund të ndihmojë vendet të ndërtojnë rrjete sigurie më elastike dhe më të forta për të përballuar goditjet, duke pasur mjete targetuese dhe programuese të qarta që mund të rriten me shpejtësi për të mbrojtur familjet më të rrezikuar. Për më tepër, zgjerimi i programeve për të siguruar ushqimin bazë, sidomos për foshnjat, dhe përmirësimi i aksesit në sistemet e shëndetit dhe të edukimit do të minimizojë mundësinë që goditjet e ardhshme të ulin kërkësen dhe të dëmtojnë akumulimin e kapitalit njerëzor. Së fundmi, Banka po investon gjithashtu për zhvillimin

e sistemit modern të menaxhimit të risqeve si sigurimi i prodhimit dhe nga katastrofat natyrore.

Mbështetja për një axhendë ndërkombeatore

Impaktet e rritjes së kohëve të fundit të çmimeve të ushqimeve po shpërndahen në dimensione kyçë të axhendës së zhvillimit, ku përfshihet zbutja e varfërisë, stabiliteti makroekonomik, nxitja e investimeve dhe sigurimi i energjisë/politika të ndryshimit klimatik. Banka është në gjendje të katalizojë veprimin global dhe të ndikojë axhendën ndërkombeatore sepse është e aftë të bashkojë perspektivën ekonomike, të varfërisë, sociale, të bujqësisë dhe të mjedisit. Tre nga çështjet për të cilat banka mund të kërkojë të përmirësojë rezultatet globale janë përmendur më poshtë, shumë prej tyre janë pasoja të drejtpërdrejtë të vendeve me të ardhura mesatare. Së pari, Banka po bashkëpunon ngushtësisht me vendet dhe donatorët për të minimizuar ndërmarrjen e politikave me efekte negative që mund të shpërndahen te të tjerët. Tarifa të larta të tregut dhe të subvencionimeve krijojnë eksternalitetë negative të mëdha. Tarifat bujqësore dhe subvencionimet në vendet e zhvilluara u kushton vendeve në zhvillim afërsisht pesëfishin e nivelit aktual të ndihmës për zhvillimin e bujqësinë në vendet përtet detit¹³. Ndalimi i eksporteve gjithashtu krijon eksternalitetë negative sidomos për vendet që varen shumë nga importet. Ata mund të shkaktojnë pikën më të lartë të çmimit në vendet importuese dhe presion politik për vetëmajtueshmëri të brendshme në ushqim. Së dyti, axhenda e ndryshimit klimatik të Bankës kërkon të informojë debatin global për biokarburantet nëpër mjet analizave, monitorimit dhe balancimit të kërkesave konkurruuese për energji dhe sigurinë e ushqimit. Çështjet në

lidhje me rritjen e përdorimit të energjisë, ndryshimit klimatik, dhe emisioneve të dyoksidit të karbonit nga karburantet e vjetra e bën përdorimin e karburanteve me më pak karbon, një prioritet politik të lartë, si në nivel global ashtu edhe në nivel vendi. Lëndët e para djegëse bio janë një burim energjie me sasi të ulët karboni edhe pse rezervat varen nga sasia e prodhimit të tyre. Brezi i dytë i karburanteve bio të prodhuar nga produkte të mëdha, mund të shëmangë ndryshimin e përdorimit të tokës dhe disa nga emisionet që lidhen me programet aktuale të karburanteve bio, dhe në këtë mënyrë mund të sjellë përfitime sociale dhe mjedisore të rëndësishme. Këto përfitime gjithsesi, duhen krahasuar me koštot potenciale të rritjes së çmimit të ushqimeve. Sipas një studimi të kohëve të fundit të IFPRI, shumë skenarë të përdorimit të rritur të bio karburanteve kërkojnë një kompromis thelbësor me çmimet e ushqimeve. Këto kompromise zbuten, edhe pse nuk mund të zhduken krejtësisht, kur merren parasysh progreset teknologjike në bio karburantet dhe prodhimin bujqësor. Kompromiset midis sigurisë së energjisë, ndryshimit klimatik, dhe objektivave të sigurisë së ushqimit, duhet të monitorohen me kujdes që të përfshihen në veprimet politike të ushqimit dhe të bio karburanteve. Së terti, rritja e çmimit të ushqimeve krijon një mundësi për komunitetin global të përqendrojë përsëri investimet në bujqësi dhe në mbrojtjen sociale. Zhvendosja strukturale në çmimet e ushqimeve krijon një mundësi për Bankën dhe donatorët për të punuar me vendet partnere për të ndërtuar një koalicion politik dhe për të mobilizuar mbështetjen e nevojshtme financiare për të përbysur problemin e vjetër të pamjaftueshmërisë së investimeve në bujqësi dhe për të ndërtuar një rrjet sigurie më të mirë për të ndihmuar më të varfrit të përballojnë nivele të larta endemike të riskut.

Përktheu Blerta HYSKA

¹³ World Bank (2008) 'World Development Report: agriculture for Development'

KRIZA E EKONOMISE GLOBALE DHE IMPLIKIMET NE EKONOMINE SHQIPTARE

Prof. Dr. ANASTAS ANGJELI

Ish Ministrë i Financave
dhe Ekonomisë.

Aktualisht President i Institutit për
Reforma dhe Zhvillim

anastasangjeli@hotmail.com

Nëse ka një fenomen sot ne botë, shpejtësia e zhvillimit të së cilit është thua se e jashtëzakonshme, është ai që ka marrë emrin e globalizmit ekonomik. Zhvillimi i këtij fenomeni, sidomos këta njëzet vitet e fundit, ka bërë që ndërthurjet, ndikimet dhe vartësitë ekonomike midis vendave, pjesëve e zonave të ndryshme, të globit te shfaqen dukshëm. Dëshmia më e mirë e këtyre proceseve janë fenomenet dhe problemet e dala nga tronditjet në tregjet globale, (tregjet e mallrave agro-ushqimore, tregjet e naftës, ato financiare e valutore) për zhvillimet ekonomike, financiare e sociale, në këta dy tre vitet e fundit, duke i shndërruar sot, ato, në çështjet më serioze për diskutim dhe zgjidhje përpëra liderëve të shteteve më të zhvilluara të botës, institucioneve dhe forumeve më të rëndësishme ndërkombëtare, sikurse janë vendet e G-7, dhe G-8, FMN, BB, OKB, OBT, BE, etj. Rrjedhojë e këtyre tronditjeve, problemet, implikimet dhe pasojat janë të ndryshme. Ky artikull trajton disa prej më shqetësueseve prej tyre.

► Kriza e produkteve ushqimore dhe varfëria

Për zhvillimet ekonomike globale, tashmë nuk ka më dyshim se kriza e produkteve bujqësore dhe ushqimore (rritia e çmimit të tyre) dhe pasojat që ky fenomen po sjell në zhvillimet ekonomike dhe thellimin e varfërisë, në një pjesë të konsiderueshme të popullsisë në botë, nuk është me një çështje debatesh dhe diskutimesh, por një problem, zgjidhja e të cilit kërkon aksione konkrete, globale, rajonale dhe kombëtare. Rritja e shpejtë globale e çmimeve të produkteve ushqimore, e shfaqur (sinjalët e para të saj u dhanë që prej vitit 2004) tashmë, duket se nuk përbën një fenomen të rastit, të përkohshëm. Gjatë vitit 2007 dhe fillim vitit 2008, ky fenomen u shfaq dukshëm dhe në muajt e parë të këtij viti. Rritja e përgjithshme e tyre, në krahasim me Qershorin e vitit të kaluar, ishte 55 %. Ndërkaq, rritja e çmimeve të drithërave në tregjet globale, në shkurt te vitit 2008, në krahasim me tre vjet më parë, u rrit me 181 %, kurse çmimet e produkteve ushqimore, me 83 % (për të njëjtën periudhë). Shqetësimet

dhe efektet e kësaj "krize", tashmë kanë dhënë pasojat e tyre, të cilat priten të jenë me efekte më të mëdha gjatë vitit 2008-2009 dhe për një pjesë të konsiderueshme të këtyre produkteve, kjo gjendje, mund të vazhdojë deri në vitet 2015. Situata vërtetoi paralajmërimet e bëra nga Institucionet dhe Organizatat Ndërkombëtare të specializuara. Kështu, FAO, Organizata e Ushqimit dhee Bujqësisë e Kombeve Bashkuara me qendër në Romë, pati paralajmëruar se çmimet botërore të ushqimit do të kenë prirje në rritje në vitin 2008 dhe në vazhdim, pas rritjes që pësuan gjatë këtij viti (2007). Ali Arslan Gurkan, shef i tregjeve të mallrave të konsumit tha se "...parashikimi për vendet importuese të mallrave të konsumit dhe naftës bruto është jo i mirë" (FINANCIAL TIME, 08/11/2007).

Já pra pse, ndërsa "kriza e çmimeve" theullohet, varfëria ka filluar të rritet. Kriza aktuale e ushqimeve është shoqëruar me konsekuenca tragjike sociale dhe politike në vende të ndryshme. Sot bota numëron 862 milion njerëz të uritur, të cilët që të mund të gëzojnë të drejtë e tyre më fondamentale njerëzore, të drejtë për tu ushqyer si element kryesor i së drejtës për të

jetuar, i duhen 30 miliardë dollarë në vit. Dhe një kërkesë e tillë bëhet në kushtet kur vetëm në vitin 2006, bota shpenzoi për armët 1200 miliard dollarë. Është kjo arsyesa, që në shumë vende dhe rajone të botës, ku progresi për reduktimin e varfërisë ka qenë i ngadaltë, pasojat kanë filluar të shfaqen dukshëm dhe me shtrirje të gjërë, ndërsa edhe në ato vende ku progresi në këtë drejtim ka qenë më i madh, varfëria po jep shenjat e rikthimit të saj. Ndiqimet më të mëdha priten të janë në vendet e Afrikës, Azisë, të Europës Lindore, (ku përfshihet edhe Shqipëria) etj., ndikime këto që, po që se nuk frenohen, mund të shndërrrohen në konflikte të ashpra sociale.

Pikërisht, në përgjigje të këtij shqetësimi, nën moton "Koha e fjalëve ka kaluar, nevojiten aksione konkrete", zhvilloi punimet Samiti i FAOs në Romë, duke risjellë kështu në vëmendjen e liderëve botërorë të shteteve (në të morën pjesë kryetarët e më shumë se 40 shteteve), dhe të institucioneve ndërkombëtare, krizën globale të çmimeve të produkteve ushqimore. Ky Samit konsiderohet si një ndërmarrje nga më seriozët për të gjetur dhe ofruar rrugët konkrete të zgjidhjes së kësaj krize. Natyrisht, zhvillimi i këtij Samiti, nuk ishte një takim i rastit, as i axhendës rutinë të FAOs, si institucion i Kombeve të Bashkuara. Ai ishte rrjedhojë e krizës globale të produkteve ushqimore, i pleksjes së saj me shumë elementë dhe faktorë të ekonomisë e të krizës globale dhe i pasojave ekonomike e sociale që ajo po shkakton në rajone e vende të ndryshme të globit. Gjithashtu ky Samit, pason reagimet e bëra dhe masat e propozuara, gjatë gjithë muajve të këtij viti, jo vetëm nga liderët e vendeve më të zhvilluara SHBA-së, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, Japonisë etj, por edhe nga grupimet dhe institucionet ndërkombëtare, si G-7, G-8, FMN, BB, OKB-ja, OPEC-u, OBT-ja, etj.

Dhe nuk kishte si të ndodhë ndryshe. Kjo sepse, këto dy-tre vitet e fundit, problemet e dala nga tronditjet në tregjet globale si: kriza e produkteve ushqimore (rritia e çmimeve të tyre), kriza energjetike (rritia e pandalshme e çmimit të naftës), të lidhura këto me ndryshimet klimatike, tronditja e tregjeve financiare (dobësimi i dollarit dhe forcimi i euros, kriza e kredive të shtëpive etj), rënia e ekonomisë amerikane dhe shfaqja e inflacionit në të (pleksja e të cilave po risjell fenomenin e viteve 70-të, atë të stagflacionit), shfaqja e fenomeneve të inflacionit edhe në

ekonominë europiane, efektet e futjes në ekonominë e tregut dhe tregun ndërkombëtar të punës (pas viteve 90-të, por veçanërisht zhvillimet pas vitit 2000) të ekonomive të vendeve të CINDIA-s (Kina dhe India) dhe të Rusisë dhe vendeve të tjera ish komuniste etj, kanë sjellë ndryshime në zhvillimet ekonomike, sociale dhe të varfërisë në botë, (veçanërisht në vendet e pazarëve) pse jo edhe të pa parashikuara. Dhe këto pasojat nuk do të janë për një e dy vjet, por parashikimet janë që ato do të vazhdojnë të ndikojnë 10-15 vjeçare... Prandaj, për të filluar realizimin e frenimit të kësaj krize (rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore), duhen zbatuar masa dhe strategji afat mesme e afat gjata. Botës- theksoi ky Samit- i nevojiten 30 miliardë dollarë në vit për të frenuar urinë në rritje. Duke vlerësuar këtë krizë dhe pasojat e saj, Samiti Romës (FAO-s) paraqiti si objektiv rritjen me 50 % të prodhimit global të produkteve ushqimore në dy dekadat e ardhshme, e cila kërkon një mbështetje të fuqishme financiare. Gjithashtu, në mbështetje të këtij objektivi, do të duhet të konsiderohen edhe politikat strukturore, fiskale dhe tregtare, për të mos lejuar barriera në këtë fushë.

Janë këto pra, arsyet që Sammiti i Romës, si përmes Fjalës së Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon, në atë të Drejtorit të Përgjithshëm të FAO-s, Jasques Diouf, dhe të kryetarëve të shumë shteteve pjesëmarrës në të, dëshmuant për një hap konkret, sipas një platforme të qartë, me aksione, veprime e masa konkrete, për përballimin e kësaj krize, e cila konsiston:

- Në rritjen e prodhimit në vendet e varfra;
- Zbatimin e programeve të anti-urisë (anti-varfërisë);
- Vlerësimi i lidhjes së krizës ushqimore me atë të karburanteve (ushqimi përballë karburanteve);
- Marrja e vendimeve kurajoze.

► Tronditja e tregjeve të naftës dhe kriza energjetike

Kur rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare arriti shifren rekord, 1 fuçi naftë = 98,62 USD dhe u pagëzua si fenomen me emrin e ri "BARRELI 100 USD", paniku i Wall Street-it nga ky fenomen, nuk mund të mos

prekte tregjet ndërkombejtare. Me gjithë reagimin e menjëherëshëm, në atë kohë, të presidentit amerikan Bush, duke thënë se: "ky është çmim shumë i lartë", dhe të ish kryeministrat italian, Prodi, që tha se: "Brukseli duhet të ndërhyjë" (La Republika, 8/11/2007 faqe nr. 2), rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombejtare dhe tronditja e këtyre tregjeve, nuk u ndalën. Kështu, sipas deklarimit të takimit të fundit të vendeve të G-8, çmimi i "arit të zi të tokës-naftës" në mes të muajit Qershori 2008, arriti vlerën e tij më të lartë, atë prej 140 USD barreli, duke shënuar një pesë-fishin të çmimit në krahasinë me vitin 2002. (me gjithë deklarimin e Arabisë Saudite se do të rrisë prodhimin e naftës me 200 mijë fuçi në ditë). Analistë, ekspertë, institucionet ekonomike ndërkombejtare, nuk kanë nguruar të deklarojnë se në fundvitin 2008 çmimi i naftës do të kapi shifrën e 200 USD barreli, ndërsa: "zëra" nga Rusia sinjalizojnë se kjo shifër mund të arrijë deri në 250 USD, duke arritur në përfundimin se tashmë e "ashtuquajtura kriza e tretë e naftës (pas asaj të viteve 1973, 1979) po shndërrohet në një kërcënëm serioz për ekonominë globale". Prandaj, ndikimet e kësaj situate nuk mund të mos konsiderohen në ekonomitë dhe situatat energetike, në vende të ndryshme, në të gjitha anët e globit. (përfshi edhe vendin tonë Shqipërinë).

Ndërkaq, kjo tronditje e tregjeve të naftës, ndryshimet klimaterike globale dhe veçanërisht parashikimet e prodhimit të naftës dhe kërkesa për të (në milion fuçi (barrela) për ditë) deri në vitin 2030, (vendet anëtare dhe jo anëtare të OPEC-ut), gjithashtu, nuk mund të mos tërheqin vëmendjen e investitorëve për rritjen e investimeve në fushën e prodhimit energetik, në të gjitha alternativat, pavarësisht qëndrimeve të rezervuara të qarqeve ambientaliste dhe antiglobaliste. Nga ana tjetër, vendet e G-8, së bashku me Kinën dhe Indinë, analizuan, gjatë ditëve të para të muajit Qershori 2008, situatën-krizë të naftës në tregjet ndërkombejtare duke shprehur shqetësimin e tyre më të madh, por dhe vlerësimin, angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre më efektiv, me institucionet dhe organizatat ndërkombejtare (FMN, OPEC), për perspektivën e kësaj situate. Ato i kërkuan FMN-së të dali me një raport konkret për gjendjen e krizës dhe ndikimin e saj ne ekonominë globale, efektet, pasojat, ndarjen e faktorëve realë me ata spekulativë, lidhjet me rënien e dollarit dhe

masat për kapërcimin e gjendjes.

Natyrisht, që edhe këto ngjarje që po ndodhin në tregjet ndërkombejtare të naftës dhe në tregjet financiare ndërkombejtare nuk ishin të rastit. Kryetarë shtetesh, politikanë, analistë, studiues, ekonomistë dhe institucionë të ndryshme ndërkombejtare, kanë ndjekur me vëmendje dhe kanë paralajmëruar ndodhinë e ngjarjeve në fjalë. Po kështu, gati dy vjet më parë, (27 Totor 2005) ish kryeministri britanik Blair, në samitin joformal të kryetarëve të shteteve të BE-së, në Hamton Court, duke shqyrtuar axhendën buxhetore të vitit 2006 të BE-së, veç të tjerave në qendër të vëmendjes pati edhe çështjen se si do të vazhdonte kriza e naftës dhe cila ishte perspektiva e zhvillimit të energjisë, naftës dhe gazit në ekonominë globale. Në këtë këndvështrim, ai parashtroi tezën se fusha e energjisë dhe zhvillimet energetike kërkohen të mbeten një prioritet dhe duhet të zhvillohen më tej me politikat e ardhshme të energjisë. Prandaj tregu energetik europian, marrëdhëniet e tij me tregun jashtë-komunitar, kërkuesat e vendeve anëtare për energji, barrierat rregullatore në tregun e energjisë, mundësitet dhe perspektivat e energjisë nukleare, etj, -tërhoqi vëmendjen ky samit, -duhet të mbeten prioritet në axhendën buxhetore europiane, që Europa të zhvillohet si fuqi e madhe ekonomike dhe konkuruese. Nga ana tjetër, gati dy-tre muaj më parë, fitueset të çmimit Nobël, iu shua dhe emri i ish-zëvendës-presidentit amerikan Al Gore, me studimin në fushën e ngrohjes globale dhe të energjisë. Pra energjia është dhe do të mbetet një nga problemet më të rëndësishme të zhvillimeve të sotme dhe të së ardhmes të ekonomise globale. ●

► "TERMET" në tregjet valutore "dobësimi i dollarit dhe forcimi i euros"

Por, tronditjet në tregjet e naftës, rritja e çmimit të "arit të zi të tokës", u shoqëruan me rënien e vlerës së dollarit amerikan dhe me ndryshime në vlerën e metaleve të çmuara, arit (ethet e arit po shfaqen), argjendit dhe platinit në raport me dollarin amerikan.

Prandaj, jo më pak interes në tregjet financiare është pritur edhe vazhdimi i rënies së vlerës së Dollarit amerikan në raport me monedhën e përbashkët europiane Euro, e cila, gjithashtu, arriti shifrën rekord në historinë e saj të këmbimit, 1 Euro = 1,58 USD, "duke marrë falënderimin

e popullsisë europiane për përballimin deri diku të pasojave të tritjes së çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare". Qershori e vitit të kaluar (2007), "bota, ekonomike e financiare, (tregjet financiare) pësuan një tronditje, u drodhën, pasi rrathët e "tërmëtit" të Bursës së Shangait, u shpërndanë gjatë gjithë javës, duke krijuar një goditje shock, në gjithë bursat e botës. Në fjalorin financiar ndërkombëtar, kjo ngjarje hyri dhe po përdoret me emrin "e marta e zezë e Shangait"

Të gjitha komentet e analistëve të tregjeve financiare, të nesërmën e së "martës së zezë" dhe gjatë ditëve në vazhdim tërhoqën menjëherë vëmendjen se Bursa e Shangait kaloi ditën e vet më të keqe të shitjes së aksioneve në këta 10 vitet e fundit, pas një vale të madhe në shitjen e aksioneve nga investitorët kryesor. Ajo arriti performancën më të keqe që nga shkurti i vitit 1997, duke e ulur indeksin e vet me 9 %. Kjo "rënie" në njërin nga Tigrat më të fuqishëm të Azisë, jo vetëm që shpërndau një frikë për rritje të inflacionit në Kinë, por njëherësh, sipas "efektit domino" tronditi dhe shkaktoi rënie në tregjet financiare në Azi, Europë e Amerikë. Bursat e Londrës, Frankfurtit, Parisit, Tokios, Hong Kongut, Brazili dhe Wall Street e ndien menjëherë tronditjen, dhe performanca e tyre u gjend e ndikuar dhe "nën presion" nga shteti dhe ekonomia kinezë.

Fillimviti që po vazhdon (2008) e zgjidhi dilemën në se tronditja e tregjeve financiare ishte "thjesht një spekulim", apo "kishte një bazë reale dhe do të jepte efekte". "E marta e zezë" u përsërit. Tregjet financiare dhe bursat u tronditën sërisht. Ekonomitë, bankat qendrore të vendeve më të zhvilluara dhe institucionet ndërkombëtare, nuk mund të mos reagonin me politika ekonomike, fiskale e në veçanti me politika monetare (politikat e interesave), për të frenuar uljen e ritmeve të rritjes, në disa prej tyre, veçanërisht në SHBA. Ekonomitë, tregtia dhe konsumatorët (jashtë SHBA) me bazë USD nuk mund të mos i ndjenin pasojet e rënies së vlerës së USD. Veçanërisht në SHBA, kjo u bë edhe më e ndjeshme, pasi u shoqërua me të ashtuquajturën "kriza e kredive, sidomos e kredive për shtëpi" dhe me recessionin në ekonomi. Uljet e disahershme të interesave që u ndërmorën nga FED dhe injektimi që Qeveria Amerikane i bëri ekonomisë (nga buxheti) për të përballuar këtë situatë, ende lënë në "fuqi" parashikimin që ish guvernatori i Federal

Rezervës së SHBA-së, zoti Greenspan, në një Konferencë në Tel Aviv, në mes të vitit 2007 do të deklaronte se "...dollarë do të vazhdojë të jetë i dobët edhe për disa vite", e që ky fenomen do të mbetej në qendër të vëmendjes.

Por, ndërsa analistë, ekonomistë, institucionë të ndryshme financiare e bankare në botë, duke analizuar këtë situatë, kanë filluar të hedhin ne "treg" mendime e teori të ndryshme për reformimin e sistemit monetar ndërkombëtar, për të kaluar në bipolizimin (dollar/euro), apo tripolizimin (dollar/euro/jen për Azinë) të valutës ndërkombëtare, guvernatori aktual i FED në SHBA, Frederik Mishkin, me gjithë situatat e krijuara në ekonominë amerikane (inflacioni në fund të muajit maj arri 4.2% dhe papunësia 5.5%) dhe në tregjet valutore ndërkombëtarë (1 Euro = 1.545 USD), në një konferencë shtypi, në fillim të muajit Qershor 2008, nuk ka nguruar të deklarojë, se "...frenimi i recensionit në ekonominë amerikane u arrit dhe se tashmë fillon rritja ..."


Implikimet në ekonominë shqiptare, masat për minimizimin e tyre

Zhvillimet dhe kriza aktuale globale nuk mund të mos ketë ndikimet e veta dhe implikimet e saj në ekonominë tonë. Kjo sepse ne jemi një ekonomi e vogël dhe relativisht e hapur. Konkrektisht, këto implikime dhe ndikime duken në:

Së pari: Kriza ushqimore (rritia, e çmimeve të produkteve ushqimore) dhe inflacioni që ka përfshirë ekonominë globale, Amerikën, Europën e Azinë ka sjellë implikimet edhe në ekonominë shqiptare, dhe goditi edhe konsumatorë shqiptarë.

"Kriza e çmimeve të produkteve bujqësore dhe ushqimore", që prej gati një viti, ka mbërthyer edhe ekonominë shqiptare dhe konsumatorët e vendit tonë. Treguesit e bërë publik nga INSTAT, dëshmojnë se rritja e çmimeve në tremujorin e parë të këtij viti shënoi një rritje të dukshme (indeksi i çmimeve të konsumit në muajin mars 2008, arri 102.4 % kundrejt muajit dhjetor 2007) duke bërë që inflacioni të tejkalonte objektivin e parashikuar, dhe të arrinte shifrën 4.6 %, një rritje prej 1.9 % në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (Edhe për 4-mujorin inflacioni mbeti në shkallën 4.4 %, me gjithë fillimin e futjes së produkteve të

prodhuara në vend). Me gjithë rritjen e lehtë të eksporteve, tregu shqiptar i produkteve bujqësore dhe ushqimore ka kryesisht burim furnizimi importin. Kësosoj, edhe deficiti tregtar shënoi një rritje prej 27 %, në fund të vitit 2007, ose 2.26 miliardë lekë apo 28.6 % të PBB-së.



Burimi: INSTAT, Indeksi i çmimeve të Konsumit, Mars 2008

Kjo ka bërë që varfëria të rritet më tej, veçanërisht në zonat verilindore dhe rurale të vendit. Buxhetet familjare, sidomos të pensionistëve, shtresave në nevojë dhe familjeve me të ardhura të pakta, po rrënohen gjithnjë e më shumë. Mjafton të përmendim se: rreth 16.9 % e popullsisë jetojnë me më pak se 2 USD/frymë, duke mos plotësuar nevojat më minimale të tyre, rreth 400 mijë familje pensionistësh jetojnë me 1.2 USD në ditë, kurse 88 mijë prej tyre jetojnë, vetëm me 1 USD në ditë. Sipas Bankës Botërore, shqiptarët që jetojnë nën minimumin jetik shpenzojnë 50 USD/muaj. Rreth 550 mijë persona në vendin tonë jetojnë në varfëri ekstreme. Kështu, kësaj situate, po t'i shtojmë dhe efektet e pritshme (të jashtme) të "krizës globale të çmimeve të produkteve ushqimore", që sipas Bankës Botërore, vetëm një rritje me 5 % e çmimeve të produkteve ushqimore (që në fakt është më e madhe), pritet të rrisë me 2 pikë përqindje numrin e të varfërvë në shtete si Shqipëria, Gjeorgjia, Azerbajxhani dhe Moldavia, pasojat do të janë edhe më të mëdha.

Së dyti: Kriza energetike (Kriza globale e tregjeve të naftës). Megjithëse Shqipëria është një vend prodhues dhe konsumator i vogël i naftës në raport me vendet e tjera Europiane dhe më gjërë, (vala e protestave të ditëve të fundit në shumë vende europiane si reagim ndaj krizës së naftës) implikimet në ekonominë e saj, për shkak të ngjarjeve në tregjet ndërkombëtare të

naftës dhe tregjet financiare ndërkombëtare, nuk mund të mos konsiderohen. Kjo jo vetëm për shkak se vendi ynë, për vite të tëra po kalon një križë të stërgjatur e të ricikluar energjetike (kriza e këtij viti dhe ajo që pritet në vitin në vazhdim është më e rënda dhe me efekte negative shumë të mëdha në ekonomi), por edhe për faktin se ndikimet dhe pasojat ekonomike e financiare (buxhetore) të kësaj krize energetike, si dhe presionet inflacioniste dhe të rritjes së çmimeve, janë tashmë prezente në ekonominë tonë, pse jo dhe kërcënuese (veçanërisht kriza energetike). Pasojat e krizës energetike vazhdojnë të kenë implikimet e veta në ekonomi, në zhvillimin e biznesit privat dhe veçanërisht pasojat shtohen dhe transferohen në "xhepat e qytetarëve shqiptarë", të konsumatorëve. Kjo, sepse brenda një kohe të shkurtër çmimi i karburanteve në vend për konsumatorët dhe prodhuesit u rrit me shpejtësi, duke pritur që, për konsumatorët, të arrijë në 200 lekë për litër dhe duke ndikuar gjithashtu dukshëm në rritjen e kostove të prodhimeve për bizneset e tyre.

Për të minimizuar ndikimin e kësaj krize globale (ushqimore dhe të naftës), mund dhe duhen të merren disa masa:

Në përcaktimin me të drejtë të strategjive, prioriteteve, politikave dhe reformës strukturore të prodhimit bujqësor e të produkteve agro-ushqimore, me synim përmirësimin e plotësimit të kërkesës në tregun vendas me prodhime vendase dhe duke ndikuar në përmirësimin e raporteve eksport-import në vend;

Në rritjen e mbështetjes financiare dhe materiale në dobi të sektorit agro-ushqimor, veçanërisht atij bujqësor në fara, ujite, teknologji në këtë sektor, etj;

Në përmirësimin e politikave tregtare, sistemit të grumbullimit dhe tregtimit të prodhimeve agro-ushqimore në vend dhe të një strukture ndihmëse të tregtisë me jashtë;

Në përmirësimin e politikës fiskale në sektorin e bujqësisë për të nxitur punimin e tokave djerrë, rritjen e prodhimit dhe të eksporteve, në përmirësimin e politikave dhe uljen e tarifave për disa produkte të importit (tarifa doganore e grurit, drithërave të tjera etj);

Në krijimin e "Depove Ushqimore" private (tip magazina Doganore) për të përballuar nevojat emergjente për këto mallra në vendin tonë (për një periudhë të caktuar);

Në krijimin dhe përdorimin e burimeve alternative energetike në vend;

Në përmirësimet në politiken fiskale dhe tativore për naftën (taksa speciale, mënyrë efikase e përdorimit të TVSH-së që të ndikojë në mënyrë fikse mbi çmimin e karburanteve, për një periudhe të caktuar kohe, tek konsumatorët - sipas propozimit të Presidentit francez Sarkozy") etj;


Në përmirësimet në politikën monetare dhe në ndjekjen e kujdeshme nga Banka e Shqipërisë të nivlet të çmimeve dhe inflacionit;

Në zbatimin e politikave diferencuese, kompensuese të pagave dhe të pensioneve, për të mbështetur më shumë familjet në nevojë, pensionistët etj,

Pra, për të minimizuar efektet e krizës globale të tregjeve ushqimore dhe të naftës është e domosdoshme për më pak fjalë e fjalime... Është koha e aksioneve, vendimeve dhe veprimeve konkrete, për të përballuar implikimet e saj. Edhe në Shqipëri është koha për veprime konkrete dhe kryerjen e reformave të nevojshme, koha të ecim drejt zhvillimit dhe integrimit të vendit në BE. ●

ANALIZA E BILANCIT TREGETAR NE SHQIPERI - PSE KAQ NEGATIV ?

Dr. SELIM BELORTAJA



► Paradoksi i stabilitetit makroekonomik në raport me klimën e biznesit dhe mirëqenien

Prej më se 17 vjetësh, ekonomia shqiptare, me ndërprerje shumë afatshkurtër ngjarjesh të jashtëzakonshme (kriza e vitit 1997), vazhdon të demonstrojë një nivel të kënaqshëm e thuajse të qëndrueshëm të treguesve makroekonomikë dhe atyre makrofiskalë. Një fakt i tillë edhe pse pak i ndjeshëm dhe i perceptueshëm në termat e mirëqenies së njerëzve dhe veçanërisht dimensioneve të saj sociale, krahas deklarimeve të qeverisë, dokumentohet edhe nga raportet e monitoruesve kryesore ndërkombëtarë, kryesishët Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Ndërkohë, edhe një shqyrtim i sipërfaqshëm i klimës së biznesit në vend dhe sidomos kushteve të jetesës, veçanërisht në tregues të tillë si niveli i varfërisë, dimensioni infrastrukturor, mjedisor e hapësinor i saj (furnizimi me shërbimet bazë me energji e ujë, strehimi, ruajtja dhe zhvillimi i ambienteve publike dhe ambientit në tërsësi, etj.), shkalla e papunësisë reale të plotë dhe të përkohshme, pabarazia e thellë sociale, si dhe imbetja pezull e çështjes së pronës si elementi bazë i klimës së biznesit dhe tërheqjes së investimeve të huaja, shpalosin një pamje tjetër. Kjo pamje dokumentohet gjithashtu më së miri nga studime të thelluara e raporte të plota të instituteve të specializuara ndërkombëtare si

Forumi Ekonomik Botëror i Gjenevës, Banka Botërore dhe programi i saj i posaçëm "Të bësh Biznes" që vlerëson klimën e sipërmarrjes dhe investimeve, si dhe një sërë raportesh të tjera mbi çështje më specifike, si korruptioni, inovacioni, infrastruktura, logistika e tregut, etj.

Këtë tablo të dyfishtë rezultatesh, që karakterizojnë gjendjen ekonomike-sociale të Shqipërisë, mund ta konsiderojmë, jo pa baza, si një paradoks. Tiparet e paradoksit shprehen jo vetëm në kahun e kundërt të rezultateve - në të dy blloqet e vlerësimit, atë "makro" nga njëra anë dhe atë "mikro" nga ana tjeter, por edhe në një fakt tjeter. Në faktin që zhvillimet më të fundit po nxjerrin në pah vështirësinë e bashkë-ekzistencës mes këtyre dy krahëve; çka shprehet më së miri në tronditjen e parë serioze mbas kaq vitesh që po pësojnë tregues bazë makroekonomikë, kryesisht çmimet me pakicë dhe shumicë dhe inflacioni.

Ky paradoks, gjithsesi, vazhdon të jetë prezent edhe sot, me gjithë luhatjet dhe rënien e mitit të qëndrueshmërisë makro, në kushtet e një paqëndrueshmërie "mikro". Edhe për vitin në vazhdim, vlerësimi i përgjithshëm lidhur me situatën makroekonomike të Shqipërisë është se ekonomia vazhdon të gëzojë një ekuilibër të qëndrueshëm. Pas rritjes me 6% në vitin 2007, prodhimi i përgjithshëm bruto, në terma reale, pritet që të ruajë të njëjtin ritëm edhe në vitin në vazhdim. Gjithashtu inflacioni, shpresohet që për vitin 2008 të mbahet në nivelin mesatar prej 4%, por me disa parakushte zhvillimesh e politikash të nevojshme. Siç vuri në dukje misioni i fundit i FMN, ruajtja e inflacionit në ato kufij do të ishte e mundur vetëm në se do "...të evitohen presionet e brendshme ndaj kërkësës" dhe të aplikohen "...politika të matura buxhetore dhe monetare".

Tab. 1 pasqyron ecurinë e treguesve kryesorë të makroekonomikë e fiskalë për periudhën 2004-2007 si dhe parashikimin për vitin në vazhdim (2008).

Tab 1. Shqipëria: Tregues të zgjedhur makroekonomikë

	2004	2005	2006	2007	2008
PBB reale	5.9	5.5	5.0	6.0	6.0
Inflacioni (Indeksi i çm. mesatare vjetore)	2.9	2.4	2.6	2.9	4.0
Bilanci fiskal (Deficiti buxhetor)	-5.1	-3.4	-3.2	-3.8	-5.2
Bilanci i llogarisë korrente	-5.5	-6.5	-5.9	-9.5	-8.8
Investimet e Huaja Direkte	4.6	3.3	3.5	6.2	3.4
Tranfertat e emigrantëve	13.8	14.2	14.0	13.9	14.0

Burimi: NSI, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, INSTAT, Banka Botërore dhe databaza të FMN

Normaliteti i afishuar i treguesve "makro" për Shqipërinë, evidentohet qartë edhe nga tabelat krahasuese me vendet e tjera në tranzicion - veçanërisht ato të rajonit. Tabela 2. sjell të dhënat krahasimore të rritjes ekonomike, inflacionit -si indeks i çmimeve me pakicë, bilancit të llogarisë korrente, deficitit buxhetor dhe borxhit publik.

Tab 2. Tregues makroekonomikë të disa vendeve te rajonit -2007

	Rritja reale e PBB (%)	Inflacioni (IÇK)	Llogaria Korente	Deficiti buxhetor	Borxhi bruto i qeverise ¹
Shqipëria	6.0	2.9	-8.3	-4.2	56.0
Bosnja & Hercegovina	5.8	1.3	-13.0	1.0	23.0
Bullgaria	6.2	7.6	-21.4	3.7	24.6
Kroacia	5.8	2.9	-8.5	-2.3	41.0
Maqedonia, FYR	5.0	2.2	-2.7	0.6	...
Moldavia	5.0	12.6	-9.7	-0.3	34.6
Mali i ZI	7.5	3.4	-37.0	5.5	...
Rumania	6.0	4.8	-13.9	-2.3	12.4
Serbia	7.3	6.8	-16.5	-1.8	39.6

Burimi: Sipas FMN, "World Economic Outlook 2008"

► Klima e biznesit dhe konkurrueshmëria – ana tjetër e medaljes

Ndërkojë, vlerësimet lidhur me konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe produkteve shqiptare dhe klimën e biznesit në Shqipëri, rezervojnë një pamje tjetër.

Thelbi i performancës dhe aftësisë së një ekonomie për t'i qëndruar presioneve konkurruuese dhe për t'u zhvilluar me ritme të qëndrueshme, në trajtën më sintetike shprehet nga indeksi i konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe prodhuesve vendas.

Konkurrueshmëria -sipas përpunuesve të Indeksit të Konkurrueshmërisë Globale - është një tregues aggregat i shumë dimensioneve, përkufizohet si "tërësia e Institucioneve, politikave, dhe faktorëve që përcaktojnë nivelin

e produktivitetit të një vendi"

Si paraqitet Shqipëria lidhur me këtë indeks dhe komponentët e tij? Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale e rendit Shqipërinë në një pozicion aspak të kënaqshme. Shqipëria 2007 klasifikohet e 109-a nga 131 vende të botës. Duke mos shënuar kurfarë progresi në krahasim me një vit më parë kur rendita ishte në vandin 98 nga 122 vende të shqyrtuara. Ecuria negative shprehet më mirë përmes treguesit absolut të pikëve të marra, ku përkatësisht për 2006 dhe 2007 është shënuar nota 3.56 dhe 3.48.

Në tregues të veçantë, mes dy mbëdhjetë treguesve që përbëjnë konkurrueshmërinë, Shqipëria paraqitet me renditje edhe më problematike. Kështu disa të dhëna të krahasuara me një vit më parë janë:

Shqipëria	2007	2006
Renditet	131	në "inovacion"
"	124	në "Infrastrukturë"
"	117	në "eficienca e tregut"
"	114	në "Institucionë"
"	74	në "gatishmëri teknologjike"

Fakti më shqetësues: reshtohemi të fundit në rajon!!

Një tregues më direkt lidhur me aftësimin e sipërmarrjes, është Indeksi i Konkurueshmërisë së Biznesit. Këtu Shqipëria 2007, renditet e 122-ta nga 127 vende të vlerësuara. Ndërkohe që për 2006 renditja është e 119-a nga 121 vende.

Ndërsa treguesi i "lehtësisë së të bërit biznes" në Shqipëri, na jep një vlerësim edhe më direkt dhe më qartësish "të kuantifikuar" të mjedisit të biznesit dhe mbështetjes që ai ofron për sipërmarrjen dhe investimet direkte. Në riportin e saj më të fundit mbi këtë temë, "Doing Business in 2008", Banka Botërore e rreshton Shqipërinë në vendin e 136 mes 178 vendeve të shqyrtuara. Është vështirë edhe këtu të identifikojmë ndonjë progres tek shohim që klasifikimi i një viti më parë ishte vendi 120 mes 175 vendeve të botës.

Në tregues më të hollësishëm, të krahasuar me një vit më parë, klima shqiptare e biznesit reshtohet:

2007	2006
165 në mbrojtje investitorëve në pakicë	(162)
118 në pagesën e taksave	(125) përmirësim
168 në "punën me licencat"	(161) problem
123 në "hapjen e një biznesi"	(121)
70 në "Tregtimin më jashtë"	(101) përmirësim
178 në "mbylljen e biznesit"	(89) problem

Po kështu sipas një raporti tjeter të posaçëm të Bankës Botërore, lidhur me Indeksin e Performancës së Logistikës së tregut (Logistics Performance Index -LPI), Shqipëria renditet e 139 nga 150 vende në total. Përsëri një vend i fund.t ne rajon.

PASOJA: - DISBALANCA DHE SHPERPJE TIME

Ndërkohë që PBB rritet me ritme të kënaqshme dhe pak a shumë të qëndrueshme, sektorë të veçantë të ekonomisë shfaqin luhatje të ndjeshme (Tab. 3). Shqetësuese është situata me ritmet e rritjes së prodhimit bujqësor, ku jeton më shumë se gjysma e popullsisë së vendit dhe ku ndodhet edhe pjesa dërmuese e të varfërve.

Tab 3. Shqipëria: Rritja e PBB sipas aktiviteteve ekonomike					
	2004	2005	2006 (vlerësim)	2007 (vlerësim)	2008 (parashikim)
Bujqësia, pyjet, peshkimi	4.0	1.0	3.0	-1.9	2.5
Industria e Minierat	14.5	3.0	7.8	14.0	10.0
Ndërtimi	7.9	11.9	10.3	8.0	8.0
Tregti, hoteleri, restorante	3.7	8.6	5.0	9.0	7.5
Transport	9.6	3.1	5.0	8.0	8.0
Post-telekomunikacioni	6.3	10.0	2.1	5.0	4.0
Shërbime të tjera	2.5	5.0	2.5	5.0	4.0
PBB reale me çmime tregu	5.9	5.8	5.0	6.0	6.0

Burimi: IMF Country Report No.08/128

Ekonomia reale veçanërisht në prodhimin bujqësor, sektorin minerar dhe atë të prodhimit të metaleve duket se po reagonjë pozitivisht ndonëse ngadalë, ndaj efektit të rritjes globale të çmimeve. Ndërkohë kontributi i bujqësisë në PBB, kryesisht si rezultat i konkurrueshmërisë së ulët, vazhdon të bjerë.

Tab 4. Shqipëria: PBB dhe struktura e tij 2007					
	2003	2004	2005	2006	2007
(Ndryshimi në përqindje përvëç rasteve te specifikuara ndryshe)				Parashikime	
PBB nominale (mln lekë)	682,670	766,379	836,833	899,637	969,000
Struktura (%)					
Industri	7.9	9	10.5	11.1	10.9
Bujqësi	21.8	20.5	21.9	21.5	21.2
Ndërtim	12.5	12.5	15	15.7	16.4
Transport	4.9	4.9	5.5	5.6	5.8
Shërbime te tjera	41.2	41.2	47.1	46	45.7
Totali	100	100	100	100	100

Burime: NSI , Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, INSTAT, Banka Botërore dhe databaza të FMN-së

Disbalancat më të theksuara "zbulohen" përmes statistikave të tregtisë së jashtme dhe të bilancit të pagesave. Kështu:

Importet 3,9 herë me te larta se eksportet (mbulimi i importeve 2007 më i ulët se sa 2006) Deficiti tregtar ndaj PBB përkeqësohet 2007 (28.6% nga 24.6%)

Rritja e eksporteve (%) pak më e ulët se sa ajo e importeve.

Hapja tregtare ende mbetet më e ulëta në rajon (me gjithë rritjen në 48% në 2008)

Përqendrim i lartë i eksporteve në pak produkte (10 grup-produktesh 44% të eksportit total).

Shpërndarje gjeografike shumë disproporcionale ("Tregu i BE" në fakt është .. Italia!!)

Fakti më shqetësues: eksportet në volum janë 2.5 herë me te larta se sa vlera e tyre në Lek. Në 2007 u regjistrua rritje me 69% në sasi (ton) e eksporteve totale te Shqipërisë, ndërsa rritja e tyre ne vlefte ishte 27 % ndaj vitit te kaluar".

Problem i mprehtë dhe kërcënëm për stabilitetin makroekonomik e atë fiskal mbetet situata në sektorin e energjisë elektrike. Ndërkohë që KESH duket se nuk po ja del dot t'i përgjigjet asaj. Mangësia kryesore lidhet me energjinë e papaguar. Vetëm gati gjysma e energjisë së furnizuar për 2007 është paguar, shifër kjo shumë larg vendeve të rajonit ku paguhet mbi 75% e energjisë së hedhur në rrjet. Ndërsa aspekti fiskal rëndohet me faktin e rritjes së çmimeve të energjisë së blerë nga KESH. Importi i energjisë për 2007 ishte rreth 7 herë më i lartë se sa ai i 2006-ës duke kaluar vlefte 200 milion Euro. Energjia e papaguar, së bashku me rritjen e çmimeve dhe sasisë së importeve mbeten problem.

Donatorët këshillojnë që masat e parashikuara nga Plan Veprimi përkatës të realizohen me korrektesë. Axbenda e privatizimit të KESH-it është duke ngjallur interesim të mirëpritur, por pozicioni finanziar i kompanisë mbetet i dobët. Rritja e tarifave prej 20 për qind në mars ndihmoi financat e kompanisë, po ashtu siç kanë ndihmuar edhe reshjet e mbarë. Për më tepër, në bashkëpunim me Bankën Botërore, planifikohen përmirësimë ambicioze në mbledhjen e të ardhurave dhe reduktimin e vjedhjeve. Megjithatë, me ecurinë aktuale, humbja indirekte e financave publike do të shkojë në treth 1.4 për qind të PBB-së. Kjo është më shumë se gjysma e shpenzimeve publike për

shëndetësinë dhe evidenton nevojën urgjente për masa korrigjuese. KESH-i duhet të reduktojë importet, të mbajë në fre kostot e personelit dhe të prioritarizojë investimet brenda një buxheti më të vogël nëse do të evitojë rritje të mëtejshme të tarifave.

Si përfundim duhet thënë se me gjithë progresin e bërë në treguesit e standardit të jetesës dhe nivelit të të ardhurave, Shqipëria mbetet ende imbrapa vendeve të rajonit. Kjo e bën të domosdoshme pëershpejtimin e masave të konvergjencës lidhur me këta tregues, sfidë kjo që nuk mund të arrihet pa siguruar një rritje me ritme më të larta e më të qëndrueshme të produktivitetit. Prandaj edhe analiza më e re që Banka Botërore është duke bërë nëpërmjet hartimit të CEM 2008 do të ketë në fokus pikërisht Mbështetjen për rritjen e Produktivitetit dhe Reduktimin e Risqeve dhe paqëndrueshmërive.

► Disa zhvillime "makro" gjatë tremujorit I 2008

Rritja e pandërprerë e çmimeve të mallrave ushqimore, të lëndëve të para, të naftës dhe nënprodukteve të saj, etj, dëshmon se presioni i ambientit të jashtëm në ekonominë shqiptare është prezent dhe po persiston edhe gjatë katër muajve të parë të vitit 2008. Por imbrapa këtij faktori global nuk mund të mohohet se

Ndërprerja e kufizimeve masive dhe të gjata të furnizimit të energjisë ka influencuar pozitivisht procesin e prodhimit dhënkonsument, në krahasim me gjysmën e dytë të vitit të kaluar. Megjithatë, sektori energetik mbeti në fokus të misionit më të fundit të FMN, bazuar në vlerësimin se, energjia vazhdon të mbetet një problem delikat si për ekuilibrat makro-fiskalë ashtu edhe për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Inflacioni vjetor në fund të muajit prill 2008 u ndal në nivelin 4.4 për qind, duke tejkular me rrith 0.4 pikë përqindjeje kufirin e sipërm të intervalit $3+/-1\%$, të synuar nga Banka e Shqipërisë. Kjo shifër në vetvete pasqyron kontributin e grupit të ushqimeve të përpunuara dhe rritjen e çmimit të energjisë elektrike, në muajin mars 2008. Rritja e fundit e çmimit të energjisë elektrike ka kontribuar me 0.7 pikë përqindjeje.

Mbështetur në parashikimet afatshkurtra, rezulton se inflacioni do të vazhdojë të luhatet në nivelet aktuale edhe gjatë muajve në vazhdim, duke ruajtur nivelin mesatar prej 4%.

Vlerësohet se presionet inflacioniste vazhdojnë të rriten si nga ana e ofertës ashtu edhe e kërkesës. Zhvillimet e fundit në tregjet ndërkombëtare si dhe ato të pritshmë lënë të hapur mundësinë për sfida të reja në këtë drejtim. Mallrat ushqimore, lëndët e para por veçanërisht nafta dhe nënproduktet e saj po njohin rritje të pandalshme në tregun ndërkombëtar.

Në krahun e kërkesës treziqet lidhen kryesisht me zgjerimin e shpejtë të kredisë për ekonominë. Rëndësi i duhet kushtuar edhe masave të mundshme që autoritetet mund të ndërmarrin për të zbutur efektin e rritjes së çmimeve të mallrave ushqimore.

Por kjo duhet bërë me kujdes, në mënyrë që të evitohet përfshirja në një spirale të re inflacioniste. Për këtë Banka e Shqipërisë rekomandon që kjo të bëhet nëpërmjet masave për financimin e drejtpërdrejtë të njerëzve në nevojë dhe jo përmes masave të natyrës subvencionuese apo të rritjes së përgjithshme të pagave e pensioneve.

Gjatë muajve të parë të vitit 2008, zhvillimet fiskale dëshmojnë për një ecuri të kënaqshme të grumbullimit të të ardhurave buxhetore. Ndërsa nuk mund të thuhet e njëjta gjë lidhur me shpenzimet, ku veçanërisht shpenzimet kapitale, dëshmojnë një nivel realizimi shumë shqetësues.

Një zhvillim tjetër që kërkon vëmendje të veçantë ka të bëjë me thellimin e deficitit të llogarisë korrente. Të dhënët e viti të kaluar e mbështesin këtë shqetësim. Aktiviteti tregtar i vendit me pjesën tjetër të botës, për muajt e parë të vitit 2008, dëshmon për një rënje të ritmit të rritjes së tregtisë së jashtme, veçanërisht në krahun e eksporteve. Pas rritjes përkatësisht me 26 dhe 25% të vlefët së importeve dhe eksporteve për vitin 2007, shifrat e 4-mujorit të parë 2008 flasin për një rritje prej vetëm 15.8% për eksportet dhe 14.6% për importet.

► Rekomandimet kryesore në linjë me monitoruesit e programit ekonomik të vendit

Studiuesit dhe sidomos monitoruesit e programit ekonomik të vendit vërejnë se performanca

përgjithësish e mirë (makro)ekonomike mund të vijojë edhe në të ardhmen në se disa probleme të vjetra do të mund të trajtohen e zgjidhen me forcën e duhur.

Veçanërisht sektori me humbje i energjisë elektrike përbën një kërcënim të madh për buxhetin dhe redukton rritjen potenciale.

Po kështu, pranohet se në përgjithësi, klima e biznesit kërkon përmirësimë për të térhequr investimet cilësore që i nevojiten ekonomisë.

Risqet fiskale duhet të trajtohen me përparësi. Rritja e dukshme e të ardhurave duhet të përdoret për të konsoliduar financat publike dhe për ta mbajtur deficitin buxhetor të 2008-ës në kufirin e 5.2% të PBB. Duke qenë se disa rreziqe fiskale mbeten—p.sh. tejkalimi i kostos në rrugën Rrëshen-Kalimash dhe situata e keqe financiare e KESH-it—planet e Ministrisë së Financave për të mbajtur fonde kontigjence të mjafqueshme janë të mirëpritura.

Buxheti duhet të ankorohet fort dhe të ulë borxhin në raport me PBB-në, të trisë besueshmërinë dhe transparencën. Kjo çështje bëhet edhe më urgjente në një kohë kur Shqipëria do të fillojë të marrë hua në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Ne i inkurajojmë autoritetet të miratojnë një rregull formal fiskal-qoftë i bazuar në shpenzimet, qoftë në deficit-më e mira do ishte duke filluar që nga buxheti i 2009. Përforcimi i kapaciteteve në menaxhimin e borxhit është gjithashtu i rëndësishëm.

Për të ruajtur stabilitetin e inflacionit, është shumë e rëndësishme të evitojen presionet e rendshme ndaj kërkesës. Në mënyrë të veçantë, ndërsa ndihma ndaj të varfërve përtë kompensuar efektet e çmimeve të rritura të ushqimeve dhe të energjisë është e drejtë, rritjet reale të rrogave në sektorin publik duhet të kufizohen fort, për të shmangur nxitjen e një spiraleje paga-inflacion. FMN rekomandon politika të kujdeshme edhe lidhur me kredi-dhënien për biznesin. Forcimi proaktiv i mbikëqyrjes dhe kuadrit tregulator duhet të ndihmojë në ngadalësimin e rritjes së kredive dhe duhet ndjekur në mënyrë të vazhdueshme. Miratimi i amendamenteve përkatëse të Kodit Civil është kyç për një ekzekutim më të mirë të kolateralit.

Reformat në sektorin e energjisë duhet të marrin prioritet real. Si rezultat i problemeve lidhur me administrimin në sektorin energetik humbja indirekte e financave publike parashikohet të rritet.

Reformat strukturore duhet të bëjnë një tjetër hap përpara. Veprimet e fundit për të lehtësuar barrën rregullative janë të rëndësishme. Megjithatë, të drejtat e pronësisë, zbatimi i kontratave, (mirë)qeverisja dhe sistemi gjyqësor mbeten dobësítë kryesore. Reformat në prokurimin publik kërkojnë zbatim më të gjerë, ndërsa shtrirja, shpeshtësia dhe cilësia e statistikave duhet të përmirësohet, sidomos përsa i përket llogarive kombëtare. Duhet bërë kujdes që INSTAT-it do t'i akordohen fonde të mjaftueshme për të zbatuar përmirësimet e nevojshme.

Duke njojur rolin që do të vazhdojnë të luajnë faktorët totalë të produktivitetit (TFP – Total Factor Productivity), dhe peshën që mban brenda tyre faktori makroekonomik, për të ardhmen kërkohet një vëmendje më e madhe lidhur me adresimin e shqëritësimeve që lidhen me këta faktorë.

Ka ardhur koha kur Shqipëria duhet të kapërcejë tashmë nga një model i bazuar në konsumin në një model me orientim nga investimet gjithnjë e më të larta dhe nga eksportet, si rruga e vetme për të realizuar një potencial rritjeje afatgjatë. Kjo është një sfidë e vështirë veçanërisht në kontekstin e disbalancave të mëdha të jashtme, rritjes së madhe të kredive, deficitit fiskal në rritje dhe rolit rë transfertave të mëdha nga jashtë.

Në këto rrethana, politikave makroekonomike ju bie një përgjegjësi edhe më e madhe. Ç'mund të bëjnë ato për të përballuar ndryshimet e mësipërme -duke ruajtur njëkohësisht nivelin e bilancit korrent dhe atij fiskal? Sa mund të ndikojnë ato për përdorimin e transfertave nga emigracioni, në një mënyrë më të balancuar mes konsumit dhe investimit? Si të harmonizohen më mirë komponentët dhe potenciali makroekonomik e fiskal me një klimë që motivon sipërmarrjen, flukset e investimeve, zgjerimin e tregjeve të eksportit dhe progresin teknologjik?

Rëndësi të veçantë merr këtu adresimi nga administrata qeverisëse e risqeve makroekonomike, si atyre ekzistuese ashtu edhe atyre të reja që po dalin, risqet që prekin balancat

e brendshme e të jashtme makroekonomike e makrofiskale. Duke i evituar ato krijohen kushtet e domosdoshme për tërheqjen e investimeve si vendase ashtu edhe atyre të huaja direkte për të cilat ekonomia ka nevojë shumë të madhe. Mbi këto pikëpyetje duhet menduar qysh tani e vazhdimisht sepse ato do të jenë sfida të pashmangshme për kërkeshat e ardhme që shtrohen në rrugën e integrimit europian të vendit. Kjo sepse është e qartë tashmë se i ashtuquajturi "Kriter ekonomik i aksesimit të BE", nuk mund të ezaurohet me tregues të thjeshtë sasiore, sikundër kuptohet e interpretohet nganjëherë gabimisht. Ai nuk duhet parë thjesht as si nivel treguesish "makro" për t'u arritur (GDP, inflacion, deficit, kursime, investime, etj), as si bilance makro-fiskale apo të pagesave (kaq para të mbledhura, aq shpenzime të kryera, kaq vepra për t'u inauguruara, etj), as si "kualifikim" i vendit për të përfituar fonde europiane në trajtë grantesh e ndihmash (më shumë ndihma se pse.. "mëshumë performancë"), as si shkallë liberalizimi tregtar tarifor, (ulja kaq apo aq e tarifave doganore) dhe as thjesht si përcaktim e fiksim "prioritetesh" te caktuara. Para së gjithash kriteri i anëtarësimit është një objektiv cilësor për t'u arritur, dhe kjo shprehet qartë në formulimin e samitit të Kopenhagenit. Deklarata e presidencës së BE e paraqet kriterin ekonomik si:

"....ekzistencën e një ekonomie tregu funksionuese, si dhe kapacitet për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut (market forces) të BE-së.."

Pra kriteri ekonomik i anëtarësimit - ne se pranojmë se ekziston një i tillë -para së gjithash është një KRITER CILËSOR dhe jo Sasiot.

Treguesit Makro janë derivate të një "ekonomie tregu funksionuese". Në se kjo e fundit nuk është i tillë; vetë treguesit lëkunden dhe këtë e tregojnë rastet e fundit të lëkundjeve.

Thelbi i vërtetë i kriterit ekonomik pra mbetet KONKURRUESHMËRIA e ekonomisë dhe e prodhuesve vendas, në të gjitha dimensionet e saj. ●

TENDENCAT NE INDUSTRINE E SIGURIMEVE NE SHQIPERI

BARDHYL MINXHOZI

Drejtori Ekzekutiv i kompanisë "Interalbanian"

bminxhozi@interalbanian.com

Tel: 069 20 31 368

Industria e sigurimeve është një nga degët e reja që u themelua vetëm pas vitit 1990. Përveç vështirësive të fillimit që ka çdo industri e re, industria e sigurimeve në Shqipëri u përball edhe me sfidat e një tranzicioni të zgjatur, nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik si dhe me krisën e "piramidave" të viteve 1996-1997. Tani, pas afër 18 vitesh, mund të kuptohen më mirë jo vetëm problemet e mëdha të rrithjes së kësaj industrie, por dhe rëndësia që kanë sigurimet në një ekonomi tregu. Mbrojtja financiare e një individi apo biznesi, në rast fatkeqësie natyrore apo aksidenti automobilistik, nuk mund të jetë thjesht një çështje personale apo private, por mbi të gjitha çështje e rëndësishme e interesit publik.

D Konsiderata të përgjithshme mbi tregun e sigurimeve

Kështu, përpara se të flasim për problematikën e tregut shqiptar të sigurimeve dhe disa tendencia të zhvillimit perspektiv të këtij tregu në vitet e ardhshme, le të flasim shkurt mbi disa nga shtylla kryesore institucionale në të cilat mbështetet funksionimi i industriës së sigurimeve.

Industria e sigurimeve mbështetet në një infrastrukturë legale komplekse.

Sigurimet konsiderohen si një nga industritë më të rregulluara. Kjo ndodh përfaktin se sigurimet janë një industri me interes të dallueshmë publik, ku kompanitë grumbullojnë para përf të marrë përsipër detyrime ndaj një publiku të gjërë në mënyrë të detyrueshme apo dhe vullnetare.

Çdo arkëtim i siguruar nga kompanitë e sigurimeve, "krijon" një përgjegjësi të shumëfishtë për klientët në rast aksidentesh apo fatkeqësish natyrore. Përveç kushteve të licencimit dhe të kryerjes së aktivitetit të kompanive (të cilat rregullohen me ligjin e sigurimeve dhe risigurimeve) për çdo produkt apo kategori treziqesh, ka rregulla të përcaktuara që kompanitë janë të detyruara t'i respektojnë. Nga ana tjetër, aftësia paguese minimale, kapitali dhe rezervat (fondi i gatshëm për pagesën e dëmeve që do të ndodhin në të ardhmen) janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në ligj dhe

akte të tjera nënligjore.

Në kushtet e Shqipërisë, sistemi ligjor është përngjasuar me sistemet europiane të sigurimeve. Rregullimi dhe kontrolli ligjor janë shtrirë në çdo element të aktivitetit të sigurimeve. Mjafton t'ju përmendim se për çdo ndryshim në statut të kompanive shqiptare të sigurimeve, sado i parëndësishëm që ky ndryshim të duket, duhet marrë më parë miratimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ligjet e reja për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si dhe ato për licencimin e agjentëve, udhëzimin e trajtimit të dëmeve, apo dhe rregulloret për aftësitë paguese dhe llogaritjen e provigjonve teknikë janë një pjesë e panoramës ligjore që rregullon tregun e sigurimeve.

Padiskutim që efekt pozitiv në forcimin e kapaciteteve financiare të shoqërive të sigurimeve ishte dhe vendimi për rritjen e fondit të garancisë, i cili detyroi kompanitë të rrisin këtë fond deri në nivelin prej rreth 3 milion euro. Por, që kjo masë të jetë efektive, duhet që të shoqërohet edhe me rregullime në tregun e sigurimeve në mënyrë që të përmirësohet është kontrolli i deformimeve të këtij tregu dhe të shmanget ulja e paarsyeshme e çmimeve tej vlerësimit real të riskut. Industria e sigurimeve mbështetet në modele teknike të sofistikuara të vlerësimit dhe administrimit të rreziqeve.

Çdo kontratë sigurimi që hidhet në treg përveç anës ligjore, ku parashikohen detyrimet dhe të drejtat e kompanisë dhe të klientëve, ka të "investuar" në të edhe një punë të konsiderueshme paraprake teknike në lidhje me llogaritjen e primit të sigurimit, vlerësimin e llojit dhe të masës së rrezikut, vlerësimin e mbajtjes së kompanisë (sa ka mundësi që kompania të marrë përsipër vetë këtë risk dhe sa duhet të transferojë në formën e risigurimit). Ky proces sidomos, është i domosdoshëm kur është fjala për sigurimin e pronës. Në tregjet e zhvilluara dhe të mëdha zbatohen modele të njohura të statistikës matematikore për të identifikuar dhe vlerësuar tendencën e ngjarjeve të papritura të natyrës, por dhe të llojeve të tjera të rreziqeve sikundër janë aksidentet automobilistike. Në analizë të fundit, ajo që një kompani sigurimesh kërkohen të dijë është: - sa është probabiliteti mesatar që mund të ndodhë një ngjarje (shpeshtësia e ndodhjes së një aksidenti) dhe - sa është probabiliteti maksimal i humbjes financiare për një ngjarje.

Mbi bazën e këtyre konkluzioneve ndërtohet sistemi tarifor i përshtatshëm për të krijuar një sasi të ardhurash të mjaftueshme për të përballuar dëmet, rezervat dhe shpenzimet administrative.

D Industria e sigurimeve mbështetet në kapacitete teknike njerëzore të përgatitura për të vlerësuar rreziqet

Modelet dhe metodat e vlerësimit të rreziqeve dhe zbatimi i tyre në produkte dhe situata konkrete, nuk mund të jetë një proces mekanik dhe përmë tepër një zbatim i thjeshtë formulash. Sigurimet janë biznesi i njerëzve, i specialistëve të përgatitur, që jo vetëm njohin teorikisht modelet dhe metodat teknike, por mbi të gjitha dinë se si t'i përshtatin në kushtet specifike. Mënyra dhe koha kur nisi të zhvillohet industria e sigurimeve në Shqipëri nuk solli avantazhe në përgatitjen e kapaciteteve njerëzore, që do të ishin të afta ta orientonin drejt tregun e sigurimeve, që prej fillimit të tij.

Në vitin 1990 Shqipëria nuk trashëgoi as përvojë, as tregje të formuara dhe as personel teknik të kualifikuar. Në këtë aspekt, kjo industri lindi në një truall të zbrazët, ku çdo institucion e marrëdhënie ekonomie duhej krijuar nga fillimi. Kështu hap pas hapi, zgjerimi i marrëdhënieve financiare në tregun shqiptar krijoi edhe kushte përritjen dhe zhvillimin e tregut të sigurimeve

dhe krijoi gjeneratën e parë të specialistëve dhe menaxherëve të parë të sigurimeve.

Dinamikat dhe sfidat e tregut të sigurimeve kanë zgjeruar kapacitetet menaxheriale në këtë treg, duke lejuar që operatorët e tregut të mund të ofrojnë zgjidhje teknike optimale. Zgjerimi i nevojave të tregut për shërbimet e sigurimeve ka shtyrë të gjithë kompanitë në treg që të kurojnë me shumë kujdes mangësitë dhe problemet që hasen në formimin e burimeve njerëzore të tyre. Por, për të qenë realistë, dhe duke marrë në konsideratë stadin e tanishëm të (ulët) zhvillimit të tregut rritja e profesionalizmit mbetet një ndër sfidat kryesore të industrisë së sigurimeve në Shqipëri.

D Industria e sigurimeve mbështetet në njohjen e teknikave për transferimin e rreziqeve në tregun ndërkombëtar të risigurimeve.

Tregjet e sigurimeve në asnjë rast nuk veprojnë të izoluara. Asnjë treg, i vogël apo i madh, asnjë kompani, i vogël apo e madhe, nuk mund të ekzistojë dhe të zhvillohet pa mbështetje të kompanive risiguruese brenda dhe jashtë vendit. Në procesin e vlerësimit të çdo rreziku apo rreziqeve në tërsi, kompanive siguruese iu duhet të kenë parasysh kapacitetet mbajtëse të tregut (të cilat përcaktohen me ligj). Kjo bën, që në rast të një dëmi, kompania të mos vë në vështirësi gjendjen financiare të saj, si dhe shërbimin e plotësimit të detyrimeve ndaj klientëve të saj.

Në këto kushte, kompanitë e sigurimeve transferojnë një pjesë të rrezikut tek kompanitë e risigurimit. Ky proces realizohet nëpërmjet teknikave dhe instrumenteve financiare të formave të ndryshme, të cilat varen si nga lloji dhe nga madhësia e rrezikut. Sipas legjisacionit shqiptar, asnjë kompani nuk mund të marrë një rrezik përsipër më shumë se 10% të kapitalit neto të saj.

D Industria e sigurimeve mbështetet një kulturë minimale të sigurimeve

Mungesa e tregut të sigurimeve para vitit 90', përveç mungesës së traditës në këtë lloj industrie, krijoi në mënyrë objektive dhe një mungese të edukatës apo të kulturës së sigurimeve. Është e kuptueshme që niveli i të ardhurave mesatare është një ndër faktorët përcaktues

për nivelin e zhvillimit të tregut të sigurimeve. Por përvoja e vendeve të zhvilluara tregon se kultura dhe edukata e sigurimeve ka një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e tregut, ose më saktë është një nga elementet kryesore të tij.

Si rregull, njerëzit i radhisin në vendet e fundit të listës së shpenzimeve të buxhetit të tyre shpenzimet për sigurimet. Kjo është aq e vërtetë sa në shumë raste megjithëse individë dhe biznese kanë të ardhura të mjaftueshme, ato nuk e konsiderojnë që shtëpia apo biznesi i tyre mund të mbrohet (kompensohet financiarisht në rast aksidenti) me një pagesë shumë të vogël se sa të ardhurat që ata do të shpenzonin për të riparuar këtë dëm individualisht.

Industria e sigurimeve në Shqipëri.

Një analizë vlerësuese

Duke e mbështetur vlerësimin në kontekstin e mësipërm, mund të themi, se megjithëse kanë kaluar 18 vjet nga fillimi i industrisë së sigurimeve, përsëri pohohet që ky treg është ende i pazhvilluar dhe mjaft i kufizuar. Treguesi kryesor është padyshim shkalla e ulët e penetrimittësherbimevetësigurimevesinëbiznes, ashtu dhe tek individi dhe familjet shqiptare.

Mesatarisht, një individ në Shqipëri paguan në vit rreth 15 USD për sigurimet (të detyrueshme dhe vullnetare). Nga një vlerësim i tregut të sigurimeve, del se Shqipëria ka treguesin më të ulët në Europë të raportit të vlerës së primeve të grumbulluara me GDP-në e një viti.

Nga një analizë e thjeshtë e këtyre treguesve ne mund të nxjerim një konkluzion të rëndësishëm, se tregu shqiptar i sigurimeve është ivogël. Në fund

të vitit 2007 tregu shqiptar i sigurimeve vlerësohej me rreth 50 milion euro. Këto përmasa janë të kufizuara jo vetëm po t'i krahasonim me fqinjët (Maqedonia grumbullon prime sigurimi afér dy herë më shumë se Shqipëria), por janë mjaft larg edhe mundësive potenciale që ka ekonomia shqiptare për të përdorur shërbimet e sigurimeve.

Problematika e tregut shqiptar të sigurimeve vazhdon edhe në drejtime të tjera. Kështu, po të shohim strukturën e primeve të grumbulluara (raporti i primeve të grumbulluarsipas produkteve të shitura)tregon se tregu vazhdon të mbizotërohet nga sigurimet e detyrueshme. Kështu, sigurimi i detyrueshëm motorik për brenda dhe jashtë vendit përbën në rreth 75 % të totalit të primeve të shkruara. Po t'i shtojmë këtij lloj sigurimi dhe llojet e tjera të sigurimit motorik atëherë mund të themi që tregu i sigurimeve dominohet nga sigurimi motorik në mbi 80% të tij.

Nga një vështrim i tregut bankar vërehet se një pjesë e rëndësishme e sigurimeve që paguhën në bankë, janë të detyrueshme për të siguruar pasurinë në formën e kolateralit. Në grafikun e mëposhtëm duket se 71% e detyrimeve të paguara në banka janë sigurime për pronën dhe praktikisht janë të detyrueshme. Në klimën e përgjithshme të biznesit shqiptar, ka një mentalitet negativdhe neglizhues ndajsigurimeve. Kjo vjen kryesisht për shkak të mungesës së traditës në tregun e sigurimeve, por edhe të mosnjohjes së pasojave të rreziqeve ekonomike që vijnë nga faktorë natyrorë apo aksidentalë.


Aktualisht, mekanizmat e tregut të sigurimeve kanë filluar të aktivizohen për mbrojtjen e bizneseve nga rreziqet komerciale. Ndërsa për sigurimet nga rreziqet e natyrës, si zjarri, tërmeti, përmbytjet etj. Vazhdojnë të jenë të kufizuara dhe të karakterizohen nga një

Dinamika e treguesve të zgjerimit të tregut të sigurimeve

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
GDP (milion \$)	3548,4	3694,5	4102,4	4496,8	5702,2	7581,0	8.528	9.100
GDP për person (milion \$)	1052,0	1086,3	1329,0	1460,0	1833,3	2434,0	2.848	2.870
Prime Sigurimi (milion \$)	13,4	14,1	20,7	27,2	30,8	40,4	39,9	45,4
Prime për person (\$)	4,2	4,1	6,7	8,8	11,5	13,2	13	14
Prime /GDP %	38	38	50	60	54	53	47	50

lloj indiferentizmi nga ana e bizneseve. Si përfundim, mund të themi se ende në Shqipëri nuk ka një tendencë të natyrshme për të siguruar pasuritë e individëve dhe të

Sigurimet e bizneseve nëpërmjet bankave



bizneseve. Kjo dukuri vazhdon të kufizojë jo vetëm përmasat e tregut të sigurimeve, por edhe i pengon ato të luajnë rolin që iu takon në një sistem ekonomik të ekonomisë së tregut.

► Sfidat e sistemit të sigurimeve në Shqipëri

Perspektiva e industrisë së sigurimeve në Shqipëri është e lidhur ngushtësisht me aftësinë e këtij tregu për t'u sjellë në mënyrë eficiente. Në këtë kuadër, një nga fushat e rëndësishmet performancës së ardhme të këtij tregu, është aftësia për t'i afuar sa më shumë shërbimet e sigurimeve tek klientët e tyre.

Në realitetin ekonomik e këtij tregu për t'u sjellë në mënyrë eficiente. Në këtë kuadër, një nga fushat e rëndësishmet performancës së ardhme të këtij tregu, është aftësia për t'i afuar sa më shumë shërbimet e sigurimeve tek klientët e tyre. Në realitetin ekonomik e këtij tregu për t'u sjellë në mënyrë eficiente. Në këtë kuadër, një nga fushat e rëndësishmet performancës së ardhme të këtij tregu, është aftësia për t'i afuar sa më shumë shërbimet e sigurimeve tek klientët e tyre.

Perceptimi i "gabuar" për kostot e sigurimeve, konsiderohet jo rrallë si barrierë e rëndësishme që e pengon këtë treg të arrijë eficiencën ekonomike. Shumë biznese i konsiderojnë pagesat për sigurime si shpenzime të tepërtë dhe elemente që rëndojnë kostot e tyre ekonomike në afat të shkurtër. Në këtë vlerësim të kostove, shumë prej tyre zgjedhin të mos t'i paguajnë sigurimet për të rritur aftësinë konkurruuese momentale të produkteve apo shërbimeve që ato prodrojnë. Por, në fakt, nëse këto biznese do të rrisin pak

fokusin e zhvillimit perspektiv të bizneseve të tyre dhe do të synonin të rrisin qëndrueshmërinë e tyre në afat të gjatë, me siguri do t'i drejtosheshin njërit nga produktet e ofruara nga kompanitë e sigurimeve. Kostot e sigurimeve, në fakt janë të papërfillshme në krahasim me shpenzimet e tjera të projekteve të mëdha të biznesit, dhe ndërkaq, më pak të përfillshme në raport me përfitimet që bizneset përfitojnë në rastin e pagimit të dëmit. Le të japim një shembull të thjeshtë: për një pronë me një vlerë prej 1 million euro (apartament, hotel apo zyrë) primi i sigurimit për t'u mbrojtur në të njëjtën kohë nga rreziku i tërmetit, zjarrit dhe përmbytjes, është afersisht një pagesë prej rreth 3 500 euro në vit.

Mosnjohje të produkteve të sigurimit përbën një tjetër eksternalitet negativ që i vjen tregut të sigurimeve nga ana e mungesës së informacionit. Vështirësitë që hasin kompanitë e sigurimeve në këtë kontekst ndodhin për "faj" të dy palëve. Nga njëra anë klientët nuk tregojnë ndonjë interes të veçantë për të njohur numrin dhe vlerën e produkteve dhe të shërbimeve që ofrohen nga tregu i sigurimeve. Në këtë mënyrë ata humbasin edhe mundësinë e vlerësimit, e përfitimit ekonomik e shoqëror që ata mund të përfitojnë nga blerja e këtyre produkteve. Nga ana tjetër, kompanitë e sigurimeve nuk tregojnë profesionalizmin e duhur në paraqitjen dhe shpjegimin kushteve të kontratave të ndryshme që lidhen me mbrojtjen e pronës në rast dëmi. Në këtë mënyrë, vetë këto kompani, shpesh, në mënyrë të pavetëdijshme, kufizojnë tregun e sigurimeve duke prekur kështu edhe objektivin themelor të biznesit të tyre që është rritja e të ardhurave financiare të tyre.

► Perspektiva e tregut shqiptar të sigurimeve

Pavarësisht nga problematika që mbart tregu aktual i sigurimeve në Shqipëri, unë mendoj se ky treg aktualisht zoteron të gjitha kapacitetet teknike e njerëzore që të plotësojë misionin e tij në mbështetje të bizneseve dhe individëve. Në këtë vlerësim pozitiv për zhvillimin perspektiv të këtij tregu do të duhet të bëhet një analizë realiste midis vlerave që janë arritur dhe objektivave drejt të cilave të gjithë operatorët e këtij tregu duhet të synojnë. Në mesataren e saj, industria e sigurimeve në vendin tonë është e aftë për të ofruar produkte dhe shërbime që garantojnë mbrojtjen

e pasurive, shtëpive, nga rreziqet natyrore (zjarr, tèrmet, përmbytje, etj), si dhe të sigurimeve ndaj personit (jeta, aksidente personale, shëndeti etj.).

Kjo industri aktualisht zotëron kapacitete të mjaftueshme teknike për vlerësimin e rreziqeve të ndryshme. Kjo cilësi është e qëndrueshme, sidomos për ato kompani sigurimesh të cilat, në strukturën e primeve të tyre, kanë, në një peshë të konsiderueshme, prime nga sigurime vullnetare. Raporti i primeve vullnetare ndaj totalitetit të primeve të grumbulluar të jetë mbi 35 % të primeve të grumbulluara. Shumica e kompanive në tregun e sigurimeve kanë kapacitete financiare të mjaftueshme (kapitale, rezerva, risigurime) për të përballuar pagesën e dëmeve. Për të rritur stabilitetin financier të kompanive të sigurimit, që nga fillimi i vitit 2008, të gjitha kompanitë janë të detyruar të kenë një minimum të kapitalit prej 3 milion Euro. Kjo kërkeshë është në konformitet edhe me direktivën e EU-së për tregjet e sigurimeve.

Në mbështerje të përpjekjeve për të rregulluar tregun e sigurimeve, legjislacioni shqiptar ka përcaktuar rregulla të sakta për kontrollin e rezervave, për kapacitetet mbajtëse të kompanive dhe standardeve të transferimit të rreziqeve tek kompanitë risiguruese.

Këto përmirësime nuk mund të janë thjesht objektiva marketingu të veçanta për një ose disa kompani. Industria e sigurimeve pritet të përballet me sfida interesante në vitet e ardhshme. Hyrja e investitorëve të huaj (Aspis Group, Uniqa, Vienna Insurance Group) është një sinjal jo vetëm pozitiv për momentin dhe në interes të kompanive përkatëse, por dhe një shpresë reale që industria e sigurimeve në 4-5 vitet e ardhshme të ofrojë një cilësi shumë më të mirë se kjo e sotmja në të gjitha drejtimet.

Ajo që pritet të ndodh në dy-tre vitet e ardhshme është tendenca e rritjes së tregut (sigurimet e pronës, sigurimet inxhinierike, sigurimet e shëndetit, sigurimet e jetës etj) për shkak të rritjes së rolit të bankave në detyrimin e bizneseve dhe individuve në momentin e marrjes së kredive. Duke qenë se sigurimet janë një industri e rregulluar, roli i shtetit ka një rëndësi jashtëzakonisht të madh në zhvillimin në një standard më të lartë.

Së pari, misioni industrisë së sigurimeve duhet të kalojë nga industri mbështetëse në një nga industritë udhëheqëse të ekonomisë shqiptare, duke marrë pjesë në investime të rëndësishme të ekonomisë.

Së dyti, sistemi i çmimeve fikse (të përcaktuar nga shteti) në sigurimin e detyrueshëm motorik duhet të ndryshojë brenda një periudhe të shkurtër në mënyrë që të ketë një hapësirë më të madhe konkurrenca reale në treg.

Në kushtet kur kapitalizimi i kompanive ka përfunduar, dhe rezervat e kompanive janë nën kontroll, liberalizimi i çmimeve është i mundshëm dhe i dobishëm për tregun dhe konsumatorin.

Së treti, është e nevojshme që sigurimi i jetës dhe pensioneve të nxitet nëpërmjet një politike fiskale nxitëse. E ardhmja e tregut të sigurimeve të zhvilluara mbështetet tek sigurimi i jetës.

Së katërti, ka nevojë për ndërrhyrje ligjore për të aplikuar sigurime të detyrueshme në disa sektorë të ekonomisë në emër të mbrojtjes së interesave të publikut.

Kështu kërkojnë përshtypim idetë për zbatuar sigurimet e detyrueshme të përgjegjësisë në industrinë ku interesat e publikut janë realisht të trezikuara si në sektorin e naftës, miniera, ndërtim etj.

► Në vend të konkluzioneve

Në qoftë se do të shtronim një pyetje: Çfarë kërkohet të ndryshohet? në mënyrë që të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm dhe afat gjatë përkëtë treg në të ardhmen, unë do të përmendja në mënyrë skematike drejtimet e mëposhtme:

- * modernizmin e produktet ekzistuese
- * konceptimin dhe përgatitjen e produkteve të reja
- * zhvillimin e produkteve të jetës
- * popullarizimin e sigurimeve shëndetësore
- * cilësinë e shërbimit,
- * kontaktet me klientët,
- * mënyrën e marketingut

DOSIER

Bankat - Çfarë po bëjnë?

Bankat Qëndrore në fokus

ADRIAN CIVICI

Hapja e sektorit Bankar, depërtimi i tij në Shqipëri

FATOS IBRAHIMI

Politika monetare si instrument për kontollin e inflacionit

GRAMOZ KOLASI

Roli i sitemit bankar shqiptar në financimin e ekonomisë

DRINI SALKO

“Bankat dhe Globalizimi”

J. C. TRICHET



BANKAT QENDRORE NE FOKUS – ÇFARE ROLI PO LUAJNE NE PERBALLIMIN E KRIZES?

Prof. Asc. Dr. ADRIAN CIVICI

Në kulmin e debateve dhe analizave mbarë botërore për shkaqet e krizës shumë dimensionale aktuale, krahas vlerësimeve të shkaqeve, efekteve të rritjes drastike të çmimive, apo situatës negative financiare botërore, skenarëve të krizës e të daljes prej saj, një vend të konsiderueshëm po zënë dhe komentet e qëndrimet mbi «rolin e Bankave Qendrore» në këtë situatë. Vëmendja ndërkombëtare mbi vendimet e Guvernatorëve të tyre si Jean Claude Trichet, Ben Bernanke, etj., është sot po aq e madhe sa ndaj udhëheqësve politikë më të mëdhenj e të rrëndësishëm botërorë si Bush, Barroso, Braun, Sarkozy, Merkel, etj. Një sërë pikëpyetjesh enden në horizont. A janë ato fajtore për «ngathësinë në parandalimin e kësaj situatë?», apo akoma më keq, a janë ato «përgjegjëset kryesore që financat botërore arritën në këtë gjendje?», a mundet që «Bankat Qendrore, të vetme, të kontrollojnë shpejt situatën dhe të gjenerojnë stabilitetin ekonomiko financiar të dëshiruar», dhe «a mundet që vetëm me politikat e tyre monetare – pa përashtuar këtu survejimin e kujdeshëm të gjithë sistemit bankar e financiar të çdo vendi – Bankat Qendrore të ndikojnë njëkohësisht mbi inflacionin, rrjetin ekonomike e punësimin?». Eksperti i njohur financiar A. Parienty e shtron akoma më direkt pyetjen nëse duhet konsideruar ky si një «arbitrazh tejet i vështirë i objektivave me përbajtje të dukshme politike, por që duhet të zgjidhet nga Banka Qendrore plotësisht të pavarura e jashtë presionit të pushtetit politik?». Përgjigje e vështirë, po të kihet parasysh se në shumë vende të botës, përfshirë këtu dhe mjast vende evropiane, bankat qendrore bëhen shpesh objekt kritikash nga ana e politikës kur është fjala për të vlerësuar neutralitetin dhe prudencën e vendimeve të politikave të tyre monetare. Në mënyrë figurative më mirë se gjithkush, këtë situatë të të genit i pavarur dhe ndërkohë nën vëmendjen dhe sulmet e të gjithëve e ka dhënë ish Guvernatori i Bankës së Italisë Guido Carli i cili mbas kolktukut të tij të zyrës mbante një pikturë që tregonte Shën Sebastianin i lirë në vendimet e tij, por i mbushur me shigjeta të ngulura në trup.

► Inflacion i lartë apo i ulët - debate dhe qëndrime të kundërtë

Pyetje dhe pikëpyetje të tipit... ekonomi me ose pa inflacion?; me inflacion të lartë apo me inflacion të ulët?; e ndihmon apo e frenon inflacioni rrjetin ekonomike?; është apo nuk është inflacioni një "taksë" plus për konsumatorët?; cilat shtresa e grupe sociale preken më shumë nga inflacioni dhe cilat përfitojnë më shumë nga mbajtja nën kontroll e tij? etj., janë tashmë që prej një kohe të gjatë në analizat dhe rekomandimet e ekonomistëve. Por

ata janë larg të qenit unanim në përgjigjet e tyre përballë kësaj problematike delikate, dhe për pasoje janë vendosur në "llogore" të ndara duke profiluar shkolla e rryma mendimi të ndryshme. Nga ana tjetër, situata e krizës aktuale financiare e ekonomike botërore ka hapur dhe një debat të ri të përqendruar në dilemën «a mundet që politikat monetare të tipit klasik të përballojnë dhe të japid zgjidhje efektive në kushtet e një kombinimi të stagflacionin me inflacionin në shumë nga ekonomitë kryesore të botës?». Sipas përvjoshës së deritashme, Bankat Qendrore ulin përqindjet e normës bazë të interesit «për

t'i ardhur në ndihmë rritjes ekonomike» e cila mund të ndikohet nga një nivel i lartë i tyre; dhe në sensin e kundërt, Bankat Qendrore trisin normat bazë të interesit kur shfaqet rreziku inflacionist dhe rritja e çmimeve». Por problemi dhe dilema qëndron në faktin se, «aktualisht, ndoshta për herë të parë në historinë ekonomike e financiare të botës moderne, këto dy fenomene po shfaqen kaq gjërësisht në të njëjtën kohë, duke i lenë vend një periudhe stagflacioniste me shumë pikëpyetje». Debatet akoma më i hapur dhe më i vështirë përti dhënë një përgjigje përfundimtare po të kemi parasysh faktin se Banka Qendrore të ndryshme kanë objektiva të ndryshme megjithëse kanë në dispozicion pothuajse vetëm një instrument qendror : « politikat monetare ». Ekspertët vlerësojnë se kur krahasojmë veprimet e Bankave Qendrore duke i vënë ato përballë njëra-tjetrës në argumentet pro ose kundër veprimit të tyre duhet “të kemi mirë parasysh diferençat dhe dallimet në objektivat dhe misionin e tyre”, sepse sipas tyre “ka shumë elementë që kontribuojnë në shpjegimin e diferençave të sjelljes monetare të BQE dhe Bankave Qendrore anglo-saksone”. BQE ka të fiksuar nga traktatet evropiane si mision principal të saj “garantimin e stabilitetit të çmimeve”, ndërkohë që Feed apo ndonjë bankë tjetër qendrore kanë “garantimin e stabilitetit të çmimeve dhe nivelit të punësimit e të rritjes ekonomike”. Këto strategji të kundërtë, në thelbin e tyre reflektojnë filozofinë ndryshme monetare. Në SHBA dhe Angli, bankat qendrore privilegjojnë aktualisht “mbështetjen e rritjes ekonomike dhe ndihmën për një sistem bankar të tronditur thellë nga kriza e kredive imobiliare me risk të lartë që ka prekur këto vende”. Shembujt e gjendjes së vështirë në të cilën ndodhen banka apo institucione financiare si “Citigroup”, “Merrill Lynch”, Freddie Mac”, “Fanny Rock”, “Northern Rock”, etj., nuk është e njëjtë me situatën e bankave në Evropë, të cilat megjithë situatën e vështirë të mjaft prej tyre, nuk janë aktualisht në të njëjtën problematikë.

Bankat Qendrore - një histori transformimesh

Banka Qendrore më e vjetër në botë është Banka e Suedisë e krijuar që në vitin 1656 e ndjekur pak më vonë nga Banka e Londrës e krijuar në 1694. Që atëherë, për më shumë se tre

shekuj, pothuajse çdo shtet ka krijuar dhe Bankën e tij qendtore. Aktualisht, në botë ekzistonjë 175 banka qendrore. Përmë shumë se dy shekuj, emetimi i monedhave nuk ishte monopol ekskluziv i bankave qendrore ashtu siç është sot. Banka të ndryshme tregtare gjëzonin privilegjin përmë emetuar monedha në shtet apo zona të caktuara gjeografike duke bërë që në një vend të vetëm të ekzistonin shumë tipe monedhash. Në SHBA, në vitin 1912, një vit përpëra krijimit të Fed, kishte 7355 banka që kishin të drejtë të emetonin dollarë! Përmë shumë dhjetëvjeçarë ka ekzistuar një debat i madh doktrinar që kishte përballë ata që mbrohin idenë e një konkurrence të lirë në fushën e emetimit monetar (free banking) dhe përkrahësit e idësë së monopolit në fushën e emetimit monetar (central banking). Bankat Qendrore janë ndoshta rasti i vetëm në historinë e kapitalizmit, ku fitorja e monopolit mbi konkurrencën e lirë është absolute. Elementi i dytë thelbësor është evolucioni i tyre në raport me sektorin privat e publik përmë arritur në situatën e sotme të pavarësisë së plotë. Deri para luftës së dytë botërore pjesa dërrmuese e Bankave qendrore ishin “shoqëri private”. Kështu p.sh., Banka e Francës, në vitin 1936 ishte një shoqëri private që drejtohej nga një asamble e përgjithshme aksionarësh, përfaqësues të 200 familjeve më të shquara të vendit. Historia fillon në SHBA, ku krizat e vazhdueshme të periudhës 1890-1907 hapën një debat shumë të madh “mbi domosdoshmërinë e krijimit të një banke qendrore”. Në vitin 1913, në vijim të projektit të P.Warburg të botuar në New York Times dhe Annual Financial Review të titulluar “A plan for a modified central bank” lindi Banka qendrore amerikane ose Fed i sotëm. Ndërkohë, procesi më intensiv i nacionalizimit të Bankave qendrore filloi mbas luftës së dytë botërore, në 1946 në Angli, 1948 në Holandë e Gjermani, etj., duke i shndërruar bankat qendrore në “autoritete publike” që zhvillonin politikën monetare të shteteve të tyre. Paralelisht me triumfin e monopolit mbi konkurrencën, historia e zhvillimit të tyre tregon se gradualisht Bankat Qendrore u nacionalizuan, përfshirë këtu dhe në vendet nga më liberale të botës, përmë ardhur në 20 vitet e fundit kur pjesa dërrmuese e tyre fitoi pavarësinë e plotë ndaj pushtetit politik. Me gjithë thelbin dhe karakterin e tyre si “institucione publike”, Bankat Qendrore janë gjithnjë e më tepër larg kontrollit të pushtetit

ekzekutiv e politik sepse tendenca kryesore e dy dhjetëvjeçarëve të fundit po i konsolidon ato drejt një statusi "të pavarur". Tradicionalisht, pavarësia e Bankave Qendrore është produkt i pastër i vendeve me strukturë federale të tilla si SHBA, Gjermania, Kanada-ja, Zvicra, etj. Por, në periudhën e dy dekadave të fundit edhe vende "unitare" si Anglia, Zelanda e Re, Suedia, Japonia, etj., kanë avancuar në të njëjtin logjikë e drejtim me bankat e tyre qendrore. Hapi më i madh në këtë drejtim u bë nga BE në kuadrin e "Traktatit të Maastricht-it" i cili e vendosi si kusht të domosdoshëm për të hyrë në zonën euro pavarësinë rigorozë të bankave qendrore. Shumë vende evropiane, si p.sh., Franca, u detyruan të ndryshojnë kushtetutën (janar 1994) në mënyrë që të garantonin pavarësinë e plotë të Bankës qendrore të vendit. Po pse ndodhi një transformim i tillë në favor të pavarësisë së Bankave qendrore? Si është e mundur që qeveritë dhe autoritetet publike pranuan të privohen nga një pjesë e rëndësishme e pushtetit të tyre monetar? Përgjigja tashmë është e qartë dhe pranohet nga të gjithë : këtë e kërkonte gjithnjë e më shumë interesë i përgjithshëm i ekonomisë kombëtare. Arsyja specifike e kësaj pavarësie gjendet tek kombinimi i domosdoshëm ndërmjet demokracisë dhe tregjeve financiare në një ekonomi gjithnjë e më të globalizuar. Në demokraci, çdo qeveri ka nevojë e dëshirë të jetë sa më populllore dhe për këtë ajo duhet të ulë sa më shumë taksat dhe të rrissë investimet publike e të ardhurat e popullsisë. Për ta arritur këtë ka vetëm dy mënyra : e para konsiston në rritjen e deficitit buxhetor që e zgjidh problemin në një periudhë afat-shkurtër por shton borxhin e brendshëm e të jashtëm me gjithë pasojat negative të tij; e dyta konsiston në "krijimin e parasë së re" dhe kjo duket si më e lehta. Por, vigilanca e tregjeve financiare ndaj kësaj mase është tmerrësish e rreptë. Çdo teprim në krijimin e parasë shkakton tensione inflacioniste të cilat nëpërmjet tregut ndëshkojnë rëndë si qeveritë ashtu dhe konsumatorët. Është kjo arsyja pse tregjet favorizojnë vendet që pranojnë ta shkëpusin Bankën e tyre qendrore nga kompetencat e ekzekutivit, në mënyrë që ti krijojnë një besim shumë të madh ekonomisë së tyre në sferën ndërkombëtare. Por, përvëç kësaj, tashmë shumë ekspertë e studiues janë të bindur se substanca e vërtetë e pavarësisë së bankave qendrore nuk është vetëm ekonomike,

por ajo ka dhe një shpjegim tjetër origjina e të cilit është filozofia politike amerikane dhe mendimi konstitucional amerikan i "baballarëve themelues" të SHBA që në Kushtetutën e vitit 1787. Sipas tyre "delegimi i administrimit të çështjeve financiare e monetare tek një autoritet i pavarur, jo vetëm që nuk krijon deficit demokratik, por përkundrazi, kjo bëhet një element esencial i funksionimit të demokracisë". Pavarësia e Bankës vetëm nëpërmjet ligjit nuk mjafton për të pasur besim të plotë tek ajo. Duhet që në veprimtarinë e saj të ekzistojë një besim dhe vlerësim i lartë kombëtar e ndërkombëtar gjë që realizohet nëpërmjet treguesit të "kredibilitetit", d.m.th., tërësisë së detyrimeve që "përgjegjësit e monedhës" duhet të plotësojnë për të siguruar tregjet dhe konsumatorët e parasë dhe produkteve të tjera financiare. Kredibiliteti i një banke qendrore përbën një nga "të mirat publike" më të rëndësishme dhe më të vlerësueshme të një vendi, një vlerë që askush thjesht për qëllime politike, konjunkturale apo individuale nuk duhet ta vërtë në diskutim.

► Politika Monetare - kolona vertebrale e Bankave Qendrore

Në pjesën dërrmuese të rasteve, Bankat Qendrore janë sot përgjegjëset kryesore të politikës monetare në nivel nacional. Kjo duket si dicë shumë e konsoliduar, ndërkohë që edhe vetë koncepti i politikave monetare është i ri. Kriza e tmerrshme e viteve 1929-32, pasojet e luftës së dytë botërore për ekonominë dhe finansat botërore, dominimi i politikave keynesianiste në vitet 1950-70, etj., bënë që shumë vende të zhvilluara të botës të kërkonin që ti përdornin politikat monetare në funksion të orientimit të zhvillimit ekonomik. Në këtë kohë lindën shprehjet dhe praktikat e "politizimit të monedhës". Paraja u "nacionalizua" dhe kontrolli i saj ju besua Shtetit ndërkohë që drejtuesit e bankave qendrore zgjidheshin dhe ishin nën varësinë e plotë të pushteteve publike. Por, tritja galoponte e inflacionit në periudhën e viteve 1970-80 e riktheu vëmendjen tek objektivi kryesor i Bankave Qendrore për të garantuar stabilitetin e monedhave. Lëvizjet e fuqishme anti-inflacioniste të filluara në SHBA në fillim të viteve 80-të të shek. XX-të u përhapën shpejt në të gjithë vendet e industrializuara duke "lindur"

kështu konceptin e stabilitetit të monedhës si objektiv final të politikave monetare. Tashmë, të gjithë u bindën se "pavarësia e Bankës Qendrore në raport me shtetin ishte mënyra më efektive për të luftuar inflacionin". Kjo mund të arrihej shumë mirë në qoftë se kombinohej si duhej politika buxhetore që ishte përgjegjësi e Shtetit me politikën monetare që ishte përgjegjësi e Bankave Qendrore dhe e vëtmja që kishte mundësi të hapte apo të mbyllte "rubinetin e emetimit të monedhave të reja".

Ndërkohë gjatë periudhës 1980-2007 në botë u shfaq një formë tjetër inflacioni që kishte të bënte me rritjen brutale dhe shpesh irrationale të çmimit të aktiveve financiare e imobiliare. Kriza japoneze e viteve 1985 dhe 1990, kriza aziatike e viteve 1990 dhe 1997, kriza e ekonomisë së re ose internetit e 1995 dhe 2001, kriza e kredive të këqija dhe vlerave imobiliare e 1996 dhe 2007 janë shembuj konkretë të kësaj forme të re inflacioni. Pasojat e tyre janë të rënda dhe kanë kërkuar kohë që të rikuperohen. Kështu, p.sh., kriza japoneze u shoqërua me një periudhë 15 vjeçare stanjacioni dhe një ulje drastike të rritjes ekonomike nga 4-4.5% në 0.8-1.4% në vit. Politikat e "parasë së lehtë" të bankave qendrore mendohet se ndikuani në shfaqjen e "fluskave spekulative" financiare të rrezikshme. Shumë ekspertë mendojnë se shkak i tyre janë mbajtja nga ana e Bankave Qendrore për një kohë të gjatë dhe në nivele të ulëta e normës bazë të interesit për paranë. Pasojë e kësaj situate është shprehja e famshme se "Bankat Qendrore janë gjithmonë midis dy zjarreve kur është fjala për objektivat dhe pasojat e politikave të tyre monetare: të kontrollojnë rigorozisht inflacionin kundrejt rrezikut që të ndikojnë në nivelin e rritjes ekonomike, apo të mbështesin aktivitetin ekonomik kundrejt riskut të rritjes së inflacionit dhe mundësive të lindjes së fluskave spekulative financiare si pasojë e parasë së lirë?". Në këtë pikë ka qëndrime të kundërtat, por ajo që dominon është pozicioni se në periudha afat-mesme e afat-gjata, "inflacioni i lartë dhe i pakontrolluar është më i rrezikshëm për një ekonomi kombëtare apo ndërkombëtare se sa thjesht ndihma e stimulimit të rritjes ekonomike nga ana e politikave monetare".

► Në përgjigje të efekteve të globalizimit

Kriza aktuale botërore që mbi të gjitha është

një krizë financiare dhe çmimesh, dukuritë dhe efektet e globalizimit po nxjerrin në evidencë edhe domosdoshmërinë e përshtatjes së aktivitetit e fokusit të Bankave Qendrore me këtë realitet të ri. Teoria moderne ekonomike ka dhënë tashmë shumë kanale nëpërmjet të cilave globalizimi mund të influencojë në nivelin e çmimeve dhe inflacionit. Jean Claude Trichet, Presidenti i Bankës Qendrore Evropiane nën vizion tre drejtime në të cilat globalizimi ndikon në nivelin e çmimeve dhe inflacionit. Së pari "nëpërmjet ekspansionit të fuqisë punëtore disponibël në nivel botëror sidomos mbas hapes së tregjeve të punës së vendeve me zhvillim të shpejtë si Kina, India e Brazili dhe atyre ish-komuniste të bllokut sovjetik" duke ndikuar ndjeshëm në koston e punës; së dyti, "duke modifikuar ekuilibrin e vendosur ndërmjet punës dhe kapitalit si dhe çmimeve e kostove të prodhimit, pasojë e së cilës është rritja e konkurrencës dhe vështirësitë e vendeve të zhvilluara për të operuar me çmime të fiksuarë për një kohë të gjatë; dhe së treti, "duke ndryshuar shpejt nivelin e produktivitetit në sektorë dhe zona të ndryshme të botës, globalizimi influencon në një ristrukturim botëror të specializimit të prodhimit dhe ndarjes së punës në nivel global". Pjetja që shtrohet në këto kushte është: cili duhet të jetë roli i bankave qendrore në reduktimin e rreziqeve të stabilitetit financiar në kushtet e këtyre efekteve të globalizimit? Përgjigja fillon nga pranimi i faktit se lidhjet e ndërsjella të shumëfishta të sistemeve financiare kanë krijuar tashmë një sistem financiar botëror i cili funksionon si një sistem i vetëm. Në këto kushte, ekspertët bankarë vlerësojnë se Bankat Qendrore mund ta garantojnë stabilitetin financiar nëpërmjet disa mënyrave. Së pari, ato duhet ti zhvillojnë analizat e tyre të stabilitetit financiar jo duke i kufizuar në kufijtë nacionalë e rajonalë por sipas një optike e perspektive botërore. Së dyti, globalizimi i sistemeve financiare kërkon një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Bankave Qendrore të shteteve të ndryshme sidomos në fushën e këmbimit të informacionit për vlerësimin e riskut dhe identifikimin e masave të përbashkëta që duhen ndërmarrë. Së treti, globalizimi kërkon nga Bankat Qendrore që të luajnë një rol të dorës së parë në përcaktimin dhe zbatimin e rregullave të survejimit financiar në nivel nacional e ndërkombëtar duke i hapur rrugë një dialogu e kooperimi të gjermanës në nivel botëror në këtë drejtim.

HAPJA E SEKTORIT BANKAR, DEPERTIMI I TIJ NE SHQIPERI DHE RAJON

Prof. Asc. Dr. Fatos Ibrahimi

Zv/Guvernator
i Bankës së Shqipërisë

email: fibraimi@bankofalbania.org

Gjatë dekadave të fundit, sistemi finanziar në Evropën juglindore (SEE) është prirur drejt zgjerimit të sektorit bankar, i cili në një masë të madhe zotërohet nga kapitali i huaj. Zhvillimet janë reflektuar veçanërisht në rritjen e pranisë së grupeve të fuqishme bankare nga Evropa perëndimore, të cilat janë mjaft aktive në këtë rajon. Hyrja e kapitalit të huaj nëpërmjet sistemit bankar ka mundësuar gjallërimin e aktivitetit bankar, zgjerimin dhe thellimin e tregut financiar dhe rritjen e kreditimit. Kjo ka qenë një faktor inovacioni që ka mbështetur produktivitetin në këtë sektor dhe përmirësuar shanson për rritjen ekonomike. Liberalizimi dhe hapja e sistemit finanziar ndaj institucioneve të huaja me përvojë të gjerë në fushën e kredi-dhënieve ka ndikuar pozitivisht në zgjerimin e shërbimeve bankare. Ekzaminimi dhe monitorimi i tyre i kujdeshëm ka qenë faktori i rëndësishëm në zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit finanziar. Megjithatë, pavarësisht potencialeve investuese në vendet e SEE, tregjet e kapitalit mbeten përgjithësisht ende të pa zhvilluara mirë. Aktorë të tjerë të tregut financiar si kompanitë e sigurimit, fondet e pensionit apo shoqërítë e kursim-kreditit aktualisht luajnë një rol (fare) të vogël në ndërmjetësimin financiar. Qëllimi i këtij artikulli është të trajtojë efektet e reformave bankare të ndërmarra për liberalizimin dhe zgjerimin e sistemit finanziar në Shqipëri dhe në rajon. Në fillim do të diskutohet shkurtimisht mbi çështjet e përgjithshme që karakterizojnë sistemin finanziar në vendet e SEE. Më pas, diskutimi do të shtrihet mbi hyrjen e bankave të huaja dhe rolin e tyre rritjen e konkurrencës dhe reduktimin e kostos së ndërmjetësimit financiar. Në fund, analiza do të përqendrohet në çështjet e kreditimit dhe implikimet që ato mund të mbartin për ekonominë.

► Zhvillime të përgjithshme në sektorin bankar

Pavarësisht karakteristikave të ndryshme midis vendeve, sistemi finanziar në Evropën juglindore shfaq mjaft tipare të përbashkëta, të përbledhura si më poshtë:


- Sektori bankar në vendet e SEE përfshirë Shqipërinë zotëron 90-95 për qind të sistemit finanziar, duke qenë kështu burimi kryesor në zgjerimin e kredisë për sektorin privat.
 - Thellimi i depërtimit finanziar dhe përmirësimet institucionale kanë mundësuar hapjen e llogarisë kapitale, duke lehtësuar edhe integrimin finanziar. Konvergjimi finanziar dhe ekonomik kërkon, sidoqoftë,
- zhvillimin e aftësive të mira reaguese ndaj goditjeve apo sfidave që sjell ky proces.
- Në shumë vende të Evropës juglindore kreditimi i konsumatorëve po rritet ndjeshëm. Nga njëra anë, ky proces mund të ndihmojë në zbutjen e efekteve të luhatjes së të ardhurave gjatë procesit të konvergjimit dhe të nxisë rritjen ekonomike. Gjithsesi, nga ana tjeter, kreditimi në monedhë të huaj që në rastin e konsumatorëve është i pambrojtur ndaj luhatjeve në kursin e këmbimit, përbën një trezik për stabilitetin financiar.
 - Kreditimi i sektorit privat zë pjesën kryesore në zgjerimin e kredisë në rajon. Pavarësisht se rritja e kreditimit mund të reflektojë konvergjimin e ndërmjetësimit financiar, normat e larta të rritjes së kreditimit në disa

vende mund të shkaktojnë probleme për stabilitetin financiar dhe makroekonomik. Gjithsesi, prania e bankave me kapital të huaj, kapitalizimi i mjaftueshmë i sistemit bankar si dhe nivele ende të ulëta të kredive të këqija shoqëruar me një politike monetare të kujdeshshme, mund të balancojnë këto rreziqe.

- Kreditimi në monedhë të huaj në Evropën Jug-Lindore është bërë një fenomen dominant dhe po zgjerohet konsiderueshmë. Historitë e normave të larta të inflacionit, apo afrimi me Bashkimin Evropian kanë favorizuar preferencën ndaj monedhës së huaj për kreditim. Ky fenomen rrit rishkin e krijimit të shumë problemeve në bilancin e sektorit privat jobankar. Për sa kohë që të ardhurat e kredi-marrësve janë në valutën vendase, si ndodh në shumicën e rasteve, riku i kusrit të këmbimit bëhet një pjesë e rëndësishme e riskut të kredisë.
- Treguesit e stabilitetit financiarë janë të qëndrueshmë për vendet SEE. Gjithsesi, rreziqet mbeten ende të pranishme. Zgjerimi i konsiderueshmë i kredisë, zhvillimet në deficitin e llogarisë korrente apo financimi i borxhit të qeverisë, janë faktorë që mund të ndikojnë negativisht stabilitetin financiar.

Për të vlerësuar ecurinë e sektorit bankar shihet me interes niveli i ndërmjetësimit financiar i matur si raporti i aktiveve bankare ndaj PBB.

Raporti i aktiveve bankare ndaj PBB (në %)



Shënim: Të dhënat për Malin e Zi dhe Serbinë janë deri në 2006


Burimi: Bankat Qendrore përkatëse

Krahasuar me zonën e Euros ku ky raport kalon 200 për qind, në vendet e Evropës Jug-Lindore ky tregues mbetet ende i kufizuar. Bullgaria e ndjekur nga Bosnje-Hercegovina kanë nivelin më të lartë të aktiveve bankare. Në rastin e Shqipërisë, ky raport në fund të vitit 2007 arrin


në 76 % të PBB.

Pavarësisht zgjerimit të konsiderueshmë të sektorit bankar në vendet SEE, ai mbetet përsëri mjaft fitimprurës dhe tërheq vazhdimisht investime të reja. Gjithsesi, për t'u mbrojtur nga rritja e vazhdueshme e kreditimit, bankave iu kërkohet të ruajnë një nivel minimal të raportit të kapitalit ndaj aktiveve. Të dhënët tregojnë se ky raport është i konsiderueshmë për vendet SEE, madje dhe për vendet me një nivel të lartë të raportit të kredive të këqija ndaj totalit të kredive, si Serbia. Në mjaft nga këto vende, rregulloret për klasifikimin e kredive dhe provigjonimin janë shtrënguar për të parandaluar përkëqësimin e portofolit të kredive.

Raporti i kapitalit rregullues bankave ndaj aktiveve



Raporti i kredive të këqija ndaj totalit të kredive



Burimi: Financial Soundness Indicators, IMF, 2007

Zhvillimi i tregut finanziar në Shqipëri përfaqësohet nga zhvillime të ngjashme me rajonin. Tregu finanziar është i dominuar nga bankat dhe kapitali i huaj. Kritja e kredisë është relativisht e shpejtë por e moderuar. Kredia në valutë dominon totalin e stokut të kredisë dhe shkon kryesisht në financimin e biznesit dhe blerjen e pasurive të patundshme. Ndër llojet e kredisë ajo konsumatore po njeh një rritje të shpejtë. Një krasim i shpejtë i treguesve kryesorë tregon se sistemi bankar shqiptar është pozicionuar relativisht mirë krahasuar me vendet e tjera të rajonit kundrejt rreziqeve që mund të shfaqen nga konvergjimi i shpejtë i tregjeve financiare. Megjithatë zhvillimet e fundit janë bërë prezente në nxitjen e shpejtë të kërkesses aggregate, rritjen e deficitit korrent, dhe nxitjen e presioneve inflacioniste. Aktualisht është e vështirë një investigim empirik i efekteve të kredisë mbi situatën makroekonomike. Studimet e bëra për ekzistencën e kanalit te transmetimit të kredisë nuk arrijnë në rezultate konkluzive kryesisht sepse seritë kohore janë mjaft të shkurtra duke qenë se kreditimi është një aktivitet që i përket tre viteve të fundit (Vika, 2007). Gjithashtu studimet empirike të Bankës së Shqipërisë (Tanku & Ruçi & Frashëri, 2007) tregojnë se deficitet korrente të ekonomisë shqiptare janë të qëndrueshme dhe rrjedhimisht nuk paraqesin probleme për stabilitetin finanziar apo atë makroekonomik. Megjithatë duke pasur parasysh episodet e krizave financiare duke filluar me më të fundit që nisi në tregun e financimit të shtëpive në Amerikë, krizën aziatike etj është evidente se autoritetet nuk i kanë vlerësuar rreziqet deri në momentin e shfaqjes së krizave financiare. Ata nuk kanë qenë të aftë të identifikojnë sinjalat dhe tu përgjigjen zhvillimeve në kohë reale. Rrjedhimisht është e natyrshme qe ti kushtohet një analizë situatës ekzistuese të tregjeve të kredisë dhe atij finanziar për të vlerësuar potencialet për gjenerimin e problemeve në periudha afatmesme. Përhapja e njëkohshme e një grapi të kufizuar bankash në rajon është gjithashtu e rëndësishme që këto zhvillime të ndiqen e vlerësohen jo vetëm në tregun e brendshëm por edhe në kontekst rajonal, sepse të gjithë vendet e rajonit kanë një ekspozim te gjerë kundrejt të numri të kufizuar bankash që operojnë njëkohësisht në të gjithë rajonin. Rrjedhimisht problemet e një prej këtyre bankave në një prej vendeve të rajonit mund

të kontaminojnë operacionet e kësaj banke në vendet e tjera.... rrjedhimisht në analiza e mëposhtme ka edhe një këndvështrim rajonal..

► Liberalizimi i Sektorit Bankar

Në dekadat e fundit vihet re një rritje e madhe e numrit të bankave të huaja në vendet në zhvillim. Sot roli i tyre është shumë i rëndësishëm, ku në vendet e Evropës lindore ato përbën rrith 65 për qind të tregut në 2003 nga 11 për qind në 1995 (Claeys & Hainz, 2007). Në përgjithësi besohet se hyrja e bankave të huaja ka përmirësuar ndërmjetësimin finanziar duke rritur konkurrencën, përmirësuar stabilitetin, dhe rritur eficiencën e këtij sektori. Prania gjithnjë e më e madhe e bankave të huaja në ekonomitë në zhvillim është, kryesisht, rezultat i reformave të mëdha që ndërmorën këto vende për liberalizimin e sistemit finanziar dhe të integrimit të tyre në tregun global. Gjithashtu, hyrja e investitorëve të huaj në këto vende është nxitur nga autoritetet vendase sidomos pas periudhave të krizave, me qëllimin për të minimizuar koston e rikapitalizimit të sistemit finanziar vendas dhe për të promovuar ristrukturimin e bankave vendase joeficiente (Lehner & Schnitzer, 2006).

Ashtu si në shumicën e vendeve të Evropës lindore, sistemi bankar shqiptar përfjetoi një rritje të madhe të numrit të bankave të huaja gjatë viteve të tranzicionit. Pjesëmarrja e tyre në tregun e kredisë u rrit nga 20.7 për qind në tremujorin e fundit 1998, në gati 88 për qind në vitin 2006. Ndryshim drastik në këtë tregues erdhë si rezultat i shtimit të numrit të bankave reja të huaja dhe gjithashtu nëpërmjet shitjes së bankave shqiptare (shtetërore) ndaj bankave të huaja (përkatesisht 12 dhe 3 deri në 2007). Prezenca e tyre ka nisur që në fillimet e tranzicionit, megjithatë interesimi i investitorëve të huaj për të hyrë në tregun bankar shqiptar ka marrë hov me zhvillimin dhe konsolidimin e sektorit bankar pas kolapsit të skemave piramidalë në vend.

Sa i përket dominimit të sistemit bankar, tre (pesë) bankat më të mëdha zotëronin mbi 43 (66) për qind të huasë totale në vitin 2006. Megjithatë, niveli i përqendrimit në aktivitetin e kredidhënies, i matur sipas indeksit HHI, është reduktuar ndjeshëm gjatë 1999-2006 duke iu

afruar gradualisht konkurrencës së plotë. Kjo tendencë mbështetet edhe nga tregues të tjerë më të përparuar për matjen e konkurrencës, siç është statistika H. Bazuar në këtë tregues, një studim nga Note (2007) që krahason shkallën e konkurrencës së sistemit bankar shqiptar me ato të Evropës lindore, rendit Shqipërinë në vendin e shtatë nga 15 vendet e zgjedhura, duke lënë prapa vendet fqinje si Bullgaria, Serbia dhe Maqedonia. Në një tjetër krahasim me vendet e zhvilluara, konkurrenca në sektorin bankar shqiptar duket t'ua kalojë edhe Spanjës, Danimarkës, apo Shteteve të Bashkuara.

Por cili ka qenë impakti i pjesëmarrjes së bankave të huaja dhe rënies së përqendrimit në spread-in e bankave? Megjithëse përgjigja e kësaj pyetje do të kërkonte një analizë ekonometrike më të detajuar, ecuria e këtij treguesi mund të jetë interesante për t'u vërejtur.

Tabela e mëposhtme paraqet spread-in e normave të interesit të aplikuara nga sistemi bankar për kreditë dhe depozitat. Ashtu siç pritej, spread-i i normave të interesit ka rënë vazhdëmisht me rritjen e pranisë së bankave të huaja që nga viti 1999. Kjo tendencë është e dukshme për të gjitha llojet e interesave – në lekë, euro apo dollarë – si në periudhën afatshkurtër ashtu edhe atë afatmesme. Rënia e spread-it është më e theksuar për normat e interesit në lekë, sidomos në periudhën afatmesme, pasi ato kanë qenë historikishtshumëmëtëlartase interesatnëvalutë.

Gjithashtu, vihet re se reduktimi më i madh i spread-eve ka ndodhur kryesisht në vitin 2001 dhe 2004. Këto dy periudha korrespondojnë me hyrjen e dy bankave të huaja në tregun shqiptar nëpërmjet blerjeve fillimisht të bankës së dytë më të madhe, Banka Kombëtare Tregtare që përbënte gati 10 për qind të aktiveve të sistemit në kohën e privatizimit, dhe më vonë të Bankës së Kursimeve (sot Banka Raiffeisen) që zotëronte mbi 50 për qind të aktiveve në fillim të 2004. Pas kolapsit të ekonomisë gjatë trazirave të vitit 1997, banka qendrore i ndaloi të dyja bankat e mëdha (me pronësi shtetërore) të ushtronin aktivitetin e kredi-dhënisë pasi ato rezultuan praktikisht të falimentuara. Sidoqoftë, privatizimi i tyre nga bankat e huaja solli përmirësimë dhe risi në produktet e ofruara deri atëherë në sistem, duke qenë se tashmë atyre u duhej të ishin aktive dhe të konkuronin në tregun e kredive me bankat aktuale që kishin përvetësuar më shumë eksperiençë në këtë drejtim.

Si përfundim, liberalizimi i sistemit bankar duke krijuar kushte të njëjtë për bankat private vendase apo të huaja duket të ketë qenë i suksesshëm. Pjesëmarrja e bankave të huaja ka ndikuar pozitivisht në rritjen e konkurrencës midis bankave, rënien e përqendrimit të mjeteve financiare në pak banka, dhe përfundimisht në uljen e spread-it të interesave të aplikuara ndaj huamarrësve. Përmirësimi i këtyre të fundit është vërtet i rëndësishëm për një vend si Shqipëria, ku tregu i kapitaleve thua jse nuk ekziston dhe

Tabelë: Spread-i afatshkurtër dhe afatmesëm i normave të interesit

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
<u>Spread-i afatshkurtër</u>									
në lekë	12.0	17.8	8.2	5.9	4.0	9.4	7.7	7.8	6.2
në dollarë				6.4	6.1	5.7	6.8	6.3	6.0
në euro				5.2	5.2	5.5	6.8	4.8	5.4
<u>Spread-i afatmesëm</u>									
në lekë	26.1	26.3	18.5	18.6	19.6	17.1	11.0	10.9	9.8
në dollarë							5.6	5.2	5.6
në euro							7.5	4.6	4.7

Shënim: spread-i afatshkurtër është llogaritur si diferenca midis normave mesatare vjetore të interesave të kredive 6-12 mujore dhe depozitave 12 mujore; ndërsa për spread-in afatmesëm janë përdorur interesat e kredive 1-3 vjeçare dhe depozitave 2 vjeçare.

shumica e firmave dhe individëve imbeshtetën tek bankat për financime të jashtme.

D Sjellja e kredisë: a duhet të shqetësohem?

Sjellja e kredisë për sektorin privat ka qenë dhe vazhdon të jetë një çështje tepër e rëndësishme dhe mjaft delikate për sistemin bankar në vendet e Evropës Juglindore. Ndryshe nga fundi i viteve '90 kur kredia e sistemit bankar për sektorin privat ishte e dobët ose inekzistente për disa nga këto vende, në vitin 2007 ajo arrin në mesatarisht 49 % të PBB-së. Rritja mesatare vjetore e kredisë për sektorin privat shënon rrëth 48% për këto vende, duke qenë rrëth 25 pikë përqindje më e lartë se rritja e këtij treguesi në vendet e Evropës Qendrore. Të dhënat tregojnë se rritjen më të shpejtë të kredisë gjatë viteve të fundit e shënon Mali i Zi i ndjekur nga Bullgaria dhe Shqipëria. Mali i Zi dhe Bullgaria kryesojnë përsëri për sa i përket nivitet më të lartë të kredisë ndaj PBB-së ndërsa Shqipëria mbetet e fundit në radhë. Muhlberger (2007)

ekuilibër, duke vërtetuar të qenit e tyre në një proces konvergjencë. Sipas llogaritjeve, Shqipëria është në procesin e konvergjencës dhe për të arritur në nivelet ekuilibër, niveli aktual i kredi/PBB duhet të ishte dy herë më i lartë.

Rritja e shpejtë e kredisë në vendet SEE edhe pse nga njëra anë shihet si një proces i nevojshëm konvergjencë që ndihmon rritjen ekonomike të mbështetur nga kërkesa e brendshme dhe nga fakti se llogaritet mbi një bazë fillostarte tepër të ulët, nga ana tjetër, komentohet si një fenomen potencial i rrezikshëm për stabilitetin makroekonomik dhe financiar. Zhvillimet e shpejta në kredi mund të ndikojnë stabilitetin e çmimeve në përmjet ndikimit në kërkësë aggregat, ashtu edhe stabilitetin financiar nëpërmjet rritjes së rrezikut të moskthimit të kredisë dhe ekspozimit më të lartë të sistemit bankar nga zhvillimet në sektorin real te ekonomisë.

Rritja e shpejtë e kredive në shumë vende është shoqëruar me një rritje tullumbace të çmimeve të aseteve të ndryshme, si për shembull të çmimeve

Tabelë: Zhvillimet në kreditinë për sektorin privat në SEE.

	Rritja vjetore e kredisë në term nominalë (%)			Kredi/PBB (%)
	2005	2006	2007*	2007*
Bullgaria	32.4	24.6	58.6	60.8
Bosnia -Hercegovina	27.4	23.3	29.3	59.1
Kosova	37.5	23.9	40.0	37.5
Maqedonia	19.7	24.3	39.0	36.0
Mali I Zi	30.1	142.4	182.9	95.7
Rumania	45.8	54.5	6.4	37.6
Serbia	53.9	17.4	40.5	34.1
Shqipëria	82.1	55.4	47.7	29.9
Mesatarja e SEE	41.1	45.7	56.7	48.8
Mesatarja e Evropës Qendrore ¹	20.6	22.0	25.5	54.0

*ose të dhënat më të fundit të disponueshme

Burimi: FMN dhe banka qendrore

¹Republika Ceke, Hungaria, Polonia, Sllovenia, Sllovakia

duke parë normat e larta të rritjes së kredisë së sektorit privat dhe normat relativisht të ulëta të kredisë ndaj PBB-së hedh pyetjen nëse këto vende po përfjetojnë thjesht një proces normal konvergjencë me vendet e Eurozonës. Kështu, duke përcaktuar “nivele ekuilibër” të treguesit kredi ndaj PBB-së ai tregon se nivelet kredi/PBB për vendet SEE janë poshtë niveleve përkatëse

të pasurive të paluajtshme, të cilat më pas kanë shpërthyer dhe kanë ndikuar negativisht vlerën e kolateralit dhe cilësinë e kredive të emetuara ndaj tyre. Rasti më i freskët i pasojave të këtij fenomeni është kriza e tregut “sub-prime” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e cila ende nuk i ka shterur pasojat e veta negative dhe kontaminuese edhe për vendet e tjera. Kjo krizë,

duke u shfaqur si një krizë likuiditetesh dhe me ndikime të drejtpërdrejta në tregjet e kapitalit, e shoqëruar me krizen e produkteve ushqimore, si dhe rritjen e shpejtë të çmimit të naftës, ka shtruar mjaft pikëpyetje për perspektivat e zhvillimit të ekonomisë botërore.

Për sa i përket kompozimit të kredisë ndaj sektorit privat, kredia për biznese ka qenë përbërsi kryesor në këto vende, kundrejt kredisë për individë. Megjithatë, gjatë viteve të fundit është vënë re një protagonizëm gjithnjë e në rritje e kredisë për individët në portofolin e kredisë për sektorin privat. Mihaljek (2006) thekson faktin se gjatë viteve 1990 individët kanë qenë pothuajse të neglizhuar nga sistemi bankar. Por kjo situatë ndryshoi me futjen e bankave të huaja në këto vende, të cilat rritën konkurrencën për pjesë në treg, prezantuan produkte të reja dhe ulën normat e interesit. Nga ana tjetër, zhvillimi ekonomik dhe rritja e të ardhurave të individëve solli rritjen e kërkesës së individëve për kredi, duke plotësuar rritjen e ofertës për kredi nga sistemi bankar.

Veçanërisht për strukturën e kredisë në Shqipëri, vihet re se ajo ka pësuar ndryshime në vitet e fundit si për sa i përket sektorëve të ekonomisë, maturimit, apo edhe valutës. Vlen për t'u përmendur se pavarësisht ndryshimeve, disa tipare janë mbizotëruar për një kohë të gjatë në sistemin bankar shqiptar. Megjithë zhvillimet pozitive në drejtim të rritjes së kreditimit ndaj individëve, bankat vazhdojnë të kenë bizneset si segmentin më të preferuar të tyre, ku teprica e kredisë për këta të fundit përbën treth 64% të kredive të sistemit në fundin e vitit 2007. Kredia për bizneset është e shpërndarë kryesisht në bizneset që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorët më jetësor të ekonomisë si tregtia, industria përpunuese dhe ndërtimi. Ndërkohë që kreditimi për një nga sektorët më të rëndësishëm, atë të bujqësisë, mbetet i kufizuar. Kjo për shkak të problemeve thelbësore që shoqërojnë këtë sektor, si problemet me pronësinë e tokave, zhvillimi i fermave korporative apo në përgjithësi të mungesës së politikave dhe strategjive për zhvillimin afatgjatë të këtij sektori.


	Rritja vjetore e kredisë (terma nominalë)				Përbërja e kredisë totale	
	biznese		individë		biznese	individë
	2006	2007	2006	2007*	2007 *	
Bullgaria	19.4	72.4	30.6	52.3	62.4	37.6
Bosnia -Hercegovina	20.3	25.3	26.6	30.0	51.1	48.9
Kosova	26.5	40.8	16.0	37.3	77.5	22.5
Maqedonia	25.3	29.5	48.8	56.5	61.3	38.7
Mali I Zi	102.3	187.3	198.3	155.5	63.7	36.3
Rumania	45.4	54.1	83.8	82.1	50.5	49.5
Serbia		33.2		50.4	62.4	37.6
Shqipëria	52.9	35.5	67.7	59.1	64.1	35.8
Mesatarja e SEE	41.7	59.8	67.4	65.4	61.6	38.4
Mesatarja e Evropës Qendrore ¹	20.6	22.0	20.6	22.0	25.5	54.0

*ose të dhënat më të fundit të disponueshme.

¹ Republika Ceke, Hungaria, Polonia, Sllovakia, Slovenia.

Burimi: FMN dhe të banka qendrore.

Struktura e kredisë sipas sektorëve (Shqipëri)



Kredia për individët ka njojur rritje të shpejtë në Shqipëri. Norma vjetore e rritjes së kësaj kredie gjatë viteve të fundit ka qenë më e lartë se ajo e bizneseve. Faktorët që kanë kontribuar në këtë rritje vlerësohen të jenë zgjerimi dhe thellimi i sektorit finanziar, duke mbuluar një shtrirje më të gjerë gjografike, orientimi i bankave më shumë drejt bankingut me pakicë, duke ofruar më shumë produkte të përshtatshme për individët, rritja e edukimit të publikut me kulturën bankare, kalimi i pagave fillimisht të sektorit publik dhe më pas privat në sistemin bankar. Këto zhvillime në sektorin finanziar janë shoqëruar me një ambient të qëndrueshëm makroekonomik me norma të ulëta inflacioni dhe norma të ulëta interesit si dhe çmime të larta të aktiveve (kryesish të banesave). Natyrishët këto zhvillime kanë pasur efekte në rritjen e kërkesës aggregate në vend. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë ka rritur 5 herë normat e interesit nga mesi i vitit 2006 e deri tani (gjithsej me 1.25 pikë përqindje) për të zbutur efektet e rritjes së shpejtë të kërkesës aggregate mbi inflacionin.

Kreditimi në valutë është një tjetër karakteristikë e vendeve të Evropës Juglindore dhe Shqipërisë. Kështu, në terma të strukturës së kreditimit të sektorit privat, kreditë në valutë kanë zënë një pjesë rëndësishme të totalit të kredisë në këto vende, duke u konsideruar shpesh dhe si burim rreziku për qëndrueshmërinë e sistemit finanziar për këto vende (Smagli, 2006). Pesha e lartë e kredive në valutë në totalin e kredisë rritet eksponenti ndaj lëvizjeve të kursit të këmbimit dhe e shndërron riskun valutor në risk të moskthimit të kredisë nga sektori privat



jofinanciar. Në masën që kredi-marrësit vendas nuk i kanë të ardhurat në valutë të huaj, risku i pambrojtur i kursit të këmbimit bëhet një pjesë e rëndësishme e pjesës së riskut të kredisë.

Në Shqipëri, vlerësimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i lekut kundrejt valutave të huaja, dollarizimi i çmimit të pasurive të paluajtshme, normat e larta të interesit për kreditinë në lek kanë ndikuar në kërkesën për kreditinë në valutë. Kredia në valutë përbën mbi 70 % të totalit të kredisë dhënë sektorit privat, dhe rreth 60 % të kredisë dhënë individëve. Të dhënët tregojnë së pavarësisht se pesha e kredisë në lekë është rritur gjatë këtyre viteve të fundit, ajo mbetet përsëri e ulët. Duhet pasur parasysh se edhe pse analizat e autoriteteve rregullative në vend nuk evidentojnë ndonjë rrezik për sistemin tonë finanziar të përcjellë nga zhvillimet rajonale e globale, ekziston mundësia që efektet e tyre të shfaqen në pjesën e huadhnies në valutë. Kjo mund të vijë si rezultat i rritjes së luhatshmërisë së kursit të këmbimit dhe ndryshimit të shpeshtë të normave të interesit. Këta janë dy faktorë veçanërisht të rëndësishëm që mund të përcaktojnë aftësinë paguese të huamarrësit në rastin e huasë në valutë. Banka e Shqipërisë ka theksuar shpesh në deklaratat e saj që bankat ashtu si edhe klientët e tyre huamarrës, duhet të ndjekin me kujdes dinamikën e zhvillimeve të këtyre faktorëve, dhe të kryejnë veprimet e nevojshme për t'u mbrojtur nga zhvillimi i tyre i pafavorshëm. Banka e Shqipërisë do të miratojë së shpejti disa masa rregullative, të cilat synojnë të zbusin këtë rrezik për bankat dhe klientët e tyre dhe të tregojnë se është e rëndësishme dhe

e shëndetshme për agjentët ekonomikë që të financojnë nevojat për zhvillim në të njëjtën monedhë në të cilën sigurojnë të ardhurat e tyre.

kërkesën për këtë kredi.

Pesha e kësaj kredie ka ardhur në rritje gjatë viteve të fundit, ku në tremujorin e parë të vitit 2008 ajo përbënte rrith 24 për qind të portofolit




Një karakteristikë tjeter e vënë re për vendet e Evropës Qendrore dhe SEE është marrëdhënia midis zhvillimit të tregjeve të pasurive të paluajtshme dhe rritjes së kredisë për sektorin privat. Në shumë nga këto vende kreditë për pasuri të paluajtshme kanë zënë një pjesë gjithnjë e më të rëndësishme në zgjerimin e kredisë (Mihaljek, 2005, Backé dhe Wójcik, 2007, Égert dhe Mihaljek, Wójcik, 2007). Gjatë vitit 2007 është vënë re një rritje mesatare prej 60 % e kredisë për pasuri të paluajtshme, dhe një nivel mesatar i këtij treguesi ndaj PBB-së, rrith 10%.

Edhe në Shqipëri, kërkesa për blerjen dhe ndërtimin e shtëpive (sidomos për metropolet ku përqendrimi i popullsisë është i lartë) ka ardhur vazhdimisht në rritje, e shoqëruar kjo me një rritje edhe të kërkesës për kredi për pasuri të paluajtshme. Ky produkt konsiderohet tashmë si një nga llojet e kredive, me interes si për bankat, ashtu edhe për klientët. Gjatë viteve të fundit është vënë re qartë agresiviteti i bankave në këtë drejtim pasi ato kanë hedhur dhe vazhdojnë të hedhin në treg (reklamojnë) produkte me kosto të ulët të kredive për banesa, duke nxitur interesimin e individëve për përfitimin e këtij produkti. Zgjerimi i portofolit të bankave në kredi për pasuri të paluajtshme lidhet dhe me faktin se ky portofol vlerësohet me një rrezik relativisht më të ulët krashevuar me produktet e tjera të kredisë, pasi në shumicën e rasteve kjo kredi është e mbuluar me kolateral me banesën për të cilën merret kredia. Nga ana tjetër edhe rritja e vazhdueshme e çmimeve te banesave sidomos në Tiranë, e ka bërë të domosdoshme financimin e blerjes se tyre me kredi, duke rritur

të kredive të sistemit bankar shqiptar. Gjithsesi, vlen të përmendet se ndërsa vendet e Evropës Qendrore Lindore arrijnë nivele dyshifrore të raportit të kredive për pasuri të paluajtshme me PBB-në, vendet e rajonit përfshirë edhe Shqipërinë janë në nivele shumë më të ulëta. Për vendin tonë kjo shifër llogaritet afersisht 7 për qind, dhe është e krahasueshme me vendet e tjera të Evropës Juglindore.

Në procesin e kredi-dhënës për pasuri të paluajtshme gjatë viteve të fundit në Shqipëri viven re dy tipare kryesore, që janë: mbizotërimi i kredisë për pasuri të paluajtshme akorduar individëve; dhe mbizotërimi i kredisë për pasuri të paluajtshme akorduar në monedhë të huaj. Kjo shpërndarje është e ndikuar nga fakti se blerjet e banesave në më të shumtën e rasteve janë nxitur nga nevoja e individëve për strehim. Po kështu edhe kuotimi i çmimeve të banesave në monedhe të huaj, euro, ka nxitur kërkesën për kredi në monedhën e blerjes së banesës.

Gjithsesi, me gjithë ecurinë në rritje të kësaj kredie, cilësia e portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme mbetet e mirë. Kredia me probleme për pasuri të paluajtshme shfaq vlera të ulëta të cilat reflektojnë zhvillimet e viteve të fundit dhe faktin e mirëpranuar se rritja e shpejtë e portofolit të kredisë shoqërohet me një përkëqësim të cilësisë së në periudha të mëvonshme. Përsa i përket cilësisë së portofolit të kredisë totale, rapporti i kredive me probleme ndaj totalit të tepricës së kredive (bruto) ka shfaqur nivele të ulëta por me një tendencë të lehte rritëse. Gjithsesi, Shqipëria renditet ndër vendet e rajonit me tregues të ulët të kredisë me



probleme ndaj totalit të kredisë.

Ndër masat që do të ndikojnë në mbajtjen nën kontroll të këtij treguesi janë edhe hyrja ne fuqi e ligjit të ri "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" në Qershorr 2007 dhe miratimi i rregulloreve të reja e ndryshimi i atyre ekzistuese, që venë theksin mbi administrimin e rrezikut te kredisë, dhe në përgjithësi në një mbikëqyrje më efektive në përpunje me direktivat e Bashkimit Evropian dhe parimet e Komitetit të Bazelit. Gjithashtu, në Janar 2008 Banka e Shqipërisë realizoi vënien në funksionim të Regjistratit të Kredive, duke ofruar një instrument tepër të rëndësishëm për thellimin e analizës dhe uljen e rrezikut të kredive nga ana e bankave.

► Referanca

- Banka e Shqipërisë, "Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes Bankare 2000"
- Banka e Shqipërisë, "Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes Bankare 2006"
- Claeys, S. & C. Hainz (2007), "Acquisition versus Greenfield: the Impact of the Mode of Foreign Bank Entry on Information and Bank

Lending Rates. Theory and Evidence," Sveriges Riksbank Working paper, no. 210.

Égert, B. & D. Mihaljek (2007), "Determinants of House Price Dynamics in Central and Eastern Europe", In: Focus on European Economic Integration 1/07, Vienna: Oesterreichische Nationalbank. 52–76.

Kiss, G., M. Nagy & B. Vonnák (2006), "Credit Growth in Central and Eastern Europe: Trend, Cycle or Boom?" Studim i prezantuar në konferencën "Finance and Consumption Workshop: Consumption and Credit in Countries with Developing Credit Markets" në Firence, qershor 16–17.

Rybiski, Krzysztof (2007), "Rapid Credit Growth in Converging Economies – the Challenges Ahead", Warsaw, 22-23 November 2007.

Note, Sofika (2007), "Konkurenca në Sistemin Bankar Shqiptar," Banka e Shqipërisë, Material diskutimi ende i publikuar, 2007.

Lechner, M. & M. Schnitzer (2006), "Entry of Foreign Banks and their Impact on Host Countries," University of Munich, Discussion paper 2006-29, Sep. 2006.

KRIZA E ÇMIMEVE: KONSEKUENCAT DHE MASAT E MUNDSHME PER ZBUTJEN E SAJ

GRAMOZ KOLASI

Banka e Shqipërisë
Drejtori i Departamentit të Politikës Monetare

gkolasi@bankofalbania.org

Zhvillimet ne tregjet ndërkombëtare kanë zënë një vend të rëndësishëm në vëmendjen e opinionit publik këto kohët e fundit, në nivel global. Vlerësohet se miliona njerëz do të vuajnë nga uria, ndërkohë që shumica e vendeve të zhvilluara apo në zhvillim do të përballen me rezikun e inflacionit. Tashmë janë kryer analizat e para për të gjetur jo vetëm shkaqet e këtij fenomeni por diçka më shumë. Janë formuluar konkluzionet e para, ku dhe globalizimi ka pjesën e tij "të fajit". Megjithatë, ajo që ka rëndësi në këtë moment lidhet me reagimin e autoriteteve. Cilat do të ishin kurat që do të zbusnin këtë efekt? Po roli i institucioneve të veçanta? Materiali në vazhdim pasi hedh një vështrim të zgjeruar mbi ambientin global, përpinqet të sjellë në vëmendjen e lexuesit disa prej politikave që duhen ndërmarrë, për të lehtësuar sadopak efektet negative që kjo situatë gjeneron mbi ekonomitë e veçanta të globit.

► Kriza. Zanafilla dhe deri kur?

Pothuajse kanë kaluar 7–8 muaj që kur fenomeni i rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore u bë pjesë e menysë mediatike në Shqipëri. Shkaku ishte i thjeshtë. Një lajm se prodhuesit e bukës do të trisnin çmimin e produktit të gatshëm, pasi prej kohësh përballeshin me çmime në rritje nga ana e importuesve të drithit, krijoj një sensibilitet të jashtëzakonshëm. Siç ndodh rëndom në kësi rastesh, filloj interesimi mediatik për të kuptuar diçka më shumë nëse bëhej fjalë për një abuzim të importuesve, një ngarkesë fiskale e re apo nëse kishte arsyë të tjera. Pak nga pak filloj të zbulohet se bëhej fjalë për një fenomen global. Çmimi i drithërave kishte shënuar rritje në tregun ndërkombëtar e për rrjedhim, kjo do të ndjehej edhe në tregun tonë. Me kalimin e kohës u mor vesh se imuniteti kishte rënë edhe për artikuj të tjerë ushqimorë si: vaji, yndyrat, mish, vezët etj.. Në shumë raste, në kronikat e lajmeve qendrore janë shfaqur pamje të trishtueshme, të mbjella që ruhen me njerëz të arrinatosur, njerëz që grinden për një dorë miell, protesta masive për më shumë mbështetje nga shteti etj..

► Çfarë ka ndodhur realisht?

Rritja e çmimeve është një dukuri e bërë prezente

këtë fillimshekulli. Viti 2000 karakterizohet si periudha e fundit me çmime të ulëta. Që nga ajo kohë çmimi i grurit në tregun ndërkombëtar është trefishuar, ndërkohë që edhe çmimi i misrit është rritur më shumë se dy herë. Çmimi i orizit marsin e fundit kërceu në mënyrë të pabesueshme, i ndjekur nga lëvizje të forta edhe në çmimet e artikujve të tillë ushqimorë si bulmet, mish, shpend dhe vaji i kuzhinës. Edhe në qoftë se do të bëjmë një lloj korrigjimi duke zhveshur çmimet aktuale nga inflacioni dhe zhylerësimi i dollarit, hapi me të cilin ato janë rritur, edhe pse më i vogël, përsëri është dramatik (grafiku 1 jep një pamje më të qartë të këtyre zhvillimeve dramatike).


Tashmë janë bërë analizat e para dhe, pak a shumë, është arritur në përcaktimin e shkaqeve të cilat kanë gjeneruar këtë epidemi rritjesh të çmimeve ushqimore. Sipas një dokumenti të përgatitur kohët e fundit nga dy prej agjencive ndërkombëtare më të specializuara në këtë drëtim, FAO-s dhe IFAD-ës konkludohet se gjashtë janë shkaqet kryesore:

- prodhimi botëror i drithërave në vitin 2005 është rritur më 3,6 për qind, i pasuar nga një tjetër rënje në masën 6,9 për qind në vitin 2006. Moti i keq vlerësohet të ketë qenë shkaku kryesor që ka dëmtuar prodhimin e të lashtave, gjatë kësaj periudhe dyvjeçare.

- gjendja e ulët e rezervave që, ka krijuar presione shtesë mbi nivelin e çmimeve. Rezervat e pakësuara e kanë bërë më të prekshëm efektin negativ të shkaktuar nga rënia e prodhimit, pasi tregu është i frikësuar nga mungesa e një jastëku amortizues. Raporti

që në Brazil dhe Indi është rritur respektivisht me 70 % dhe 20 %. Përderisa nevoja për të produhuar një 1 kg mish është 5 kg drithë, ky ndryshim në menynë ushqimore të këtyre vendeve po i bën drithërat gjithnjë e më të shtrenjta. - kohët e fundit, prodhues të mëdhenj të

Çmimet botërore të mallrave (janar '00 – shkurt '08; US\$/ton).




rezervave të drithërave në vitin e të lashtave 2007/08 ndaj totalit të shfrytëzuar të drithërave, vlerësohet të jetë vetëm 18,7 për qind, niveli më i ulët në tre dekadat e fundit.- çmimet e karburanteve janë shumë të korreluara me çmimet e artikujve ushqimore. Sipas matjeve të fundit koeficienti i korrelacionit është më shumë se 0,6. Për rrjedhim, rritja e shpejtë e çmimeve të naftës dhe nënprodukteve të saj ushtron një presion të drejtpërdrejtë mbi çmimet e ushqimeve, përderisa në dy vitet e fundit çmimet e plehrave janë trefishuar dhe kostot e transportit janë dyfishuar.

- kërkesa në rritje nga ana e sektorit të biokarbureve ushtron presione në kahun rritës mbi çmimet e produkteve ushqimore. Ka vlerësimë se rrith 100 milionë ton grurë (4,7 për qind e prodhimit të përgjithshëm të drithërave) janë përdorur në periudhën e të lashtave 2007/08 për prodhimin e biokarbureve. Për të njëjtën periudhë vetëm në SHBA pritet që rrith 80 milionë ton misër të përdoren për prodhimin e etanolit, sasi që nënkupton një rritje prej 37 për qind në raport me vitin e kaluar. - rritja ekonomike në disa ekonomi të mëdha në zhvillim po çon në ndryshime në modelin e ushqimit të popullsive të këtyre vendeve, kryesisht në formën e një kërkese të rritur për ushqime me bazë drithëresh. Gjatë 15 viteve të fundit, konsumi i mishit në Kinë është dyfishuar, ndërkohë

drithërave, kanë aplikuar disa politika tregtare penguese, duke prezantuar taksa eksporti e për rrjedhim, ndikimi ka qenë i menjëhershëm në çimin e drithërave. Ajo çka rrit kompleksitetin e këtij fenomeni, është lidhur me zhvillime të tjera të natyrës ekstreme. Kohët e fundit, çmimet e lëndëve të para janë rritur në mënyrë të pandalshme. Çmimi i naftës nuk rresht së regjistruari rekorde ditore. Në datën 7 qershor 2008, çmimi i naftës bruto në bursën e New York-ut u rrit deri në nivelin 139 dollarë përfundit. Rritja e pandërpërre e çmimit të naftës këto pesë vitet e fundit është udhëhequr kryesisht nga faktorë themelorë. Grafiku 2, ilustron një fakt shumë domethënës: Edhe pse konsumi i vendeve të zhvilluara (Amerika e Veriut dhe Evropa) vahdojnë të konsumojnë rrith gjysmën e prodhimit botëror të naftës, vendet re një rritje shpejtë e konsumit të naftës nga kontinenti Aziatik. Për më tepër, një grup vendesh në zhvillim që kryesisht përfaqësojnë rajone të ndryshme gjeografike, si nga Evropa, Lindja e Mesme dhe veçanërisht Azia, me oreksin e madh të këtyre pesë vitezave të fundit, kanë kontribuar në masën 60 për qind në rritjen e konsumit të karburanteve në periudhën 2003 – 2006. Nga ana tjetër, Amerika e Veriut dhe Evropa, për të njëjtën periudhë, kanë kontribuar vetëm në

Konsumi i naftës në vitin 2006




Burimi: Angjencia Ndërkombëtare e Energjisë

masën 20 për qind. Faktori më specifik në gjithë këtë ecuri i përket ekonomisë kineze, konsumi i së cilës në periudhën 1990 – 2006, tritet me një përqindje vjetore eksponenciale në masën 7,2 për qind (James D. Hamilton, maj 2008). Në qoftë se supozojmë që kjo rritje do të vazhdojë edhe në vitet në vijim, në vitin 2020, Kina

vlerësohet se nuk është një fenomen kalimtar. Përkundrazi, ekspertë të ndryshëm besojnë se ajo do të jetë prezente në një horizont kohor afatmesëm. Pavarësisht rritjes së prodhimit botëror të drithërave me 4,7 për qind në 2007 dhe projeksiioneve për një rritje 2,6 për qind në vitin 2008, studimet e Institutit Ndërkombëtar

Rritja e konsumit të naftës gjatë periudhës 2003 – 2006



Burimi: Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë

do të konsumonte 20 milionë fuçi në ditë, një shumë e përafërt me konsumin e sotshëm të SHBA. Ndërsa q në vitin 2030, konsumi i Kinës do të kapërcente shifrën 40 milionë fuçi në ditë, dy herë më shumë se konsumi aktual i SHBA.

► Sa do të zgjasë ajo?

Rritja në çmimet e produkteve ushqimore

të Politikave Ushqimore, të OECD-së dhe të FAO-s të lënë të kuptosh se çmimet e produkteve ushqimore, do të vazhdojnë të qëndrojnë sipër tendencës së tyre afatgjatë për një periudhë të konsiderueshme. Më konkretisht, vlerësohet se çmimet e mallrave ushqimore, në 10 vitet që do të vijnë, do të jenë më të larta se niveli i tyre në 10 vitet e mëparshme. Ndërsa faktorët kryesorë që mendohen se do të kushtëzojnë këtë nivel të lartë

çmimesh, përmenden përsëri kërkesa e lartë për biokarbure, tritja e lartë e ekonomive në zhvillim si dhe rreziqet e lidhura me ndryshimet klimaterike. Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, sipërfaqja e tokës arë e destinuar për tritjen e biomasës për hidrokarbure të lëngshme do të trefishohet në 20 vitet në vijim. Po kështu, ekonomitë në zhvillim do të ruajnë ritme tritjeje ekonomike treth 6 për qind çdo vit, duke ushtruar në këtë mënyrë presione të vazhdueshme mbi kërkesën për mallra ushqimore. Tabela në vijim pasqyron projekzionet e çmimeve të drithërave për vitet në vijim.

Projekzionale të indeksit të çmimeve të të korruvave ushqimore (në terma realë; 2004 = 100)

Çmimet Reale	2007	2008	2009	2010	2015
Misër	141	179	186	176	155
Grurë	157	219	211	204	157
Oriz	132	201	207	213	192
Sojë	121	156	150	144	127
Vaj Soje	138	170	162	153	119
Sheqer	135	169	180	190	185

Burimi: Grupi i Prospekteve të Zhvillimit, Banka Botërore

Sipas këtij parashikimi çmimet pritet të qëndrojnë në nivele të larta në vitin 2008 dhe atë 2009, duke i lënë më tej vendin një periudhe me rënje çmimesh, si rezultat i veprimit të forcave të tregut (reagimi i ofertës dhe kërkesës ndaj çmimeve të rritura). Megjithatë, duhet theksuar se në vitin 2015, niveli i tyre përsëri do të vazhdojë të jetë ndjeshëm më i lartë se niveli respektiv në vitin 2004, për pjesën më të madhe të të korruvave.

► Po me çmimet e naftës çdo të ndodhë?

Në paragrafët e mësipërm u tha që konsumi i ekonomive në zhvillim do të rritet në vjetet që vijojnë, duke bërë të mundur një ambient global me çmime të larta të karburanteve në përgjithësi. Veçanërisht së u përmend në mënyrë specifike, ekonomia kineze, gjeneron një kërkesë të lartë në rritje, e cila nga ana e saj ushtron presion mbi çmimin e naftës.

Ekzistojnë arsyet e besueshme që e bëjnë realist skenarin e mësipërm, për një rritje eksponenciale vjetore në masën 7 për qind të konsumit të naftës nga ana e ekonomisë së Kinës. Në vitin 2006, Kina përdori rreth 2 fuçi për person, ndërkohë që Meksika përdori 6,6 fuçi në ditë dhe SHBA 25 fuçi. Nga një studim i fundit (Max Auffhammer and Richard Carson, gusht 2007) përmendet fakti se ende në Kinë numri i automobilave për 100 persona është i vogël, vetëm 3,3 për 100 kinezë rezidentë. Ndërkohë që në SHBA ky numër është 77. Pa dyshim që këta dy shembuj nuk lënë mëdyshje se potenciali për

një kërkesë të lartë të Kinës në të ardhmen është plotësisht i besueshëm. Kohët e fundit, është ngritur edhe shqetësimi për rritje spekulative të çmimit të naftës (James D. Hamilton, maj 2008). Megjithatë i rëndësishëm mbetet fakti se në ecurinë afatgjatë të çmimit të naftës, efekti kryesor vjen nga faktorët themelorë dhe jo nga spekulime të veçanta të momentit.

► Pasojat me të cilat përballemi?

Çmimet e rritura kanë ndikuar në mënyra të ndryshme ekonomitë e ndryshme të globit. Në nivel kombëtar, vendet që janë eksportuese për neto të produkteve ushqimore do të përfitojnë, si pasojë e përmirësimit të termave të tregtisë. Megjithatë, në këtë moment, disa prej vendeve eksportuese kanë adoptuar politika proteksioniste në raport me eksportet ushqimore, duke ndikuar deri-diku në zbehjen e këtyre përfitimeve. Vendet importuese për neto të produkteve ushqimore, sigurisht që do të preken negativisht nga fenomeni i çmimeve të rritura, përderisa atyre iu duhen përpjekje të mëdha, për të përballuar kërkesën e brendshme për ushqime. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, pothuajse i gjithë kontinenti afrikani, i cili është një importues për neto i drithërave, është goditur shumë nga rritja e çmimeve.

Nga këndvështrimi i individëve, rritja dhe paqëndrueshmëria e çmimeve godet segmentin më të pambrojtur dhe më të varfër të shoqërisë. Në nivel botëror apo edhe në kontekst të një ekonomie të dhënë, numri i individëve të

cilët janë eksportues për neto të produkteve ushqimore, për rrjedhim, shitës për neto që përfitojnë nga çmimet e rritura, është i vogël. Nga ana tjetër, numri i individëve që për neto janë blerës të produkteve ushqimore (për fat të keq ky numër përbën shumicën), do të preket nga ky fenomen.

Ushqimi bazë i shtresave të varfra është vënë në rrezik. Çmimet e rritura ndikojnë në uljen e konsumit ushqimor nga shtresat e varfra, duke shkaktuar një përkqësim të balancës së domosdoshme ushqimore. Në terma afatgjatë kjo përbën një trezik për gjendjen shëndetësore të këtyre grupeve të popullsisë botërore. Për ta bërë më të qartë këtë problem, supozojmë se për një familje prej 5 personash të cilët jetojnë me një dollar amerikan për kokë, çdo ditë, një rritje prej 50 për qind në çmimin e ushqimeve gërryen buxhetin familjar prej 5 dollarësh me 1,5 dollarë çdo ditë. Ky efekt negativ pëershkallëzohet më tej në rast të kombinimit të saj me rritjen e kostos së energjisë, kryesisht nëpërmjet rritjes së çmimit të naftës.

Me pak fjalë ajo çka po ndodh me çmimet e produkteve ushqimore dhe lëndëve të para në përgjithësi, mund të cilësohet si një presion sistematik mbi mirëqenien e shumë kombeve të varfra, e cila kryesisht gërryhet nga inflacioni i rritur ndërkohë që dhe balancat tregtare të tyre sa vijnë e përkqësohen. Sipas një studimi të Bankës Botërore në shumë nga vendet e varfra të globit, ku progresi në rritjen e të ardhurave ka qenë i ngadalët këto 5 – 10 vitet e fundit, ekziston rreziku që përfitimet të zhdulen me shpejtësi, të paktën në horizontin afatshkurtër. Në terma afatgjatë parashikimi bëhet më i vështirë, pasi për momentin është ende pak e qartë se si do të reagojë aktiviteti i përgjithshëm ekonomik ndaj bilancit kursim - investim të përfituesve për neto, nga rritja e çmiveve.

► Reagimi, receta dhe masat e marra

Ndoshta me pak vonësë, por gjithsesi, institucionet e specializuara ndërkombëtare, pas një diagnostikimi ende jo të plotë, kanë formuluar tashmë një sërë rekomandimesh, të cilat më së shumti kanë të bëjnë me rolin e institucioneve ekzekutive. Nga ana tjetër, ende nuk është ravigjëzuar ndonjë sugjerim specifik, i cili të gjëzojë një konsensus të gjerë në lidhje

rolin e bankave qendrore në klimën aktuale. Sigurisht, që ekonomia botërore është ndeshur dhe më parë me kriza të çmimeve të lëndëve të para, dhe eksperiencat e nxjerra prej tyre shërbijnë sadopak. Megjithatë, kriza aktuale është e shoqëruar edhe me një element të tretë, krizen e kredive që ka gjeneruar ekonomia amerikane, e cila është shpërndarë edhe në shumë prej ekonomive të zhvilluara.

Shumë vende kanë ndërmarrë tashmë veprime konkrete në përpjekjet e tyre për të minimizuar efektet e çmimeve të rritura ndaj popullatës. Argjentina, Bolivia, Kamboxhia, Kina, Egjipti, Etiopia, India, Indonezia, Kazakistan, Meksika, Maroku, Rusia, Tailandë, Ukraina, Venezuela dhe Vietnam kanë zgjedhur si rrugën më të thjeshtë vendosjen e barrierave në drejtim të eksporteve ushqimore dhe në disa raste kanë vënë nën kontroll edhe çmimet për disa prej artikujve ushqimorë. Për shembull, Kina ka ndaluar eksportin e orizit dhe të misrit; India ka ndaluar eksportin e qumështit pluhur; Etiopia ka ndaluar eksportin e drithërave. Vende të tjera kanë ndërrhyrë në uljen e tarifave për importet ushqimore. Kështu, Maroku ka reduktuar tarifën doganore të importit të grurit nga 130 për qind, në vetëm 2,5 për qind, ndërkohë që Nigeria ka reduktuar taksën e importit të orizit nga 100 për qind, në vetëm 2,7 për qind.

► Sa efektive kanë qenë masat e mësipërme?

Sigurisht që kontrolli i çmimeve dhe modifikimi i politikave të tregtisë së jashtme, mund të jetë si një pikë fillimi për të adresuar çështjen e mbrojtjes së shtresave në nevojë. Por, duhet theksuar se shumë prej këtyre politikave kanë efekte anësore, të cilat mund të çojnë në një treg ndërkombëtar më të vogël dhe më të paqëndrueshëm. Kontrolli i çmimeve dëmon motivimin e fermerëve për më shumë prodhim bujqësor, për aq kohë sa vendosja e kontrollit ndikon në rënje, çmimet me të cilat fermerët shesin prodhimin e tyre bujqësor. Çdo strategji afatgjatë që do synojë stabilitetin e çmimeve ushqimore nënkuption rritjen e prodhimit bujqësor, dhe nga ky këndvështrim kontrolli mbi çmimet ndikon negativisht duke dekurajuar rritjen e prodhimit bujqësor nga ana e fermerëve. Për më tepër, meqenëse kemi të bëjmë me masa nga të cilat

përfitojnë të gjithë konsumatorët (edhe ata që janë në gjendje të përballojnë çmimet e rritura), atëherë mund të konkludohet se kontrolli i çmimeve zhvendos burimet drejt njerëzve që jo domosdoshmërisht kanë nevojë. Kufizimet në eksport dhe subvencionimi i importeve kanë efekte të ndjeshme në vendet partnere tregtarë me varësi të madhe nga importet, ndërkohë që dekurajon përsëri fermerët në lidhje me prodhimin bujqësor, duke zvogëluar tregun potencial ku ata mund të shesin prodhimet e tyre.

► Çfarë sugjerohet?

Çfarë mund të bëjnë qeveritë? Kjo është një prej pyetjeve të shtruara nga ekspertët e Bankës Botërore. Duke i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje ata konkludojnë se ndërhyrjet nëpërmjet politikave ekonomike mund të ndahen në grupe të mëdha: (i) ndërhyrje për të garantuar furnizimin ushqimore të grupeve në nevojë; (ii) ndërhyrjet për të ulur çmimet e brendshme ushqimore nëpërmjet masave afatshkurtra në politikat tregtare ose nëpërmjet vendimeve administrative; (iii) ndërhyrje për të nxitur ofertën ushqimore në kalimin e kohës.

► Sigurimi i ushqimit të individëve nëpërmjet programeve të posaçme për njerëzit në nevojë.

Opzioni i parë më efikas për të adresuar pasigurinë ushqimore mbetet transferimi i drejtëpërdrejtë i mbështetjes financiare në formë të parasë fizike, në grupet më të ekspozuara ndaj krizës së çmimeve. Kjo është një masë, e cila ruan të pandryshuar fuqinë blerëse të shtresave të varfra ndërkokë që nga ana tjetër, vazhdon të sigurojë stimujt e duhur për prodhimin vendas bujqësor. Më konkretisht, bëhet fjalë për transferim të fondevë financiare në formën e parasë së gatshme ose siç quhet ndryshe në formë kesh, nga buxheti i shtetit në duart e individëve përkundrejt plotësimit të disa kriterieve të caktuara (për shembull, niveli i ulët i të ardhurave, vendndodhja, apo dhe profesioni) ose angazhimit të tyre në respektimin e normave të detyruara shoqërore (për shembull, të ndjekurit e arsimit të detyrueshëm prej fëmijëve të tyre). Shkalla, efektiviteti dhe vlera e këtyre transferimeve janë të lidhura drejtëpërdrejtë me


shkallën e përgjithshme të zhvillimit të çdo vendi, duke mbajtur parasysh ndërlifikimet dhe kostot fiskale të rastit. Vlefshmëria e këtij opzioni në vendet me të ardhura të ulëta dhe kapacitete administrative të pakualifikuara është i dyshimtë dhe jo domosdoshmërisht i duhur. Programe të ndryshme të transferimit të ndihmës financiare janë zbatuar kohë e fundit në Brazil, Kinë, Etiopi, Egjipt, Indonezi, Meksikë, Mozambik, Afrikën e Jugut, Sri Lanka dhe Tunizi. Një numër vendesh përfshirë Bangladeshin, Kamboxhian dhe Indinë janë duke aplikuar programe të natyrës ushqim kundrejt punës. Ndërkokë që, disa vende të tjera si Afganistani dhe Angola shpërndajnë ndihma ushqimore për shtresat më të prekura. Gjithsesi, duhet thënë se transferimi fizik i ushqimeve është një proces i kushtueshëm dhe që mund të çojë edhe në shpërdorime apo firo të ndryshme. Nga ana tjetër, ndihma ushqimore mund të krijojë demotivim mbi prodhimin vendas, në qoftë se ai zgjatet përtej fazës së emergjencës apo nuk lidhet me programet e punësimit. Vende të tilla si Burkina Faso, Brazili, Kina, Kenia, Honduras, Meksika dhe Mozambiku, kanë adoptuar programe të ushqimit shkollor, duke synuar përmirësimin e ushqimit për nxënësit e shkollave dhe prindërit e tyre.

► Sigurimi i ushqimit nëpërmjet uljes së çmimeve të brendshme ushqimore.

Opzioni më i mirë përtëulur çmimet e brendshme, nënkupton uljen e tarifave dhe taksave të tjera që aplikohen mbi produktet kryesore. Dihet që shumë vende aplikojnë tarifa mbi importet e produkteve ushqimore, me qëllimin e dyfishtë për të mbrojtur prodhimin vendas si dhe për të siguruar të ardhura të mjaftueshme fiskale. Në trethanat e rritjes së shpejtë të çmimeve, ulja e tarifave dhe taksave mund të sigurojë një lehtësim për konsumatorët, pavarësisht se ajo është e shoqëruar me kosto të caktuar fiskale.

Pakësimi i të ardhurave, i shkaktuar nga ulja e tarifave dhe kombinimi i tyre me politika shpenzimesh buxhetore që synojnë mbrojtjen sociale të grupeve në nevojë, mund të shkaktojnë ndërlikime fiskale, që kryesisht lidhen me moskryerjen e shpenzimeve të planifikuara në fusha të tjera. 24 nga 58 vende të monitoruara kanë ulur taksat doganore dhe TVSH-në, si përgjigje ndaj rritjes së çmimeve ushqimore.

Vendimet e adoptuara ndaj krizës së çmimeve.



Burimi: Bazë të dhënash ndërtuar me përgjigjet e dhëna nga 58 vende të pyetura nga Banka Botërore

Në përgjithësi, ky grup masash, ashtu siç u përmend edhe në hyrje të këtij kapitulli, ka efekt të kufizuar në nivelin e çmimeve të brendshme ndërkokë që ka një ndikim të konsiderueshëm negativ në fitimet e prodhuesve të brendshëm dhe të eksportuesve. Nga ana tjetër, ato mund të shkaktojnë luhatshmëri të çmimeve të brendshme, për të gjitha ato vende që kanë varësi të madhe nga importet.

► Masat për të stimuluar rritjen e prodhimit në terma afat-mesëm

Çmimet e rritura, përvèç efekteve negative, përfaqësojnë edhe një oportunitet për të nxitur prodhimin e drithëra dhe për të përmirësuar kontributin e prodhimit bujqësor në rritjen ekonomike afatmesme të vendit. Prodhes bujqësorë të tillë si Brazili, Malajzia dhe Tajlanda kanë arritur një progres të konsiderueshëm vitet e fundit në komercializimin e bujqësisë dhe njëkohësisht, kanë ndërmarrë investimet të mëdha në punën kërkimore për të rritur produktivitetin dhe për të zvogëluar rrezikun bujqësor. Masa të tilla si adoptimi i instrumenteve të tregut në administrimin e rrezikut dhe përmirësimi i aksosit në sistemet e informacionit të tregut, janë të rendësishme për mobilizimin e burimeve të reja në sektorin privat, reduktimin e kostove të marketingut dhe rritjen e eficiencës së tregjeve të drithit në horizontin afatmesëm.

► Masat për të adresuar efektet anësore të politikave ekonomike

Shumë nga politikat e diskutuara në paragrafët e mësipërme kanë implikime të konsiderueshme të natyrës fiscale. Konsekuentat makroekonomike të shpenzimeve të rritura buxhetore varen gjërësisht nga mënyra se si do të financohen ato.

Në qoftë se shpenzimet buxhetore shtesë financohen nëpërmjet rritjes së huamarries së brendshme, kjo mund të çojë në një inflacion më të lartë. Si burim alternativ do të ishte transferimi i kësaj kostoje tek takspaguesit e pasur, një zgjidhje që varet shumë nga specifikat e çdo vendi në kapacitetet e grumbullimit të taksave dhe konsideratat e ekonomisë politike. Zhvendosja e burimeve financiare nga investimet publike apo nga kategori të tjera të shpenzimeve me natyrë sociale drejt masave afatshkurtra, mund të krijojë kosto oportune të konsiderueshme në terma afatmesëm dhe afatgjatë.

Vendosja dhe fuqia e grupeve të ndryshme të interesitështënjë faktor themelor në influencimin e politikave ekonomike që do të adoptohen. Edhe në rastet kur vendet janë eksportuese për neto të produkteve ushqimore, qeveritë e tyre mund të përballen me stimuj shumë të fortë për të adoptuar masa proteksioniste. Pra siç mund të vihet re, përzgjedhja e recetës së duhur është një detyrë shumë komplekse dhe e kushtëzuar

nga shumë faktorë. Në përgjithësi, një reagim i shëndoshë do të nënkuçtonte marrjen e masave që ekonomikisht duken më efektiv, që nga ana tjetër përputhen me konsideratat e ekonomisë politike dhe që në përfundim, janë në përputhje me hapësirat fiskale që ka vendi dhe kapacitetet institucionale të tij. Në përgjithësi, politikat ekonomike të çdo qeverie janë të kuptueshme dhe të pranueshme nga publiku i gjérë, nëse ato janë të shoqëruara me një strategji komunikimi efektive dhe transparente mbi shkaqet e rritjes së çmimeve dhe masat që do të ndërmerrën për të zbutur efektin e tyre.

► Inflacioni dhe roli i politikës monetare

Një nga konsekuitat e krizës së fundit ka qenë rritja e inflacionit në nivel botëror, duke mos kursyer edhe ekonomitë e zhvilluara. Parashikimet e fundit të BQE flasin për një inflacion në masën 3,4 për qind në Eurozonë, ndërkohë që në shumicën e anëtarëve të rintë të BE inflacioni ka arritur nivele dyshifrore. Po kështu, vendet fqinje po vuajnë nga ky fenomen duke regjistruar norma inflacioni të nivelit 8 dhe mbi 10 për qind. Duke u ndalur pak edhe tek ekonomia jonë, shifra më e fundit e publikuar nga INSTAT tregon se në muajin maj 2008, inflacioni vjetor u ul më tej, duke arritur nivelin 4,2 për qind. Ky është muaji i dytë që regjistron rënje të normës vjetore të inflacionit, krahasuar me muajin mars 2008 kur norma e inflacionit regjistroi vlerën 4,6 për qind. Në përgjithësi, duket se ekonomia jonë ka shfaqur një lloj imuniteti në raport me fqinjët dhe shumë ekonomi të tjera në zhvillim.

Faktorët që mund të kenë ndikuar janë të ndryshëm por gjithsesi, mund të bëhet një lloj përgjithësimi i tyre ku veçohet: (1) vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006 dhe ato të gjysmës së dytë të 2007. Duhet theksuar se kemi pasur të bëjmë me një seri rritjesh, gjithsej 5 të shpërndara në harkun kohor të 17 muajve. Sipas vlerësimeve të bëra nga stafi i Bankës së Shqipërisë duket se ekonomia ka reaguar ndaj këtyre vendimeve, veçanërisht në drejtim të minimizimit të efekteve të raundit të dytë dhe ankorimit të prishmërive inflacioniste në nivelet e synuara prej saj; (2) aksesi i ulët i prodhimit vendas në eksport, mund të jetë një arsy që nuk ka lejuar një

konvergim të shpejtë të çmimeve të brendshme me ato të tregut ndërkombëtar. Edhe pse ky zhvillim mund të ketë ndihmuar deri më tash, duhet theksuar se stimujt që ushtrojnë çmimet e rritura janë të një intensiteti të lartë dhe shumë shpejt mund të krijojnë premisat për një orientim të prodhuesve vendas drejt eksportit, që do të thotë një konvergim i shpejtë i çmimeve të produkteve të brendshme ushqimore me ato të tregut ndërkombëtar; (3) politika fiskale e zbatuar në vitet e fundit, përfshirë dhe muajt e parë të vitit 2008, mund të përcaktohet si politikë e shtrënguar. Në përgjithësi, impulsi fiskal ka qenë i dobët duke mos shkaktuar presione mbi kërkësen e brendshme.

Duke u kthyer në një kontekst më global, mund të thuhet se përgjithësisht rreziku për zhvillimet inflacioniste është i zhvendosur në kahun rritës. Në ditët tona debati rreth rolit të bankave qendrore në përballimin e kësaj situate është zgjeruar shumë, duke përfshirë vendimarrës, aktorë të tregut, akademikë dhe ekspertë të shumtë. Diskutimi nëse politika monetare duhet të reagojë ndaj goditjeve nga ana e ofertës është më i nxehthë se kurrë.

Për të nxjerrë më mirë në pah kompleksitetin e situatës aktuale mund të citohen dy vargjet e para të poezisë "Zjarr dhe akull" e poetit amerikan Robert Frost se ... "disa thonë që bota mund të përfundojë në zjarr dhe disa të tjerë thonë në akull". Në këtë shprehje metaforike, "akulli" përfaqëson rritjen e presioneve inflacioniste në nivel ekonomie botërore ndërsa "zjarri" turbullirën financiare, që u shkaktua nga kriza e kredive në SHBA. Në këtë ambient të përgjithshëm, ku eksposimi i ekonomive të veçanta ndaj fenomeneve globale është bërë më i madh, roli kryesor i politikës monetare mbetet mbajtja në kufij të pranuar të efekteve negative të raundit të dytë. Origjina e rritjes së çmimeve është tërësisht e lidhur me zhvillimet ndërkombëtare, një konstatim ky që e bën të pashmangshëm fenomenin edhe nga këndvështrimi i bankës qendrore. Megjithatë, duhet theksuar se potenciali kontaminues në grupet e tjera të çmimeve dhe në paga, nëpërmjet të ashtuquajturve efekte të raundit të dytë, i jep politikës monetare një rol të rëndësishëm. Duke marrë për bazë jetëgjatësinë e krizës aktuale të çmimeve, mund arrihet në një lloj përfundimi se ekonomitë tona do të përballen me këto efekte dikur, pasi dihet që çmimet dhe pagat

në mënyrën se si formohen mbartin një lloj elementi inercie brenda vetes së tyre.

Në këtë kuptim, roli i politikës monetare është që të sigurojë një korrektimi të çmimeve relative, që arrihet pa krijuar rritje të inflacionit përtej një dinamike normale. Pra, e thënë ndryshe, siç thotë Guvernatori kilian José De Gregorio ... "politika monetare duhet të garantojë që dinamika e çmimeve është në përputhje me konvergencën e inflacionit drejt objektivit të vënë për të, brenda horizontit kohor që është pjesë e regjimit të inflacionit të shënjestruar. Kjo është ajo për të cilën politika monetare duhet të shqetësohet dhe ndaj të cilës duhet të reagojë. Dinamikat e paqëndrueshme mund të çojnë në rritje të inflacionit, i cili mund të kërkojë kosto shumë të madhe më vonë për t'u vënë nën kontroll. Këto janë të padëshiruarat efekte të raundit të dytë, që domosdoshmërisht kërkojnë veprime energjike të politikës monetare për t'u vënë nën kontroll".

Dorëzimi pakushte ndaj zhvillimeve inflacioniste, qoftë edhe në një ambient kaq specifik sa ky aktual, do të dëmtonte rëndë, pritshmëritë inflacioniste, duke i bërë ato të lidhura më shumë me të kaluarën sesa me të ardhmen.

► Rasti i Shqipërisë

Duke u shpërndalur edhe një herë në ambientin shqiptar, mund të thuhet se si në shumicën e vendeve të tjera të prekura nga ky fenomen, inflacioni vjetor edhe tek ne, kryesishet reflekton ndikimin e çmimeve të rritura të produkteve ushqimore si dhe lëvizjen e fundit të çmimeve të energjisë elektrike. Kjo duket qartë edhe në grafikun 5, ku edhe një sy i pastërvitur mund të dallojë se pjesa kryesore që formon inflacionin në Shqipëri (kuadrati me ngjyrë blu) për një kohë relativisht të gjatë i takon grupit ushqimor. Publikimet e fundit të INSTAT-it janë përcjellë me një sensibilitet të madh publik dhe mediatik. Ky është një fakt impresionues, pasi më në fund publiku po fillon të shqetësohet apo më mirë të themi të interesohet për tregues të tillë, duke krijuar një perceptim dhe qëndrim të caktuar, ndaj këtij treguesi.

Kjo nuk është e rastësishme. Përveç ndërgjegjësimit të publikut ajo flet edhe për një efektshmëritë përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë për të edukuar publikun, tregun, aktorët e ndryshëm në ekonomi, me koncepte të tillë si

inflacioni dhe konsekuitat e tij. Ajo dëshmon për transparencën e shtuar, për kredibilititin e rritur, për përgjegjshmërinë më të madhe të saj në përbushje të objektivit parësor, stabilitetit të çmimeve. I gjithë ky progres institucional ka bërë që agjentët ekonomikë të janë më të arsyeshëm në vlerësimin që i bëjnë të ardhmes, duke krijuar kështu pritshmëri më racionale, duke ndihmuar Bankën e Shqipërisë në ankorimin gjithnjë e më të mirë të pritshmërive rrith objektivit të synuar prej saj. Ndonëse zhvillimet e dy muajve të fundit tregojnë për një atrim të inflacionit drejt nivelit të sipërm të zonës së tolerancës prej 4 për qind, mbështetur në parashikimet e stafit të Bankës së Shqipërisë, pritshmërise të sistemit bankar, biznesit dhe konsumatorëve, si dhe në analizat e shumta që i janë bërë këtij fenomeni mund të arrihet në përfundimet e mëposhtme:

-Kemi të bëjmë me një kapërcim të përkohshëm të normës vjetore të inflacionit, i cili reflekton efektin negativ të goditjeve shock që gjenerojnë faktorët e ofertës, kryesisht në formën e çmimeve të rritura të produkteve ushqimore dhe në formën e rritjes së çmimit të kontrolluar të energjisë elektrike. Në lidhje me këtë të fundit, për ekonomitë në zhvillim, fenomene të tillë janë të pranishme, përderisa çmimet ende nuk janë plotësisht të liberalizuara. Banka e Shqipërisë e paralajmëroi një efekt të tillë që në muajin dhjetor 2007, meqenëse rritja aktuale pritej të ndodhë që në atë kohë.


-Zhvillimet në ofertën e parasë dhe politika fiskale deri në këtë moment kanë ndikuar në kontrollin e kërkesës së brendshme. Për më tepër, tregues të tjerë të rëndësishëm, që përshkruajnë më mirë presionet inflacioniste që shkakton kërkesa e brendshme në ekonomi, si treguesi i inflacionit bazë dhe inflacionit të mallrave të patregueshëm, janë ende në ylera të ulëta.

-Parashikimet e stafit të Bankës së Shqipërisë për 12 muajt në vijim tregojnë për një ecuri të inflacionit vjetor rrith nivelit 4 për qind, me një mundësi për të rënë poshtë këtij niveli në fund të vitit 2008.

-Pritshmëritë e tregut, biznesit dhe individëve flasin për një zhvendosje të lehtë të tyre mbi nivelin 3 për qind, megjithatë ato vazhdojnë të janë të ankoruara poshtë vlerës kritike 4.

-Deri në këtë moment ende nuk janë evidentuar

Kontributi i grupeve kryesore në formimin e inflacionit vjetor



Burimi: Banka e Shqipërisë

efekte të raundit të dytë. Rritja e pagave në sektorin publik do të jetë vetëm 9 për qind, ndërkohe që aplikimi i taksës së sheshtë mbi të ardhurat personale, përfshirë edhe ato me pagat ulëta mund të ketë shërbyer si një lloj elementi korrektues.

Zhvillimet në kreditin për ekonominë dhe ato në tregun ndërkombëtar e bëjnë të domosdoshëm një ekuilibër më të mirë midis stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetit financiar.

Pavarësisht sa më sipër, thelbësor mbetet fakti se Banka e Shqipërisë është plotësisht e angazhuar dhe vigilente për të siguruar stabilitetin e çmimeve në Shqipëri. Siç e ka bërë të quartë edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Ardi Fullani në fjalën e tij të raportit të radhës së politikës monetare... "Duke bërë një përgjithësim të të gjithë faktorëve të rrezikut si dhe duke u ndalur në mundësinë që ata kanë pët t'u materializuar në ekonomi, Banka e Shqipërisë, vlerëson se bilanci mbetet i zhvendosur në kahun rritës... Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të jetë vigilente, veçanërisht në drejtim të zhvillimeve inflacioniste në ekonomi. Për këtë qëllim, ajo do të analizojë me përgjegjshmëri, zhvillimet e faktuara, rreziqet e ndryshme me të cilat përballet e ardhma e stabilitetit makroekonomik dhe atij financiar, përfshirë dhe pritshmëritë inflacioniste të agjentëve të ndryshëm në ekonomi. Banka e Shqipërisë mbetet tërësisht e angazhuar në përmbylljen me sukses të objektivit të saj ligjor,

angazhim që nënkupton marrjen e vendimeve të përshtatshme në momentin e duhur, duke mos përjashtuar dhe kombinimin e tyre me masa të natyrës administrative.”.

► Në vend të mbylljes

Goditjet e fundit në inflacion, përbëjnë kërcënime serioze për politikën monetare. Masat e ndërmarra deri më sot kanë qenë të ndryshme në kohë dhe në formë ndërmjet vendeve të ndryshme.

Shumë prej tyre janë munduar të shmanget rritjen e çmimeve nëpërmjet veprimeve fiskale. Gjithsesi, efikasiteti i këtyre vendimeve në çmimet relative është ende i paqartë përderisa kohëzgjatja e krizës është e konsiderueshme dhe mungojnë rishpërndarjet e përshtatshme të burimeve. Ekonomia botërore po përjeton një situatë shumë komplekse. Edhe pse situa aktuale nuk mund të krahasohet me atë viteve '70, përsëri frika për një ngadalësim ekonomik në kushtet e një inflacioni në rritje është prezante. Ky është një moment kur politika monetare është para një testimi të përgjithshëm, i cili sipas të gjithave gjasave do të imponojë domosdoshmërinë për një rafinim të mëtejshëm në të ardhmen të kornizave politike të adoptuara nga bankat qendrore deri më sot.

Përbledhje e politikave të mundshme për tu zbatuar.

	Destinuar për grupet më të prekura	Siguron stimuj	Kostot të kufizuara brenda kufijve nacionalë	Lehtësia në zbatim	Menaxhim i kufizuar/ shqetësimë të qeverisjes
Programe për lehtësimin e situatave emergjente					
Transfera parash (të synuar/të kushtëzuar)	✓	✓	✓		✓
Ushqim në këmbim të punës	✓	✓	✓		
Ndihmë Ushqimore	✓		✓	✓	
Politikat për të reduktuar çmimet e ushqimeve në vend					
Reduktum i akcizave të importit dhe i TVSH-së		✓	✓	✓	✓
Subvencione konsumatore te shenjestruara/racionim	✓	✓	✓		
Përdorimi i stoqeve rezerve për të rritur ofertën			✓		✓
Subvencione konsumatore te përgjithësuara			✓	✓	
Ndalim/kufizim i eksporteve				✓	
Kontroll mbi çmimet e prodhimit		✓	✓	✓	✓

● Literatura:

"High food prices: Impact and recommendations" - Paper prepared by FAO, IFAD and WFP for the meeting of the Chief Executives Board for Coordination on 28-29 April 2008, Berne, Switzerland;

Opinioni i Bankës së Shqipërisë "Mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2008", publikuar në maj 2008;

- "The great moderation and the risk of inflation: a view from developing countries" - José De Gregorio - Governor, Banco Central de Chile, May 2008;

"Oil price fundamentals" James Hamilton, University of California, San Diego. Econbrowser - Analysis of current economic conditions and policy;

"Forecasting the Path of China's CO2 Emissions Using Province Level Information", Maximilian Auffhammer, University of California, Berkeley, Richard T. Carson, University of California, San Diego, August 2007;

World Bank Background Note: "Rising food prices: Policy options and World Bank response", April 2008.

The International Food Policy Research Institute (IFPRI), Policy Brief: "Rising Food Prices. What Should Be Done?", Joachim von Braun, April 2008.

SISTEMI BANKAR SHQIPTAR DHE ROLI I TIJ NE FINANCIMIN E EKONOMISE

Prof. Dr. DRINI SALKO

Universiteti Bujqësor i Tiranës
Fakulteti i Ekonomisë

email: drinisalk@yahoo.com

Pavarësish nga shkalla e lartë e perfektionimit dhe sofistikimit të tregjeve financiare në ditët e sotme, sistemi finanziar, vazdon të luajë një rol të pazëvendësueshëm në ndërmjetësimin e fondeve. Sistemi finanziar i një vendi përfshin tre komponentë kryesore: instrumentet financiare, tregjet financiare dhe institucionet financiare. Meqenëse niveli i ndërmjetësimit finanziar ndikon drejt përsëdrejti në nxitjen e investimeve dhe sidomos në rritjen ekonomike, ai bëhet veçanërisht i rendësishëm për vendet në zhvillim me një sektor finanziar të brishtë. Ndërmjetësuesit finanziarë kryejnë funksionin e ndërmjetësimit nëpërmjet grumbullimit të fondeve nga njësítë ekonomike (ekonomitë familjare, shoqëritë tregtare, shteti etj) që dëshirojnë të investojnë kursimet e tyre tek ato njësi ekonomike që kërkojnë financim. Ata veprojnë si agentë për kursimtarët duke iu siguruar informacionin e nevojshëm për investimin e kursimeve të tyre dhe në të njëjtën kohe realizojnë transformimin e këtyre aseteve në kontrata financiare. Këto kontrata financiare iu përshtaten preferencave të individëve që investojnë kursimet e tyre, pasi kanë kosto më të ulët monitorimi, likuiditet më të lartë, si dhe janë më pak të ekspozuara ndaj ndryshimeve të çmimit.

Ndërmjetësuesit, duke përfituar nga ekonomitë e shkallës, arrijnë të reduktojnë ndjeshëm koston e informacionit dhe të transaksionit, e për pasojë trisin eficencën e investimeve të kursimeve në ekonomi. Një avantazh tjetër i ndërmjetësuesve finanziarë është aftësia e tyre për të reduktuar rrezikun nëpërmjet diversifikimit të portofolit. Ata marrin përsipër rrezikun e kombinimit të maturiteteve midis aseteve dhe detyrimeve duke ju përshtatur më mirë preferencave të njësive suficitare dhe deficitare të ekonomisë. Ekzistojnë një numër i madh ndërmjetësish finanziare që kryejnë këto funksione dhe që mund të jenë institucione financiare bankare, institucione financiare jo-bankare, apo institucione financiare të investimeve. Megjithatë, në këtë punim, për vetë nivelin aktual të ndërmjetësimit finanziar në Shqipëri si dhe të rolit përcaktues të bankave tregtare si ndërmjetëse finanziare, do tu referohemi rolit të këtyre institucioneve në këtë proces të rëndësishëm ekonomiko-financiar. Sistemi bankar është njëkohësisht dhe segmenti më i zhvilluar i sektorit finanziar në Shqipëri. Duke pasur kështu rolin kryesor në ndërmjetësimin finanziar. Në tërësi, sistemi bankar shqiptar ka pasur një ecuri pozitive

dhe vendi ynë ka qenë një ndër vendet më të hapura për thithjen e kapitalit të huaj bankar. Pavarësish nga zhvillimet pozitive, sistemi bankar shqiptar ka përjetuar problemet që shpesh kanë qenë të paeyitueshme për çdo sistem bankar të ekonomive në tranzicion, si: veprimitari joefikase e bankave shtetërore dhe nevoja për likuidim ose privatizim të tyre, lidhje e dobët e klientëve me bankat, ndërmjetësim i ulët finanziar etj.

D Sistemi Bankar Shqiptar dhe zhvillimi i tij gjatë dekadës së fundit

Reformat e ndërmarrë në sistemin bankar shqiptar dhe ecuria e zhvillimeve makroekonomike kanë bërë që këto reforma të konsiderohen të suksesshme duke e konsideruar tashme këtë sistem relativisht të konsoliduar. Zhvillimet në sistemin bankar shqiptar gjatë gjithë periudhës postkomuniste do t'i përfshinin në tre fazë kohore:

Faza e parë që përfshin periudhën 1991-1996 konsiderohet si periudhë e krijimit të sistemit bankar dy-nivelor dhe e hedhjes së bazave ligjore e institucionale bashkëkohore. Gjatë kësaj periudhe u krijuan kushtet për privatizimin e

bankave shtetërore dhe u themeluan bankat e para private me kapital të huaj.

Faza e dytë 1997-2001 konsiderohet si faza e konsolidimit të sistemit bankar shqiptar me zhvillime të rëndësishme kryesisht sasiore. Gjatë kësaj periudhe u kapërcyen pasojat e krizës financiare të vitit 1997 (rrjedhojë e falimentimit të skemave piramidale) u rikthyen besimi i publikut tek bankat, filloj privatizimi i bankave shtetërore dhe u shtuan numri i bankave private që operonin në vend.

Faza e tretë 2002 e në vazhdim, mund të konsiderohet si periudha e zhvillimeve sasiore dhe cilësore të sistemit bankar shqiptar. Gjatë viteve të fundit përfundoi privatizimi i bankave me kapital shtetëror dhe u rrit me tej numri i bankave private me kapital të huaj dhe vendas. Gjatë kësaj periudhe kemi një rritje të konkurrencës në tregun bankar shqiptar e cila ndikoj në zhvillime cilësore mjaf të rëndësishme në sektorin financier. Tashmë bankat tregtare kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre jo vetëm me dy shërbimet bazë, kredi dhe depozitat, por po ofrojnë në treg produkte të reja të cilat janë mirëpritur në tregun bankar.

Privatizimi i suksesshëm i Bankës së Kursimeve nga banka e mirënjojur në tregun ndërkontrollor, Raiffeisen Bank ka krijuar premisa të mëtejshme të konsolidimit dhe zhvillimit të sistemit bankar shqiptar.

Numri i bankave që veprojnë në Shqipëri në fund të vitit 2007 është 18, por gjithashu është shtuar numri i degëve dhe agjencive të këtyre bankave në vend, që përbën një zhvillim cilësor për sistemin bankar shqiptar duke mbuluar gjithnjë e më mirë me shërbime e produkte bankare gjithë territorin ekonomik të vendit. Madje bankat kanë filluar të hapin degë edhe jashtë kufijve të vendit tonë (si Banka Amerikane e Shqipërisë me degë në Greqi, Kosovë, etj, Banka Raiffeisen me degë në Kosovë).

Në anët e forta të sistemit tonë bankar mund të përmendim:

- * Sistemi bankar shqiptar, është i favorizuar nga një situate makroekonomike e qëndrueshme dhe në përmirësim të vazdueshëm. Kjo mbart mbi vete një potencial zhvillimi.

- * Rrjeti bankar po zgjerohet gjithnjë e më shumë në formën e degëve, të agjencive, zyrave të shërbimit bankar etj.

- * Struktura e sistemit bankar shqiptar

paraqitet pothuajse tërësisht në favor të kapitalit privat.

- * Kapitalizmi i sistemit paraqitet në nivele të kënaqshme.

- * Likuiditeti është në nivele të kënaqshme.

Në anët e dobëta të këtij sistemi mund të përmendim:

- * Ende nuk kemi një sistem të zhvilluar pagesash.

- * Mungon tregu i zhvilluar financier (bursa pothuajse është joekzistente) dhe instrumentet financiare janë ende në numër mjaft të kufizuar.

- * Me gjithë rritjen e veprimtarisë së bankave tregtare, ende banka Raiffeisen zotëron një pjesë të konsiderueshme të tregut bankar shqiptar.

► Financimi i ekonomise nga sistemi bankar, ecuria dhe problematika

Shprehje e nivelit të financimi të ekonomisë shqiptare janë treguesit e ndërmjetësimit financier (këtu nënkuptojmë ndërmjetësimin bankar). Treguesit që përdoren për të matur shkallën e ndërmjetësimit financier janë të shumtë, por duhet bërë kujdes që të zgjidhen ata që më mirë dhe më saktë e pasqyrojnë një gjë të tillë në varësi të zhvillimit ekonomik të një vendi të caktuar dhe para së gjithash në varësi të zhvillimit të të tre komponentëve të sistemit financier. Parë në ketë kuadër, ndër treguesit kryesorë të ndërmjetësimit që mund të llogariten e të analizohen gjatë dekadës së fundit mendojmë se do të ishin: raporti i depozitave të individëve ndaj PBB-së, raporti i kreditit të brendshëm të sistemit bankar ndaj PBB-së, raporti i kreditit akorduar sektorit privat mbi bazën monetare ose në përqindje ndaj PBB-së, raporti i kredisë dhënë sektorit privat ndaj totalit të kreditit të brendshëm, raporti i kredisë me afat ndaj depozitave me afat etj.

Tabela e mëposhtme na jep disa nga treguesit kryesorë të ndërmjetësimit financier në vendin tonë.

Tregues të ndërmjetësimit finansiar në Shqipëri (në %)

Treguesit	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Depozita me afat / PBB	25.9	29.4	32.7	33.2	36.4	34.7	37.1	35.4	36.5	57	63.4
Krediti i brendshëm / PBB	27.5	28.2	30.4	30.6	32.5	44.8	44.6	42.5	48.4	54	62.2
Kredi sektori privat / PBB	3.8	3.2	3.6	4.5	5.9	5.7	6.8	8.4	14.6	21.3	30.1
Kredi sektori privat / Depozita me afat	14.6	11	11	13.6	16.1	16.4	18.3	23.7	41	37.4	47.4

Si tregues optimal dhe matës i mirë i efikasitetit të nivelistët të ndërmjetësimit finansiar në Shqipëri do të gjykohej për shembull raporti i kredive dhënë në sektorit privat ndaj depozitave me afat, që siku se duke nuk mund të tabelon e mësipërme, ka shënuar rritje nga viti 1999 në 2007, duke u rritur nga 11 % në 47.4 %. Ky raport shpreh pikërisht pjesën e kursimeve të grumbulluara nga bankat, që shkon për kreditimin e ekonomisë, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit.

dhe që tregon sensibilitetin e sistemit bankar dhe prirjen gjithnjë e më shumë drejt financimit të projekteve afatgjatë. Ndërkohë analiza e portofolit të kredive sipas, degëve të ekonomisë, tregon njëanëshmërinë e këtij procesi në favor të tregtisë, ndërtimit dhe industrisë përpunuese. Fatkeqësisht aktivitetet bujqësore dhe financimi i zonave rurale vazhdojnë të mbeten larg preferencave të bankave për kreditim. Megjithatë, nuk duhet lënë pa përmendur fakti që në vitet

Treguesit e tepricës së kredisë për ekonominë në vite (në miliardë lekë)

Teprica e kredisë	Vitet						
	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Gjithsej	27.9	38.7	50.6	69.3	121.9	191.2	287.6
Në lekë	5.2	8.8	9.9	13.4	31.0	55.4	79.7
Në valutë	22.7	29.9	40.6	55.9	90.9	135.8	207.8

Burimi: Banka e Shqipërisë; Raporti statistikor, 2007

Nga sa u përmend më sipër është e qartë se, ndërmjetësimi finansiar në procesin e financimit të sektorit prodhues të ekonomisë përfaqëson një nga funksionet kryesore të sistemit bankar. Shenjë e përmirësimeve të dukshme në këtë fushë është edhe analiza e ecurisë së treguesve të tepricës së kredisë që ka shënuar rritje të vazhdueshme, duke reflektuar një angazhim më të madh të kursimeve në financimin e aktivitetit ekonomik.

Po të bëjmë një analizë të treguesve të tepricës së kredisë dhe të kredisë së re për ekonominë pas vitit 1999, vëmë re një zhvendosje të portofolit të saj drejt kredisë afatmesme dhe afatgjatë. Kjo është një tendencë pozitive që duhet inkurajuar

2005, 2006 dhe 2007 ka një tendencë përmirësimi të lehtë në portofolin e kredisë në favor të kreditimit të kësaj dege të ekonomisë. Veçanërisht gjatë vitit 2006 dhe 2007, sektori i bujqësisë ka fituar një mbështetje më të madhe financiare edhe si rrjedhojë e zgjerimit të veprimit tarive të shoqërive të kursim kreditit që operojnë në fshat në kuadër të Unionit Shqiptar Kursim Kredi, si dhe të veprimit tarisë së Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Zonave Malore.

Një pamje më të qartë e jep tabela e mëposhtme e cila na tregon ecurinë e kredisë së re për ekonominë dhënë nga bankat.

Ecuria e treguesve të kredisë së re në vitet e fundit (në miliardë lekë).

Treguesit / Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Kredi e re gjithsej	24.2	40.6	62.6	92.6	88.8	120	157	246
Sipas maturimit								
a. Afat shkurtër	12.9	27.6	44.7	63.1	56.2	58.4	71.4	119
b. Afat mesme	10	10.4	13	22.2	19.9	33.3	45.8	54.5
c. Afat gjatë	1.3	2.6	4.8	7.4	12.7	28.2	39.8	72.5
Sipas monedhës								
a. Kredi e re në lekë	4.4	10	20.8	30.8	29.6	37.4	51.5	77.3
b. Kredi e re në valutë	19.8	30.6	41.8	61.8	59.2	82.5	105.5	168.7

Burimi: Banka e Shqipërisë : Raporte Statistikore 2007

Megjithëse kreditimi i ekonomisë nga sistemi ynë bankar, mbetet ende shumë larg ekonomive të zhvilluara, është me interes të theksohet se kredia për ekonominë ka shënuar rritje të shpejtë në vitet e fundit (tabela e treguesve të kredisë së re). Raporti i kredisë afatshkurtër ndaj kredisë se re të akorduar si sistem bankar, vazhdon të mbetet i lartë me gjithë progresin e dy viteve të fundit. Kjo është një nga arsyet që teprica e kredive rritet me ritme të ulëta, edhe pse kredia e re e dhënë në ekonomi shënon rritje nga viti në vit.

Rritja e konkurrencës bankare, rritja e cilësisë së shërbimittë bankavedhe institucioneve të kreditit, duke iu përshtatur në mënyrë të vazdueshme nevojave në rritje të biznesit, ka ushtruar presion në tkurrjen e mëtejshme të tregut informal në fushën e kreditimit. Nuk duhet harruar që ky treg favorizohet nga "procedurat më pak burokratike" që ai ofron. Vihet re një tendencë pozitive në drejtim të burimeve kryesore të financimit të bizneseve vendase. Përdorimi i fitimit vazhdon të jetë burimi kryesor i financimit të zgjerimit të bizneseve, por në të njëjtën kohë vihet re një tendencë në rritje edhe nga kredia e akorduar nga sistemi bankar.

Sic shihet nga të dhënat e mësipërme, treguesit e mobilizimit nga bankat të depozitave dhe përdorimit të tyre në financimin e ekonomisë, pas krizës financiare të vitit 1997, kanë qenë në rritje duke reflektohar stabilitetin makroekonomik të arritur.

Prirjet pozitive të rritjes së kreditimit të ekonomisë janë shoqëruar me një ndryshim pozitiv të strukturës së kredisë sipas afateve e sektorëve të ekonomisë, por dhe me kreditime të objekteve

shumë pak të preferuara më parë nga bankat. Mjafton të theksojmë kreditin e konsumit, ku kreditë për shtëpi po njohin një zhvillim mjaft premtues. Hyrja në tregun e kredisë të Bankës Raiffeisen jo vetëm përbën një faktor mjaft të rëndësishëm në rritjen e kreditimit në sasi dhe cilësi për ekonominë tonë, por do të bëjë të mundur përmirësimin e shpejtë të treguesit të ndërmjetësimit financiar, duke e përafruar atë me vendet e rajonit.

Zhvillimet e shumëpritura pozitive në sistemin bankar, tashmë kanë krijuar premisat për të kaluar në tregues më efektivë të ndërmjetësimit financiar. Tashmë janë të gjitha mundësítë që ritmi i rritjes së depozitave bankare të përafrohet me një ritëm të njëjtë të kreditimi të ekonomisë. Stabiliteti makroekonomik, i reflektoar në një kosto kreditimi gjithnjë e më e ulët, e shoqëruar me rritjen e konkurrencës bankare përbëjnë premisat dhe sigurinë e përmirësimeve të mëtejshme të ndërmjetësimit financiar në vendin tonë.

Rritja e kreditimit nga bankat të ekonomisë shqiptare, duhet theksuar se po shoqërohet me rritje të riskut të kredisë. Kjo tendencë rritjeje e riskut, reflektohet edhe në treguesin e kredive me probleme, që në fund të vitit 2007 arriti 3.4 %, kundrejt 3.1 % të një viti më parë. Ky tregues ka vazduhar të rritet edhe gjatë muajve të parë të vitit 2008. Kjo është rrjedhojë e mjaft faktorëve si:

Dominimi i kredi-dhënies në valutë (në strukturë ajo zë mbi 70 % të tepricës së kredisë) që rrit riskun e ndikimit të luhatshmërisë së kurseve të këmbimit valutor.

Problematika që shoqëron një analizë të plotë e të saktë nga banka të kredi-

marrësve potencialë, e cila kushtëzohet nga niveli i larte i ekonomisë informale. Ndryshueshmëritë e shpeshta të normave të interesit si rrjedhojë edhe i faktorëve të jashtëm (për kredi-dhënien në valutë), por edhe të brendshëm të lidhura me ndikimin e normës bazë të interesit, që tashmë, prej afro një viti ka ndryshuar kahun në rritje. Rritja e kredi-dhënies konsumatore (individëve) si një produkt që ka shënuar progres të dukshëm, shoqërohet me rritjen e riskut të moskthimit të kredisë.

Në këtë kuadër, bankat tregtare, nga njëra anë duhet t'i paraprijnë analizave të kujdeshme lidhur me kredi-dhënien, dhe Banka e Shqipërisë, nga ana tjetër, të përshtatë dhe forcojë masat rregullative me synim zbutjen e riskut. Për të analizuar dhe gjykuar drejt mbi shkallën e

se, ende niveli i ndërmjetësimit në Shqipëri, me gjithë përmirësimet e arritura, është i ulët krahasuar me vendet e rajonit.

Këta tregues, nxjerrin gjithashtu në evidencë faktin se bankat në Shqipëri janë më aktive në grumbullimin e depozitave, të cilat i investojnë në pjesën më të madhe në bono thesari dhe ri-depozitime (depozitat në valutë) duke mbajtur kështu në një nivel të ulët ndërmjetësimin financiar.

► Përfundime dhe rekondime

Sistemi bankar shqiptar përfaqëson komponentin më të zhvilluar të sistemit financiar, dhe përrjedhoje bankat janë ndërmjetësit kryesor financiar në ekonomi.

Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit (madje edhe në kulmin e operimit të skemave piramidale)

Analizë krahasuese me vendet e rajonit në vitin 2006 (në %)

Treguesit	Vendet							
	Shqipëri	Bullgari	Kroaci	Maqedoni	Rumani	Sloveni	Turqi	
Dep. me afat/PBB	45.6	33.5	53.9	32.5	21.4	31.6	44	
Depozita totale/ PBB	63.4	53.3	67.4	37.9	27.3	55	51.5	
Krediti brendsh/ PBB	62.2	43	80	24.3	26.7	74.5	60	
Kred. sek. privat/ PBB	30.1	47.4	69	29.5	26.3	56	34	
Kredi sek. privat/ dep. me afat	65.4	141.4	128	96	123	177	78	
Kredi sek. priv./ Krediti brendsh.	47.7	110.3	85	128	98	75.2	57	

Burimi: IFS Raport Vjetor 2006

ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, do të na ndihmonë analiza krahasuese e treguesve të ndryshëm të ndërmjetësimit financiar me vendet e rajonit. Fakt është, se gjatë 4-5 viteve të fundit, treguesit kryesor të ndërmjetësimit financiar kanë ardhur në përmirësim të vazhdueshëm, rrjedhojë kjo e zhvillimeve pozitive në sektorin financiar në tërësi, dhe sistemin bankar në veçanti. Kështu, treguesi i raportit të depozitave ndaj PBB-së për vitin 2007, krahasuar me vendet e tjera të rajonit, është në shifrën 63%, duke qenë tregues më i lartë krahasuar me vende të tilla si Bullgari, Maqedoni dhe Rumani. Ndërsa treguesi tjetër, ai i raportit të kreditimit të ekonomisë ndaj PBB-së, është në nivelin më të ulët të vendeve si Bulgaria, Kroacia, Slovenia, dhe pothuajse i njëjtë me vendet e tjera të rajonit. Krahasimi i këtyre shifrave, evidenton faktin

ecuria e depozitave në sistemin bankar shqiptar ka qenë e kënaqshme, duke bërë që bankat të mos ballafaqohen me probleme të imprehta likuiditeti.

Zhvillimet e viteve të fundit në sistemin bankar shqiptar tregojnë se treguesi i kredi-dhënies për ekonominë është në përmirësim të ndjeshëm dhe premisat janë shumë më premtuese. Ky tregues është njëkohësisht dhe mjapt i kënaqshëm po të kemi parasysh krahasimin cilësor të tij me periudhën e viteve të para të tranzacionit (1993-1996) ku ish bankat me kapital shtetëror grumbulluan një portofol të konsiderueshëm kredi me probleme. Rritja e kreditimit nga bankat gjatë viteve të fundit dhe prirja e bankave për të vepruar më aktivisht në tregun e kreditit, shtrojnë njëkohësisht nevojën e një ndjekjeje më të ymendshme dhe të përmirësimit të mëtejshëm

të kuadrit rregullativ e mbikëqyrës nga ana e Bankës së Shqipërisë si bankë qendrore.

Tashmë, kur sistemi bankar shqiptar ka shënuar progres të kënaqshëm sasior dhe po hyn në fazën cilësore të zhvillimit te tij, konkurenca në tregun e kreditit do bëjë që të përmirësohet më tej treguesi i ndërmjetësirnit financiar, duke e përafruar këtë tregues me atë të vendeve të rajonit. Gjithashtu, zhvillimi i mëtejshëm i institucioneve financiare rurale (Unioni Shqiptar Kursim Kredi), do mobilizonin më mirë burimet financiare rurale dhe përdorimin e tyre në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë tonë.

Për një rritje më të shpejtë e më të qëndrueshme të treguesit të ndërmjetësimit, duhet që të përmirësohen edhe më tej komponentët e tjera të sistemit financiar, siç është bursa e letrave me vlerë dhe emetimi i instrumenteve të tjera financiare.

Rritja e kreditimit nga bankat gjatë viteve të fundit dhe prirja e bankave për të vepruar më aktivisht në tregun e kreditit, shtrojnë njëkohësisht nevojen e një ndjekjeje më të vëmendshme dhe të një përmirësimi të mëtejshëm të kuadrit rregullativ e mbikëqyrës nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Përmirësimet në kuadrin ligjor e bëjnë të domosdoshëm rishikimin e dy ligjeve bazë, atë të Bankës së Shqipërisë dhe të sistemit bankar. Ky proces rishikimi duhet të marrë parasysh eksperiencën e deritanishme dhe fazën aktuale të zhvillimit të sistemit bankar.

Përmirësimet në kuadrin ligjor dhe rregullativ bëhen emergjente edhe për institucionet e tjera jo-bankare, e sidomos ato në fushën e sigurimeve, ku ka zhvillime mjaft pozitive gjatë viteve të fundit. Mendojmë se ngritja e një institucioni mbikëqyrës për gjithë pjesën e institucioneve financiare jo bankare, është një drejtim tjetër ku duhet përqendruar vëmendja.

Për vetë stadin aktual të zhvillimit të sistemit financiar shqiptar, kreditimi i ekonomisë duhet konsideruar për një periudhë kohe afatmesme (3-5 vjet) si drejtimi kryesor i rrëtjes së shkallës së ndërmjetësimit financiar në vendin tonë.

Sugjerohet një mbikëqyrje më e rreptë dhe më strikte nga ana e Bankës Qendrore, që të shërbejë si rregulluese dhe "amortizuese", për të balancuar parametrat dhe treguesit ndërmjet bankave, në kushtet e një situate të tejkaluar në drejtim të konkurrencës në sistemin bankar, për sa i takon kredi-dhënie. Pra, nëpërmjet politikave stabilizuese të BSH-së, të synohet tritja

e pjesëmarrësve aktiv në procesin e kreditimit, pasi pozitat e dobëta konkurruese, çojnë në krijimin e monopoleve dhe në një mbiçmim fiktiv të kredisë.

L iteratura

* Allen Franklin dhe Santomero Anthony, "What do financial intermediaries do?", shtator 1999.

* Hirshleifer, Jack, Investment, Interest and Capital (Englewood Cliffs, N.J. : Prentice-Hall, 1970).

* Pierce, James, Monetary and Financial Economics (New York: John Wiley & Sons, 1984).

* Bonin John, "Financial Intermediation in Southeast Europe: Banking in Balkan", tetor 2000.

* World Bank "Interpreting Financial Statements" volumi 2, World Bank - Banking Institution in Developing Markets, korrik 1994.

* Banka e Shqipërisë "Shkalla e ndërmjetësimit financiar në Shqipëri", Eriona Suljoti, Shtator 2002.

* Banka e Shqipërisë "Raportet statistikore", 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007

ROLI I BANKAVE QENDRORE NE NJE EKONOMI TE GLOBALIZUAR¹

JEAN CLAUDE TRICHET

President i Bankës Qëndrore Europiane

www.ecb.int



J. C. TRICHET

► Disa prirje që qëndrojnë pas globalizimit

Globalizimi përfshin një tërësi dukurish dhe prirjesh që kanë çuar në një ndërvarësi të shumicës së ekonomive në botë. Nga kjo vjen një rritje e fortë e shkëmbimeve ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve, të kapitaleve, të krahut të punës dhe të burimeve natyrore. Do të shtoja se po shohim paralelisht një rritje shumë domethënëse të shkëmbimeve ndërkufitare të ideve dhe të koncepteve midis institucioneve të ndryshme, organizata dhe instanca të vetë shoqërive civile. Nacioni i globalizimit është imponuar gjatë 20 vjetëve të fundit dhe dukuria eci me ritme veçanërisht të shpejta gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, si pasojë e bashkëveprimit të disa faktorëve si shpërhapja e teknologjisë e informacionit dhe të komunikimit gjithnjë e më të sofistikuar dhe më afër shumicës. Kostoja e transportit të mallrave gjithashu ka pësuar rënje. Ekonomitë kanë vazhduar hapjen dhe shumë bariera tregtare dhe financiare janë hequr. Kudo janë fshirë pengesat kombëtarë të qarkullimit të mallrave, shërbimeve dhe të faktorëve të prodhimit. Fluksi i investimeve të huaja të drejtëpërdrejta është rritur po ashtu ndjeshëm, duke çuar në një ndërkombëtarizim të proceseve të prodhimit dhe të metodave të reja të punës, duke qenë se ndërmarrjet krijojnë filiale jashtë me qëllimin e dyfishët për të hyrë në tregjet ndërkombëtare dhe për të ulur kostot e prodhimit.

Falë globalizmit, shumë vende në dalje e sipër, kanë mundur të hyjnë në tregjet ndërkombëtarë dhe të marrin pjesë në konkurrencën ndërkombëtare. Për të pasur një ide të përmasave të kësaj dukurie në shkallë planetare, duhet të kemi parasysh se krahu i punës i gatshëm dhe aktiv në tregjet botërore është pothuaj dyfishuar, duke kaluar nga 1.5 miliard në 3 miliard njerëz, pas hapjes së Kinës, Indisë, të shumë ekonomive dikur të centralizuara, dhe të shumë vendeve në dalje e sipër. Lëvizshmëria e krahut të punës mbetet e kufizuar, po të kemi parasysh shifra në shkallë planetare, por fleksibiliteti në rritje i flukseve të kapitalit u jep ndërmarrjeve mundësi më të mira se më parë në lidhje më ofertën botërore të punës. Si pasojë, shumë industri, kanë instaluar rrjete prodhimi në nivel botëror.

Do të doja të përmendja rëndësinë dhe shtrirjen e globalizmit me anë të disa shifrave.

Hapja e tregjeve botërorë - e matur me pjesën e eksporteve dhe të importeve botërorë të mallrave dhe shërbimeve të shprehur në përqindje të GDP botërore, - praktikisht është dyfishuar gjatë 20 viteve të fundit, duke kaluar nga 33.9 % të GDP botërore në vitin 1986 në 60% të GDP botërore në vitin 2006. Një faktor gjithnjë e më shumë vendimtar ka qenë rritja e shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve të ndërmjetme që kanë ardhur nga progresi i ndërkombëtarizimit të proceseve të prodhimit.

¹Referat i mbajtur në konferencën e 13^{te} Bankave Qëndrore, Montana, Kanada 18 qershor 2008

Sistemet financiare (tregje, infrastruktura ose institucionale) janë prekur po ashtu, sepse përforcimi i nxitjes për investuesit që të mbajnë asete huaj në portofollet e tyre dhe shumëfishimi i mundësive për të diversifikuar dhe shpërndarë risqet financiare në shkallë botërore, kanë pasur një ndikim mbi tërësinë e përbërësve të këtij sistemi.

Më lejoni të ilustroj shkurtimisht disa evolacione të rëndësishme. Pjesët e aseteve ndërkombëtarë bruto si përqindje e GDP – që jep një ide të hapjes së sistemeve financiarë- është 8-fishuar gjatë 25 viteve të fundit dhe sot përfaqëson 130 % të GDP botërore. Për sa i përket fluksit botëror të kapitaleve, përbërtja e tyre ka evoluar ndjeshëm vitet e fundit. Ndërsa flukset e investimeve të huaja direkte dhe operacionet ndërkombëtare mbi veprimet ishin mbizotëruar në fund të viteve 90, operacionet ndërkufitarë të portofolit sidomos në lidhje me asetat më likuide kohët e fundit kanë pësuar rritje, duke shpjeguar në masë të madhe rritjen e lëvizjeve botërore të kapitaleve. Shpërndarja ndërkombëtare e rreziqeve dhe transferta e vetëfinancimit midis vendeve janë dy elementë të rëndësishëm të këtij procesi.

Ekonomitë e vendeve që janë duke dalë rritin pjesën e tyre në GDP botërore. Në të dhëna të aggreguara, ato kanë regjistruar dalje të pastra të kapitaleve në USD 650 Mds në vitin 2006, përkundrejt 458 USD në 2005. Balanca neto e investimeve direkte ka qëndruar e pandryshuar për të gjithë globin gjatë kësaj periudhe, ndërsa hyrjet neto janë 267 Md dollarë në vitin 2006. Kurse, balanca e investimeve të portofolit, që përfshin sektorin publik, ka regjistruar dalje më të larta në vitin 2006, duke arritur 397 Md dollarë, përkundrejt 258 Md dollarë në vitin 2005, ndërsa investimet e portofolit drejt ekonomive në dalje kanë pësuar një rënje të lehtë. Në total, ekonomitë që po dalin, i kanë siguruar pjesës tjetër të botës burime neto që përputhen me tepricat e tyre aktuale. Kjo shpjegohet kryesisht me kapacitete përthithjeje të brendshme të kufizuara të këtyre ekonomive dhe të sistemeve të tyre financiarë pak të zhvilluar.

Globalizimi përforcon prosperitetin ekonomik dhe lejon përmirësimin e niveleve të jetesës me mënyra të ndryshme. Konkurenca ndërkombëtare është më e gjallë, transfertat e

teknologjisë dhe të dijeve më të shumta. Nga kjo vjen një fitim në produktivitet dhe një rritje më e fortë botërore. Teprica e efikasitetit ekonomik ndihmon në uljen e kostove për ndërmarrjet dhe çmimet e mallrave të shkëmbbyeshëm. Seria e produkteve të rinj, është gjithnjë e më e gjërë. Burimet shpërndahen në veprimtaritë më fitimprurëse në botë, ndërsa mundësitë e diversifikimit dhe të shpërndarjes së rreziqeve rriten në shkallë planetare. Mbikëqyrja e ushtruar nga investitorët ndërkombëtarë është gjithashtu një vektor disipline që rrit cilësinë e politikave ekonomike të brendshme, gjë që ndihmon në përmirësimin e elementeve kryesorë ekonomikë.

Globalizimi gjithsesi, shoqërohet edhe me disa sfida dhe rreziqe. Integrimi botëror është gjithnjë e më i ngushtë dhe përforcimi i qarkullimit të lirë të kapitaleve e ka bërë sistemin financiar ndërkombëtar më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të vlerësimit të investitorëve. Për më tepër, shkëmbimet ndërkombëtare dhe lidhjet financiare kanë prirjen të intensifikojnë transmetimin e goditjeve nga një vend në tjeterin dhe të rrisin efektet e përhapjes përtet kufijve. Është e nevojshme të mos harrojmë se disa vite më parë, një sërë krizash financiare kanë rrezikuar seriozisht sistemin financiar ndërkombëtar, si psh kriza aziatike që filloi në vitin 1997 ose kriza ruse e vitit 1998. Këto kriza kishin një karakter krejt të veçantë dhe komuniteti ndërkombëtar diti si t'u jepte zgjidhje. Çdo krizë ka ilustruar domosdoshmërinë e investimit në mënyrën e përshtatshme në institucionet dhe në kapitalin njerëzor, me qëllim përforcimin e qeverisjes ekonomike. Do t'i rikthehem pasojave të krizave të mëdha financiare mbi bankat qendrore, në pjesën e tretë të diskutimit tim. Krizat e kaluara tregojnë se sa i prekshëm është sistemi ekonomik dhe financiar botëror dhe na kujtojnë se është më me vend të jemi gjithmonë syçelë, dhe asnjëherë të mos jemi tolerantë me to.

► Integrimi i zonës euro në një ekonomi të globalizuar

Pista ime e dytë e arsyetimit ka të bëjë me lidhjet ekonomike dhe financiare që ekzistojnë midis zonës euro dhe pjesës tjetër të botës. Dua të theksoj se integrimi ndër-evropian është zhvilluar në harmoni të përsosur me integrimin

e Evropës në ekonominë botërore. Për shembull, nga pikëpamja tregtare, zona euro është shumë e hapur ndaj botës, më e hapur se Shtetet e Bashkuara dhe Japonia. Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve jashtë zonës euro janë në shifrat 20% të GDP të zonës, një shifër e njëjtë me atë të importeve të mallrave dhe shërbimeve që vijnë nga pjesa tjetër e botës. Këto shifra janë dukshëm më të lartë se ato të SHBA-ve dhe Japonisë. Në rastin e parë, eksportet e importet e mallrave dhe shërbimeve përfaqësojnë respektivisht rrith 10 % dhe 16 % të GDP. Në Japoni, eksportet totale përbëjnë 15% të GDP dhe importet 13.4%. Ajo që bën më shumë përshtypje veçanërisht për zonën euro, është se rritja e tregtisë me pjesën tjetër të botës ka qenë më e madhe se rritja e shkëmbimeve në zonën euro.

Edhe më mbresëlënës është fakti se zona euro, është ndoshta më e hapur nga ana financiare se SHBA dhe Japonia. Do të bëj katër vëzhgime këtu. Së pari, kreditë dhe angazhimet e jashtme të zonës euro janë shumë të rëndësishme si përqindje e GDP me rrith 124% dhe 137% respektivisht. Për krahasim, shifrat që korrespondojnë me SH. B. A janë më të ulëta, kreditë e jashtme që përfaqësojnë 90% të GDP dhe angazhimet 110 %. Në Japoni, asetet financiare të jashtme janë po ashtu më të ulët se ata të zonës euro, me 94 % të GDP në 2005, hendek edhe më i madh për sa u takon angazhimeve të jashtme, që shkojnë deri në 60 % të GDP, ose më pak se gjysma e shiftrës që i korrespondon zonës euro. Kjo tregon mirë se në çmasë zona euro është e kthyer drejt pjesës tjetër të botës.

Vëzhgimi im i dytë ka të bëjë me faktin se monedha e vëtmë ka të ngjarë të ketë kontribuar në hapjen financiare të zonës euro. Nga ana e kredive, qarkullimi i aseteve të zonës euro të mbajtur jashtë zonës kanë kaluar nga më pak se 87% të GDP në vitin 1999 në 124% në vitin 2005. Kur është fjala për angazhimet, rritja ka qenë po ashtu substanciale, duke qenë se këta të fundit kanë kaluar nga 92% të GDP në 137%. SH. B. A kanë regjistruar rritje shumë më pak të shënuara, qarkullimi i aseteve amerikanë të mbajtur jashtë, avancon me nga 80% të GDP në 1999, në 91 % dhe 110 % të GDP. Me terma të tjera, rritja ka qenë më e fortë për zonën euro që prej fillimit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

Vëzhgimi im i tretë, ka të bëjë me se sa tërheqëse është zona euro për investimet e huaja direkte.

Fluksi i investimeve të huaja direkte përfaqëson në fakt më shumë se 27% të GDP së saj, përkundrejt 22.5 % për SHBA. Si përqindje e GDP, zona euro do të ishte destinacioni i një vëllimi investimesh të huaja direkte po aq të madh sa edhe Kina, - pra 27.3% në të dy rastet- sipas statistikave të FMN. Në terma neto, qarkullimi i investimeve të huaja direkte është pak më i lartë se ai i regjistruar në zonën euro, me 30.4 % për të parët dhe 27.3% për të dytët. Vëzhgimi im i katërt ka të bëjë me partnerët dypallesh të zonës euro në fushën e investimeve të huaja të drejtpërdrejta. Sipas të dhënave që zoterojmë, është me vend të vëmë re se investimet e huaja të drejtpërdrejta të zonës euro jashtë, janë realizuar kryesisht mbi ekonomi të zhvilluara, me afërsisht 21% në SHBA, 24% në Britaninë e Madhe, 9% në Zvicër, dhe nga 2.5% në 3% në Suedi, Kanada, dhe Japoni. Në të njëjtën mënyrë, në lidhje me angazhimet, Mbretëria e Bashkuar dhe SH. BA përfaqësojnë një pjesë më të rëndësishme se sa në lidhje me asetet. (rrith 40% dhe 23.5% respективisht)

Duhet vënë në dukje gjithashtu se shuma e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në zonën euro në ekonomitë e tregut që janë duke dalë ka avancuar shpejt. Midis 1999 dhe 2005, investimet e huaja të drejtpërdrejta të realizuara nga zona euro në vende si Brazil, Rusi, Indi, Kinë, (BRIK) kanë pësuar rritje të fortë. Gjatë kësaj periudhe, qarkullimi i investimeve të huaja të drejtpërdrejta në këto vende ka kaluar nga 63 në 133 miliardë euro, (pra një rritje prej 111%). Për krahasim, gjatë të njëjtës periudhë, qarkullimi i investimeve të huaja direkte të zonës euro në SHBA ka avancuar me 55%, nga 360 në 558 miliardë euro. Zona euro vëtë është bëre më tërheqëse për investitorët nga këto vende. Në vitet 1999-2005, qarkullimi i investimeve të huaja direkte të këtyre vendeve me destinacion zonën euro janë trefishuar dhe kanë kaluar nga 4 në 12 miliardë euro, edhe pse me terma relativë ngelen të dobët. Kështu, gjatë të njëjtës periudhë, investimet e SH. B. A -ve në zonën euro janë rritur nga 322 miliard euro në 560 miliardë. Këto janë investime të realizuara nga ndërmarrje braziliiane dhe ruse që marrin pjesën e luanit nga rritja e investimeve të huaja të drejtpërdrejta të vendeve të BRIK me destinacion zonën euro, por investimet e huaja të drejtpërdrejta që vijnë nga Kina dhe India, janë rritur këto kohët e fundit. Në tërsësi, këto të dhëna dëshmojnë se nuk

ekziston as "fortesa Evropë", as "fortesa zonë euro".

► Pasojat e globalizmit për bankat qendrore

Pista ime e tretë e arsyetimit ka të bëjë me pasojat e globalizmit për bankat qendrore nga pikëpamja e dy misioneve të tyre kryesore, pra drejtimit të politikës monetare dhe ruajtjes së stabilitetit financiar.

► Globalizimi dhe politika monetare

Çështja e impaktit të episodit historik të globalizimit të përshpejtuar që po vëzhgojmë që prej disa muajsh mbi inflacionin, është njëherazi e rëndësishme dhe e kundërshtueshme. Teoria ekonomike tregon shumë mënyrë me anë të të cilave globalizimi mund të ndikojë nivelin e çmimeve por këto ndikime nuk janë të vetme. Kam përmendur tashmë fenomenin themeltar të ekspansionit të krahut të punës të gatshëm në nivelin e ekonomisë botërore me hapjen e përgjithësuar të ekonomive të reja dhe të ish ekonomive komuniste. Kjo dukuri ushtron një presion edhe në tritjen më të vogël të kostos së punës, sidomos të punës jo të kualifikuar. Në një mënyrë më të përgjithshme, ajo ka prirjen ta ndryshojë ndjeshëm në nivel botëror ekuilibrin e mëparshëm midis kapitalit dhe punës. Globalizimi ushtron gjithashtu një presion në favor të stabilitetit të çmimeve duke përforcuar ndjeshëm konkurrencën në shkallë botërore, duke zgjeluar aftësinë e ndërmarrjeve përtë fiksuar çmimet dhe duke ushtruar presion mbi kostot unitare të produkteve në vendet e industrializuara.

Së fundi, ndikimi i tretë, në harmoni me të parët, globalizimi ka pasur një ndikim pozitiv mbi produktivitetin e sektorit produktiv në nivel botëror duke lehtësuar dhe duke përshpejtuar dukurinë e ristrukturimit dhe të optimizmit të ndarjes së punës në një perspektivë ndërkufitare të zgjeruar. Por do të ishte naivë të besoje se globalizimi ka një marrëdhënie vetëm me një kah me inflacionin. Kështu, dalja e ekonomive të reja dhe me rritje të shpejtë në ekonominë botërore, ushtron një presion kur triten çmimet e produkteve të minieravë dhe të energjive të vjetra. Kjo dukuri është veçanërisht e dukshme që prej vitit 2003.

E njëjtë dukuri e rritjes së çmimeve është vënë re tek disa produkte bujqësore. Arritja e një niveli më të lartë jetese nga një klasë e re e mesme e shumtë në numër ka sjellë ndryshime të rëndësishme të zakoneve të të ushqyerit, dhe si rrjedhojë edhe në ekonominë e sektorëve të mishit, drithërave, dhe produkteve të freskët në nivel botëror.

Duke qenë se teorikisht, ndikimet që ka globalizimi mbi çmimet janë të shumta dhe në kahe të ndryshme, një koniunkturë deri diku e natyrshme do të ishte supozimi se globalizimi si një dukuri e vazdureshme, kur ushtron ndikimin e tij në një kohëzgjatje mesatare - në se është e gjatë sjell ndryshime thelbësore të çmimeve relative - çmimet e produkteve manifakturorë do të ulen, dhe çmimet e naftës, gazit dhe të disa produkteve bazë do të rriten, - pa e prekur ndjeshëm nivelin e përgjithshëm të çmimeve. Kërkimet empirike nuk lejojnë që kjo koniunkturë të konfirmohet por as të refuzohet për këtë periudhë të vonë. Në tërësi, të dhënat e disponueshme konfirmojnë se çmimet e produkteve të importuara në zonën euro ishin më të ulët në vitin 2006 se në vitin 2001. Edhe pse çmimet e importit të lëndëve të para janë rritur që prej vitit 2003, mund të konsiderojmë se për të njëjtën periudhë, rritja e tërësisë së çmimeve të importit të të gjithë produkteve, u moderua nga rritja e importeve të zonës euro që vinin nga vendet me kosto të ulët prodhimi. (Vende të Evropës Lindore dhe Azisë, sidomos Kinës)

Dukuria e globalizimit dhe e përshpejtimit të tij është që prej mesit të viteve '90, ka koinciduar me një rënje të nivelit të inflacionit dhe të luhatjeve të tij. Në të njëjtën kohë, dhe si pasojë e stabilitetit të këtij inflacioni në nivele të ulëta, është vënë re gjithashtu, një luhatje më e dobët e variablate makroekonomikë.

Por nuk duhet arritur në konkluzionin se ky korrelacion i globalizimit dhe inflacionit të ulët tregon një marrëdhënie shkakore. Mund të identifikohen shumë faktorë të tjerë - të pavarur nga globalizimi - që ndihmon në shpjegimin e këtyre rezultateve të mira. Unë kam gjetur të paktën katër prej tyre.

Së pari, zhvillimet shumë të shpejta të teknologjive dhe sidomos të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit - sjellin zhvillime në produktivitet që koincidonë me globalizimin

dhe janë në fakt një nga shkaqe e tij.

Së dyti reformat strukturore që u kryen në vendet e zhvilluara në fillim të viteve '80 dhe që u intensifikuan gradualisht në të gjitha ekonomitë. Këto reforma, ashtu edhe përhapja e teknologjive kanë ndihmuar në rritjen e potencialit për rritje të ekonomive dhe pra, në stabilitetin e çmimeve. Së treti, disiplina buxhetore e rritur, që la gjurmë në shumicën e ekonomive të kohëve të fundit, pas çregullimeve buxhetore të periudhave të mëparshme.

Së treti, politika monetare e ndjekur nga bankat dhe rritja e besueshmërisë të tyre.

Do të doja të ndalesha më shumë te pika e fundit. Cilat do qofshin ndikimet që ushtrohen në kuadrin e globalizimit, parimi themeltar që lejon zbatimin e politikës monetare mbetet po ai: në afat gjatë, inflacioni është një fenomen monetar. Për pasojë, globalizimi nuk prek as rolin qendror, as përgjegjësinë kryesore të bankave qendrore, që është ruajtja e stabilitetit të çmimeve.

Në afat shkurtër, banka qendrore duhet të vazhdojë të fiksojë pritshmërinë e inflacionit në një nivel që përputhet me përcaktimin që i ka dhënë ajo stabilitetit të çmimeve. Më lejoni të ilustroj me një shembull diskutimin tim. Le të matrim si pikënisje rritjen e fortë të çmimit të energjisë të kohëve të fundit. Po nisem nga hipoteza e angazhimit të besueshëm të bankës qendrore, që ndër të tjera gjëzon edhe besimin e plotë të publikut dhe të përgjegjësve të tjere të politikës ekonomike, për të ruajtur stabilitetin e çmimeve. Ndërmarrjet, për të cilat energjia është një input në procesin e prodhimit, konstatojnë një rritje të ndjeshme dhe të beftë të kurseve të naftës. Në kuadrin e angazhimit të besueshëm për të sigruar ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në afat mesëm dhe të fiksimit solid të parashikimeve të inflacionit në nivele të ulët, sipërmarrësit e kuptojnë lehtë se rritja e kurseve prek çmimin relativ të energjisë, ndërsa niveli i përgjithshëm i çmimeve ndoshta nuk rritet po aq. Si rrjedhim, ata ndihen më pak të tunduar për të tejçuar krejtësisht rritjen e çmimeve të inputit tek konsumatori, sepse, nëse do të vepronin kështu, ata mund të dëmtoton konkurrencën e tyre, veçanërisht në një mjedis botëror gjithnjë e më shumë konkurrues. Ky shembull tregon se besueshmëria e bakës qendrore ul ndjeshëm efektet inflacioniste të raundit të dytë dhe minimizon luhatjet makroekonomike në terma

të prodhimit dhe të inflacionit.

Çfarë roli kanë tani bankat qendrore mbi reduktimin e risqeve për stabilitetin financiar që vjen nga globalizimi?

Ndërlidhja e përgjithësuar e sistemeve financiarë ka krijuar një sistem financiar botëror që po kthehet në njësinë e vërtetë të vlefshme në nivel botëror. Kjo ndikon mbi vlerësimin e stabilitetit financiar nga bankat qendrore në dy mënyra:

Së pari, këto të fundit duhet të vendosin analizën e tyre të stabilitetit financiar në një perspektivë botërore. Kështu, në lidhje me zonën euro, për shembull, nuk mund të kemi një vizion të plotë të burimeve kryesore të risqeve dhe të vulnerabiliteteve për sistemin financiar pa marrë parasysh c'ekuilibr e rendësishëm botërorë ose shqetësimet në lidhje me tepricat në likuiditet.

Së dyti, globalizimi i sistemeve financiarë kërkon një bashkëpunim ndërkufitar të përforcuar dhe shkëmbim informacioni midis bankave qendrore (ashtu edhe midis tyre dhe autoriteteve që kontribuojnë në stabilitetin financiar). Kjo duhet të lejonte nga njëra anë, sigurimin e një vlerësimi të detajuar të risqeve dhe nga ana tjetër, identifikimin e masave të duhura dhe efektive që duhen marrë. Në Bashkimin European, është kryesisht Komiteti ekonomik dhe financiar (dhe tryeza e tij e stabilitetit financiar që grupon përfaqësues të ministrive të financave, të bankave qendrore dhe të autoriteteve të mbikëqyrjes në fushën bankare, të titujeve dhe të sigurive) si edhe Sistemi i Bankave Qendrore Europiane / Eurosistemi, që ndjekin këtë qëllim. Në nivelin e G 10, realizimi i këtij qëllimi i takon Forumit mbi stabilitetin financiar dhe komitetet e tjera sektoriale.

Globalizimi i sistemeve financiarë ka gjithashtu ndikim mbi rolin e bankave qendrore në lidhje me përcaktimin e rregullores dhe të mbikëqyrjes financiare. Ky funksion i takon bankave qendrore, sepse ose janë ato që ushtrojnë një përgjegjësi të drejtpërdrejtë në fushën e mbikëqyrjes, ose ato ndërhyjnë me anë të një misioni këshillimi për qeveritë. Në mënyrë të përgjithshme, globalizimi financiar kërkon një intensifikim të përpjekjeve nga ana e rregulatorëve në nivel ndërkufitar, me qëllim që këta të fundit të vendosin norma rregulluese dhe mbikëqyrjeje koherente. Duhet gjithashtu të promovohet barazia në trajtim

dhe të ulen arbitrazhet rregullues. Eksperiencia e Bashkimit Europian, ku krijimi i një tregu të vetëm financiar përbën një objektiv strategjik të madh dhe supozon heqjen e të gjithë pengesave potenciale në fushën e rregullimit dhe të mbikëqyrjes, na jep një shembull të shkëlqyer. Eksperiencia e Bashkimit Europian dëshmon gjithashtu dobishmérinë e ecjes me etapa në procesin e konvergjencës, duke u ndalur fillimisht në kërkesat rregulluese dhe më pas, në normat dhe praktikat në fushën e mbikëqyrjes.

Në këtë kontekst, do të doja të jepja tre konsiderata.

Së pari në fushat e përcaktuara qartë kohë më parë, është e rëndësishme që rregulatorët e sistemeve kryesore financiare të thellojnë dhe përforcojnë dialogun e tyre në nivel botëror. Ne mbështesim veçanërisht iniciativën e Komisionit Europian me qëllim shtrirjen e dialogut mbi çështjet rregulluese me SH. B. A dhe vende të tjera të rëndësishme si Kina dhe Japonia.

Së dyti, shohim të rritet numri i fushave të reja në të cilat nevoja e një qasjeje koherente në nivel botëror është e ndjeshme. Institucionet financiare të niveleve të larta e ilustrojnë mirë këtë situatë. Mbi bazën e mandatit të dhënë në mënyrë joformale nga G8, forumi mbi stabilitetin financiar ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në vendosjen e rekomandimeve në nivel botëror të drejtar ndaj rregulatorëve, kundërshtarëve të fondevit mbështetëse, investitorëve në këto fonde. Vetë institucionet financiare janë inkurajuar të krijojnë, nën përgjegjësinë e tyre dhe vullnetarisht, elementët e sjelljes optimale si nga pikëpamja e transparencës ndaj palës tjetër, dhe të investitorëve të tyre, ashtu edhe nga pikëpamja e menaxhimit optimal të risqeve. Mund gjithashtu të citojmë tregjet e derivateve të kreditit ndër fusha të tjera për të cilat është e domosdoshme një qasje koherente në nivel global.

Së treti, në mënyrë më të përgjithshme, shumë ngelet për t'u bërë për të harmonizuar praktikat efektive të mbikëqyrjes në nivel ndërkombëtar. Kjo është paradoxale kur bëhet fjalë për bankat meqë komiteti i Balit është më i përparuar dhe më i vjetri me misionin e kontrollit se të gjithë parimet dhe nocionet e mbikëqyrjes së kujdeshshme janë përcaktuar në mënyrë të vetme, në shkallë botërore. Por duke pasur parasysh, diversitetin e praktikave, është i nevojshëm një harmonizim dhe që aktualisht është kryer

nga "grupi për zbatimin e marrëveshjes" të komitetit të Balit; i ngarkuar për të studiuar çështjet e zbatimit në praktikë të konvergjencës së praktikave të mbikëqyrjes bankare në nivel ndërkombëtar.

Konkluzione

Do të doja të tërhojja vëmendjen tuaj mbi pesë pikat që vijojnë:

Së pari, të mos harrojmë kurrë, se në themel të globalizimit qëndrojnë progresi shkencor dhe teknologjik. Nuk mund të ketë transmetim të menjëhershëm të informacionit dhe me kosto të ulët, të nocioneve dhe të shërbimeve në nivel botëror pa teknologjité e reja të informacionit dhe komunikimit. Nuk ka ekspansion shumë të shpejtë të tregtisë ndërkombëtare të mallrave pa progresin teknologjik të transporteve detare dhe ajtore.

Së dyti, nëse shkenca dhe teknologjia, janë në origjinë të globalizimit bashkëkohor, ky i fundit, mund të jetë një fenomen jo vetëm i vazhdueshëm por edhe të ketë prirje të përforcohet: në fakt asgjë nuk tregon se zhvillimet shkencore dhe teknike do të kenë prirje të ngadalësohen, përkundrazi.

Së treti, rritja e shpejtë ekonomike që ne vemi te në nivel botëror dhe shndërrimet shumë të rëndësishme për të cilat kjo rritje është në të njëjtën kohë pasoja dhe shkaku në nivelin e se cilës prej ekonomive, ndryshimet e shpejta të peshave ekonomike respektive të ekonomive të kontinenteve të ndryshme dhe të strukturës së ekonomisë botërore, për pasojë, gjithçka ndërthuret për t'i bërë më pak të besueshme parashikimet e bazuara mbi rregullsitë e vëzguara në të kaluarën. Si rrjedhojë, pasiguria ka prirje të rritet dhe risqet ekonomike dhe financiare me probabilitet të ulët ose shumë të ulët por me një potencial të madh destabilizues shfaqen si një kundërpeshë e pashmangshme dhe "normale" e një periudhe prosperiteti ekonomik pa precedent. Nuk është momenti të biem dakord.

Së katërti, më shumë se kurrë në periudhë globalizimit të përshtpjtar, besueshmëria e bankave qendrore është kryesisht për të fiksuar pritjet inflacioniste dhe për të shërbyer si një bazament i fortë për stabilitetin financiar dhe monetar në një ekonomi ndërkombëtare brilante dhe të lëvizshme por në të cilën pasiguritë dhe risqet nuk mund të neglizohen.

Së pesti, është e domosdoshme thellimi dhe përforcimi i qeverisjes botërore duke shfrytëzuar në maksimum të gjitha mundësitë e ofruara nga tërësia e institucioneve financiarë formale dhe joformale ekzistues, dhe duke konsoliduar stabilitetin financiar botëror jo vetëm nëpërmjet unifikimit të parimeve dhe koncepteve të mbikëqyrjes së kujdeshme dhe të rregullimit, por edhe të unifikimit real, efektiv, ne nivel botëror, të zbatimit praktik të rregullimit dhe të mbikëqyrjes.

Bibliografi

- 1.Baumann, U. et F. di Mauro (2007), Globalisation and euro area trade: interaction and challenges, Série d'études de la BCE concernant des sujets spécifiques, n° 55.
- 2.Borio, C. and Filardo, A. (2007), Globalisation and inflation: New cross-country evidence on the global determinants of domestic inflation, BIS Working Papers No. 227.
- 3.BCE (2006), Effets sur les prix à l'importation de la zone euro résultant d'une intégration croissante des pays à faibles coûts de production dans les échanges mondiaux, encadré dans le Bulletin mensuel, août.
- 4.BCE (2007), Financial integration in Europe, rapport pouvant être téléchargé (en anglais) à l'adresse suivante : <http://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/financialintegrationineurope200703en.pdf>.
- 5.Devereux, M. B. and Sutherland, A. (2007), Financial Globalisation and Monetary Policy, Discussion Paper Series No 6147, International Macroeconomics, Centre for Economic Policy Research.
- 6.European Central Bank, Financial Stability Review (June 2007).
- 7.Freeman, R. (2006), The great doubling: the challenge of the new global labour market, août.
- 8.FMI (2006), Quelle influence la mondialisation a-t-elle eue sur l'inflation ?, Perspectives économiques mondiales, chapitre III, avril.
- 9.OCDE (2006), Mondialisation et inflation dans les économies de l'OCDE, ECO/CPE/WPI.
- 10.Papademos, L. (2006), Monetary Policy in a Changing World: Commitment, Strategy and Credibility, Speech at the Fourth Conference of the International Research Forum on Monetary Policy, Washington D.C, 1 December.
- 11.Paramo, G. (2007), Globalisation and monetary policy, discours disponible (en anglais) sur le site Internet de la BCE à l'adresse suivante : <http://www.ecb.europa.eu/press/key/date/2007/html/sp070316.en.html>.
- 12.Rogoff, K. (2006), Impact of Globalization on Monetary Policy, Harvard University (prepared for symposium sponsored by the Federal Reserve Bank of Kansas City on "The New Economic Geography: Effects and Policy Implications" Jackson Hole, Wyoming, 24-26 August).
- 13.Trichet, J-C. (2006), L'intégration économique dans la zone euro, 15ème Conférence Régionale européenne du conseil des Gouverneurs - Université de Tel Aviv, Paris, 31 Mars
- 14.Trichet, J-C. (2007), The current state of European Financial Integration, University of Stirling, 11 May.

AMERIKA DHE KINA NE GJEOEKONOMINE GLOBALE

Pse shekulli i 21-të do të vazhdojë të jetë një “shekull amerikan”?

FATOS TARIFA

PhD në Sociologji
Dr në Shkenca Politike
fatos.tarifa@usa.net

Vitet e fundit është bërë një mit shumë i përhapur ai se, “shekulli amerikan” ka mbaruar dhe shekulli i 21-të do të jetë “shekulli kinez”. Ky mit, mbështetet kryesisht në argumentin se, ngritja e Kinës si një fuqi e madhe po e transformon peizazhin ekonomik dhe politik të globit, duke i dhënë fund hegemonisë amerikane. Ky argument nuk merr në konsideratë faktin se, vetë ngritja e Kinës është rezultat i ndryshimeve ekonomike, teknologjike dhe politike që po ndodhin në një botën gjithnjë e më të globalizuar, ndryshime këto, të cilat e shtyjnë Kinën drejt një integrimi dhe bashkëpunimi më të madh me aktorë të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtarë, në radhë të parë me fuqinë më të madhe politike, ekonomike, ushtarake dhe teknologjike botës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky artikull argumen-ton se shekulli i 21-të do të vazhdojë të mbetet një “shekull amerikan”.

Fatos Tarifa¹

Aktualisht, dhe për një kohë të gjatë, asnjëra nga fuqitë e mëdha të Azisë Kina, Japonia apo India nuk duket se do të jetë në gjendje të krijojë një kundërpeshë ndaj superfuqisë së vetme, Shteteve të Bashkuara. Në këtë artikull unë do të përqendrohem kryesisht në rastin e Kinës. Nuk ka dyshim se, një ndër zhvillimet më të rëndësishme dhe më komplekse ndërkombëtare në shekullin e 21-të, do të jetë ngritja në skenën politike globale e Kinës, si një fuqi e madhe ekonomike, politike dhe ushtarake (Randt

¹ Fatos Tarifa, sociolog, studiues i shkencës politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, filozof dhe diplomat, është autor i 23 librave dhe mbi 40 artikujve studimorë të botuar në revista akademike në Shtetet e Bashkuara dhe në Europë. Ai ka fituar gradën PhD në Sociologji nga Universiteti i Karolinës së Veriut në Chapel Hill (SHBA) dhe një doktoraturë në shkencat politike nga Universiteti i Tiranës. Nga viti 1998 deri më 2005 ai ka përfaqësuar Shqipërinë si ambasador në Holandë dhe në Shtetet e Bashkuara. Dr. Tarifa ka mbajtur një sërë pozicionesh akademike në SHBA dhe në Holandë, si në University of North Carolina, Campbell University, Webster University, Institute of Social Studies (Hagë) dhe, nga janari 2006 deri në qershor 2008, në Eastern Michigan University si Distinguished Visiting Scholar dhe Visiting Professor në sociologji dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Dr. Tarifa është themelues dhe kryeredaktor i revistës *Sociological Analysis* dhe anëtar i bordeve editorialë të revistave ndërkombëtare *Journal of Social Sciences* dhe *Journal of Applied Social Science*.

2005: 23). Nisur nga ritmet shumë të larta të zhvillimit ekonomik të këtij vendi, sot është bërë një mit shumë i përhapur ai se Kina, e cila shpesh krahasohet me një “komb të nevrikosur”, apo me “një dragua që po zgjohet nga një gjumë shumëshekullor” (Mahbubani 2005a: 49), do të bëhet “superfuqia e ardhshme ekonomike” dhe se ajo do të jetë ekonomia më e madhe në botë në 10, 20 apo 30 vjet të ardhshëm. Ky mit shoqërohet zakonisht me një mit tjetër, atë se deficiti aktual tregtar i Amerikës (një e treta e të cilit është deficit në tregtinë e saj me Kinën), është rritur në një shkallë të papërbollueshme, gjë që mund të çojë në një kataklizëm ekonomik global. Ndonjë autor, madje, shkon aq larg sa të deklarojë se, “Shekulli amerikan ka mbaruar; tashmë ka filluar shekulli kinez” (Rorty 2005: 91). Çështja paraqitet gati-gati sikur pas ngjarjeve tragjike të 11 shtatorit 2001, dhe me daljen spektakolare të Kinës në skenën politike dhe në sistemin e tregtisë botërore, në historinë e njerëzimit po hapet një kapitull i ri. Siç shkruante Richard Rorty jo shumë kohë më parë. Sulmet e 11 shtatorit 2001, na kanë bërë të kuptojmë, se sa pak të ngjărë ka që Perëndimi të mund të përcaktojë të ardhmen e botës. Ka ardhur dita, që fatet e kombeve joperëndimorë do të përcaktohen më shumë

në Pekin se sa në Uashington (Rorty 2005: 92).

D Konsiderata gjeoekonomike dhe gjepolitike

Është për t'u çuditur se sa lehtë mund të krijohen mite të tillë në fushën e marrëdhënieve dhe të politikës globale, të cilët bazohen në "iluzionin materialist" se, fuqia ekonomike, krijon domosdo influencë gjepolitike dhe statusin e një "aktori polar". Japonia dhe Gjermania, për shembull, dy fuqitë ekonomike më të mëdha pas Shteteve të Bashkuara, të cilat gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë shfrytëzuan ndihmat financiare dhe ombrellën mbrojtëse të Amerikës për të rindërtuar ekonomitë e tyre moderne të industrializuara, janë një shembull i qartë se zhvillimi dhe fuqia ekonomike e një vendi nuk e transformojnë atë domosdo edhe në një fuqi politike dhe ushtarake. Me fjalë të tjera, "gjeoekonomia" nuk përkthehet vetveti në "gjeopolitikë" (shih Donnelly 2004). Përveç kësaj, miti tashmë shumë i përhapur se "shekulli amerikan" ka mbaruar dhe shekulli i 21-të do të jetë "shekulli kinez" mbështetet mbi një argument të rëndësishëm, por të njëanshëm, në atë se ngritja e Kinës si një fuqi e madhe po e transformon peizazhin ekonomik dhe politik të globit, pa i kushtuar vëmendjen e duhur një argumenti tjetër po kaq të rëndësishëm, atij se vetë ngritja e Kinës është rezultat i ndryshimeve ekonomike, teknologjike dhe politike që po ndodhin në një botë gjithnjë e më të globalizuar, ndryshime këto të cilat e shtynë Kinën jo drejt izolimit dhe autarkisë, si deri dy-tre dekada më parë, por drejt një integrimi dhe bashkëpunimi më të madh me aktorë të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtarë, në radhë të parë me fuqinë më të madhe të politike, ekonomike, ushtarake dhe teknologjike botës Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në fillim të viteve 1960-të, vetëm një dekadë pasi teoricienët dhe analistët e marrëdhënieve ndërkombëtare kishin zhvilluar konceptin e "dypolaritetit", studiues të ndryshëm filluan të argumentojnë se me rimëkëmbjen ekonomike të Europës dhe të Japonisë bota po bëhej shumëpolare. Pas rënies së Saigonit më 1975 dhe dështimit të Amerikës në Vietnam, ishin të shumtë ata që shpallën krijimin e një bote shumëpolare. Sidoqoftë, teksti më me influencë në fushën e marrëdhënieve

ndërkombëtare në atë kohë, Teoria e Politikës Ndërkombëtare (Theory of International Politics), shkruar nga neorealisti Kenneth N. Waltz (1979), argumentonte se, pavarësisht perceptimeve gjerësisht të përhapura mbi fundin e sistemit dypolar, një analizë e vëmendshme e strukturës materiale të botës tregonte se sistemi global vazhdonte të ishte në thelb dypolar. Në vitet 1980-të shumëkush besonte se Japonia do të bëhej sunduesja ekonomike e globit. Disa blerje spektakolare që bënë kompanitë japoneze në Shtetet e Bashkuara krijuan mitin se "Japonia po e blen Amerikën". Më 1992, ish-Senatori amerikan nga shteti Masaçusets, Paul Tsongas, i cili kandidoi për postin e presidentit të SHBA-së, e bëri pjesë të fushatës së tij elektorale sloganin e famshëm "The Cold War is over, and Japan won" (Lufta e Ftohtë ka mbaruar dhe Japonia fitoi). "Paniku" që u krijuar në atë kohë, sidqoftë nuk zgjati shumë, kur u provua se blerjet prej kompanive japoneze ishin bërë për një vlerë më të madhe se vlera reale e industrive të shitura. Në përgjithësi, mund të thuhet se edhe pse përfundimi i Luftës së Ftohtë nuk e dëmtoi Japoninë, me mbarimin e saj ky vend filloj të ndjej "më i shqetësuar se i kënaqur dhe më i kërcënuar se i sigurt" (Mahbubani 1992: 126). Që nga ajo kohë dhe deri disa vjet më parë, ekonomia japoneze ka qenë pothuajse në stanacion, ndërsa ekonomia amerikane, e cila ndërkohë zhvilloi Internetin dhe teknologjinë e informacionit, është rritur më shumë se 40 përqind. Në fund të vitit 2004, vlera e investimeve të drejtpërdrejta japoneze në ekonominë globale ishte më pak se 400 miliardë dollarë, vlerë kjo, e cila ndonëse është 10 herë më e madhe se ajo e investimeve të drejtpërdrejta kineze, është, sidqoftë, pesë herë më e vogël se vlera e investimeve të drejtpërdrejta amerikane në ekonominë globale për të njëjtën periudhë (Gottesman 2006: 42). Në fillim të viteve 1990-të, kur pas dizintegrimit të Bashkimit Sovjetik në tregun e ideve u bë sunduese teza mbi sistemin njëpolar, me Shtetet e Bashkuara si e vëtmja superfuqi e këtij sistemi, Kenneth Waltz shpalli se bota shumë shpejt po bëhej përsëri shumëpolare. Perceptime të tillë mbi ndryshimin e strukturës së sistemit global janë ushqyer nga besimi se me fuqizimin ekonomik dhe ushtarak të shteteve të tjerë dhe me daljen në skenën botërore të fuqive të reja të mëdha, Amerika do të humbiste supremacinë e saj dhe influenca e saj në politikën dhe në

marrëdhëniet ndërkontinentare do të balancohen nga ajo e fuqive të tjera. William Wolfson, në një artikull botuar kohë e fundit në Harvard International Review, ve në dukje se shqetësimi i sotëm mbi rënien e supremacisë amerikane në politikën globale nuk është diçka e re. Kjo, sipas tij, është e katërtë herë qysh nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore që thuhet se hegemonia amerikane po merr fund. Për herë të parë kjo ndodhi në vitet 1950-të, kur Bashkimi Sovjetik lëshoi Sputnikun e tij në hapësirën kozmike; për herë të dytë ndodhi në vitet 1970-të, pas rënies së Saigonit dhe stagfacionit në Shtetet e Bashkuara dhe për herë të tretë në vitet 1980-të si rezultat i sfidës ekonomike të Japonisë (Wohlforth 2007: 44). Në të gjithë këta raste, ndryshimet që ndodhën në arenën ndërkontinentare ishin reale dhe, pa dyshim, shumë të rëndësishme. Ato sugeronin se, në një planet, i cili përvëç Amerikës popullohet edhe nga fuqi të tjera të mëdha, fuqia politike, ekonomike dhe ushtarake mund të rishpërndahet. Sidoqoftë, asnjë nga episodet e sipërpërmendur, as në vitet 1950-të, as në vitet 1970-të, as në vitet 1980-të, nuk e transformoi strukturën e sistemit global të marrëdhënieve ndërkontinentare në një sistem shumëpolar, në të cilin tre apo më shumë fuqi pak a shumë të barabarta të konkurronin dhe të balanconin mes njëra-tjetrës peshën politike të globit. Deri në dizintegrimin e Bashkimit Sovjetik bota mbeti dypolare. Pas kësaj kohe, pesha e gravitetit politik, ekonomik dhe ushtarak të saj filloi të bjerë dhe vazhdon të bjerë mbi Shtetet e Bashkuara, e cila mbetet e vetmja superfuqi.

A po bie ekonomikisht Amerika ndërsa Kina ngrihet?

Le të analizojmë më në hollësi rastin e Kinës. Sot, iluzionin e dikurshëm mbi triumfin japonez e ka zënë një tjetër iluzion: ai se Kina do të bëhet shumë shpejt fuqia dominuese ekonomike (dhe ndoshta politike dhe ushtarake) e gjelbit në shekullin e 21-të. Autorë të ndryshëm, madje, i referohen Napoleon Bonapartit, i cili citohet të ketë thënë se "Kur Kina të zgjohet, ajo do të trondisë botën" (cituar në Kristof & Wudunn 2005). Duke filluar nga gjysma e dytë e viteve 1970-të, Kina ka pasur dhe vazhdon të ketë një rritje të tillë ekonomike që nuk e ka rishohur jo vetëm ajo gjatë dyqind viteve të fundit të historisë së saj, por as pjesa më e madhe e ekonomive të zhvilluara

të botës. Ekonomisti i shqar amerikan Jeffrey Sachs e konsideron Kinën si "historinë më të suksesshme të zhvillimit në historinë botërore" (cituar në Zakaria 2008: 89). Qysh nga viti 1979, ekonomia kineze është rritur me një ritëm mesatar vjetor prej 9.4 përqind shifër kjo tre herë më e lartë se rritja mesatare vjetore e ekonomisë globale. Në vitin 2006 ekonomia kineze pati një rritje vjetore të jashtëzakonshme, 10.7 përqind, ndërsa në tremujorin e parë të vitit 2007 rritja ekonomike e saj kapi nivelin me të lartë të rritje vjetore të jashtëzakonshme, 11.1 përqind (Barth & Caprio 2007: 29-30). Mjafton të përmendim se sot, në një ditë të vetme Kina eksporton aq sa ka eksportuar ajo gjatë gjithë vitit 1978, për të kuptuar përmesat e vërteta të zhvillimit ekonomik të saj gjatë këtyre 30 viteve të fundit. Kina ka krijuar gjithashtu rezervat më të mëdha të valutës së huaj në botë, të cilat llogariten në shifrën 1.5 triliard, shifër kjo, e cila është 50 përqind më e lartë se rezervat valutore të Japonisë, vendit të dytë që vjen pas saj dhe tre herë më e lartë se rezervat valutore të krejt Bashkimit European. Edhe pse koha do të tregojë nëse një politikë e tillë financiare është largpamëse apo jo, vetë kjo rezervë e jashtëzakonshme valutore e Kinës është një tregues i fleksibilitetit të ekonomisë kineze përballë krizave të mundshme financiare (Zakaria 2008: 89, 92). Mundësitet e Kinës për zhvillim ekonomik dhe tregu gjigant i saj kanë tërhequr dhe vazhdojnë të tërheqin shumë investime të huaja të drejtpërdrejta. Kompani dhe institucione financiare pothuajse nga çdo vend i botës kërkojnë të hyjnë në Kinë për të ndërtuar fabrikat e tyre dhe për të ngritur selitë e tyre për krejt rajonin e Lindjes së Largët. Një dukuri e tillë ka bërë që Tokio dhe Singaporit të mos janë më qendrat e vetme ekonomike dhe financiare të Azisë; Shangai është bërë sot një qendër po aq e rëndësishme sa ato. Janë të shumtë ata autorë që besojnë se Kina po bëhet konkurrues kryesor i Amerikës për statusin e një "aktori të ri polar" në skenën e politikës botërore, se ajo do të jetë "superfuqia e ardhshme", apo "Bashkimi Sovjetik i ardhshëm" dhe se sfida më e madhe geopolitike dhe gjeoekonomike për Amerikën në shekullin e 21-të është se si do të mundet ajo të frenojë ngritjen e Kinës si një superfuqi. Ky "panik" nuk është askund më i përhapur se në vetë Shtetet e Bashkuara, ku mendimi se "Kina po e blen Amerikën" është bërë tashmë conventional wisdom. Mjafton të ndjekësh

emisionet e përditshme të Lou Dobbs në CNN, (të cilat kanë përfshirë refren "eksportimin e vendeve të punës" nga Amerika në Kinë apo në Indi dhe efektet gjoja "shkatërrimtare" të kësaj dukurie në ekonominë amerikane), përfshirë kuptuar se sa i përhapur është bërë ky mit në publikun dhe mediat amerikane. Shumë njerëz në Shtetet e Bashkuara, me të cilët më është dhënë rasti të bisedoj gjatë këtyre viteve të fundit, pyesin të shqetësuar se ç'do të mbetet të prodhohet në Amerikë kur pothuajse çdo gjë që ata konsumojnë dhe blejnë në tregun e tyre është "Made in China"? Këtu gjiej rast të hap një parantezë, përfshirë theksuar se ajo çka eksposozhet në media dhe besohet nga publiku i pari formuar nuk është gjithmonë realiteti i vërtetë i gjërave.² "Eksportimi i vendeve të punës" në sektorin manifaktural nga Amerika në vende të "botës së tretë" është një fenomen që duhet parë dhe vlerësuar në kontekstin e ekonomisë globale, në të cilën, vende të tillë si Kina, India, Vietnami, Indonezia, Brazili apo Meksika janë bërë pjesë e rëndësishme e zinxhirit të prodhimit industrial përfshirë treg por, sidoqoftë, janë vetëm një pjesë e tij. Në këtë kontekst, duhet venë në dukje se ndërsa vendet e punës që Amerika "eksporton" në shtete të "botës së tretë" kanë të bëjnë kryesisht me industri tradicionalisht manifakturale, vetë ekonomia amerikane po dominohet gjithnjë e më shumë nga industri që janë "knowledge-based" (të cilat mbështeten, pra, në njojuritë shkencore bashkëkohore dhe jo aq në aktivitetin fizik) dhe po shndërrohen gjithnjë e më shumë në një "ekonomi shërbimi" (service economy). Ekonomia amerikane është më shumë se çdo ekonomi tjetër në botë një "ekonomi e dijes" ("knowledge economy"). Llogaritet se rreth 50 përqind e GDP-së së Shteteve të Bashkuara prodhohet nga "knowledge economy", përqindje kjo, e cila përfshirë vendet e Bashkimit European

varion nga 30 deri në 40 përqind e GDP-së së tyre, ndërsa përfshirë Kinë është shumë më e ulët. Shumica prej jush, madje edhe shumica e amerikanëve, nuk kanë dëgjuar ndoshta përfshirë ashtuquajturën "kurbë buzëqeshëse" (smiley curve). Është kështu përfshirë shkak të formës "U" të buzëqeshjes në një postër fare të thjeshtë krijuar në vitet 1970s përfshirë simbolizuar një fytyrë të lumtur, kurba ilustron zhvillimin e një produkti nga ideja përfshirë prodhimin e tij tek shitja në treg. Në krye të kurbës është anë të majtë fillohet me idenë dhe dizenjon industriale të produktit që do të prodhohet si do të duket produkti përfundimtar dhe si do të kryejë ai funksionin përfshirë cilin prodhohet. Më poshtë është kurbë vjen plani i detajuar inxhinierik përfshirë prodhimin e tij. Në pjesën e poshtme të kurbës është prodhimi i pjesëve, montimi i tyre në një produkt të vetëm, ambalazhimi dhe transportimi i tij. Pas kësaj, në pjesën e djathë të kurbës që zë e ngjitet dhe deri sipër, janë shpërndarja, marketimi, shitja, kontratat e shërbimit dhe shitja e pjesëve dhe e aksesorëve. Pothuajse në çdo sektor të prodhimit manifaktural, Kina realizon sot ato procese që janë në pjesën e poshtme të kurbës prodhimin e pjesëve, montimin i tyre, ambalazhimin dhe transportimin ndërsa Amerika realizon proceset që janë në krye të saj, pikërisht atje ku janë të ardhurat. Të pohosh se paraja e vërtetë është atje ku është emri i produktit dhe shitja mund të tingellojë një e vërtetë fare e thjeshtë, por implikimet e kësaj të vërtetë janë të rëndësishme. Një shembull domethënës përfshirë ilustruar këtë është iPod: ai prodhohet kryesisht jashtë Shteteve të Bashkuara por pjesa më e madhe e vlerës së shtuar të këtij produkti shkon tek një kompani amerikane Apple, Inc. në Kaliforni. Përfshirë iPod video me kapacitet 30 gigabajt që në vitin 2007 u shit përfshirë 299 USD, kostojë e prodhimit të pjesëve të tij jashtë Amerikës ishte 144 USD ndërsa fitimi neto i kësaj kompanie amerikane ishte 80 USD (Linden et al. 2007). Le ta shohim çështjen nga një këndvështrim tjetër, nga këndvështrimi i së ardhmes. Ekonomia amerikane jo vetëm mbështetet në teknologjinë më të avancuar, por ajo është, gjithashtu, ekonomia më dinamike në botë. Kjo vërehet veçanërisht nëse u referohemi industrive të së ardhmes, siç janë, ndërtësja, teknologjia nano (Nanotechnology) dhe bioteknologjia (Biotechnology). E para, si një shkencë e aplikuar që merret me kontrollin e lëndës në

² Kështu, përfshirë shembull, nëse Amerika ka "eksportuar" gjatë viteve të fundit 600 mijë apo 700 mijë vende pune në Kinë, Indi, Vietnam, Meksikë dhe në vende të tjera, kryesisht të "botës së tretë", çka do të thotë se këtë vende pune i kanë humbur qytetarët amerikanë, një dukuri e tillë është shoqëruar në të njëjtën kohë me "importimin" në Amerikë të 6 apo 7 milion vendesh të reja pune, në të cilat janë punësuar qytetarë amerikanë (Sinai & Merrill 2005: 59). Vetëm kompania gjermane Siemens, përfshirë shembull, punëson në Shtetet e Bashkuara mbi 70 mijë njerëz; qindra mijëra të tjera janë punësuar nga kompanitë japoneze dhe gjermane të prodhimit të automobilave, apo nga kompanitë mëdha britanike, franceze apo holandeze.

shkallë atomike dhe molekulare, mendohet se do të çojë në një sërë zhvillimesh revolucionare në fushën e teknologjisë dhe të prodhimit, në atë shkallë sa në një të ardhme (ndoshta brenda 50 vitesh), njerëzit do të prodhojnë produkte të ndryshëm në shtëpitë e tyre duke përdorur lëndë të para ndërsa bizneset thjesht do të krijojnë formulat përmes të cilave atomet do të mund të shndërrohen në produkte për konsum. Se sa e mundshme është kjo, këtë do ta tregojë koha. Ajo që duhet venë në dukje këtu, sidoqoftë, është se Amerika qysh sot dominon në këtë fushë në atë shkallë sa asnjë vend tjetër nuk do të mund t'i afrohet asaj për një kohë shumë të gjatë. Shtetet e Bashkuara kanë sot më shumë "qendra nano" (nanocenters) se tre shtetet që vijnë pas saj Gjermania, Anglia dhe Kina të marrë së bashku. Shumë nga qendrat e reja të saj (si, për shembull, Emory-Georgia Tech Nanotechnology Center for Personalized and Predictive Oncology), fokusohen në veprimtari shumë të specializuara me potenciale veçanërisht të mëdha për aplikime praktike dhe të marketueshëm. Investimet e shtetit amerikan për zhvillimin e teknologjisë nano janë dy herë më të mëdha se ato të konkurruesit më të madh që vjen pas saj në këtë fushë Japonisë, ndërkohë që Amerika ka krijuar më shumë patentë për teknologjitet nano se sa të gjithë vendet e botë të marrë së bashku (Zakaria 2008: 184). Më shumë se çdo vend tjetër i globit, siç ka mundur të konstatojë Dr. Michael Holman në një studim të kompanisë Lux pak kohë më parë, Amerika ka aftësinë të "gjenerojë rritje ekonomike nga inovacionet shkencore". Studimi në fjalë evidenton se vende të tillë si Kina, Franca, madje edhe Britania, të cilët investojnë në mënyrë të konsiderueshme për zhvillimin e kërkimeve shkencore, nuk arrijnë t'i aplikojnë arritjet e tyre shkencore në fushën e biznesit dhe se 85 përqind e investimeve kapitale në teknologjitet nano në shkallë globale kanë shkuar në kompanitë amerikane (Holman 2006). E njëjtë gjë mund të thuhet edhe për bioteknologjinë, e cila ka të bëjë me përdorimin e sistemeve biologjikë për krijimin e produkteve mjeksorë, bujqësorë dhe industrialë. Kjo industri shumëmiliardëshe dominohet gjithashtu nga Shtetet e Bashkuara. Në vitin 2005, Amerika investoi mbi 3.3 miliardë dollarë për zhvillimin e kompanive bioteknikë të saj, ndërkohë që, po atë vit, kompanitë europiane u financuan në një masë dy herë më të vogël. Ashtu si me

teknologjitet nano, kompanitë amerikane dominojnë dukshëm mbi ato europiane përsa i përket aftësisë për t'i shndërruar idetë në produkte të marketueshëm dhe të kërkuar. Në vitin 2005, të ardhurat e Shteteve të Bashkuara nga industria bioteknologjike ishin rreth 50 miliardë dollarë, pesë herë më të mëdha se ato të vendeve të Europës të marrë së bashku, apo sa 76 përqind e të ardhurave globale nga kjo industri e re (Zakaria 2008: 185). Përtë provuar se Amerika mbetet dhe do të vazhdojë të jetë për një kohë të gjatë fuqia dominuese ekonomike e botës le të marrim një makinë të thjeshtë llogaritëse. Në vitin 2006, prodhimi i përgjithshëm i vendit (Gross Domestic Product GDP) i Shteteve të Bashkuara ishte 13.245 triliard dollarë. Lexuesi mund ta ketë të vështirë të kapë kuptimin e vërtetë të një shifre të tillë në triliard dollarë, monedha bazë në të cilën shprehen treguesit statistikorë ekonomikë në shumicën e vendeve të botës. Një shifër e tillë, me pak fjalë, do të thotë se Shtetet e Bashkuara janë, në aspektin material, shteti më i fuqishëm që ka njohur ndonjëherë histori qysh nga krijimi i sistemit modern të marrëdhënieve ndërkombëtare me Traktatinë Westfaliasmë 1648. Përtë bërë më të kuptueshme domethënien e kësaj shifre dëshiroj t'i referohem gazetarit të famshëm të Financial Times, Nico Colchester, i cili, në një artikull të botuar më 1996, pak ditë pas vdekjes së tij, argumentonte se ekonomia botërore mund të përfytyrohet si shuma e 26 Italive (Colchester 1996: 31). Nga këto, më shumë se tetë Itali ishin në Amerikën e Veriut (një prej tyre Kalifornia), tetë Itali të tjera në Europë dhe pesë në Japoni. Këto të gjitha bënin më shumë se 21 Itali. Të gjithë vendet e Azisë Lindore, përfshirë Kinën, Indinë dhe katër "tigrat" aziatikë Hong Kongun, Singaporin, Korenë e Jugut dhe Tajvanin ishin të barabartë vetëm me 2 Itali. Pjesa tjetër e shteteve të botës (më shumë se 150 vende, përfshirë Rusinë, të gjithë vendet e Amerikës së Jugut, Afrikën, Lindjes së Mesme, Azinë Qendrore dhe Oqeaninë të marrë së bashku) ishin vetëm 3 Itali. Gjatë njëmbëdhjetë viteve të fundit kjo tablo nuk duket se ka ndryshuar shumë, me përjashtim të zhvillimit të Kinës dhe, katër-pesë vitet e fundit, të Rusisë. Tabela 1 përmban klasifikimin e 16 vendeve (çdonjëri prej të cilëve i kontribuon ekonomisë globale një prodhim të përgjithshëm me vlerë mbi 500 miliardë dollarë), si edhe shpërndarjen e DGPs-së së tyre përfrymë të

popullsisë. Për të argumentuar pikëpamjen tonë, ndoshta do të ishte më e dobishme të vinim në dukje se ekonomia amerikane është sot e barabartë afërsisht me pesë Kina. Sipas statistikave të mësipërme, me një GDP 2.6 triliardë dollarë, ekonomia kineze është aktualisht sa 1.5 Itali, apo më e vogël se ekonomia e dy shteteve të SHBA-së (Kalifornisë dhe Teksasit) të marrë së bashku.

Tabela 1: Vendet kontribuuese kryesore në ekonominë globale dhe niveli i GDP/frymë, 2006

Vendi	GDP (US\$ miliard)	DGP përfrymë (US\$ mijë)
SHBA	13.245	44.000
Japonia	4.367	33.100
Gjermania	2.897	31.900
Kina	2.630	7.700
Anglia	2.346	31.800
Franca	2.232	31.100
Italia	1.785	30.200
Kalifornia	1.700	
Kanadaja	1.269	35.600
Spanja	1.034	27.400
Brazili	967	8.800
Koreja e Jugut	897	24.500
India	804	3.800
Meksika	743	10.700
Rusia	733	12.200
Holanda	663	32.100
Australia	644	33.300

Burimet: International Monetary Fund; The CIA World Factbook, 2007

Tabela 2 përmban të dhëna mbi kontributin (në përqindje) të pesë fuqive më të mëdha ekonomike në GDP-në e përgjithshmetë globalisë së dhetë përqindjen që zënë në popullsinë e sotmetë e popullsitë e tyre.

Tabela 2: Kontributi i ekonomive kryesore në GDP e përgjithshme të globit dhe popullsitë e tyre, 2005

2005	Bota	Kina	India	SHBA	Japonia	BE
GDP	\$44 triliard	5.0%	1.7%	28.1%	10.3%	31.5%
Pop.	6.5 miliard	20%	17.0%	4.6%	2.0%	7.1%

Burimi: Baarth & Caprio 2007: 35

Sic tregohet qartë në tabelën 2, dallimet midis Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Europian dhe Japonisë, nga njëra anë, dhe Kinës apo Indisë, nga ana tjetër, janë të konsiderueshme. Me 4.6 përqind

të popullsisë së botës, pra me një popullsi gati 5 herë më të vogël se popullsia e Kinës, apo 4 herë më të vogël se popullsia e Indisë, në vitin 2005 Amerika prodhonte 28.1 përqind të GDP-së së globit, ose mbi 4 herë më shumë se Kina dhe India të marra së bashku. Nga ana e saj, Japonia, me një popullsi 10 herë më të vogël se popullsia e Kinës dhe 8.5 herë më të vogël se ajo e Indisë, kishte një GDP mbi 2 herë më të lartë se Kina dhe 6 herë më të lartë se India. SHBA, Japonia dhe BE të marra së bashku, me një popullsi sa 13.7 përqind e popullsisë së globit, apo 2.7 herë më të vogël se popullsitë e Kinës dhe të Indisë të marra së bashku, i kontribuonin së bashku ekonomisë së globit, në vitin 2005, afro 70 përqind të GDP-së tij, ose 10.4 herë më shumë se GDP-të e Kinës dhe Indisë të marra së bashku. Vetëm me rritjen vjetore të GDP-së së saj, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i shtojnë ekonomisë së globit pothuajse një Australi, apo një Zvicër të re, çdo vit. Gerard Baker (2006) vë në dukje se hegemonia ekonomike e Shteteve të Bashkuara nuk ka qenë asnjëherë më e madhe se c'është sot dhe se ajo do të vazhdojë të ruhet edhe për një kohë të gjatë. Le të vazhdojmë më tej arsyetimin tonë. Nëqoftëse GDP-ja e Shteteve të Bashkuara vazhdon të rritet (si deri më sot) rrëth 3 përqind në vit³, pas 30 vjetësh ajo, siç parashikon Philip Merrill, do të jetë mbi tre herë e gjysëm më e lartë se c'është sot, që do të thotë rrëth 50 triliardë dollarë (Sinai & Merrill 2005: 57). Nëqoftëse GDP-ja e Kinës vazhdon të rritet me ritmet e viteve të fundit (rrëth 9 përqind në vit), pas 30 vjetësh ajo do të arrrijë vlerën 17.1 triliardë dollarë, çka është rrëth një e treta më shumë se vlera e GDP-së së Amerikës sot. Prej këtej rezulton se në vitin 2035 ekonomia kineze jo vetëm që s'do të jetë ekonomia më e fuqishme në botë, por nuk do të jetë as sa

³ Allen Sinai, ekspert i njohur i ekonomisë globale dhe president i Decision Economics, Inc., pohonte në vitin 2005 se "nuk ka asnjë arsy" që rritja ekonomike vjetore e Shteteve të Bashkuara të bjerë nën 3 përqind. Kjo ka qenë rritja mesatare vjetore e ekonomisë së Shteteve të Bashkuara gjatë më shumë se 200 vjetëve të fundit. Sinai argumenton se "3 përqind rritje në vit për ekominë amerikane, e shprehur në GDP reale, është një rritje relativisht e fuqishme, veçanërisht po të krahasonet me ritmet e rritjes së vendeve të tjera të industrializuar të G-8" (Sinai & Merrill 2005: 56). Duhet theksuar se rënia e ndjeshme e shkallës së rritjes së ekonomisë amerikane në 0.5 përqind gjatë gjysmës së parë të vitit 2008 është një rast po thuaqse pa precedent në historinë e këtij vendi dhe besohet gjërësisht se do të jetë një episod i shkurtër.

gjysma e ekonomisë së Shteteve të Bashkuara, vend ky i cili, siç shprehet Philip Merrill, në saje të "kapaciteteve të habitshme [që ka] për rritjen e prodhimit dhe ripërtëritjen ekonomike të tij", "do të vazhdojë të njohë një rritje eksplozive në shekullin e 21-të, njëloj si edhe në dy shekujt e kaluar" (Sinai & Merrill 2005: 58). Përllogaritjet e mësipërme përputhen pak a shumë me parashikime të tjera më të detajuara. Ndër to mund të përmendim konkluzionet që ofron një studim i korporatës RAND, sipas të cilit, në vitin 2025 GDP-ja e Kinës do të jetë sa gjysma e asaj të Shteteve të Bashkuara (Crane et al. 2005: 46-48). Po të supozojmë se zhvillimi ekonomik i Kinës do të vazhdojë me të njëjtat ritme si ato të 20-30 viteve të fundit, parashikimi i GDP-së së saj në vlerën rrëth 17 triliardë dollarë, siç thamë më sipër, duket se është i saktë. Robert W. Fogel, profesor në Universitetin e Çikagos, vë në dukje se nga një vend i varfér në vitin 2000, Kina do të jetë një vend "super i pasur" në vitin 2040, por përsëri do të jetë pas Amerikës (Fogel 2007: 90). Edhe pse asnjë vend tjetër i madh nuk ka njohur një rritje mesatare prej më shumë se 9 përqind të GDP-së së vet për afro 30 vjet me radhë, siç ka ndodhur në Kinë, ekspertë të sistemeve financiarë argumentojnë se Kina nuk mund të vazhdojë të ketë për shumë kohë të njëjtat ritme të larta zhvillimi që ka sot (Baker 2006; Barth & Caprio 2007: 30). Përveç kësaj, duhet theksuar se parashikimet optimiste mbi Kinën nuk marrin parasysh problemet serioze me të cilat mund të ndeshet Kina së brendshmi, me fjalë të tjera, krizat politike, sociale dhe demografikë që mund t'i vijnë një vendi që zhvillohet ekonomikisht me ritme kaq të shpejta, rreziqe këto, të cilat mund t'i ulin shumë ritmet e zhvillimit ekonomik, madje të sjellin një "rritje" negative në ekonominë e vendit (shih Joffe 2006). Zheng Bijian me të drejtë ve në dukje se: vetëm rritja ekonomike nuk krijon një pamje të plotë mbi zhvillimin e një vendi. Kina ka një popullsi prej 1.3 miliardë. Çdo vështirësi e vogël në zhvillimin ekonomik dhe social të saj që mund të ndjehet në këtë masë të madhe njerëzish mund të shndërrohet në një problem të madh (Bijian 2005: 19). Ekspertë dhe analistë të zhvillimeve në Kinë, në analogji me eksperiencën e Rusisë, ku shembja e komunizmit coi jo në krijimin e një demokracie liberale por në konsolidimin e një regjimi autokratik, shprehin shqetësimin e tyre se një tronditje sizmike e sistemit politik në

Kinë mund të shkaktojë një situatë të ngjashme, e cila mund të mos i shërbejë një zhvillimi të qëndrueshëm afatgjatë dhe pasojat e së cilës është e vështirë t'i përfytyrojmë sot (Pei 2006: 73). Të mos harrojmë gjithashtu se popullsia e Kinës është aktualisht mbi katër herë më e madhe se popullsia e Shteteve të Bashkuara dhe përvlerën e GDP-së përfrymë në vitin 2005 Kina renditej në vendin e 100-të në botë.⁴ Pas 30 vjetësh, GDP-ja përfrymë të popullsisë në Kinë parashikohet të jetë më pak se një e katërtë e GDP-së përfrymë në Shtetet e Bashkuara sot. Prej këtej rezulton se nëse Kina ka sot një GDP-ja përfrymë të popullsisë 5.7 herë më të vogël se ajo e Shteteve të Bashkuara (siç tregohet në Tabelën 2), pas 30 vjetësh kjo diferençë do te jetë "reduktuar" në më shumë se 4 herë e vogël krahasuar me GDP-në përfrymë të Amerikës sot (jo me atë që do të jetë 30 vjet më vonë). Me fjalë të tjera, pas 30 vjetësh hendeku midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës jo vetëm që nuk do të jetë ngushtuar në mënyrë të dukshme, por mund të zgjerohet edhe më shumë. Thënë ndryshe, një fëmijë 10-vjeçar në Kinë sot pritet të ketë një kapacitet produktiv rreth 10,000 dollarë në vit (në vlerën e dollarit sot) kur ai të jetë 40 vjeç. Kjo shifër është tluajse e njëjtë me kufirin e sotëm të nivelit zyrtar të varfërisë përf një familje me një person në Amerikë.⁵ Problemi i popullsisë në Kinë ka edhe një aspekt tjetër, i cili ka të bëjë me plakjen e shpejtë të saj. Për shkak të politikës anti-nataliste (one-child policy) të ndjekur që nga vitit 1979, ritmet e shtimit të popullsisë në Kinë kanë shënuar rënje të ndjeshme sidomos gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit. Aktualisht, shkalla e fertilititetit në Kinë është mesatarisht 1.7 fëmijë përf çdo grua, çka edhe pse më e lartë se në shumicën e vendeve europiane, është sidoqoftë nën nivelin e ripërtëritjes natyrore të popullsisë, ndërkokë që shkalla e fertilititetit në SHBA është 2.1 fëmijë përf çdo grua. Parashikimet zyrtare amerikane dhe ato të Organizatës së Kombeve të Bashkuara thonë se

në vitin 2025 rritja absolute vjetore e populsisë së Shteteve të Bashkuara do të jetë më e madhe se ajo e Kinës (shih Eberstadt 2007: 58). Rënia e ndjeshme e ritmeve të shtitimit të populsisë në Kinë, e cila vazhdon dhe do të vazhdojë për një kohë relativisht të gjatë, shumë shpejt do të krijojë probleme serioze për një ekonomi, e cila zhvillohet me ritme kaq të larta si ajo kineze. Siç shprehet Ian Bremmer, "perspektiva e zhvillimit afatgjatë të Kinës mund të bëhet viktimi e suksesit të politikës 'një fëmijë' të saj" (Bremmer 2007: 32). Përsa i përket deficitit të sotëm tregtar të Shteteve të Bashkuara, me çka po të shprehemi thjesht kuptojmë diferençën midis mallrave dhe shërbimeve që Amerika blen nga jashtë dhe atyre që ajo u shet vendeve të tjerë, kjo është një çështje, e cila kohët e fundit ka ngjallur diskutime të shumta në SHBA dhe jashtë saj përsa i përket stabilitetit të ekonomisë amerikane dhe mundësive të saj për të vazhduar së qeni promotori i zhvillimit ekonomik në shkallë globale. Revista prestigjioze The American Interest, e cila botohet në Uashington, D.C. nën drejtimin intelektual të Francis Fukuyamës, në një nga numrat e parë të saj organizonte një debat mbi të ardhmen e ekonomisë amerikane, të cilin e çelte me këtë pyetje: "A ka ekzistuar ndonjëherë ndonjë fuqi po kaq a madhe sa Shtetet e Bashkuara, e cila të ketë qenë një shtet debitor?" Një ndër pjesëmarrësit në këtë forum, Philip Merrill, shpreh një pikëpamje tepër optimiste dhe realiste mbi gjendjen e ekonomisë amerikane dhe perspektivat e saj, me të cilën unë pajtohem plotësisht. Sipas tij, Shtetet e Bashkuara po e nxisin ekonominë botërore në mënyrë më të vendosur se në çdo kohë tjetër qysh nga vitet 1960-të. Kjo nuk ndodh thjesht për shkak të madhësisë së saj, por për shkak të kapaciteteve inovuese të saj në shkencë dhe teknologji, [që janë] forca lëvizëse e zhvillimit ekonomik modern dhe [përmes] mënyrave inovuese të saj në menaxhim dhe marketim. Pasuria e Amerikës dhe mënyra se si krijohet ajo përcaktojnë epokën tonë (Sinai & Merrill 2005: 56). Për një ekonomi shumë të zhvilluar, komplekse dhe dinamike, siç është ekonomia amerikane, e cila për shumë dekada me radhë ka qenë dhe vazhdon të jetë "lokomotiva" e ekonomisë botërore, deficiti i saj tregtar me Kinën nuk përbën një problem shumë serioz apo iminent. Efekti i tij minimizohet, nga njëra anë, për shkak të fuqisë dhe dinamizmit të jashtëzakonshëm të

4 Nuk mund të mohohet, sidqoqtë, se kushtet ekonomike të popullsisë kineze janë përmirësuar në mënyrë të ndjeshtme gjatë dy dekadave të fundit. Edhe pse një pjesë e madhe e saj vazhdon të jetojë në kushte të mjetueshme, qindra milionë kinezë kanë mundur të dalin nga niveli i varfërisë absolute brenda jetëgjatësisë së një brezi njerëzor (Randt 2005: 25; Barth & Caprio 2007: 29).

5 U.S. Census Bureau, Poverty Thresholds, revised January 28, 2005.

ekonomisë amerikane dhe, nga ana tjetër, për shkak të karakterit të hapur të saj ndaj ekonomive të vendeve të tjera. Deficiti i Shteteve të Bashkuara me Kinën në vitin 2005 vlerësohej të ishte 190 miliardë dollarë. Kjo, e shprehur me një gjuhë të thjeshtë, do të thotë se për të balancuar tregtinë e vendit të vet me Kinën, çdo qytetari amerikan i duhet të kursejë 25 dollarë për çdo 1,000 dollarë që ai shpenzon (Gottesman 2006: 39). Allen Sinai dhe Philip Merrill venë në dukje se një ekonomi shumë e zhvilluar dhe dinamike si ajo e Shteteve të Bashkuara, e cila rritet më shumë dhe më shpejt se deficiti tregtar (apo ai buxhetor), mund t'i financojë këto deficite pa ndonjë vështirësi të madhe (Sinai & Merrill 2005: 62, 63; Baker 2006). Edhe pse vlera e dollarit amerikan sot ka rënë ndjeshëm në krahasim me pesë vjet më parë, kjo nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë amerikane (ibid.: 64). Madje, siç shprehet Bremmer (2005: 133), "nëse ndodh që një ditë të caktuar të javës situata financiare në Wall Street të mos jetë e mirë, po atë ditë situata nuk do të jetë e mirë as në Shanghai".

► “Ruga ekonomike” e Kinës si fuqi globale: Një version kinez i “Doktrinës Monroe” në Azinë Lindore?

Le ta shohim problemin në një kontekst global. Çdo të ndodhë sikur konsumatorët amerikanë, nisur nga "motive patriotike" (si ato që i shtynë shumë prej tyre në vitin 2003 të bojkotonin importin e verërave franceze), të pushonin së blieri mallra dhe shërbime të prodhua rastitë Amerikës për të zvogëluar, apo eliminuar, deficitin tregtar të vendit të tyre? Të parët që do ta ndjenin pasojën e një veprimi të tillë do të ishin vendet eksportuese me një bilanc tregtar pozitiv, në radhë të parë Kina, pastaj Meksika, Brazili dhe Malajzia, ekonomitë e të cilave do të humbitin në tregun amerikan një kërkësë në vlerën 650 miliardë dollarë. Nëse do të flisnim vetëm për Kinën, dinamizmi ekonomik dhe social i së cilës sot kushtëzohet në një masë të madhe nga ndërvarësia e saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës⁶ (Mahbudani 2005a: 50), mund të themi se nga balancimi i tregtisë së Shteteve të Bashkuara me të Kina do të humbiste 190

6 SHBA është tregu më i madh për eksportet kinez pas Bashkimit Europian (Randt 2005: 25).

miliardë dollarë, vlerë kjo e barabartë afersisht me 13.8 përqind të GDP-së saj. Kjo, përvetë të tjerash, është arsyja që shpjegon përsë, siç shprehet Mahbudani, "sot, vetëm një vend mund të ofrojë lidershipin e duhur për ta integruar, modernizuar dhe përmbytjor Kinën. Dhe ky vend është Shtetet e Bashkuara" (2005a: 60). Një tjetër aspekt i rëndësishëm për të vlerësuar zhvillimet e ardhshme të Kinës në raport me Shtetet e Bashkuara është të krahasojmë investimet e drejtpërdrejta të këtyre dy vendeve në ekonomitë e vendeve të tjera. Edhe pse që nga fundi i viteve 1970-të, kur Ten Hsiaopin u hapi rrugë investimeve kapitale të huaja në Kinë me thënien e tij të famshme se "nuk ka rëndësi nëse macja është e zezë apo e bardhë sa kohë që ajo zë minj" Kina ka mundur të tërheqë investime kapitale të huaja në një masë të jashtëzakonshme, vlera e përgjithshme e vetë investimeve të drejtpërdrejta kineze në tregjet e huaja në fund të vitit 2004 ishte vetëm 40 miliardë dollarë. Kjo shifër është më e vogël se vlera e tregut vetëm të njëjës prej kompanive më të mëdha amerikane, siç është Home Depot. Krahasuar me vlerën e investimeve të drejtpërdrejta amerikane në ekonominë globale, e cila në fund të vitit 2004 ishte më shumë se 2 triliardë, Kina investon kapitalet e saj në tregjet e huaja në një masë 50 herë më të vogël se Shtetet e Bashkuara. Vetëm 20 përqind e investimeve të drejtpërdrejta të saj janë bërë në Amerikë dhe në Europë të marra së bashku. Nuk ka dyshim se Kina do të jetë një fuqi e madhe ekonomike, politike dhe ushtarakë në shekullin e 21-të. Sidoqoftë, në dallim nga shumë autorë, të cilët besojnë se shndërrimi i Kinës në një fuqi të madhe do të shoqërohet me militarizimin e politikës dhe të ekonomisë së saj duke u bërë një kërcënim përfqenden dhe sigurinë në rajonin e Azisë dhe të Pacifikut, madje duke kërkuar të bëhet një kundërpeshë ushtarakë dhe politike ndaj superfuqisë së vetme amerikane, unë mendoj se Kina do të synojë të realizojë aspiratat e saj duke ndjekur një "rrugë ekonomike", paqësore. Në kohën tonë, përfqenden fituar statusin e një fuqie të madhe nuk është e domosdoshme të bësh luftë dhe të pushtosh territorë të reja. Zhvillimi i tregtisë dhe integrimi ekonomik janë një rrugë më e sigurt përfqenden e kësaj aspirate, e cila nuk është një aspiratë vetëm e Kinës. Përlidershipin e sotëm kinez, i cili, përfqenden të së vërtetës duhet thënë se është lidershipi më i

mirë që Kina ka pasur për gjenerata me radhë, shembulli i rimëkëmbjes ekonomike dhe politikë të Japonisë dhe Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore përbën një filozofi më të urtë se sa etika konfuciane apo filozofia e konfrontimit të hapur politik dhe ushtarak. Duke iu përbajtur një filozofie të tillë dhe me përkrahjen e Shteteve të Bashkuara, në vitin 2001 Kina mundi të anëtarësohet në Organizatën Botërore të Tregtisë (World Trade Organization), gjë që e lehtësoi dhe e shpejtoi mjaft integrimin e saj në sistemin tregtar botëror duke i kontribuar në mënyrë substanciale tritjes ekonomike të saj. Anëtarësimi në OBT e shndërroi Kinën nga një aktor me një peshë të vogël në tregtinë ndërkombëtare 25 vjet më parë, apo me një peshë të mesme 10 vjet më parë, në një ndër aktorët kryesorë sot. Tabela 3 dëshmon se ekonomia kineze është bërë sot pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e ekonomisë globale dhe se Kina ka sot një ndër ekonomitë më të hapura në botë, duke u renditur e treta (pas Shteteve të Bashkuara dhe Gjermanisë) përvillimin e tregtisë, i matur si shuma e eksporteve dhe importeve të saj. Kina ka 20 përqind të popullsisë së botës por disponon vetëm 1.8 përqind të rezervave të saj të naftës, çka e detyron atë të importojë më shumë se gjysmën e sasisë së naftës që konsumohet në këtë vend çdo ditë. Në vitin 2004, një e treta e rritjes së sasisë së naftës së konsumuar në shkallë botërore kishte si shkak rritjen e nevojave të Kinës për naftë (Bremmer 2005: 131). Me ritmet galopante të zhvillimit të saj ekonomik, me një të pestën e popullsisë së botës dhe me një klasë të mesme disa qindra milionëshe, Kina është bërë (qysh nga viti 2004) konsumatorja e dyte më e madhe në botë e naftës dhe e nënproukteve të saj (pas Shteteve të Bashkuara).

Tabela 3: Vendet kryesore në tregtinë e sotme botërore dhe % e të ardhurave nga tregtia në GDP-në e tyre, 2006

Vendi	Tregtia (US\$ miliard)	Tregti/GDP (përqindje)
SHBA	\$ 2.958	22.3%
Gjermania	2.045	70.6
Kina	1.761	67.0
Japonia	1.230	28.2
Franca	1.021	45.7
Holanda	758	114.2
Kanadaja	747	58.9

Belgjika	723	183.7
Hong Kongu	651	343.7

Burimet: Barth & Caprio, 2007: 30

Kina është e uritur për energji dhe po përpinqet me çdo kusht dhe me çdo çmim ta sigurojë atë nga çdo burim i mundur nga Sudani dhe Çadi, nga Venezuela dhe Rusia, nga Arabia Saudite dhe Irani, nga Egjipti dhe Indonezia, nga Angola dhe Oman, nga Nigeria dhe Azerbajxhani, nga Kanadaja dhe madje nga vetë Shtetet e Bashkuara, siç dëshmojnë përpjekjet e saj në vitin 2005 për të blerë kompaninë amerikane të naftës Unocal⁷. Ekonomistët perëndimore llogarisin se deri në vitin 2020 nevojat e Kinës për naftë do të rriten, në vlerë absolute, pothuajse po aq sa nevojat e Shteteve të Bashkuara (Long 2005). Kjo do të thorë se ndërsa në vitin 2005 Kina importonte mbi 40 përqind të naftës (2.5 milionë fuçi nafte në ditë) për nevojat e ekonomisë së saj, në vitin 2025 ajo do të importojë 80 përqind të naftës për të cilën do të ketë nevojë një ekonomi shumë më e zhvilluar se kjo që ka Kina sot, çka do të thotë 9.5 deri në 15 milionë fuçi nafte në ditë (USDD 2007: 8). Përpjekjet agresive të Kinës për të siguruar burime energetike nga çdo anë bëhen në kushtet kur nevojat për konsum të energjisë (naftës dhe gazit) në shkallë botërore janë rritur dhe pritet të rriten në nivele të panjohura më parë. Sipas Administratës për Informacion mbi Enerjinë (EIA Energy Information Administration), e cila është pjesë e Departamentit të Energjisë të Shteteve të Bashkuara, deri në vitin 2025 nevojat për konsum të energjisë në shkallë globale pritet të rriten në masën 57 përqind, ndërkohë që rritja më e madhe e konsumit të energjisë do të ndodhë

në ekonomitë e reja të Azisë kryesisht në Kinë dhe Indi për shkak se rritja e shpejtë ekonomike në këta vende nxit nevojat e tyre për energji (shih Gaffney 2006: 90). Qysh sot, për shembull,

7 Në qershor të vitit 2005, kompania shtetërore kineze e naftës CNOOC (China National Offshore Oil Corporation), vlera e përgjithshme e së cilës në treg është 22 miliardë dollarë, ofroi ta blejë kompaninë amerikane të naftës Unocal (Union Oil Company of California) për një çmim 18.5 miliard dollarë. Shitja e kësaj kompanie private amerikane një korporate shtetërore kineze u kundërshtua me një shumicë dëtrivuese votash nga Dhoma e Përfaqësuesve e Kongresit amerikan si një çështje që cenonte interesat kombëtare të Shteteve të Bashkuara. Në gusht të atij viti, Unocal u ble nga korporata amerikane e naftës Chevron.

Kina dhe India kanë secila një klasë të mesme pothuajse të barabartë në numër me popullsinë e Shteteve të Bashkuara. Kjo ka bërë, ndër të tjera, që tregu kinez për automobila privatë të jetë sot më i madh se tregjet e Gjermanisë dhe Francës të marrë së bashku dhe, brenda vitit 2010, ky treg do të jetë dy herë më i madh se sot. Po në vitin 2010, tregu i Indisë për automobila privatë do jetë më i madh se tregjet e Gjermanisë dhe Francës të marrë së bashku (see Walker 2006). Kina, natyrisht, i ka të freskëta mësimet e historisë nga shekulli i 20-të lidhur me pasigurinë e burimeve energetike. Prerja nga ana e Shteteve të Bashkuara e burimeve të naftës për Japoninë dhe etja e kësaj të fundit për naftë të importuar ishte motivi kryesor që e shtyu Japoninë të sulmonte bazën amerikane në Pearl Harbor në dhjetor 1941. Fatmirësisht, Kina sot as mundet dhe as kërkon (të paktën edhe për një periudhë kohe) të ndjekë shembullin e Japonisë militariste kur kjo e fundit, më shumë se 60 vjet më parë, pushtoi me forcë rajonet naftëmbajtëse dhe të pasura me burime të tjera natyrore në Azinë Lindore. Edhe pse gjatë dekadave të fundit Kina nuk është përzier asnijëherë në debate apo konflikte ndërkombëtarë, të cilët nuk kanë pasur të bëjnë direkt me rreziqe ndaj interesave të saj kombëtare,⁸ rritja e jashtëzakonshme e nevojave të saj për energji ka bërë që Pekini të angazhohet sot energjetikisht në rajone politikisht të trazuar dhe të rreziqshëm, në të cilët Shtetet e Bashkuara mund të thuhet se kanë pasur monopolin e influencës ndërkombëtare qysh nga mbarimi i Luftës së Ftohtë në Afrikë, në Lindjen e Mesme dhe në Amerikën Latine. Kjo është një dukuri e re në marrëdhëniet ndërkombëtare në dekadën e parë të shekullit të 21-të, e cila mund të sjellë konsekuenca serioze në marrëdhëniet e Kinës me Shtetet e Bashkuara. Sepse zgjerimi i influencës kineze në të gjithë këta rajone nuk mund të bëhet pa i "rënë në qafë" Amerikës dhe pa u konfrontuar me interesat dhe influencën e saj. Fjala vjen, përpjekjet e Kinës për të investuar

8. Këtë tipar të politikës së jashtme kineze Fareed Zakaria e sintezizon me këto fjalë: "Për një kohë të gjatë Kina i ka vlerësuar marrëdhëniet e mira me Amerikën si një faktor themelor për zhvillimin e saj, pjesërisht edhe për shkak se ajo kërkonte të hynte në tregun më të madh të botës dhe në vendin me teknologjinë më të avancuar. Në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Kina ka votuar zakonisht në favor, ose ka abstenuar duke mos venë veton për rezolutat e sponsorizuara nga Uashingtoni....Kjo politikë e mosndërhyrjes dhe e moskonfrontimit në përgjithësi vazhdon. Me përashtim të çdo gjëje që lidhet me Tajvanin, Pekini tenton të evitojë konfrontime me qeveritë e vendeve të tjerë (Zakaria 2008: 105).

në rërat bituminoze në Alberta të Kanadasë, nënshkrimi prej saj i një marrëveshjeje me Karakasin për të bërë kërkime në 15 fusha naftëmbajtëse në pjesën lindore të Venezuelës dhe mundësia për të ndërtuar rafineritë e saj në këtë vend, nënshkrimi prej Kinës i një marrëveshjeje të ngashme me Argjentinën për eksplorimin e burimeve energetike të këtij vendi si edhe disa marrëveshje tregtare me Brazilin, Kilin dhe vende të tjera të Amerikës Latine, pra në një rajon të gjerë, i cili qysh nga krijimi i "Doktrinës Monroe" më 1823 konsiderohet sferë e influencës amerikane, kanë krijuar shqetësime serioze në Uashington dhe rritjen e presioneve politike të tij ndaj qeverisë kineze. Kjo strategji e re kineze, përvèç rrezikut të konfrontimit të Kinës me Shtetet e Bashkuara, ka gjithashtu një kosto të lartë politike për shkak të pozicionit kundërshtues që mban sot Pekini ndaj qëndrimeve dhe përpjekjeve të Uashingtonit dhe të komunitetit ndërkombëtar për një sërë çështjesh të rëndësishme të kohës sonë. Për shembull, marrëveshja e Kinës me Teheranin për çështje të energjisë ka bërë që Kina të kundërshtojë çdo përpjekje të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për të vendosur sanksione ndaj Iranit. Për shkak se Kina ka nevojë për naftën e Iranit, ajo ka zëvendësuar tani Rusinë si pengesa kryesore për të ushtruar një presion efektiv shumëpalësh ndaj regjimit të Teheranit lidhur me ambiciet e tij nukleare si edhe për të ndaluar sponsorizimin nga ana e tij të grupeve terroriste në Palestinë dhe Liban. Përkështu, interesat dhe prania e Kinës në Sudan,⁹ prej nga ajo importon sasi të mëdha nafte, i kanë komplikuar përpjekjet e Uashingtonit dhe të Kombeve të Bashkuara për t'i dhënë fund gjenocidit të sponsorizuar nga shteti sudanez në Darfur.¹⁰ Kina ka mundur të influencojë vendimet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së në atë mënyrë që duke mos kundërshtuar dërgimin e forcave paqeruajtëse në Darfur të pengojë vendosjen e sanksioneve ekonomike ndaj Sudanit, të cilat do vështirësonin apo ndërprisin

9. Që nga vitin 1999 Kina ka investuar mbi 3 miliardë dollarë në fushat naftëmbajtëse të Sudanit. Ajo ka mbi 6000 ushtarë në këtë vend, të cilët mbrojnë interesat kineze dhe garantojnë sigurinë e transportit të naftës nga fushat naftëmbajtëse (krysish shtetit në Darfur) në portet sudaneze, prej nga ajo eksportohet në Kinë. (Zakaria 2006; 2008: 118).

10. Darfuri ndodhet në një zonjë të pasur naftëmbajtëse, në të cilën Korporata Kombëtare kineze e Naftës ka koncensionet më të mëdha dhe prej nga kompanitë kineze blejnë 65 përqind të naftës që eksportohet.

shfrytëzimin prej saj të naftës së këtij vendi. Politologu Robert Gilpin vinte në dukje afro tre dekada më parë se kur fuqia e një shteti rritet, ai “do të tentojë të përpinqet të rrissë kontrollin e tij mbi mjedisin që e trethon. Në mënyrë që të rrissë sigurinë e vet, ai do të përpinqet të zgjerojë kontrollin e tij politik, ekonomik dhe territorial dhe do të përpinqet të ndryshojë sistemin ndërkombëtar në përputhje me interesat e tij të veçanta” (Gilpin 1981: 94-95). Nuk ka dyshim se si vendi më i populluar i globit dhe me një ndër ekonomitë më të mëdha dhe më dinamike në botë, Kina po përpinqet dhe do të vazhdojë të përpinqet të zgjerojë interesat e saj, rrjedhimisht edhe influencën e saj, në rajonin rrëth saj dhe në botë. Ka autorë, të cilët mendojnë se gjatë viteve të fundit Pekini po përpinqet të hedhë bazat e një versioni kinez të “Doktrinës Monroe” në Azinë Lindore, duke synuar, siç shprehet John Mearsheimer, t’i “nxjerrë Shtetet e Bashkuara jashtë Azisë, pothuaj njëlljoj siç bënë Shtetet e Bashkuara kur nxorrën jashtë Hemisferës Perëndimore fuqitë e mëdha të Europës” (shih Brzezinski & Mearsheimer 2005). Angazhimi ushtarak i Shteteve të Bashkuara në Afganistan dhe sidomos në Irak gjatë viteve të fundit i kanë dhënë Kinës një shans ideal dhe kohën e nevojshme për të vepruar “pa u ndjerë” në dobi të zgjerimit të influencës politike dhe ekspansionit ekonomik të saj në Azinë Lindore. Këtij objektivi të politikës së jashtme kinezë i ka ndihmuar edhe reputacioni pozitiv i saj pas krizës financiare të Azisë në vitet 1997-1998, e cila nuk pati pothuajse asnjë ndikim në ekonominë kinezë, si edhe afro tre dekada të suksesshme të një rritjeje ekonomike galopante. Edhe pse Kina nuk del përgjithësisht hapur kundër interesave të Shteteve të Bashkuara në arenën ndërkombëtare kur është fjala për qëndrime të caktuara të Uashingtonit, me të cilat Pekini nuk është dakord, udhëheqësit kinezë përpinqen të bëjnë ç'është e mundur për të minimizuar rolin e Shteteve të Bashkuara apo për ta “përashtuar” atë nga rajoni i Azisë Lindore, të cilin Kina synon ta bëjë ekskluzivisht zonë të influencës së saj. Sidoqoftë, sot dhe për një kohë të gjatë, Kina nuk është e interesuar dhe nuk ka të ngjarë të konfrontohet ushtarakisht as me Amerikën as me fuqi të tjera që kanë interesa vitale në atë rajon. Në nivel strategjik, sot dhe në një të ardhme jo të afërt, Kinës i mungojnë dhe do t’i mungojnë kapacitet ushtarake për t'u përballuar

me Shtetet e Bashkuara. Dhe nëse një vend nuk ka kapacitetet ushtarake për të arritur objektivat e tij politikë, çdo konfrontim ushtarak me një shtet më të fuqishëm, në këtë rast me Shtetet e Bashkuara (por edhe me Japoninë apo Indinë), do të ishte kundërproduktiv dhe në dëm të aspiratave të udhëheqjes së sotme kinezë. Është lehtësish e imaginueshme që, në rast të një konflikti të hapur ushtarak me Amerikën, Kina do të gjendej e izoluar nga një bllokadë detare prej saj dhe aleates më të ngushtë të Amerikës në rajon, Japonisë. Një bllokadë e tillë, siç thekson me të drejtë Zbigniew Brzezinski, do ta ndalonte tèresisht tregtinë kinezë me anë të detit, do ta ndërpriste importimin e naftës në brigjet e Kinës dhe do ta paralizonte tèresisht ekonominë e këtij vendi (Brzezinski & Mearsheimer 2005: 46). Kjo është arsyja që, sot për sot, Kina po ndjek një politikë të admirueshme pragmatike në marrëdhëniet e saj me Shtetet e Bashkuara, me Japoninë, Indinë dhe Rusinë, pavarësisht marrëdhënieve të saj shumë konfliktuale me këta vende në të kaluarën. Nëse Kina ka arritur gjatë këtyre 20-30 viteve të fundit një zhvillim kaq të madh, kjo ka ndodhur, ndër të tjera, edhe për shkak se ajo nuk është angazhuar gjatë kësaj periudhe në asnje luftë me Shtetet e Bashkuara apo me ndonjë prej fuqive të mëdha fqinjë të saj. Udhëheqja kinezë është në gjendje të kalkulojë se në rast se Kina angazhohet në një garë intensive armatimi apo në veprime ushtarake për hegemoni në rajon, ajo do t’i ketë kundër të gjithë fqinjët e saj Indinë, Japoninë, Australinë, Singaporin, Korenë e Jugut, Vietnamin, madje ndoshta edhe Rusinë të cilët do të radhiten përkrah Shteteve të Bashkuara në një përpjekje të përbashkët për ta penguar Kinën të realizojë synimet e saj. Shtetet e Bashkuara kanë krijuar një sërë aleancash formale dhe instrumentesh strategjikisht të rëndësishëm me vende të tillë si Australinë, Filipinet, Singaporin, Tailandën, Korenë e Jugut dhe, natyrisht, Japoninë për të ruajtur dhe forcuar sigurinë në rajonin e Azisë Lindore dhe në Paqësor, të cilat e bëjnë të vështirë realizimin e synimit të Kinës për të mënjanuar Amerikën nga ky rajon dhe për të vendosur hegemoninë e saj mbi të, edhe sikur këtë synim Kina të përpinqej ta arrinte përmes militarizimit të saj. Një ndër ekspertët më të njohur të politikës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në ditët tona, Fareed Zakaria, në librin e tij të fundit Bota post-amerikane

(The Post-American World), argumenton se: Shtetet e Bashkuara dinë se si ta përballojnë një avancim ushtarako-politik tradicional. Në fund të fundit, kjo ishte natyra e rrezikut sovjetik dhe e ardhjessë nazistëve në pushtet. Shtetete Bashkuara kanë si kornizën konceptuale ashtu edhe mjetet armë, paketa ndihmash, aleanca me të cilat të konfrontojnë avancime të tilla. Nëse Kina do të tregonte forcën e saj, do të nervozonte fqinjët e saj dhe do të ngallte panik në botë, Uashingtoni do të ishte në gjendje të përgjigjej me një varg politikash efektive duke shfrytëzuar proceset natyrore balancuese përmes të cilave Japonia, India, Australia dhe Vietnami dhe ndoshta vende të tjera do të bashkoheshin për të kufizuar fuqinë në ngritje të Kinës (Zakaria 2008: 127). Nuk duhet harruar, gjithashtu, se Kina ka pasur historikisht probleme dhe pretendime territoriale pothuajse ndaj të gjithë fqinjëve të saj. Lista e territoreve, të cilat Pekini ka pretenduar dhe pretendon se i takojnë Republikës Popullore të Kinës dhe të cilat duhet t'i rikthehen asaj, përfshin jo vetëm Tajvanin dhe një numër ishujsh në Detin e Verdhë, në Detin e Kinës Jugore dhe në Detin e Kinës Lindore, por edhe shumë rajone, të cilat janë bërë gati një shekull e gjysmë më parë pjesë integrale të territorit të Rusisë. Gjatë viteve 1960-te dhe 1970-te, periudhë kjo kur divergjencat midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik u bënë më të ashpra se kurrë, Kina protestoi shumë herë kundër padrejtësive që i ishin bërë asaj në të kaluarën. Më 1964 Mao Ce Duni ka dekluaruar se "rreth 100 vjet më parë, territoret në lindje të Liqenit Bajkal u bënë pjesë e territorit të Rusisë dhe që atëherë Vladivostoku, Kabarovski, Kamçatka dhe territore të tjera kanë qenë territore sovjetike", duke theksuar se një ditë Kina mund të paraqiste "listën me kërkesat e saj". Më 1973, gjatë një bisëde me Sekretarin amerikan të Shtetit Henry Kissinger, Kryetari Mao fare papritur i shprehu diplomatit të lartë amerikan pakënaqësinë e tij se "Bashkimi Sovjetik kishte rrëmbyer 1.5 milion kilometra katrorë nga Kina". Në vitet 1960-te dhe 1970-te e njëjtë Parti Komuniste që sot drejton Pekinin pretendonte si territore kineze rajone të tëra, të cilat sot janë pjesë e territoreve të Kazakistanit, Taxhikistanit dhe Kirgistanit (Terrill 2005: 58-59). Edhe pse gjatë viteve të fundit pretendime të tillë territoriale nuk kanë qenë pjesë e retorikës politike dhe diplomatike të Pekinit, askush nuk mund të thotë me siguri nëse një ditë Kina, më

e fuqishme dhe më e sigurt në vetvete se ç'është sot, dhe me një popullsi mbi 16 herë më të dendur se Rusia," nuk do t'i kërkojë Moskës kthimin e territoreve "të humbura" të saj. Sidoqoftë, ndërsa pretendimet territoriale të Kinës në kufirin verior të saj duken shumë të vështira të realizohen pa terezuar një konfrontim të hapur ushtarak me Rusinë, partneren e saj të sotme, në rastin e Tajvanit Pekini pret një moment oportun për ta rimarrë atë. Një moment i tillë i volitshëm për Kinën do të nënkuptonte në fakt kombinimin në një të vetëm të paktën të katër faktorëve, siç janë: (a) një politikë e brendshme e Taipenit në favor të Pekinit, (b) kapacitete më të mëdha kineze për transportimin e shpejtë të trupave dhe materialeve ushtarake përtej 100 miljeve të Kanalit të Tajvanit, (c) një Japoni më fleksible se ç'është sot ndaj aspiratave kineze dhe (d), çka është akoma më e rendësishme, "lodhjen" e Uashingtonit në mbështetje të Tajvanit. Asnjë prej këtyre faktorëve, sidoqoftë, nuk ekziston sot dhe nuk ka të ngjarë të krijohet për një periudhë relativisht të gjatë kohe. Sa për interesat dhe praninë e Shteteve të Bashkuara në Azinë Lindore dhe mbështetjen e Uashingtonit për Japoninë dhe Tajvanin, Zbigniew Brzezinski, më qartë se kushdo tjetër, ka argumentuar pikëpamjen se Kina e ka të pamundur ta "nxjerrë jashtë" Amerikën nga ky rajon për t'i marrë asaj statusin dhe rolin e fuqisë hegjemone. Në një pasazh të gjatë, të cilin e shoh me vend ta riprodhoj të plotë, Brzezinski shkruan: Si mundet Kina t'i nxjerrë Shtetet e Bashkuara jashtë nga Azia Lindore? Apo, më konkretisht, si mundet Kina ti nxjerrë Shtetet e Bashkuara jashtë Japonisë? Edhe sikur Shtetet e Bashkuara të nxirreshin në një farë mënyre nga Japonia apo të vendosnin të largoheshin vetë duke e lënë këtë [vend] në punën e vet, çdo të bënin japevezët? Japonia ka një program ushtarak impresiv dhe, brenda disa muajve, ajo mund të krijojë një kapacitet të konsiderueshëm bërthamor mbrojtës. Unë sinqerisht dyshoj nëse Kina do të mund t'i nxirre Shtetet e Bashkuara jashtë Azisë. Por edhe sikur të mundte, unë nuk mendoj se ajo do të donte të ndeshej me pasojat: një Japoni e fuqishme, nacionaliste dhe e armatosur me armë bërthamore. Natyrisht, 11 Sipas parashikimeve të OKB-së, në fund të shekullit të 21-të popullsi e Rusisë do të jetë reduktuar në 80 milion ndërsa Kina, me gjithë rënien demografike të saj, do vazhdojë të jetë mbi 1 miliard banorë.

tensionet mbi çështjen e Tajvanit përbëjnë rrezik strategjik edhe më shqetësues. Sidoqoftë, qdo strateg ushtarak kinez do të duhej të llogariste mundësinë që edhe nëse Kina do të mund ta merrete Tajvanin, Shtetet e Bashkuara do të bëheshin pjesë e konfliktit. Mundësia e kësaj ndërhyrjeje e bën thuajse të pavlefshëm qdo kalkulim politik që mund të justifikonte një veprim ushtarak deri kur dhe [vetëm] nëse Shtetet e Bashkuara s'do të ishin më në horizont. Por Shtetet e Bashkuara nuk do të largohen nga horizonti për një kohë të gjatë, shumë të gjatë (Brzezinski & Mearsheimer 2005: 50).

► Politika kineze e “buzëqeshjeve në shumë drejtime”

Edhe pse motivet dhe synimet e vërteta të politikës së jashtme të një vendi që del si një fuqi e madhe mund të mos jenë gjithmonë krejtësisht të qarta, unë mendoj se Kina synon të bëhet një fuqi e madhe kapitaliste dhe një hegemon rrajanal, por jo një fuqi e tipit të vjetër imperialist dhe merkantilist. Një analizë e vëmendshme e politikës së jashtme kineze evidenton se ajo synon, para së gjithash, të maksimalizojë stabilitetin e brendshëm në vend. Edhe pse këtë synim e kanë edhe shtete të tjerë, në rastin e Kinës ai merr një rëndësi parësore. Kontrolli mbi një popullsi që po i afrohet shifrës 1.4 miliard dhe mbi minoritetet e ndryshëm që popullojnë rajone të gjera të Kinës në provincat perëndimore dhe veriore të saj nuk ka qenë kurrë diçka e lehtë për shtetin kinez, as pas vitit 1949, kur pushteti ra në duart e Partisë Komuniste, as në 150 vitet e trazuara nga revolta të brendshme dhe presione nga jashtë, të cilat çuan në rënien e dinastisë Çing.¹² Udhëheqja kineze i ka të

freskëta ngjarjet dramatike të Sheshit Tienanmen më 1989 dhe bën shumë kujdes t'i mbajë nën kontroll tensionet social-politike në radhët e popullsisë.¹³ Në Raportin e tij mbi Kinën në vitin 2007 (Military Power of the People's Republic of China: A Report to Congress), paraqitur para Kongresit amerikan, Departamenti i Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara thekson se: në qendër të strategjisë së përgjithshme të Kinës është synimi për të ruajtur sundimin e vazhdueshëm të Partisë Komuniste Kineze (PKK). Frika e thellë se ajo mund të humbasë pushtetin politik përcaktion qëndrimin strategjik të udhëheqjes dhe shumë prej vendimeve të saj (USDD 2007: 6). Një tjetër synim i rëndësishëm i politikës së jashtme të Kinës është të garantojë ruajtjen e ritmeve të larta të rritjes ekonomike që ka arritur gjatë dy-tre dekadave të fundit, me çka udhëheqja e sotme kineze përpinqet të gjenerojë legitimitet për politikat e saj dhe të vazhdojë të qëndrojë në pushtet (Terril 2005: 54; Zhao 2005: 76). Duke qenë se ideologjia marksiste, si ideologji zyrtare e partisë-shtet në Kinë, ka humbur rolin e saj të dikurshëm dhe asnjë filozofi tjetër zyrtare nuk e ka zëvendësuar atë, bazat e legitimitetit të udhëheqjes së sotme kineze, e cila nuk është venë kurrë përballë konkurrencës së alternativave të tjera politike dhe testit të zgjedhjeve të lira demokratike, mbeten standardi i përmirësuar i jetesës dhe krenaria kombëtare. Sipas raportit të sipërpermendor të Departamentit amerikan të Mbrojtjes, “për të zëvendësuar dështimin e ideologjisë komuniste, PKK e ka mbështetur legitimitetin e saj në...arritjet ekonomike dhe nacionalizmin” (USDD 2007: 6). Raportet e udhëheqjes së sotme kineze me Marksin dhe teorinë marksiste, sidoqoftë, nuk mund të konsiderohen krejt të papërfillshme. Edhe pse në praktikë udhëheqësit e sotëm teknokratë të Kinës i kanë braktisur Marksin dhe Leninin, duke krijuar një ekonomi, së cilës në perëndim i referohen si “leninizëm i tregut”, verë thelli i teorisë sociale të Marksit ka dhe Grupe të caktuar të popullsisë që jetojnë në territorin e saj përbëjnë minoritete, lidhjet racore, fetare, gjuhësore dhe historike të të cilëve janë me popullsi të tjera jashtë territorit të Republikës Popullore të Kinës (Terril 2005: 52-53).

13 Gazeta Epoch Times e Nju Jorkut raportonte, në gusht të vitit 2005, se gjatë vitit 2004 në Kinë u numëruan 58,000 greva dhe protesta kundër qeverisë dhe se 3.2 milionë anëtarë të Partisë Komuniste u larguan prej radhëve të saj (Online source: <http://en.epochtimes.com/news/5-8-8/31043.html>).

s'mund të mos ketë implikime praktike për Kinën. Kjo teori parashikon se me ndryshimin e bazës ekonomike të shoqërisë në mënyrë të paevitueshme ndryshon edhe sistemi politik. Marksia argumentonte se kur një shoqëri orientohet nga tregudhë modernizohet, ajo tenton gjithashtu të demokratizohet. Historia dëshmon në mënyrë të qartë korrelacionin që ekziston midis ekonomisë së tregut dhe modernizimit të shoqërisë, nga njëra anë, dhe zhvillimit konsolidimit të demokracisë, nga ana tjetër, edhe pse kjo ndonjëherë kërkon kohë. Në se i lemë mënjanë vendet e pasura prodhuese të naftës, sot në tërë botën ka vetëm një vend Singapor i cili ka arritur një nivel perëndimor të zhvillimit ekonomik por akoma nuk është bërë plotësisht një demokraci funksionuese. Nëse u referohemi vendeve të tillë si Korea e Jugut, Tajvani, Spanja, Portugalia, Argjentina apo Turqia, tendenca historike ka qenë dhe mbetet e pagabueshme: sa më shumë që regjimet autokratikë kanë lejuar apo lejojnë modernizimin e ekonomive të tyre dhe sa më shumë që një ekonomi e mbështetur në tregun e lirë ka qenë apo është në gjendje të krijojë një shtresë popullsie, e cila për nga të ardhurat konsiderohet "klassë e mesme", aq më i sigurt ka qenë dhe është transformimi dhe konsolidimi i shoqërisë si një demokraci liberale. Kina, sado kohë të marrë transformimi politik i saj, nuk ka pse të jetë një përfashtrim nga ky rregull i përgjithshëm. Sidoqoftë, siç ve në dukje me të drejtë Fareed Zakaria, cilado që të jetë e ardhmja politike e Kinës, nuk ka të ngjarë që ngritja e saj si fuqi e madhe në skenën globale të pengohet apo prapësohet. Forcat që e nxisin ngritjen e saj nuk do të zhduken edhe sikur regjimi aktual [në Kinë] të përmbyset apo, siç ka më shumë të ngjarë, të përçahet në fraksione. Pas revolucionit të saj, Franca kaloi përmes dy shekujsh krizash politike, krijoj dy perandori, një diktaturë dhe katër republika. Sidoqoftë, përmes trazirash politike ajo lulëzoi ekonomikisht, duke mbetur një ndër vendet më të pasur në botë (Zakaria 2008: 103-104). Sot dhe për një të ardhme të parashikueshme, Kina as është e interesuar dhe as mundet realisht të sfidojë supremacinë ushtarake të Shteteve të Bashkuara. Për këtë arsy, fokus i saj është dhe do të mbetet zhvillimi dinamik i ekonomisë. Ndoshta ajo që synon realisht Pekini është krijimi i një ekonomie po aq të fuqishme apo më të fuqishme se ekonomia e Shteteve të Bashkuara, në mënyrë

që kjo t'i shërbejë Kinës për t'u bërë një fuqi ushtarake si edhe për të projektuar influencën e saj në çdo rajon të globit, duke rivalizuar si e barabartë me superfuqinë amerikane. Sot për sot, sidoqoftë, një politikë e jashtme konfliktuale pa dyshim që do ta ndërpriste zhvillimin me ritmet aktuale të ekonomisë kineze, do të dëmtonte rreth 400 milionë njerëz në Kinë, të cilët zhvillimi ekonomik i saj i ka nxjerrë nga varfëria gjatë 20-30 viteve të fundit dhe do të rrezikonte vetë pozitën sunduese të Partisë Komuniste të Kinës në pushtet. Udhëheqja e sotme kineze duket se është e ndërgjegjshme si për rritjen ekonomike të Kinës dhe forcimin e rolit të saj në rajon dhe në botë, ashtu edhe për rreziqet që mund të sjellë për të një politikë e jashtme joracionale dhe konfliktuale. Politika e jashtme e Kinës synon, gjithashtu, të ruajë një mjedis paqësor në situatën e komplikuar gjeopolitike në rajonin rreth saj.¹⁴ Për meritë të Kinës dhe në të mirë të Azisë, duke filluar nga vitet 1980-të Pekini ka adoptuar një politikë të jashtme të re, e ashtuquajtur politikë e "buzëqeshjeve në shumë drejtime", apo e njohur ndryshe si "politikë e paqes dhe e pavarësisë". Duke mos hyrë në luftë me asnjë vend qysh nga viti 1979, Kina i ka zbutur shumë marrëdhëniet e saj me Rusinë dhe ka filluar të bashkëpunojë me të, ka përmirësuar ndjeshëm marrëdhëniet e saj me Indonezinë, ka njohur Korenë e Jugut dhe, në marrëveshje me Moskën, ka krijuar një rol për veten e saj në Azinë Qendrore. Për shkak të kësaj politike paqësore, Kina është anëtarësuar në një varg organizatash ndërkombëtare. Ajo është bërë anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së afro 40 vjet më parë, është pranuar në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe ka krijuar marrëdhëniet më të ngushta tregtare me Shtetet e Bashkuara se në çdo periudhë tjetër të historisë së saj. Mjafton të përmendim se ndërsa në vitin 1985 shkëmbimet tregtare midis Amerikës dhe Kinës llogariteshin në vlerën 7.7 miliardë dollarë, dhjetë vjet vonë, në vitin 1995, kjo vlerë u trit

¹⁴ Kina ndan kufirin e saj me 14 shtete fqinjë. Në tridhjetë vitet e para të ekzistencës së saj Republika Popullore e Kinës hyri disa herë në luftë me fqinjët e saj. Në Luftën e Koresë ajo humbi rreth një milion njerëz, ndërsa më 1959 dhe 1962 ajo hyri në luftë me Indinë. Kina dërgoi 320.000 trupa që të ndihmonin Ho Shi Minin për të fituar luftën në Vietnam. Më 1969 trupat kineze dhe ato sovjetike u ndeshën në veri-lindje të Kinës, në lumenjtë Amur dhe Usur, ndërsa më 1979 Kina sulmoi Vietnamin për t'i "dhënë Hanoiit një mësim".

në 57.3 miliardë dollarë, kurse në vitin 2005 në 231.4 miliardë dollarë (Mahbubani 2005b: 62). Nga sa vumë në dukje më sipër, mund të konkludojmë se në politikën e saj të jashtme Kina vazhdon t'i përbahet filozofisë pragmatiste të Ten Hsjaopinit, të formuluar në vitin 1991 dhe të njojur si strategjia "Karakter 24", e cila sugjeron një dëshirë për t'i përbajtur ambicjet e saj për një periudhë kohe, duke i dhënë përparrësi synimit afatgjatë të Kinës për të maksimalizuar opsonet e saj për të ardhmen.¹⁵ Siç e konceptojnë atë në Uashington, politika e jashtme kineze synon që dy dekadat e para të shekullit të 21-të të janë: një periudhë 20-vjeçare oportunitetesh, me çka [në Pekin] kuptohet se kushtet rajonale dhe ndërkombëtare do të janë përgjithësisht paqësore dhe inkurajuese për zhvillimet ekonomike, diplomatike dhe ushtarake dhe, për këtë arsy, edhe për ngritjen e Kinës si një fuqi e madhe (USDD 2007: 7). Siç vumë në dukje më sipër, deri më sot udhëheqja kineze është përpjekur të evitojë çdo konfrontim të hapur me Shtetet e Bashkuara apo me fuqi të tjera perëndimore, ndërsa mungesa e një lideri karizmatik si Mao Ce Duni apo Ten Hsjaopini, apo e një lideri pathologjikisht ambicioz, i ka ndihmuar drejtuesit e sotëm pragmatistë të Pekinit ta orientojnë Kinën në një kurs racional përsë i përket marrëdhënieve të saj ekonomike dhe politike me vendet e tjerë, pasojat e të cilët mund të parashikohen (Zhao 2005: 82; Sinai & Merrill 2005: 61). Në dallim nga 30 vitet e parë pas themelimit të Republikës Popullore të Kinës (1949-1979), Pekini sot duket se nuk ka armiq (edhe pse ka disa shtete rivalë) dhe udhëheqja kineze bën kujdes të ruajë këtë status quo.

Përfundim

Si një fuqi e madhe e re që po ngrihet, marrëdhëni e Kinës me çdo fuqi tjetër të madhe kanë rëndësi për zhvillimet e sotme dhe të ardhme në rajonin e Azisë dhe në botë. Por marrëdhëni e Kinës me asnjëren prej fuqive të mëdha nuk kanë atë rëndësi për të sotmen dhe të ardhmen e globit që kanë marrëdhëni e saj me

15 Në gjuhën e Ten Hsjaopinit, kjo strategji është formuluar kështu: "Vëzhgo me qetësi, siguro pozitën tënde, përballoi çështjet me qetësi, mos i ekspozo kapacitetet e tua dhe prit kohën tënde, mbaj një profil të ulët dhe kurri me pretendon leadership". Më vonë, këtij formulimi iu shtuan edhe fjalët "jep një kontribut" (See USDD 2007: 7).

Shtetet e Bashkuara. Po të shprehem i me fjalë të tjera, mund të themi se asnjë nga problemet me të cilat potencialisht ndeshet apo do të ndeshet Kina ka vërtet rëndësi nëse këta probleme nuk implikojnë Amerikën apo nuk cenojnë interesat e saj. Historikisht, ngritja e një fuqie të madhe në skenën botërore në kurriz të fuqisë dominuese ka çuar pothuajse gjithnjë në luftë midis tyre, luftë në të cilën, si rregull, janë përfshirë (në njërin apo tjetrin krah) edhe fuqitë e tjera të mëdha. A do të thotë kjo përvojë historike se ngjyra e Kinës në skenën botërore si një fuqi e madhe do të jetë domosdo e dhunshme dhe se e ardhmja e marrëdhënieve kino-amerikane është në mënyrë të paevitueshme lufta? Nuk ka dyshim se fuqizimi i mëtejshëm ekonomik dhe ushtarak i Kinës si edhe zgjerimi i influencës së saj në Azinë Lindore dhe në rajone të tjerë të globit natyrshëm do të krijojnë konflikte dhe antagonizëm midis Pekinit dhe Uashingtonit, madje edhe do të nxisin një garë armatimesh midis tyre. Historia, sidoqoftë, nuk njeh deri më sot asnjë rast që fuqi dominuese të kenë hequr dorë vullnetarisht nga pozita e tyre për t'ia lenë vendin një fuqie të re që kërkon të dominojë. Nuk ka asnjë arsy që besojmë se Amerika, fuqia e vetme hegjemonie në kohën tonë, do të veprojë ndryshe. Edhe pse asnjëra palë nuk e pohon publikisht, logjika të thotë se si Kina ashtu edhe Amerika përgatiten për kohë më të turbullta dhe më të rrezikshme që mund të vijnë më vonë. Lufta midis këtyre dy fuqive nuk mund të përashtohet në mënyrë absolute pasi njëra qeveri ose qeveritë e të dy vendeve mundet të bëjnë një hap të gabuar, fjala vjen, lidhur me çështjen e Tajvanit. Aktualisht dhe për një të ardhme të parashikueshme, përvëç çështjes së Tajvanit unë nuk shoh ndonjë arsy tjetër përse Kina dhe Shtetet e Bashkuara do të duhej t'i shpallnin luftë njëra-tjetrës, aq më tepër kur për një varg çështjesh të shumë rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen e sigurisë në rajonin e Azisë, Pekini dhe Uashingtoni në përgjithësi pajtohen me njëri-tjetrin edhe, nëse nuk bien dakord mbi mënyrën e trajtimit apo priorititet e tyre. Robert Art identifikon gjashtë interesa kryesore të Shteteve të Bashkuara në rajonin e Azisë Lindore, të cilat janë njëkohësisht edhe interesa të Kinës dhe për të cilat Pekini dhe Uashingtoni në përgjithësi pajtohen. Këto janë: (1) siguria reciproke kino-amerikane për mosshkatërrimin e njëra-tjetrës, (2) ruajtja e stabilitetit në Kanalin

e Tajvanit dhe zgjidhja paqësore e çështjes së këtij ishulli, (3) çarmatimi bërthamor dhe bashkimi përfundimtar i gadishullit korean, (4) ruajtja e aleancës SHBA-Japoni dhe e statusit të Japonisë si një fuqi jobërthamore, (5) zgjidhja paqësore e divergjencave të Kinës me fqinjët e saj lidhur me një varg ishujsh në ujërat rrithet saj dhe ruajtja e lirisë së lundrimt tregtar në Detin e Kinës Jugore dhe (6) ruajtja e sistemit të një ekonomie të hapur në Azinë Lindore. Edhe pse mosmarrëveshjet midis Pekinit dhe Uashingtonit lidhur me mënyrat se si mund të realizohen këto interesa të përbashkëta nuk janë të pakta dhe të parëndësishme, ato janë më të menaxhueshme se ç'do të ishin kontradiktat lidhur me qëllimet e njërs apo tjetrës fuqi (Art 2007: 36). Sidoqoftë, një lufte e nisur për shkak të kalkulimeve të gabuara është gjithnjë e mundshme edhe nëse kostoja e saj do të ishte shumë e madhe. Megjithatë, as Kina as Amerika nuk do të dëshironin të konfrontoheshin ushtarakesh. Kjo i bën si Pekinin ashtu edhe Uashingtonin të jenë shumë të kujdeshëm në marrëdhëni e tyre me njeri-tjetrin. Por, nëse një konfrontim ushtarak midis këtyre dy fuqive do të bëhej i pashmangshëm, ajo që do të dilte e humbur prej tij dhe do të pësonte disfatë të plotë si Japonia dhe Gjermania më 1945 do të ishte, pa më të voglin dyshim, Kina. Historia e shekullit të 20-të ka njojur katër përplasje të mëdha midis një fuqie të madhe që ngrihej dhe fuqisë dominante të kohës Gjermania kundër Britanisë para Luftës së Parë Botërore, përsëri Gjermania kundër Britanisë para Luftës së Dytë Botërore, Japonia kundër Shteteve të Bashkuara para Luftës së Dytë Botërore dhe Bashkimi Sovjetik kundër Shteteve të Bashkuara gjatë Luftës së Ftohtë. Çdo analogji me ndonjërin prej episodeve historikë të sipërpërmendur që mund të bëhej përsa u përket marrëdhënieve kino-amerikane sot do të ishte e gabuar. Kina nuk përbën sot për sigurinë e Amerikës të njëtin kërcënim apo rrezik gjeopolitik që përbente Gjermania për Britaninë para dhe gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, apo Japonia për Amerikën para Luftës së Dytë Botërore, apo Bashkimi Sovjetik për Amerikën gjatë Luftës së Ftohtë. Për Britaninë, fjala vjen, rreziku gjerman ishte i qartë: Nëse Gjermania do të pushton kontinentin dhe do të kontrollonte dhe shfrytëzonte burimet ekonomike dhe industriale të tij, ajo do të ndërtonte një makinë të fuqishme

ushtarake me anë të së cilës do ta mposhtte Britaninë. Kina në asnjë mënyrë nuk mund ta bëjë dot këtë ndaj Shteteve të Bashkuara. Për të sulmuar Amerikën Kinës do i duhej që më parë të kapërcente Oqeanin Paqësor, gjë që arsenali i armëve bërthamore të Shteteve të Bashkuara do ta bënte të pamundur. Qoftë edhe vetëm ky arsenal bërthamor që posedon Amerika e siguron dhe e mbrojnë këtë vend nga një Kinë e fuqishme në një mënyrë që Britania kurrë nuk mund të sigurohej nga hegemonia gjermane. Kina gjithashtu posedon armë bërthamore, por, mendoni për një çast sa të pabarabartë janë këta dy shtete në pikëpamje të potencialeve ushtarakë: Edhe pse gjatë viteve të fundit Kina e ka rritur buxhetin e saj të mbrojtjes me mbi 10 përqind çdo vit, ajo shpenzon për qëllime ushtarake vetëm 10 përqind të buxhetit vjetor të Pentagonit. Shtetet e Bashkuara kanë 12 aeroplan-mbajtëse prej nga mund të lançojnë sulme bërthamore, ndërsa inxhinierët kinezë akoma nuk kanë prodhuar dot një anije të tillë. Kina, sipas vlerësimeve të Pentagonit, ka 20 predha me mbushje bërthamore, të cilat mund të mbërrijnë në brigjet e Amerikës, por ky arsenal bërthamor është vulnerabël përballë kapacitetit të Amerikës për një sulm bërthamor "parandalues" (pre-emptive strike) ndaj Kinës. Krahasuar me këtë arsenal të vogël kinez, Shtetet e Bashkuara kanë rrith 9 mijë predha me mbushje bërthamore, prej të cilave rrith 5 mijë predha strategjike (shih Zakaria 2008: 126). Edhe vetëm këto të dhëna mjaftojnë për të thënë se "dragoi" kinez nuk mund ta mposhtë dot me anë të forcës "shqiponjën" amerikane dhe se çdo aventurë ushtarake do të ishte një vetëvrasje kombëtare për Kinën. A nuk ishte një vetëvrasje e tillë aventura japoneze kundër Amerikës në Pearl Harbor? Por le ta lemë "rrezikun e luftës" dhe të kthehem përsëri tek "armët" e preferuara të Kinës, zhvillimi ekonomik dhe tregtia e saj. A janë në të vërtetë këto armët, të cilat do ta mposhtin Amerikën dhe do ta bëjnë Kinën superfuqinë e shekullit të 21-të? Unë vendosmërisht them se jo. Sado paradoksale që të tingëlojë, zhvillimi ekonomik i Kinës është edhe në interes të Amerikës pasi kjo përfiton nga prosperiteti ekonomik i këtij gjigandi të Azisë dhe nga tregtia me të. Kjo shpjegon, ndërt të tjera, pse gjatë viteve të fundit Uashingtoni e ka inkurajuar pjesëmarrjen dhe rolin aktiv të Kinës në organizatat rajonale të Azisë Lindore si APEC (Asia-Pacific Economic

Cooperation) apo ASEAN (Association of Southeast Asian Nations) (USDD 2007: 2). Në vitet 2003-2004 Kina arriti të zërë vendin e Japonisë (dhe më pas të Meksikës) si tregu i dytë më i madh (pas Kanadasë) për importet e Shteteve të Bashkuara, duke u bërë, gjithashtu, tregu i katërt më i madh për eksportet amerikane (Sinai & Merrill 2005: 60). SHBA është e interesuar që Kina dhe vendet e tjera ekonomikisht në rritje të dalin nga prapambetja, duke stimuluar rritjen e kërkeseve për produkte dhe shërbime në tregjet e tyre, duke konsumuar më shumë dhe, rrjedhimisht, duke importuar më shumë nga Amerika. Siç vë në dukje Ian Bremmer, ekspert i politikës së jashtme amerikane në Institutin e Politikës Botërore (World Policy Institute) në Nju Jork, Kërkosat e Kinës janë stimuluesi më i rëndësishëm për rritjen e ekonomisë në shkallë globale, nga e cila varet prosperiteti i Amerikës...[ashtu si] tregu amerikan është jetik për vazhdimësinë e rritjes [ekonomike] të Kinës (Bremmer 2005: 133). Në analogji me këtë arsyetim, Philip Merrill argumenton se Shtetet e Bashkuara nuk do të ishin aspak më mirë sot nëse Gjermania, Japonia dhe vendet kryesore të Europës apo të Azisë do të ishin ekonomikisht në një gjendje si ajo në të cilën ata dolën nga Lufta e Dytë Botërore, apo nëse India dhe Kina do të mbeteshin vende të varfër. Përkundrazi, thekson ai, është në interesin e Shteteve të Bashkuara që këta vende të zhvillohen ekonomikisht dhe kjo shpjegohet kryesisht për shkak të tregtisë me to (Sinai & Merrill 2005: 58-59). Sidoqoftë, konkludon ky ekspert i njohur i tregjeve financiarë, "si India ashtu edhe Kina do të vazhdojnë të mbeten mjaft mbrapa Shteteve të Bashkuara në të gjithë treguesit kryesorë të ekonomisë. Asnjëra prej tyre nuk do të mund të zëvendësojë [Amerikën], dhe ndoshta hendeku midis pasurive të tyre mund të thellohet edhe më tej" (ibid.: 61).

Për hir të së vërtetës, duhet thënë se edhe nëse Shtetet e Bashkuara, për të penguar fuqizimin e mëtejshëm ekonomik të Kinës do të reagonin ndryshe, fjala vjen, duke bllokuar eksportet kineze në tregun amerikan, kjo do të ishte kundërproduktive dhe, në fakt, e pamundur për shkak të ndërvarësisë reciproke që ekziston tashmë midis ekonomive të këtyre dy vendeve. Nëse kjo do të ndodhë, Kina do të humbiste një treg të madh, në të cilin ajo eksporton mbi 12 përqind të GDP-së saj, gjë që tregon se sa e varur

është ekonomia kineze nga tregu amerikan. Por kjo do të kishte gjithashtu pasoja shumë të padëshiruara për vetë Amerikën, pasi Kina, duke zotëruar 350 miliardë dollarë (apo 7 përqind) të bonove të thesarit të Shteteve të Bashkuara, mund të hakmerrej ndaj saj (Art 2007: 34). Përveç kësaj, një embargo amerikane ndaj eksporteve kineze, me gjithë dëmin jashtëzakonisht të madh që do i shkaktonte ajo Kinës, nuk do të ishte plotësish e suksesshme për shkak të rëndësise jetike që kanë marrëdhëniet ekonomike e tregtarë të shumë vendeve të tjera të botës me Kinën, ekonomitë kombëtare të të cilëve kanë nevojë për tregun e madh kinez dhe fuqinë e lirë punëtore të këtij vendi, ashtu sikurse tregjet e tyre kanë nevojë për eksportet e lira kineze. Eksperti amerikan i marrëdhënieve ndërkombëtare Robert Art ve në dukje se "Tregu kinez është shumë i rëndësishëm për shumë vende, të cilët nuk do të zgjidhnin të bashkëpunonin me Shtetet e Bashkuara në një luftë ekonomike kundër një vendi që ndjek një strategji paqësore rritjeje, [ndërsa] vetë kinezët janë aq të zgjuar sa të mos ndërmarrin veprime që do të krijonin një koalicion armiqësor ndaj saj" (Art 2007: 34). Në përfundim mund të themi se ndonëse Amerika nuk mund ta pengojnë Kinën të fuqizohet ekonomikisht, ajo mund të bëjë shumë për ta destabilizuar Kinën nëse kjo do ishte në interesin e saj ndërsa Kina nuk mund të bëjë dot gjë për ta destabilizuar politikisht Amerikën. Siç ve në dukje me të drejtë një ndër ekspertët më në zë të politikës kineze: paradoxi i madh i Kinës sot është se ajo ndjehet e fortë dhe vulnerable njëkohësisht: e fortë për shkak të suksesit të saj ekonomik të jashtëzakonshëm, i cili bën që bota të trokasë në dyert e saj, por sidoqoftë vulnerable ndaj lëvizjeve politike të Shteteve të Bashkuara (Mahbubani 2005a: 55).

► Referencat

- Art, Robert J. 2007. "Agreeing to Agree (and Disagree)", *The National Interest* 89 (May/Jun): 33-39.Baker, Gerard. 2006. "America's Economic Hegemony is Safe", *The Times* (London), 25 April.Barth, James R. & Gerard Caprio Jr. 2007. "China's Financial System: The Perils of Riding the Wave", *The Milken Institute Review* 9, 3: 29-39.Bijian, Zheng. 2005. "China's 'Peaceful Rise' to Great-Power Status", *Foreign Affairs* 48, 5 (September/

- October): 18-24.Bremmer, Ian. 2005. "The Dragon Awaken", *The National Interest* 80 (Summer): 128-134.Bremmer, Ian. 2007. "A Second Look...", *The National Interest* 90 (July/August): 31-34.
- Brzezinski, Zbigniew & John J. Mearsheimer. 2005. "Clash of the Titans", *Foreign Policy* 146 (January/February): 46-50.
- Colchester, Nico. 1996. "The Worl We're In", *Prospect* (UK), November.
- Crane, Keith, Roger Cliff, Evan S. Medeiros, James C. Mulvenon & William H. Overholt. 2005. *Modernizing China's Military: Opportunities and Constrains*. Santa Monica, CA: RAND Corporation.
- Donnelly, Thomas. 2004. "The Proof of Primacy", (February), Washington, D.C.: AEI.
- Eberstadt, Nicholas. 2007. "Born in the USA: America's Demographic Exceptionalism", *The American Interest* 2, 5: 52-58.
- Fogel, Robert W. 2007. "Capitalism and Democracy in 2040", *Dædalus* (Summer): 87-95.Gaffney, Frank J., Jr. 2006. "Power Play", *Journal of International Security Affairs* 101 (Spring): 89-96.Gilpin, Robert. 1981. *War and Vhange in World Politics*. Cambridge: Cambridge University Press.Gottesman, A. Edward. 2006. "The Myth of Globalization", *World Policy Journal* 23, 1: 37-44.
- Holman, Michael W. 2006. Profiting from International Nanotechnology. Lux Research (December).Joffe, Josef. 2006. The John B. Hurford Memorial Lecture (A Conversation with Josef Joffe), Council on Foreign Relations, New York, 16 June; (http://www.cfr.org/publication/10982/john_b_hurford_memorial_lecture.htm).
- Kristof, Nicholas D. & Sheryl Wudunn. 1995. *China Wakes: The Struggle for the Soul of a Rising Power*. New York: Vintage.
- Linden, Greg, Kenneth Kraemer, and Jason Debrick. 2007. Who Captures Value in a Global Innovation System? The Case of Apple's iPod. Personal Computin Industry Center (June).Long, Simon. 2005. "The Tiger in Front: A Survey of India and China", *The Economist*, 5 March, ff. 1-6.Mahbubani, Kishore. 1992. "Japan Adrift", *Foreign Policy* 88 (Autumn): 126-144.
- Mahbubani, Kishore. 2005a. "Understanding China", *Foreign Affairs* 84, 5 (September/October): 49-60.Mahbubani, Kishore. 2005b. "Asia's Destiny, America's Choice", *The American Interest* 1, 1 (Autumn): 58-68.
- Pei, Minxin. 2006. "Long March to Nowhere", *Foreign Policy* (May/June): 73.
- Randt Jr., Clark T. 2005. "Global Impact: United States-China Relations in the 21-st Century", *The Ambassadors Review* (Fall): 23-28.Rorty, Richard. 2005. "A Quasy Agnosticism", *Dissent* (Fall): 91-94
- Sinai, Allen & Philip Merril. 2005. "Debating the Future of the U.S. Economy", *The American Interest* 1, 2 (Winter): 54-67.
- Terril, Ross. 2005. "What Does China Want?", *The Wilson Quarterly* 39, 4 (Autumn): 50-61.
- U.S. Department of Defence (USDD). 2007. *Military Power of the People's Republic of China: A Report to Congress*. Washington, D.C. Department of Defence.
- Walker, Martin. 2006. "America's Romance with the Future", *The Wilson Quarterly* 30, 1 (Winter): 22-26.Waltz, Kenneth N. 1979. *Theory of International Politics*. New York: McGraw-Hill.
- Wohlforth, William C. 2007. "Unipolar Stability: The Rules of Power Analysis", *Harvard International Review* 29, 1 (Spring): 44-48.
- Zakaria, Fareed. 2006. "The Age of Petrostates", *The Brown Journal of World Affairs* 12, 2 (Winter/Spring): 11-20.
- Zakaria, Fareed. 2008. *The Post-American World*. New York: W.W. Norton & Company.
- Zhao, Suisheng. 2005. "Nationalism's Double Edge", *The Wilson Quarterly* 39, 4 (Autumn): 76-82.

“INTEGRIMI FINANCIAR I ANETAREVE TE RINJ TE BASHKIMIT EUROPIAN”

Dr. ARJAN KADARE

Anëtar i Këshillit mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë ; ECB

Pedagog në Universitetin e New Yorkut Tiranë

Ky studim vlerëson për një sërë shtetesh, anëtarë të rinj të Bashkimit European (BE), shkallën e integrimit finansiar ndërmjet tyre dhe me zonën euro. Nëpërmjet një modeli faktorësh për kthimin nga investimet, ne e shprehim integrimin si pjesa e variacionit të shpjeguar nga faktori i përbashkët. Në këtë studim demonstrohet që shkalla e integrimit koinçidon me korrelacionin e kthimeve nga investimi. Korrelacioni është përafruar me bashkë-lëvizjet e kthimeve nga investimi në aktive që tregtohen në vende të ndryshme. Bashkë-lëvizjet vlerësohen nëpërmjet metodës së regresionit të kuantileve.

Gjetjet tona në tregun e aksioneve tregojnë që për anëtarët e rinj të BE-së me ekonomi më të mëdha, si Republika Çeke, Polonia dhe Hungaria, bashkë-lëvizjet ndërmjet tyre dhe me zonën euro janë mjaft të konsiderueshme. Për sa u përket vendeve me ekonomi më të vogël, vetëm për Estoninë dhe deri diku Qipron dokumentohet një rritje e bashkë-lëvizjeve me zonën euro dhe me anëtarët e rinj të BE-së me ekonomi më të mëdha.

Në tregun e obligacioneve qeveritare ne dokumentojmë një rritje të integrimit vetëm midis Republikës Çeke dhe Gjermanisë si edhe Republikës Çeke dhe Polonisë.

Fjalët më të përdorura: Integrimi, anëtarët e rinj të BE-së, regresioni i kuantileve.

Nga Lorenzo Cappiello¹, Bruno Gérard², Arjan Kadareja³ dhe Simone Manganelli⁴

1. ▷ Hyrje

Masa e integrimit të tregjeve financiare dhe të mallrave është me interes për bankat qendrore dhe agjentët ekonomik si firma, investorë apo ndërmjetës financiare. Nga njëra anë, një masë e lartë integrimi është dobi-prurëse, sepse ndihmon rritjen ekonomike, mundëson shpërndarjen e mëtejshme të riskut finanziar, si edhe rrit eficencën ekonomike të investimeve. Nga ana tjeter, integrimi i avancuar forcon varësinë ekonomike ndërmjet shteteve, si edhe rrit transmetimin e goditjeve “shok” nga një shtet në tjetrin.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë për një sërë shtetesh, anëtarë të rinj të BE (AR), shkallën e integrimit finansiar ndërmjet tyre dhe me zonën euro. Në literaturë nuk ka një përkufizim unanim të integrimit. Në një sërë studimesh ekonomike e financiare (Adler and Dumas, 1983, Stulz, 1981, Errunza and Losq, 1985, dhe Flood and Rose, 2005), tregjet përkufizohen të integruar, kur vetëm faktorët e tyre të përbashkët të riskut reflektohen në çmimin e aktiveve dhe për pasojë në kthimin nga investimet. Tregjet quhen pjesërisht të pa-integruar, kur edhe faktorët e riskut lokal (të një tregu të

¹ Senior Economist, ECB.

² Director, Mellon Capital Management.

³ Banka e Shqiperisë, Universiteti i New York/Tirana dhe ECB.

⁴ Principal Economist, ECB.

vetëm) marrin pjesë në përcaktimin e çmimit të aktiveve. Një përkufizim tjetër më i përgjithshëm e njëson integrimin ekonomik me forcimin e lidhjeve financiare dhe ekonomike ndërmjet vendeve (Dumas, Harvey and Ruiz, 2003). Për të bërë vlerësimin empirik të integrimit, nisur nga përkufizimi i parë, i dhënë më sipër, nevojiten teste të komplikuara të përcaktimit të çmimit të aktiveve (Bekaert and Harvey, 1995 dhe 1997, dhe Rockinger and Urga, 2001). Vlerësimi i integrimit, nisur nga përkufizimi i dytë është më i thjeshtë dhe kryhet nëpërmjet hulumtimit të ndryshimit të bashkë-lëvizjeve të kthimeve nga investimi në aktive që tregtohen në vende të ndryshme (Dumas, Harvey and Ruiz, 2003, dhe Aydemir, 2004). Në këtë studim, ne përdorim vlerësimin e integrimit nisur nga përkufizimi i dytë.

Shumë studime për integrimin janë përqendruar në tregjet e vendeve të zhvilluara (Jorion and Schwartz, 1986, Korajczyk and Viallet, 1989, Campbell and Hamao, 1992, Carrieri, Errunza and Sarkissian, 2004, Baele et al., 2004, dhe Flood and Rose, 2005), por kohët e fundit, mjafit prej tyre merren me tregjet e vendeve në zhvillim (Bekaert and Harvey, 1995 dhe 1997 dhe 2000, Bekaert and Urias, 1996, De Santis and Imrohoroglu, 1997, Bekaert et al., 1998, Bekaert, 1999, Rockinger and Urga, 2001, Gérard et al., 2003, dhe De Jong and De Roon, 2005). Megjithatë, relativisht pak studiues janë fokusuar tek integrimi i AR, me gjithë veçoritë interesante të tyre (Dvorak and Geiregat, 2004, dhe Reininger and Walko, 2005 si edhe referencat e tyre). Nga pikëpamja ekonomike, pjesa më e madhe e këtyre vendeve kaluan nga ekonomi të planifikimit të centralizuar, tek ekonomi tregu, dhe plotësisht të hapura. Ekonomitë e tyre, brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohe prej 12 vjetësh, u bënë anëtarë të një zone të lirë tregtare, si edhe tregjet financiare u zhvilluan dhe u liberalizuan. Pra ndryshimi ishte i shpejtë dhe me ritme të përafërtë për të gjitha vendet. Studimi bëhet më interesant po të kihet parasysh se, këto vende, eventualisht do t'i bashkohen zonës euro. Pra, monitorimi i integrimit të tyre me zonën euro duket të jetë i dobishëm për politikë-bërjen nga bankat qendrore përkatëse.

Ne e vlerësojmë integrimin mes AR dhe zonës euro për dy periudha: para dhe gjatë procesit të anëtarësimit, dhe për këtë përdorim një model faktorësh që përcakton çmimet e

aktiveve, pra edhe kthimin nga investimet. Modeli bën dallimin mes faktorëve të përgjithshëm, që janë veçori e dy ose më shumë tregjeve, dhe atyre lokalë që karakterizojnë tregje të veçanta. Ky model është i përshtatshëm për të vlerësuar konvergencën (integrimin) e faktorëve ekonomik themelorë, duke qenë se këta reflektohen tek çmimet e aktiveve që tregtohen në tregjet financiare. Megjithëse në këtë studim përdorim një model faktorësh për kthimet nga investimi, ndryshe nga studiues të tjerë të integrimit dhe bashkë-lëvizjeve (Bekaert and Harvey, 1995, Rockinger and Urga, 2001, Bekaert, Hodrick and Zhang, 2005, dhe De Jong and De Roon, 2005) ne nuk e vlerësojmë (angl. estimate) modelin vetë, por shfrytëzojmë atë që ai nënkupton për sjelljen e bashkë-lëvizjeve të kthimit nga investimet. Kështu, brenda një zone ekonomike, flukset e të ardhurave për firmat janë gjithnjë e më shumë subjekt i faktorëve të përbashkët me uljen e kufizimeve të lëvizjeve të kapitaleve dhe të flukseve tregtare. Ceteris paribus, kjo nënkupton një rritje të bashkë-lëvizjeve të kthimit nga investimi në aktivet e këtyre firmave.

Modeli i thjeshtë i përdorur na lejon të adoptojmë masën e mëposhtme intuitive të integrimit ndërmjet tregjeve: sa më e lartë të jetë pjesa e variabilitetit të kthimit nga investimi; që shpjegohet nga faktorët e përbashkët kundrejt atyre lokalë, aq më e konsiderueshme shkalla e integrimit. Ne gjithashtu tregojmë që kjo masë integrimi koinçidon me korrelacionin e kthimeve nga investimi. Bashkë-lëvizjet e kthimeve nga investimi ne i vlerësojmë me metodologjinë e Cappiello, Gérard and Manganelli (2005). Kjo mënyrë vlerësimi ka, inter alia, dy përparësi të rëndësishme. E para, ka imunitet në rastet kur shpërndarja reale nuk është ajo normale, si edhe kur varianca e çmimit të aktiveve është funksion i kohës. E dyta, ofron një masë vlerësimi të thjeshtë, lehtësish të dallueshme dhe intuitive të integrimit.

Në këtë studim ne vlerësojmë integrimin e tregjeve të aksioneve dhe të obligacioneve qeveritare për AR me zonën euro, para dhe gjatë procesit të anëtarësimit. Rezultatet tregojnë që gjatë procesit të anëtarësimit në BE kemi një rritje të masës së integrimit për tregjet e aksioneve. Kështu është arritur një nivel i përparuar integrimi i tre ekonomive më të mëdha, Republikës Çeke, Hungarisë

dhe Polonisë, ndërmjet tyre si edhe me zonën euro. Ekonomitë më të vogla kanë një shkallë të ulët integrimi ndërmjet tyre. Vetëm Estonia dhe deri diku Qipro, tregojnë rritje të integrimit me zonën euro dhe me bllokun e tre ekonomive më të mëdha. Slovenia dhe Letonia janë akoma në nivele të ulëta integrimi. Rezultatet tregojnë se me gjithë përparimin e vrullshëm në tregjet financiare të AR, niveli i integrimit dhe shpejtësia e konvergjencës janë cilësisht të ndryshme përvende të ndryshme të AR.

Për tregjet e obligacioneve qeveritare, të dhëna të besueshme ka vetëm për tre ekonomitë më të mëdha. Metoda jonë tregon se ka rritje të integrimit vetëm ndërmjet Gjermanisë (që përdoret si nivel vlerësimi i zonës euro) dhe Republikën Çeke, si edhe kësaj të fundit dhe Polonisë.

Një kritikë e drejtë që mund t'i bëhet metodës sonë të vlerësimit të integrimit është injorimi i efektit të faktorëve globalë (që veprojnë në shkallë botërore) në nivelin e integrimit të vendeve të AR, mes tyre dhe me zonën euro. Për këtë ne ndërmarrim një hap të dytë për të kontrolluar efektin e faktorëve globalë nëpërmjet përdorimit të një variabli të ndërtuar mbi bazën

e korrelacionit ndërmjet tregjeve të aksioneve dhe të obligacioneve qeveritare të AR dhe tërësisë së tregjeve më të rëndësishme botërore respektive. Analiza tregon se me gjithë ndikimin e rëndësishëm të faktorëve globalë në integrimin rajonal të AR dhe me zonën euro, përsëri faktorët specifikë të vendeve të AR dhe zonës euro mbeten përcaktues mjaf të rëndësishëm të integrimit financiar.

Studimi është strukturuar si me poshtë. Seksioni 2⁵ pasqyron një përbledhje të shkurtër të literaturës që na motivon të përdorim një tregues të veçantë integrimi. Në seksionin 3 përshkruhet metoda empirike e vlerësimit të integrimit. Seksioni 4 përmban një përshkrim të të dhënavë dhe zhvillimeve kryesore të tregjeve të aksioneve dhe obligacioneve qeveritare të vendeve të AR. Në seksionin 5 diskutohen rezultatet e arritura, ndërsa analiza e cilësisë së rezultateve është përfshirë në seksionin 6. Konkluzionet janë dhënë në seksionin 7.

⁵ Ky seksion është menduar të mos përfshihet në këtë artikull. Lexuesi i interesuar është i lutur t'i referohet ECB working paper No 683 të përmendur më sipër.

3.1 Metoda empirike

Në këtë studim demonstrohet që niveli i integrimit koinçidon me korrelacionin e kthimeve nga investimi. Korrelacioni përafrohet me bashkë-lëvizjet e kthimeve nga investimi në aktive që tregtohen në vendë të ndryshme.

Bashkë-lëvizjet e kthimeve nga investimi ne i vlerësojmë me metodologjinë e Cappiello, Gérard and Manganelli (2005). Në këtë seksion përshkruhet formalisht kjo metodologji.

Le të shënojmë me $\{r_t\}_{t=1}^T$ dhe $\{r_j\}_{t=1}^T$ dy seritë kohore që janë kthimet nga investimi për dy tregjet e ndryshme, i dhe j. Gjithashtu $q_{\theta_t}^{r_i}$ simbolizon kuantilen θ^6 në kohën t të shpërndarjes së kushtëzuar të kthimit r_i . Për analogji $q_{\theta_t}^{r_j}$ simbolizon kuantilen θ në kohën t të shpërndarjes së kushtëzuar të kthimit r_j . Le të shënojmë me $F_t(r_i, r_j)$ shpërndarjen e përbashkët kumulative në kohën t të dy kthimeve, r_i dhe r_j . Le të përkufizojmë dy madhësi të rëndësishme probabilitare si më poshtë:

$$F_t^-(r_i | r_j) \equiv \Pr(r_t \leq r_i | r_j \leq r_j) \text{ dhe } F_t^+(r_i | r_j) \equiv \Pr(r_t \geq r_i | r_j \geq r_j).$$

Mjeti bazë i analizës sonë është probabiliteti i kushtëzuar, si më poshtë:

⁶ Më poshtë jepet kuptimi i kuantileve. Kuantilja 0.05 (e shpërndarjes së kushtëzuar të kthimit r_i) është ajo vlerë kthimi më e madhe se 5% e kthimeve të tërhequra në mënyrë të rastit nga shpërndarja e kushtëzuar e r_i .

$$p_t(\theta) \equiv \begin{cases} F_t^-(q_{\theta t}^r | q_{\theta t}^l) & \text{if } \theta \leq 0.5 \\ F_t^+(q_{\theta t}^r | q_{\theta t}^l) & \text{if } \theta > 0.5 \end{cases} \quad (1)$$

Probabiliteti i kushtëzuar si më sipër paraqet në mënyrë efektive karakteristikat e $F_t(r_u, r_p)$. Për çdo kuantile θ , $p_t(\theta)$ shpreh probabilititin që, në kohën t , kthimi në tregun i të jetë më poshtë (më sipër) se sa kthimi që i korrespondon kuantiles θ , kur e njëjtë ngjarje ndodh në tregun j. Karakteristikat e $p_t(\theta)$ mund të analizohen me lehtësi në atë që ne e quajmë kutia e bashkë-lëvizjeve (fig.1). Kjo kuti ka formë katrori me gjatësi 1 njësi dhe brenda saj ndërtohet kurba e grafikut të $p_t(\theta)$ kundrejt θ . Forma e kurbës në përgjithësi varet nga karakteristikat e shpërndarjes së përbashkët të kthimeve, $F_t(r_u, r_p)$, kështu që për shpërndarje të çfarëdoshme ajo mund të përcaktohet veçse me simulime numerike. Megjithatë janë tre raste speciale që nuk kërkojnë simulime: 1) korrelacioni ose bashkë-lëvizja e përsosur pozitive, 2) pavarësia e lëvizjeve, 3) bashkë-lëvizja e përsosur negative. Për dy tregje të pavarur (rasti 2) $p_t(\theta)$ është linear me pjerrësi të barabartë me 1 për $\theta \leq 0.5$, dhe me pjerrësi të barabartë me -1 për $\theta > 0.5$. Kur tregjet janë të integruar në mënyrë të përsosur (rasti 1) forma e kurbës është vijë e drejtë horizontale me vlerë 1. Në këtë rast të dy tregjet kthehen në një të vetëm. Në rastin 3, $p_t(\theta)$ është gjithmonë i barabartë me zero. Ajo që ndodh në këtë rast me kthimet në një treg është (përsosmërisht) e kundërtë e asaj që ndodh në tregun tjetër.

Diskutimi më lart, sugjeron se sa më pranë vlerës 1 vlerat e kurbës $p_t(\theta)$, aq më i avancuar integrimi midis dy tregjeve që merren në shqyrtim. Në këtë studim ne vlerësojmë $p_t(\theta)$ për dy periudha: para dhe gjatë procesit të anëtarësimit në BE të vendeve të AR. Kur probabiliteti i kushtëzuar për këto dy periudha pasqyrohet në të njëtin grafik, diferençat e bashkë-lëvizjeve mund të identifikohen lehtësisht (me sy). Kështu, intuitivisht, një kërcim më lart (më poshtë) i kurbës së $p_t(\theta)$ në periudhën e dytë tregon një rritje (zvogëlim) të integrimit. Këtë intuitë ne e formalizojmë si më poshtë.

Le të janë $\mathbf{p}^B(\theta) \equiv B^{-1} \sum_{t<\tau} p_t(\theta)$ dhe $\mathbf{p}^A(\theta) \equiv A^{-1} \sum_{t \geq \tau} p_t(\theta)$, ku B dhe A janë respektivisht numri i observacioneve para dhe pas një datë referimi, τ . Ne e përcaktojmë si më poshtë rritjen në integrim:

Përcaktim 1 (Integrimi) - Integrimi rritet nëse

$$\xi(0,1) = \int_0^1 [\mathbf{p}^A(\theta) - \mathbf{p}^B(\theta)] d(\theta) > 0$$

$\xi(0,1)$ është e barabartë me sipërfaqen midis $\mathbf{p}^A(\theta)$ dhe $\mathbf{p}^B(\theta)$ në kutinë e bashkë-lëvizjeve. Vlerësimi i kutisë së bashkë-lëvizjeve dhe testimi formal i diferençave në probabilitet (integrime) kërkon hapat e mëposhtëm. Së pari, duke lejuar që të ndryshojnë në kohë, vlerësohen veç e veç kuantilet për çdo kthim nga investimi. Për këtë përdoret modeli CAViaR⁷ me autorë Engle and Manganelli (2004). Së dyti, për çdo kthim nga investimi dhe për çdo kuantile, ne ndërtojmë një funksion tregues që merr vlerën 1 nëse kthimi nga investimi është më i vogël se kuantilia dhe zero në të kundërt. Së fundmi, ne vlerësojmë lidhjen mes funksioneve tregues të kthimit në tregun j dhe i, duke përdorur edhe variabla kohore të krijuar artificialisht (angl. dummy) që identifikojnë periudhat me shkallë të ndryshme integrimi. Konkrektisht, kjo bëhet duke vlerësuar relacionin e mëposhtëm:

$$\mathbf{I}_t^{r_i r_j} (\hat{\beta}_\theta) = \alpha_\theta^1 + \alpha_\theta^2 \mathbf{D}_t^T + \eta_t \quad (2)$$

7 Në anglisht, Conditional Autoregressive Value at Risk

ku $I_t^{r_i r_j} \equiv I(r_t \leq q_t^{r_i}(\hat{\beta}_{\theta r_i})) \cdot I(r_t \leq q_t^{r_j}(\hat{\beta}_{\theta r_j}))$ për $\theta \in (0, 1)$ dhe për çdo kuantile;

$q_t^{r_i}(\hat{\beta}_{\theta r_i})$ dhe $q_t^{r_j}(\hat{\beta}_{\theta r_j})$ janë kuantilet e vlerësuara në hapin e parë dhe D_t^T shërbën për identifikimin e periudhës së dytë kur $t > \tau$.

Cappiello, Gérard dhe Manganelli (2005) demonstrojnë që vlerësuesit e $p_t(\theta)$ sipas metodës OLS të relacionit (2) janë asimptotikisht konsistentë. Këta vlerësues janë si më poshtë:

$$\hat{\alpha}_\theta^1 \xrightarrow{P} E[p_t(\theta) | \text{period B}] \equiv p^B(\theta)$$

$$\hat{\alpha}_\theta^1 + \hat{\alpha}_\theta^2 \xrightarrow{P} E[p_t(\theta) | \text{period A}] \equiv p^A(\theta)$$

$\hat{\alpha}_\theta^1$ është parametri i barabartë me probabilitetin e kushtëzuar të periudhës së parë. Shuma

$\hat{\alpha}_\theta^1 + \hat{\alpha}_\theta^2$ jep probabilitetin e kushtëzuar për periudhën e dytë. Nëse termi i dytë në shumën e mësipërme është i ndryshëm nga zero, atëherë ka ndryshim të probabilitetit në periudhën e dytë. Kjo kryhet me testin e mëposhtëm:

$$\hat{\xi}(\underline{\theta}, \bar{\theta}) = (\# \theta)^{-1} \sum_{\theta \in [\underline{\theta}, \bar{\theta}]} \hat{\alpha}_\theta^2, \quad (3)$$

ku $\# \theta$ jep numrin e elementeve në shumën e mësipërme. Cappiello, Gérard dhe Manganelli (2005) jepin vlerësuesa për gabimet standarde të testit të mësipërm.

4.1 Të dhënat⁸

Analiza empirike kryhet mbi bazën e kthimeve nga investimi në indekset e tregut të aksioneve dhe të obligacioneve qeveritare 10-vjeçare. Kthimet jepen ne monedhën lokale. Indekset e tregut të aksioneve përfshijnë Eurostoxx350, që përfaqëson indeksin për gjithë zonën euro, si edhe indekset për Qipron, Republikën Çeke, Estoninë, Hungarinë, Letoninë, Poloninë dhe Slloveninë. Për testet e kualitetit të rezultateve është marrë në konsideratë edhe një indeks botëror i aksioneve. Për sa i përket obligacioneve qeveritare, të dhënat me frekuencë ditore mund të gjenden vetëm për Republikën Çeke, Hungarinë, dhe Poloninë. Fër të përfaqësuar zonën euro, në përdorim obligacionet qeveritare të Gjermanisë. Për testet e kualitetit të rezultateve përf tregjet e obligacioneve, ne përdorim të dhënat për obligacionet në Japoni, Shtetet e Bashkuara dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Tregjet e aksioneve përf vendet që analizojmë janë të hapura përafërsisht në kohë të njëjtë gjatë ditës. Kjo praktikisht përashton çdo ndikim në kthime si rezultat i mospërputhjes kohore. Megjithatë mospërputhjet mund të lindin meqenëse ditët e pushimit nuk janë të njëjtë dhe si rezultat tregjet janë hapur në një vend dhe mbyllur në tjetrin. Ne konsiderojmë kthimet nga investimi në

⁸ Edhe ky seksion është i shkurtuar. Për seksionin e plotë mund t'i referoheni ECB Working Paper Series No. 683 / Tetor 2006

ditët, kur të dy tregjet janë hapur, si edhe kanë qenë hapur një ditë më parë. Një rregullim i njëjtë është bërë edhe për obligacionet.

Kthimet nga investimi në indeksin e tregut të aksioneve janë llogaritur mbi bazën e të dhënave nga Global Financial Data. Këto të dhëna përfshijnë dividendët dhe ndikimi i çdo përbërësi në indeks është në përpjesëtim të drejtë me peshën e tij në treg. Të dhënat fillojnë në 1994 për shumicën e vendeve, përjashtim bëjnë Estonia dhe Letonia, që fillojnë përkatësisht në Korrik 1995 dhe Janar 1997. Të dhënat përfundojnë në Nëntor 2005.

Kthimi nga investimi në obligacionet qeveritare është llogaritur me formulën e mëposhtme:

$$\begin{aligned} r_b &= p_b - p_{b-1} \\ &= n(y_{t-1} - y_t), \end{aligned}$$

ku r_b është kthimi (ditor) nga investimi në obligacione, p_b është logaritmi natyral i çmimit të obligacioneve, y_t është logaritmi natyral i interesit deri në maturim (angl. yield to maturity) dhe n është numri i viteve deri në maturim (në rastin tonë 10 vjet). Të dhënat për interesin deri në maturim janë marrë nga Global Financial Data. Të dhënat fillojnë në fillim të 2000 për Hungarinë, në Tetor 2000 për Republikën Çeke dhe në Shtator 2001 për Poloninë. Të dhënat përfundojnë në Nëntor 2005.

5. Rezultatet

Ne vlerësojmë probabilitetin e kushtëzuar të bashkë-lëvizjeve ($p_t(\theta)$) për dy periudha. Për tregjet e aksioneve bëhet dallimi midis periudhës para anëtarësimit në BE (para Janarit 2000) dhe periudhës së anëtarësimit (pas Dhjetorit 1999). Për tregjet e obligacioneve qeveritare, për shkak të mungesës së të dhënave, periudha e parë fillon në Shtator 2001 dhe mbaron para Janarit 2003, kurse periudha e dytë fillon pas Dhjetorit 2002 dhe mbaron në Nëntor 2005. Një rritje në integrim në periudhën e dytë do të reflektohej nga një kërcim lart i kurbës së $p_t(\theta)$ në kutinë e bashkë-lëvizjeve.

5.1 Tregjet e aksioneve

Rezultatet grafike përmbledhëse të analizës së integrimit të tregjeve të aksioneve ndërmjet vendeve të AR dhe zonës euro janë dhënë në figurat 2. Aty tregohen mesataret⁹ e probabilitetit të kushtëzuar të bashkë-lëvizjeve ($p_t(\theta)$) për dy periudhat e përmendura më sipër. Në figurën 2a, jepen mesataret e probabilitetit të kushtëzuar ndërmjet të gjitha vendeve të AR dhe zonës euro për të dy periudhat. Në këtë figurë shihet qartë se ka rritje të bashkë-lëvizjeve me zonën euro gjatë periudhës së anëtarësimit në BE. Kjo rritje i dedikohet kryesisht tre ekonomive më të mëdha (Hungarisë, Republikës Çeke dhe Polonisë (A3)) siç e bëjnë të qartë figurat 2b dhe 2c. Në figurat 2b dhe 2c jepen mesataret e probabilitetit të kushtëzuar me zonën euro të tre ekonomive të mëdha dhe të ekonomive të vogla, respektivisht. Arsyet duhen kërkuar tek faktorët institucionalë, madhësia e ekonomisë, distanca gjeografike, lidhjet ekonomike me zonën euro, etj. Konkluzionet e mësipërme mbështeten më tej nga analiza e integrimit ndërmjet çdo vendi të marrë veçmas dhe zonës euro. Probabilitetet e kushtëzuarat të bashkë-lëvizjeve ndërmjet çdo vendi të AR dhe zonës euro që jepen në figurat 3¹⁰ përfshijnë edhe intervalet e konfidencës të nivelit 95%.

Konkluzione cilësishët të ngashme me më sipër mund të arrihen edhe nëse bëhet një analizë rajonale integrimi për vendet e AR. Rezultatet e saj pasqyrohen në figurat 4, ku jepen mesataret rajonale të probabiliteteve të kushtëzuara të bashkë-lëvizjeve ndërmjet vendeve të AR. Figura 4a mbështet një rritje të përgjithshme të integrimit rajonal. Sikurse nënëvizar edhe më lart, kjo i dedikohet më së shumti rritjes së integrimit për ekonomitë e A3 (figura 4b), ndërsa ekonomitë e

⁹ Mesatarja është e peshuar me produktin e brendshëm bruto për çdo vend.

¹⁰ Këtu për mungesë vendi është dhënë vetëm figura 3a (figurat e plota ndodhen në ECB Working paper No.686)

vogla mbeten pothuajse independente (figura 4c).

Krahasimi i figurave 4b dhe 2b tregon se në periudhën e anëtarësimit për vendet e A3, integrimi mes tyre arrin nivel më të lartë se integrimi me zonën euro. Kjo diferençë vërehet edhe në periudhën para anëtarësimit dhe mund të shpjegohet nga lidhjet e forta ekonomike që nga koha e komunizmit. Analiza e mëtejshme e integrimit për çdo dyshe të mundshme nga vendet e AR, e mbështet më tej këtë konkluzion (figurat 5¹¹). Rastet Poloni-Republika Çeke, Poloni-Hungari dhe Republika Çeke-Hungari tregojnë se këto tregje kanë arritur shkallë të lartë integrimi.

Tabelat 1 dhe 2 për çdo dyshe vendesh përbajnjë respektivisht mesataret (sipas θ) e probabilitetit të bashkë-lëvizjeve për të dy periudhat dhe statistikën (3) me gabimet standard,

5.2 Tregjet e obligacioneve qeveritare

Analiza e integrimit për tregjet e obligacioneve përfshin tre ekonomitë e A3 (për të cilat ka të dhëna) dhe një përfaqësues të zonës euro, Gjermaninë. Të dhënrat janë klasifikuar në dy periudha: e para nga Tetor 2000 deri në Dhjetor 2002, e dyta nga Janar 2003 deri në Nëntor 2005. Figura 6 tregon mesataret e probabilitetit të kushtëzuar të bashkë-lëvizjeve ($p_t(\theta)$) për dy periudhat e përmendura më sipër ndërmjet Gjermanisë nga njëra anë dhe secilit prej Hungarisë, Republikës Çeke dhe Polonisë. Figurat 7¹² tregojnë probabilitetet e kushtëzuara të bashkë-lëvizjeve ndërmjet çdo vendi të A3 dhe Gjermanisë (zonës euro) së bashku me intervallet e konfidencës të nivelit 95%.

Rezultatet për tregjet e obligacioneve janë cilësishët të ndryshme nga ato të tregjeve të aksioneve. Ashtu sikurse Reininger and Valko (2005), rezultatet tona tregojnë se ka një rritje të rëndësishme të probabilitetit të kushtëzuar të bashkë-lëvizjeve vetëm ndërmjet Republikës Çeke dhe Gjermanisë për periudhën e dytë. Për dy vendet e tjera të A3 nuk vërehet një rritje e tillë. Një arsy që e shpjegon këtë diferençë është sasia e obligacioneve që mbahet në portofilet e investimit të të huajve. Kështu në fund të 2004-s, të huajt kishin blerë vetëm 10% - 30% të obligacioneve qeveritare të vendeve të A3. Është krejt e kundërtë për sa i përket tregut të aksioneve, kështu në Hungari, në fund t 2004-s, të huajt zotëronin 80% të aksioneve të kuotuara në treg.

Analiza racionale e integrimit të tregjeve të obligacioneve për vendet e A3 tregon se vetëm rasti Poloni-Republika Çeke tregon një farë rritjeje në probabilitetin e bashkë-lëvizjeve (në shkallen e integrimit).

Tabelat 3 dhe 4 për çdo dyshe vendesh përbajnjë respektivisht mesataret (sipas θ) e probabilitetit të bashkë-lëvizjeve për të dy periudhat dhe statistikën (3) me gabimet standard.

6. Konkluzione

Ky studim vlerëson për një sërë shtetesh, anëtarë të rinj të Bashkimit European, shkallën e integrimit financiar ndërmjet tyre dhe me zonën euro. Analiza është e përqendruar tek tregjet e aksioneve dhe të obligacioneve qeveritare. Rezultatet tregojnë që shkalla e integrimit ndërmjet anëtarëve të rinj të BE dhe me zonën euro është rritur gjatë procesit të anëtarësimit. Një shqyrtim më i hollësishëm tregon praninë e një lidhjeje më të fortë ndërmjet tre shteteve më të mëdha, Hungarisë, Republikës Çeke dhe Polonisë. Në mes të katër shteteve më të vogla, Qipro, Estonia, Letonia dhe Sllovenia, ne gjemjë një shkallë më të ulët integrimi. Megjithatë, Estonia, dhe në një farë mase Qipro, tregojnë një rritje të integrimit me zonën euro dhe me tre ekonomitë e mëdha. Faktorë institucionalë, madhësia e ekonomisë, distanca gjeografike dhe lidhjet e dobëta ekonomike me zonën euro, mund të jenë arsyet e këtyre diferençave në rezultate. Rezultatet tregojnë se me gjithë përparimin e vrullshëm në tregjet financiare të këtyre vendeve, niveli i integrimit dhe shpejtësia e konvergjencës janë cilësishët të ndryshme për vende të ndryshme. Rezultatet për tregjet e obligacioneve janë cilësishët të ndryshme nga ato të tregjeve të aksioneve. Ne evidentojmë se ka një rritje të rëndësishme statistikisht të integrimit ndërmjet Republikës Çeke dhe Gjermanisë dhe deri diku ndërmjet Republikës Çeke dhe Polonisë.

11 Të papërfshira për mungesë vendi (shih shenimin 11)

12 Këtu për mungesë vendi është dhënë vetëm figura 7b (shih shenimin 11)

D Referencat

- [1] Adler, M. and B. Dumas, 1983, "International Portfolio Choice and Corporation Finance: A Synthesis," *Journal of Finance* 38 (3): 925-984.
- [2] Ammer, J. and J. Mei, 1996, "Measuring International Economic Linkages with Stock Market Data," *Journal of Finance* 51(5): 1743-1763
- [3] Aydemir, A.C., 2004, "Why Are International Equity Market Correlations Loë?" Unpublished working paper, Carnegie Mellon University.
- [4] Baele, L., A. Ferrando, P. Hordahl, E. Krylova, and C. Monnet, 2004, "Measuring Financial Integration in the Euro Area," ECB OP #14.
- [5] Bekaert, G., 1999, "Is There a Free Lunch in Emerging Market Equities?" *Journal of Portfolio Management* 25(3): 83-95.
- [6] Bekaert, G., C.B. Erb, C. R. Harvey and T.E. Viskanta, 1998, "Distributional Characteristics of Emerging Market Returns and Asset Allocation," *Journal of Portfolio Management* 24(2): 102-116.
- [7] Bekaert, G., and C.R. Harvey, 1995, "Time-Varying World Market Integration," *Journal of Finance* 50(2): 403-444.
- [8] Bekaert, G., and C.R. Harvey, 1997, "Emerging Equity Market Volatility," *Journal of Financial Economics* 43(1): 29-77.
- [9] Bekaert, G., and C.R. Harvey, 2000, "Foreign Speculators and Emerging Equity Markets," *Journal of Finance* 55(2): 565-613.
- [10] Bekaert, G., R.J. Hodrick and X. Zhang, 2005, "International Stock Returns Comovements," NBER Working Paper # 11906.
- [11] Bekaert, G., and M.C. Urias, 1996, "Diversification, Integration and Emerging Market Closed-End Funds," *Journal of Finance* 51(3): 835-869.
- [12] Campbell, J.Y. and Y. Hamao, 1992, "Predictable Stock Returns in the United States and Japan: A Study of Long-Term Capital Market Integration," *Journal of Finance* 47(1): 43-70.
- [13] Cappiello, L., R.F. Engle and K. Sheppard, 2003, "Asymmetric Dynamics in the Correlations of Global Equity and Bond Returns," ECB ÈP Series # 204.
- [14] Cappiello, L., B. Gérard, and S. Manganelli, 2005, "Measuring Comovements by Regression Quantiles," ECB WP Series # 501.
- [15] Carrieri, F., V. Errunza and S. Sarkissian, 2004, "Industry Risk and Market Integration," *Management Science* 50(2): 207-221.
- [16] Cavilia, G., G. Krause, and C. Thimann, 2002, Key Features of the Financial Sectors in EU Accession Countries, in C. Thimann (ed.), *Financial Sectors in EU Accession Countries*, European Central Bank.
- [17] Dvorak, T. and C.R.A. Geiregat, 2004, "Are the New and Old EU Countries Financially Integrated?" mimeo, Union College, Schenectady, NY.
- [18] de Jong, F. and F. de Roon, 2005, "Time Varying Market Integration and Expected Returns in Emerging Markets," *Journal of Financial Economics* 78(3): 583-613.
- [19] De Santis, G. and S. Imrohoroglu, 1997, "Stock Returns and Volatility in Emerging Financial Markets," *Journal of International Money and Finance* 16(4): 561-579.
- [20] Dumas, B., C.R. Harvey and P. Ruiz, 2003, "Are Correlations of Stock Returns Justified by Subsequent Changes in National Outputs?" *Journal of International Money and Finance* 22(6): 777-811.
- [21] Engle, R.F. and S. Manganelli, 2004, "CAViaR: Conditional Autoregressive Value at Risk by Regression Quantiles," *Journal of Business and Economic Statistics* 22(4): 367-381.
- [22] Errunza, V. and E. Losq, 1985, "International Asset Pricing under Mild Segmentation: Theory and Test," *Journal of Finance* 40(1): 105-124.
- [23] Flood, R.P. and A.K. Rose, 2005, "Estimating the Expected Marginal Rate of Substitution:

- Asystematic Exploitation of Idiosyncratic Risk," *Journal of Monetary Economics* 52(5): 951-969.
- [24] Forbes, K.J. and R. Rigobon, 2002, "No Contagion, Only Interdependence: Measuring Stock Market Comovements," *Journal of Finance* 57(5): 2223-2261.
- [25] Gérard, B., K. Thanyalakpark and J. Batten, 2003, "Are East Asian Markets Integrated? Evidence from the ICAPM," *Journal of Economics and Business* 55(6): 585-607.
- [26] Hartmann, P., S. Straetmans and C. de Vries, 2004, "Fundamentals and Joint Currency Crises," *Review of Economics and Statistics* 86(1): 313-326.
- [27] Jorion, P. and E. Schwartz, 1986, "Integration vs. Segmentation in the Canadian Stock Market," *Journal of Finance* 41(3): 603-613.
- [28] Korajczyk, R. A. and C.J. Viallet, 1989, "An Empirical Investigation of International Asset Pricing," *Review of Financial Studies* 2(4): 553-586.
- [29] Longin, F. and B. Solnik, 2001, "Is the Correlation in International Equity Returns Constant: 1970-1990?" *Journal of Finance* 56(2): 649-676.
- [30] Reininger, T., and Z. Walko, 2005, "The Integration of Czech, Hungarian and Polish Bond Markets with the Euro Area Bond Market," paper presented at the "Conference on European Economic Integration," November 2005, Vienna.
- [31] Rockinger, M. and G. Urga, 2001, "A Time-Varying Parameter Model to Test for Predictability and Integration in the Stock Markets of Transition Economies," *Journal of Business and Economic Statistics* 19(1): 73-84.
- [32] Sontchik, S., 2003, "Financial Integration of European Equity Markets," mimeo HEC University of Lausanne and FAME.
- [33] Stulz, R. M., 1981, "A Model of International Asset Pricing," *Journal of Financial Economics* 9(4): 383-406.

Tabela 1: Probabiliteti mesatar i bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në indeksin e tregut të aksioneve.

Kjo tabelë tregon për çdo dyshe vendesh (sipas radhës dhe kolonës) dy probabilitete bashkë-lëvizjesh: (i) atë para anëtarësimit në BE, $p^B(\theta)$; dhe (ii) probabilitetin gjatë anëtarësimit në BE, $p^A(\theta)$. Mesataret e probabiliteteve janë llogaritur sipas të gjitha kuantileve, në intervalin (0.05, 0.95). Indekset në tabelë i referohen Eurostoxx350 (EA, zona euro), Polonisë (PL), Republikës Çeke (CZ), Hungarisë (HU), Estonisë (EE), Letonisë (LV), Qipros (CY) dhe Sllovenisë (SI).

		$\theta \in [0.05, 0.95]$						
		PL	CZ	HU	EE	LV	CY	SI
$P^n(0)$	EA	0.34	0.37	0.40	0.30	0.26	0.25	0.28
	PL		0.34	0.37	0.30	0.28	0.28	0.28
	CZ			0.37	0.29	0.26	0.27	0.29
	HU				0.31	0.27	0.26	0.29
	EE					0.31	0.27	0.30
	LV						0.25	0.28
	CY							0.27
$P^*(\theta)$	EA	0.43	0.44	0.43	0.36	0.26	0.33	0.28
	PL		0.44	0.46	0.35	0.28	0.30	0.30
	CZ			0.45	0.36	0.29	0.30	0.29
	HU				0.35	0.29	0.32	0.29
	EE					0.29	0.31	0.29
	LV						0.28	0.29
	CY							0.28

Tabela 2: Test për diferenca në probabilitetin mesatar të bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në indeksin e tregut të aksioneve.

Kjo tabelë jep statistikat e duhura për të testuar nese për çdo dyshe vendesh (sipas radhës dhe kolonës) probabiliteti i bashkë-lëvizjeve para anëtarësimit në BE është i ndryshëm nga probabiliteti gjatë anëtarësimit në BE. Statistikat janë llogaritur sipas të gjitha kuantileve, në intervalin (0.05, 0.95). Statistikat e rëndësishme në nivelin 5% janë dhënë në bold. Shenjat * dhe ** simbolizojnë statistikisht e rëndësishme në nivelin 5% dhe 10%, respektivisht. Gabimet standard janë dhënë në italics poshtë statistikave. Indekset në tabelë i referohen Eurostoxx350 (EA, zona euro), Polonisë (PL), Republikës Çeke (CZ), Hungarisë (HU), Estonisë (EE), Letonisë (LV), Qipros (CY) dhe Slovenisë (SI).

		$\theta \in [0.05, 0.95]$						
		PL	CZ	HU	EE	LV	CY	SI
EA	EA	0.09* 0.03	0.07* 0.03	0.03	0.06* 0.03	0.00	0.07* 0.02	0.00
	PL		0.10* 0.03	0.09* 0.03	0.05** 0.03	-0.00	0.02	0.02
	CZ			0.08* 0.03	0.07* 0.03	0.03	0.03	0.00
	HU				0.03	0.02	0.05* 0.02	-0.00
	EE				0.03	0.03	0.02	0.02
	LV					-0.01	0.04	-0.01
	CY					0.03	0.02	0.02

Tabela 3: Probabiliteti mesatar i bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në obligacionet qeveritare.

Kjo tabelë tregon për çdo dyshe vendesh (sipas radhës dhe kolonës) dy probabilitete bashkë-lëvizjesh:

(i) atë para anëtarësimit në BE, $p^B(\theta)$; dhe (ii) probabilitetin gjatë anëtarësimit në BE, $p^A(\theta)$. Mesataret e probabiliteteve janë llogaritur sipas të gjitha kuantileve, në intervalin (0.05, 0.95). Simbolet në tabelë i referohen Gjermanisë (DE), Polonisë (PL), Republikës Çeke (CZ), Hungarisë (HU).

		$\theta \in [0.55, 0.95]$		
		PL	CZ	HU
$p^B(\theta)$	DE	0.27	0.38	0.28
	PL		0.31	0.28
	CZ			0.31
$p^A(\theta)$	DE	0.37	0.50	0.27
	PL		0.39	0.34
	CZ			0.31

Tabela 4: Test për diferenca në probabilitetin mesatar të bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në obligacionet qeveritare 10-vjeçare.

Kjo tabelë jep statistikat e duhura për të testuar nëse për çdo dyshe vendesh (sipas radhës dhe kolonës) probabiliteti i bashkë-lëvizjeve para anëtarësimit në BE është i ndryshëm nga probabiliteti gjatë anëtarësimit në BE. Statistikat janë llogaritur sipas të gjitha kuantileve, në intervalin (0.05, 0.95). Statistikat e rëndësishme në nivelin 5% janë dhënë në bold. Shenja * simbolizon statistikisht e rëndësishme në nivelin 5%. Gabimet standard janë dhënë në italics poshtë statistikave. Simbolet në tabelë i referohen Gjermanisë (DE), Polonisë (PL), Republikës Çeke (CZ), Hungarisë (HU).

		$\theta \in [0.05, 0.95]$		
		PL	CZ	HU
DE	0.08	0.15*	-0.00	
	0.06	<i>0.04</i>	<i>0.04</i>	
PL		0.11*	0.06	
		<i>0.05</i>	<i>0.05</i>	
CZ			0.01	
			<i>0.04</i>	

Fig. 1: Kutia e bashkë-lëvizjeve

Kjo figurë tregon probabilitetin që kthimi nga investimi në një aktiv është më poshtë (më lart) se sa kuantilja e tij θ , kur është e dhënë që kthimi i një aktivit tjetër është më poshtë (më lart) se sa kuantilja e tij θ , për $\theta < 0.5$ ($\theta \geq 0.5$). Në figurë jepen rastet e korrelacionit ose bashkë-lëvizjes së përsosur pozitive (Co-Monotonicity), pavarësisë së lëvizjeve (Independence) dhe bashkë-lëvizjes së përsosur negative (Counter-monotonicity).




Fig. 2: Mesatarja e peshuar e probabilitetit të bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në indeksin e tregut të aksioneve – zona euro vs. rajoni AR

Fig. 2a-2c jepin mesataren e peshuar të probabilitetit të bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në indekset e tregut të aksioneve për vendet e AR dhe zonën euro dhe për dy periudhat: para anëtarësimit në BE dhe gjatë anëtarësimit. Simbolet “EA”, “NEUMS”, “LNEUMS” dhe “SNEUMS” i referohen përkatësisht zonës euro, të gjitha vendeve të AR, tre vendeve me ekonomi më të mëdha (Polonisë, Republikës Çeke dhe Hungarisë) dhe katër ekonomive më të vogla (Estonisë, Letonisë, Qipros dhe Sllovenisë). Mesatarja e peshuar e probabilitetit është llogaritur mbi bazën e PBB-s.

Figure 2a: EA vs NEUMS




Figure 2b: EA vs LNEUMS




Figure 2c: EA vs SNEUMS




Fig. 4: Mesatarja e peshuar e probabilitetit të bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në indeksin e tregut të aksioneve – rajoni AR

Fig. 4a-4c jepin mesataren e peshuar të probabilitetit të bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në indekset e tregut të aksioneve për vendet e AR dhe për dy periudhat: para anëtarësimit BE dhe gjatë anëtarësimit. Simbolet “NEUMS”, “LNEUMS” dhe “SNEUMS” i referohen përkatësisht të gjitha vendeve të AR, tre vendave me ekonomi më të mëdha (Pölonisë, Republikës Çeke dhe Hungarisë) dhe katër ekonomive më të vogla (Estonisë, Letonisë, Qipros dhe Sllovenisë). Mesatarja e peshuar e probabilitetit është llogaritur mbi bazën e PBB-së.

Figure 4a: All NEUMS




Figure 4b: LNEUMS





Fig. 3: Probabiliteti i bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi ne indeksin e tregut te aksioneve – zona euro vs. vendet e AR

Fig. 3a tregon probabilitetin e bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në indekset e tregut të aksioneve për Polonië dhe zonën euro dhe për dy periudhat: para anëtarësimit në BE dhe gjatë anëtarësimit.

Figure 3a: Euro area vs Poland




Fig. 6: Mesatarja e peshuar e probabilitetit te bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në

obligacionet qeveritare – Gjermani vs. LNEUMS

Fig. 6 jep mesataren e peshuar të probabilitetit të bashkë-lëvizjeve ndërmjet kthimeve nga investimi në obligacionet qeveritare për Gjermaninë dhe LNEUMS, dhe për dy periudhat: para anëtarësimit në BE dhe gjatë anëtarësimit. Simboli “LNEUMS” i referohet tre vendeve me ekonomi më të mëdha (Polonisë, Republikës Çeke dhe Hungarisë). Mesatarja e peshuar e probabilitetit është llogaritur mbi bazën e PBB-së.

Figure 6: Germany vs all NEUMS





Figure 7b: Germany vs Czech Republic
Prob. gjate antaresimit



të nëpunësit, aq më i madh do të jetë edhe probabiliteti i zbulimit të korruptionit të kryer prej tij (në qoftë se ai është i korruptuar). Në paragrafin pasardhës, ky pohim do të vërtetohet matematikisht.

Një rrjedhim i rëndësishëm i monitorimit të indikatorëve të korruptionit është krijimi i një mjedisi armiqësor dhe të pasigurt për aktivitetet korruptive.

► Probabiliteti i Zbulimit dhe Probabiliteti i Ndëshkimit të Korruptionit

Shqyrtohet një nëpunës i çfarëdoshëm në sektorin shtetëror; për shembull, ministër, kryetar bashkie, inspektor i tatim-taksave, doganier, gjyqtar, prokuror, pedagog universiteti, etj. Veprimtaria e tij do të monitorohet me anën e 47 indikatorëve të korruptionit. Supozohet se në veprimitarinë e tij është konstatuar i pranishëm indikatori me numër k , për $1 \leq k \leq 4$. Le të jenë:

A_k – ngjarja e rastit që ky nëpunës të jetë i korruptuar,

A'_k – e kundërtë e ngjarjes A_k ,

$P(A_k) = p_k$ – probabiliteti i ngjarjes së rastit A_k .

Supozohet se në veprimitarinë e këtij nëpunësi shtetëror janë konstatuar të pranishëm m indikatorë të korruptionit, ndërsa ($4 - m$) indikatorë të tjera nuk janë konstatuar. Për të mos e mbingarkuar studimin tonë me simbole matematike, këta m indikatorë të konstatuar do të rinumërohen $1, 2, \dots, m$. Duke respektuar supozimin dhe rinumërimin, do të përdoren simbolet e mëposhtme:

B_k – ngjarja e rastit që nëpunësi të jetë i korruptuar, në qoftë se në veprimitarinë e tij konstatohet i pranishëm indikatori me numër rendor k ,

B'_k – e kundërtë e ngjarjes B_k , për

$$1 \leq k \leq m \leq 4 ,$$

A – ngjarja e rastit që nëpunësi të jetë i korruptuar, në qoftë se në veprimitarinë e tij janë konstatuar m indikatorë të korruptionit,

A' – e kundërtë e ngjarjes A ,

$P(B_k) = p_k$ – probabiliteti i ngjarjes së rastit B_k ,

$P(A) = p$ – probabiliteti që nëpunësi të jetë i korruptuar,

C – ngjarja e rastit që korruptioni i këtij nëpunësi të zbulohet nga organet e antikorruptionit (për shembull, nga Byroja e Investigimit të Korruptionit brenda institucionit ose nga Agjencia Kombëtare e Antikorruptionit ose nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga SHISH).

$P(C | A)$ tregon probabilitetin me kusht të zbulimit të korruptionit, ndërsa $P(C \cap A)$ tregon probabilitetin pa kusht të zbulimit të korruptionit të nëpunësit shtetëror të shqyrta.

Është e kuptueshme se

$$A = B_1 \cup B_2 \cup \dots \cup B_m .$$

Duke zbatuar formulën e probabilitetit me kusht gjejmë

$$P(A') = P(B'_1 \cap B'_2 \cap \dots \cap B'_{m-1}) = P(B'_1) \cdot$$

$$\dots \cdot P(B'_2 | B'_1) \cdots P(B'_m | B'_1 \cap B'_2 \cap \dots \cap B'_{m-1})$$

Rrjedhimisht do të kemi

$$P(A) = 1 - P(B'_1) \cdot P(B'_2 | B'_1) \cdots \cdot$$

$$\cdots \cdot P(B'_m | B'_1 \cap B'_2 \cap \dots \cap B'_{m-1})$$

Në qoftë se në formulën (1) zbatohet Rregulli De Morgan ose Parimi i Dualitetit i S.N. Bernshtejnit, atëherë përfshohen rezultatet e mëposhtme për probabilitetet me kusht:

$$P(B'_2 | B'_1) = \frac{1 - P(B'_1 \cup B'_2)}{1 - P(B'_1)}$$

$$P(B_3 | B_1 \cap B_2) = \frac{1 - P(B_1 \cup B_2 \cup B_3)}{1 - P(B_1 \cup B_2)}$$

$$= \frac{1 - P(B_1 \cup B_2 \cup \dots \cup B_{m-1} \cup B_m)}{1 - P(B_1 \cup B_2 \cup \dots \cup B_{m-1})}$$

Prandaj, është i rëndësishëm vlerësimi i probabiliteteve $P(B_1 \cup B_2)$, $P(B_1 \cup B_2 \cup B_3)$, ..., $P(B_1 \cup B_2 \cup \dots \cup B_{m-1} \cup B_m)$.

Në qoftë se B_1, B_2, \dots, B_m janë ngjarje të rastit të pavarura midis tyre, atëherë formula (1) merr trajtën kompakte

$$P(A) = 1 - (1 - p_1) \cdot (1 - p_2) \cdots (1 - p_m) \quad (2)$$

Për një studim më të hollësishëm të probabilitetit me kusht dhe pavarësisë së ngjarjeve të rastit shih [6].

Ekspertë në fushën e aktivitetit që kryen nëpunësi shtetëror në bashkëpunim me profesorë të Teorisë së Probabilitetit përdorin përkufizimin statistikor ose subjektiv të probabilitetit për të vlerësuar probabilitetet p_1, p_2, \dots, p_m dhe $P(B_1 \cup B_2), P(B_1 \cup B_2 \cup B_3), \dots, P(B_1 \cup B_2 \cup \dots \cup B_{m-1} \cup B_m)$.

Meqenëse në vendin tonë nuk disponohen të dhëna statistikore disavjeçare për zbulimin e korrasjonit me anën e monitorimit të indikatorëve të tij, rrjedh se për vlerësimin e probabiliteteve të mësipërme do të përdoret përkufizimi subjektiv i probabilitetit (e ashtuquajtura Metoda Von Mises-Kollmogorov), shih [6]. Sipas kësaj metode, ekspertë të fushave të ndryshme përdorin eksperiencën në punë, opinionet dhe informacionet tjera individuale për

të vlerësuar probabilitetet p_1, p_2, \dots, p_4 . Kjo do të thotë se vlerësimi i probabilitetit

p_k nga një ekspert shpreh besimin e tij për vërtetësinë e barazimit $P(B_k) = p_k$. Probabilitetet subjektive p_1, p_2, \dots, p_4 ndryshojnë në mënyrë të rastësishme nga eksperti në ekspert. Këto probabilitete quhen ndryshe probabilitete personale. Pasi ekspertët bëjnë vlerësimë të probabiliteteve të mësipërme, pastaj këto rezultate individuale përpunohen statistikisht dhe, në këtë mënyrë, përftohen vlerësimet e kërkuar.

Duke iu referuar listës së 47 indikatorëve të korrasjonit, unë sugjeroj këtë vlerësim paraprak orientues të probabiliteteve

$p_1, p_2, p_3, \dots, p_6, p_7$:

$P_1 = 0.9$	$P_{18} = 0.8$	$P_{35} = 0.5$
$P_2 = 0.6$	$P_{19} = 0.9$	$P_{36} = 0.9$
$P_3 = 0.9$	$P_{20} = 0.8$	$P_{37} = 0.8$
$P_4 = 0.5$	$P_{21} = 0.8$	$P_{38} = 0.6$
$P_5 = 0.8$	$P_{22} = 0.8$	$P_{39} = 0.8$
$P_6 = 0.2$	$P_{23} = 0.2$	$P_{40} = 0.5$
$P_7 = 0.4$	$P_{24} = 0.7$	$P_{41} = 0.6$
$P_8 = 0.5$	$P_{25} = 0.8$	$P_{42} = 0.8$
$P_9 = 0.9$	$P_{26} = 0.3$	$P_{43} = 0.9$
$P_{10} = 0.3$	$P_{27} = 0.8$	$P_{44} = 0.9$
$P_{11} = 0.4$	$P_{28} = 0.6$	$P_{45} = 0.8$
$P_{12} = 0.1$	$P_{29} = 0.9$	$P_{46} = 0.8$
$P_{13} = 0.6$	$P_{30} = 0.8$	$P_{47} = 0.9$
$P_{14} = 0.3$	$P_{31} = 0.2$	
$P_{15} = 0.3$	$P_{32} = 0.5$	
$P_{16} = 0.4$	$P_{33} = 0.3$	
$P_{17} = 0.8$	$P_{34} = 0.9$	

Është e vërtetë formula e shumëzimit të probabiliteteve

$$P(A \cap C) = P(A) \cdot P(C | A) \quad (3)$$

Theksojmë se probabiliteti me kusht i zbulimit të korrasjonit varet nga niveli i profesionalizmit,

i përkushtimit në punë dhe i ndershmërisë së punonjësve të sistemit të antikorrupsionit. Vlerat ekstreme (kufitare) të këtij probabiliteti me kusht janë:

$$P(C | A) \approx 1 \text{ (nivele të larta të profesionalizmit, përkushtimit në punë dhe ndershmërisë)}$$

$$P(C | A) \approx 0 \text{ (sistemi i anti-korrupsionit është bërë maksimalisht i korruptuar).}$$

Një rrjedhim i drejtpërdrejtë i formulave (1), (2) dhe (3) është ky: Në qoftë se së bashku me indikatorët e korrupsionit të monitoruar më parë do të monitorohet edhe një indikator tjetër i korrupsionit, atëherë probabiliti pa kusht i zbulimit të korrupsionit do të rritet.

Vërejtje 1. Bashkësia e indikatorëve të korrupsionit është dinamike, sepse probabilitetet

p_1, p_2, \dots, p_4 ndryshojnë me kalimin e kohës. Prandaj këto probabilitete duhen rivlerësuar nga ekspertët çdo dy vjet. Sa më i plotë të bëhet informacioni ynë për monitorimin e indikatorëve të korrupsionit, aq më efektiv do të jetë përdorimi i përkufizimit statistikor të probabilitetit për të vlerësuar probabilitetet

p_1, p_2, \dots, p_4 . Vërtetësia e këtij pohimi deduktohet nga Teorema e Kollmogorovit mbi stabilitetin e dendurive relative (shih [6]).

Vërejtje 2. Disa nga probabilitetet subjektive

p_1, p_2, \dots, p_4 mund të ndryshojnë edhe në varësi të profesionit të nepunësit shtetëror.

Për shembull, probabiliteti p_0 mund të jetë i ndryshëm për nepunës të tillë si doganier, inspektor i tatim-taksave, pedagog universiteti, oficer policie, gjyqtar, prokuror, etj. Këto specifikime janë të dobishme dhe do të kryhen nga grupi i ekspertëve.

Modeli matematik i këtij studimi përbëhet nga katër komponentë:

1. Probabiliteti që nepunësi shtetëror i monitoruar të jetë i korruptuar.
2. Probabiliteti që korrupsioni i tij të zbulohet.
3. Probabiliteti që nepunësi të akuzohet penalisht, me kusht që korrupsioni i tij

të jetë zbuluar.

4. Probabiliteti i ndëshkimit të nepunësit, me kusht që ai të jetë akuzuar penalisht për korrupsion të faktuar.

Komponenti i parë dhe i dytë kanë të bëjnë me organet e antikorrupsionit, komponenti i tretë ka të bëjë me prokurorinë, ndërsa i katërti me gjykatën.

Një aplikim tjetër i rëndësishëm i këtij studimi është llogaritja e probabilitetit pa kusht të ndëshkimit të korrupsionit.

Letëjenepërkatesisht p, q, r, s , probabilitetet e katër komponentëve të mësipërme, ndërsa P probabiliteti pa kusht i ndëshkimit të nepunësit shtetëror me akuzën për korrupsion.

Sipas Teorisë së Probabilitetit është e vërtetë formula

$$P = p \cdot q \cdot r \cdot s \quad (4)$$

Kjo formulë tregon se probabiliteti pa kusht i ndëshkimit të korrupsionit është i vogël, në qoftë se korrupsioni është i pranishëm në sistemin e antikorrupsionit, prokurori dhe gjykatë. Është e rëndësishme të theksohet se korrupsioni i nepunësit të antikorrupsionit, prokurorit dhe gjyqtarit zbulohen gjithashtu me anën e monitorimit të 47 indikatorëve të korrupsionit.

Shembull

Gjatë monitorimit të veprimtarisë së një nepunësi në sektorin shtetëror me anën e 47 indikatorëve të korrupsionit janë konstatuar të pranishëm vetëm indikatorët me numra rendorë 2, 15, 18 dhe 29.

- (i) Të llogaritet probabiliteti i ngjarjes së rastit që ky nepunës të jetë i korruptuar;
- (ii) Të llogaritet probabiliteti pa kusht i zbulimit të korrupsionit të këtij nepunësi, në qoftë se jepet probabiliteti me kusht i zbulimit të korrupsionit i barabartë me 0.4;
- (iii) Të llogaritet probabiliteti pa kusht i akuzimit të këtij nepunësi për korrupsion, në qoftë se jepet probabiliteti me kusht e akuzimit

- (iv) për korruption i barabartë me 0.8; Të llogaritet probabiliteti pa kusht i ndëshkimit të këtij nëpunësi për korruption, në qoftë se jepet probabiliteti me kusht i ndëshkimit të korruptionit i barabartë me 0.5.

Zgjidhje

Indikatorëve të korruptionit me numra rendorë 2, 15, 18 dhe 29 u korrespondojnë përkatesisht ngjarjet e rastit A_2 , A_5 , A_8 dhe A_9 . Konstatohet se këto ngjarje janë të pavarura ndërmjet tyre, në kuptimin e Teorisë së Probabilitetit. Duke u mbështetur në vlerësimin paraprak të probabiliteteve të indikatorëve të korruptionit, gjenden në tabelën përkatesë vlerat:

(i) Probabiliteti që ky nëpunës të jetë i korruptuar llogaritet me formulën (2)

$$p = 1 - (1 - p_2) \cdot (1 - p_5) \cdot (1 - p_8) \cdot (1 - p_9) = 0.9944$$

$$p_2 = 0.6 \quad p_5 = 0.3 \quad p_8 = 0.8 \quad p_9 = 0.9$$

(ii) Probabiliteti pa kusht i zbulimit të korruptionit të këtij nëpunësi llogaritet me formulën (3):

$$0.9944 \cdot 0.4 = 0.398$$

(iii) Probabiliteti pa kusht i akuzimit të këtij nëpunësi për korruption llogaritet me formulën analoge:

$$0.9944 \cdot 0.4 \cdot 0.8 = 0.3184$$

(iv) Probabiliteti pa kusht i ndëshkimit të nëpunësit për korruption llogaritet me formulën (4):

$$P = 0.9944 \cdot 0.4 \cdot 0.8 \cdot 0.5 = 0.1592.$$

Interpretim i rezultateve:

$p = 0.9944$ tregon se ky nëpunës është

praktikisht i korruptuar, ndërsa $P = 0.1592$ tregon se probabiliteti pa kusht i ndëshkimit të këtij nëpunësi është mjaft i vogël.

Kjo dukuri negative (domethënë, forca ndëshkimore mjaft e vogël e korruptionit) shkaktohet nga fakti se korruptioni në këtë shembull është i pranishëm në disa fusha; konkretisht, në organet e antikorruptionit, prokurori dhe gjykatë. Theksojmë se ky shembull vlen për t'u stërvitur me llogaritjet e probabiliteteve p dhe P , ndonëse të dhënat numerike të probabiliteteve me kusht q , r , s janë vetëm vlera hipotetike.

Konkluzione

1. Zbulimi dhe ndëshkimi i korruptionit me anën e monitorimit të indikatorëve të tij, i bazuar në llogaritjen e probabiliteteve me formulat (1) - (4), është një metodë shkencore, e cila harmonizon arritje bashkëkohore të Kërkimit Shkencor në Kriminologji me Teorinë e Probabilitetit. Kjo metodë shkencore është e fuqishme dhe universale, sepse zbatohet në çdo fushë të aktivitetit njerëzor (në ekonomi, sistemin juridik, në ministritë, bashkitë, në arsim, shëndetësi) dhe në çdo periudhë kohore, duke ndëshkuar konform ligjit persona të korruptuar pavarësisht nga bindjet politike, pozita shtetërore, seksji, mosha, të ardhurat personale ose vjetërsia në aktivitete korruptive. Indikatorët e korruptionit përbajnë fakte reale. Ata nuk janë thjesht supozime ose hipoteza. Prandaj, këta indikatorë kanë forcë investiguese. Për shkak të monitorimit të 47 indikatorëve të korruptionit, rezulton se metoda shkencore e parashtruar në këtë studim zbulon dhe ndëshkon edhe aktivitete korruptive të sofistikuara.

2. Dy faktorë shumë të rëndësishëm të mbijetesës së sistemit të korruptionit janë mungesa e monitorimit të indikatorëve të korruptionit dhe mungesa e vullnetit politik për ndëshkimin e aktiviteteve korruptive. Monitorimi me anën e indikatorëve të korruptionit duhet të kryhet nga maja deri në bazë (për shembull, nga ministri deri tek nëpunësit e thjeshtë në bazë ose nga prokurori i përgjithshëm deri në oficerët e policisë gjyqësore në prefektura). Korruptioni mbijeton në qoftë se nuk çrrënjoset në të gjitha segmentet e administratës shtetërore. Malazja,

Indonezia, Nikaragua dhe Brazili kanë servirur shembuj të spikatur të dështimit të luftës kundër sistemit të korruptionit në vitet 1980 për shkak se nuk u çrrënjos korruptioni në bazë, ndonëse u ndëshkuan rreptë ministra, kryetarë bashkish, prokurorë dhe gjyqtarë të korruptuar.

3. Zbulimi dhe ndëshkimi i aktiviteteve korruptive janë, në thelb, ngjarje të rastit. Prandaj, është e arsyeshme dhe e dobishme llogaritja e probabilitetit të zbulimit dhe e probabilitetit të ndëshkimit të aktiviteteve korruptive. Këtu konsiston qëllimi kryesor i këtij studimi.

4. Origjinaliteti i këtij studimi është në deduktimin e disa formulave për llogaritjen e probabilitetit të zbulimit të korruptionit dhe të probabilitetit të ndëshkimit të korruptionit, me anën e monitorimit të indikatorëve përkatës.

5. Indikatorët e korruptionit nuk janë njëloj të rëndësishëm, sepse disa prej këtyre indikatorëve kontribuojnë më tepër se sa të tjerët në zbulimin e aktiviteteve korruptive.

6. Vendimi për monitorimin e indikatorëve të korruptionit do të merret nga Kryeministri, ndërsa zbatimi në praktikë i këtij vendimi mund të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Antikorruptionit në bashkëpunim me Byrotë e Investigimit Antikorruption në ministritë, bashkitë, prokuroritë, gjykatat dhe me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Në qoftë se monitorimi nuk do të kryhet në krejt territorin e Republikës së Shqipërisë ose nuk do të jetë i vazdueshëm në kohë ose do të kryhet "shkel e shko" (domethënë, pa efektivitet të lartë), atëherë lufta kundër sistemit të korruptionit do të rezultojë në humbje. Rasti më i turpshëm është kur një pjesë e konsiderueshme punonjësish në sistemin antikorruption do të bëhen të korruptuar. Prandaj, ka rëndësi të veçantë monitorimi me anën e indikatorëve të korruptionit i nëpunësve të sistemit të antikorruptionit.

Cilësia e monitorimit te indikatorëve të korruptionit është tepër e rëndësishme për të fituar luftën kundër sistemit të korruptionit. Kjo cilësi është gjithashtu matës i pavartësisë së aktivitetit të sistemit antikorruption nga ndërhyrje ose presione politikanësh të korruptuar ose biznesmenësh të korruptuar. Ky monitorim

duhet të kryhet me ndershmëri dhe përgjegjësi të lartë.

7. Zbatimi në praktikë i këtij studimi kërkon një vlerësim paraprak të probabiliteteve subjektive p_1, p_2, \dots, p_4 dhe $P(B_1 \cup B_2), \dots, P(B_1 \cup B_2 \cup \dots \cup B_{m-1} \cup B_m)$ dhe probabiliteteve me kush q, r, s të formulës (4). Me qenë se në vendin tonë nuk disponohen të dhëna disavjeçare për zbulimin, akuzimin dhe ndëshkimin e korruptionit me anën e monitorimit të indikatorëve përkatës, rrjedh se për vlerësimin e probabiliteteve të mësipërme duhet të përdoret Metoda Von Mises-Kollmogorov e probabiliteteve subjektive. Ky vlerësim paraprak do të bëhet nga një grup ekspertësh dhe profesorësh të matematikës. Specialistë nga Kryeministria, Ministritë, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe profesorë nga Universiteti i Tiranës shpresohet të jenë kandidatë të duhur për ekspertë.

8. Impakte të drejtpërdrejta të këtij studimi janë zmadhimi i probabilitetit të zbulimit të korruptionit dhe i probabilitetit pakusht të ndëshkimit të nëpunësve të korruptuar. Rrjedhimisht, nëpunës me prirje korruptive do të kenë frikë të kryejnë aktivitete korruptive, në qoftë se monitorohen me anën e indikatorëve të korruptionit dhe se po të kryejnë aktivitete korruptive, atëherë do të zbulohen dhe ndëshkohen në përputhje me ligjin.

Zbatimi në praktikë i këtij studimi do të mundësojë, brenda pak vitesh, ndryshimin e perceptimit të përgjithshëm të korruptionit nga "një aktivitet me rrezik të vogël dhe përfitim të madh" në "një aktivitet me rrezik të madh dhe pa përfitim".

9. Në qoftë se korruptioni do të mbahet në nivele të ulëta për të gjithë administratën për një periudhë kohore dhjetëvjeçare, atëherë shpresohet të gjenerohet një trajktore e gjendjes së qëndrueshme me nivele të ulëta korruptioni.

10. Ky studim duhet të zbatohet veçanërisht në ato fusha ku sistemi i korruptionit shkatërron zhvillimin ekonomik dhe dëinton funksionimin e institucioneve kryesore shtetërore (për shembull, në doganat, tatim-taksat, në të drejtat e pronës dhe shpronësimet, në ministritë, bashkitë,

prokuroritë, gjykatat, universitetet, etj).

Vëmendje e veçantë duhet të tregohet në monitorimin e veprimtarisë së politikanëve me anën e indikatorëve të korruptionit. Pasi të grumbullohen të dhënat e monitorimit, do të zbatohen metoda të Statistikës Matematike për kontrollin e disa hipotezave statistikore. Për shembull,

H_0 : Politikanët shqiptarë nuk janë të korruptuar,

H_a : Politikanët shqiptarë janë të korruptuar; ose

H_0 : Më pak se 30% e politikanëve shqiptarë janë të korruptuar,

H_a : Jo më pak se 30% e politikanëve shqiptarë janë të korruptuar; ose

H_0 : Politikanët shqiptarë janë më pak të korruptuar se njëzet e tjerë,

H_a : Politikanët shqiptarë nuk janë më pak të korruptuar se njëzet e tjerë;

Propozimi për kontrollin e hipotezave statistikore të mësimpërme bazohet në kërkime shkencore bashkëkohore për evidentimin e korruptionit të politikanëve në disa shtete europiane (shih [2], [12], [13]).

11. Mbijetesa e korruptionit shpeshherë është argumentuar me anën e parimit të reputacionit kolektiv të keq të brezave: të rinjtë trashëgojnë një reputacion të keq nga persona të korruptuar të moshuar. Për pasojë, një pjesë e brezit të rindikohet nga përvoja korruptive e të moshuarve. Një rrjedhim i drejtpërdrejtë i këtij argumentimi është rreziku serioz i korruptimit të një pjesë të konsiderueshme të studentëve në mjedise universitare të infektuar nga korruptioni. Mund të imagjinohet dëmi i familjeve dhe i krejt shoqërisë shqiptare, i shkaktuar nga ky lloj korruptioni. Rezultatet matematike të paraqitura në këtë studim duhet të zbatohen edhe për zbulimin, ndëshkimin dhe parandalimin e këtij lloj korruptioni.

12. Disa autorë e përkufizojnë aktin korruptiv si çdo lloj përdorimi të jashtëligjshëm të

pozitës shtetërore, partiakë ose të autoritetit të pushtetarit për të garantuar përfitime personale (shih [1], [2]). Ndonsë ky përkufizim mundëson analizën juridike të një bashkësie mjaft të gjërë të aktiviteteve korruptive, fatkeqësisht ky të jashtë disa strategji djallëzore të mbështetura në marrëveshje të ligjëruara në parlament ose në qeverinë e mëparshme, të cilat gjenerojnë korruption. Pavarësisht nga mangësi të tillë, të cilat mund të janë të pranishme edhe në Shqipëri, metoda e monitorimit të indikatorëve të korruptionit lejon llogaritjen e probabilitetit të zbulimit të korruptionit.

Bibliografi

- 1.A. V. Banerjee. A Theory of Misgovernance. *Quarterly Journal of Economics*, Vol. 112, 1997, 1289–1332.
- 2.D. Della Porta and Y. Meny. *Democracy and Corruption in Europe*. London, Pinter, 2003.
- 3.A. Doig. Dealing with Corruption: The Next Steps, in *Controlling Corruption Around the World*. Ed. A. Doig, Pitman, London, 2000, 99–112.
- 4.R. Klitgaard. *Controlling Corruption*. University of California Press, Berkley and Los Angeles, 1988.
- 5.R. Klitgaard. Cleaning up and Invigorating the Civil Service, in *Controlling Corruption Around the World*. Ed. A. Doig, Pitman, London, 2000, 217–239.
- 6.A. N. Kolmogorov. *Probability Theory*. Moscow, Nauka, 2001.
- 7.P. Poerting and W. Vahlenkamp. Internal Strategies Against Corruption. *Crime, Law & Social Change*, Vol 29, 1998, 225–249.
- 8.S. Rose-Ackerman. Corruption and Development, in *Controlling Corruption Around the World*. Ed. A. Doig, Pitman, London, 2000, 85–90.
- 9.A. Shleifer and R. Vishny. Corruption. *Quarterly Journal of Economics*, Vol

- 108, 1993, 599–617.
- 10.W. Vahlenkamp and I. Knaub. Corruption: Taking Precise Aim at an Amorphous Phenomenon. Trends in Organized Crime, Vol 2, No 4, 1997, 21–25.
- 11.J. Van Gogh. Applied Systems Theory. Academic Press, New York, 2002.
- 12.S. Van de Walle. Decontaminating Subjective Corruption Indicators. Ed. by Katholieke Universiteit Leuven, Belgium, 5 June 2005.
- 13.J-M. Yante. La Corruption dans l'Administration Belge aux XIXe et XXe Siècles.IOS Press, 2003, 65–82.

BANKA E SHQIPERISE - NGA KRIJIMI DERI NE FUND TE LUFTES SE II BOTERORE (1863-1944)

Prof.Dr. KSENOFON KRISAFI

Zv/Rektor dhe Dekan i fakultetit Juridik në UET
Anëtar i Këshillit mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë
email:krisaf2002@yahoo.com

Veprimtaria e institucioneve bankare në Shqipëri daton nga viti 1839, kur degë apo filiale të bankave osmane kryenin veprime në territoret shqiptare. Në fundin e shekullit të kaluar, në qytetet shqiptare të Shkodrës, Manastirit, Shkupit e Janinës ishin hapur filialat e Bankës Kombëtare Otomane. Ideja fillestare për themelimin e bankës kombëtare i përket njërit prej ideologëve më të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Sami Frashërit. Marrëveshja përkujdesore e Bankës Kombëtare Shqiptare, u nënshkrua më 4 tetor 1913, nga kryeministri i asaj kohe Ismail Qemali, me përfaqësuesit e bankës austriake "Vine-Bankë Ferrin" dhe përfaqësuesit e Bankës Tregtare Italiane. Jeta e saj ishte e shkurtër.

Në vitet 1921-1924 financat në Shqipëri karakterizoheshin nga një situatë kaotike. Qarkullonin monedha turke, lira italiane, franga zvicerane dhe belge, korona austriake, drahmi greke, dinarë serb, franga franceze, dollarë amerikanë, stërlina angleze etj. Sipas ekspertit të Lidhjes së Kombeve Albert Kalmes, në Shqipëri në vitin 1921 kishte në qarkullim apo të thesarizuara 50 deri në 100 milionë franga ari, duke përfashtuar bishuteritë dhe objektet e zbuluar prej ari. Në mars 1925, u nënshkrua në Tiranë konventa e krijimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, midis qeverisë shqiptare dhe një grupei financiare italiane. Më 12 shtator 1925, Banka nisi veprimtarinë. Për shqiptarët ajo identifikohej me një faktor progresi, përpjekje e huaj do të ishte alibia e qeverisë italiane, instrumenti përkushtuar ekonominë, politikën dhe zhvillimin e Shqipërisë. Pasojë e këtij koncepti ishte politika deflacioniste permanente, e cila do të ndryshonte pas 7 prillit 1939, kur Banka kaloi në politikën inflacioniste. Pas Luftës qeveria shqiptare abrogoi Konventën e 15 marsit, sekuestroi aksionet e saj dhe e kaloi të gjithë aktivitetin bankar në varësi të shtetit Shqiptar.

Uilliam Roxher, senator amerikan, duke folur përkushtuar qëndrore të bankave qendrore ka thënë se "...tre janë shpikjet më të mëdha, që nga fillimi i kohës së sotme: zjarri, rrota dhe banka qendrore."¹ Ky përcaktim përmendet zakonishët si cilësimi më i përshtatshëm dhe më domethënës, përpjekja e treguar hopin e jashtëzakonshëm që shkaktoi dhe kontributet e mëdha që solli krijimi i bankave qendrore në përshtetjen e ritmeve të zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Hapja e të parës bankë qendrore në botë përkon me mesin e shekullit të XVII. Ajo u themelua në Suedi, në vitin 1656 dhe konsiderohet si banka më e vjetër në botë. Më vonë, më 1694 u krijua

Banka e Londrës. Tendenca, dhe trjedhimisht nevoja e krijimit të bankave qendrore u përhap në të gjithë kontinentin europian. Brenda një harku kohor prej rreth tre shekujsh, pothuajse të gjithë shtetet europiane do të kishin bankën e tyre qendrore. Ky proces do të vazhdonte dhe do të përhapej gradualisht edhe në kontinentet e tjera. Numri i bankave qendrore në krejt ruzullin, sot ka arritur në 175.

Qëllimi kryesor i veprimit të bankave qendrore në fillimet e veta ishte emetimi i letrave me vlerë. Me kalimin e kohës ato do të përqendrohen në emetimin e monedhave kombëtare, duke ruajtur me ndonjë përfashtim ekskluzivitetin dhe monopolin e kësaj të drejte.²

Kjo sepse në periudhat e para të ekzistencës dhe

2 Po aty

¹ Citohet nga "Bankat qendrore të rajonit", botim i Bankës së Shqipërisë, pa vit dhe vend botimi, fq.6.

véprimtarisë, e drejta e emetimit të monedhave nuk ishte ende monopol ekskluziv i tyre. Atë e tushtronin edhe banka të tjera. Pasojë e drejtëpërdrejtë e kësaj dukurie ishte fakti që në një shtet mund të ishin në qarkullim lloje të ndryshme monedhash. Në SHBA, p.sh. në vitin 1912, vepronin 7355 banka me të drejtën e emetimit të dollarit. Një përvojë e tillë, shumë heterogjene, shtroi për diskutim çështjen; në se ishte e pranueshme dhe e dobishme konkurrenca e lirë edhe në fushën e emetimit monetar (free banking), apo e drejta e emetimit duhet t'iu përkiste vetëm bankave qendrore (central banking). Për një varg specifikash thelbësore triumfoi ideja e dytë, çka bëri që bankat qendrore, të jenë ndoshta rasti i vetëm në historinë e kapitalizmit, ku fitoja e monopolit mbi konkurrencën e lirë është absolute.³

Historitë e themelimit të bankave qendrore janë njëkohësisht të ndryshme dhe të ngashme. Të krijuara “nga nevoja e shteteve për të mbuluar deficitet e bilancit apo për të financuar bizneset e luftërat, qëllimi i tyre final është një: të nxisin rritjen e ekonomike, duke ruajtur stabilitetin e çmimeve”.⁴

E ndërsa banka e parë qendrore u krijuar rreth 350 vjet më parë, siç u tha, në skajet më veriore të kontinentit; në rajonet jugore të tij, themelimi i tyre do të niste gati dy shekuj me vonë.

Më 1863 themelohet Banka Kombëtare Osmane, më 1879 Banka e Bullgarisë, më 1880 Banka e Rumanisë, më 1883 Banka e Serbisë, më 1893 Banka e Italisë, më 1925 Banka Kombëtare e Shqipërisë, e cila kishte edhe tiparet dhe funksionet e Bankës qendrore dhe më 1928 u krijuar Banka e Greqisë.

Përpjekjet e para për krijimin e bankave në Shqipëri

Propozimet konkrete dhe përpjekjet e para për ngritjen e një banke në Shqipëri i përkasin gjysmës së dytë të shekullit të XIX, periudhës kur rilindasit shqiptarë hartonin platformat e krijimit të shtetit shqiptar të pavarrur dhe proklamonin programet e zhvillimit ekonomik e të prosperitetit të shpejtë të vendit.

3 Të dhënat e mësipërmie janë marrë nga artikulli i prof. Adrian Civicit, “Bankat qendrore, fajtore për krizën? Kur u themeluan, çfarë funksionesh kanë dhe në ç'mënyrë drejtojnë financat e një vendi? Çfarë roli kanë luajtur dhe luajnë në situatën ekonomike globale?”, botuar në Gazeten “Shqip”, 22 maj 2008.

Po aty.

Dokumentohet se, veprimtaria e institucioneve financiare në Shqipëri ka nisur në vitin 1839, kur degë apo filiale të bankave osmane kryenin veprime në territoret shqiptare.

Në fundin e shekullit të kaluar, në qytetet shqiptare të Shkodrës, Manastirit, Shkupit e Janinës ishin hapur filialet e Bankës Kombëtare Otomane, që ishte themeluar më 4 shkurt 1863, me kapitalet e një shoqërie anglo-franceze. Statuti i saj u miratua në vitin 1875.

Ato funksiononin duke iu nënshtruar legjislativit financiar të Perandorisë Otomane, që realizohej nëpërmjet një mbikëqyrësi të emëruar nga qeveria otomane.

Kapitali fillestar i asaj banke ishte 2 700 000 sterlina, dhe vetëm mbas trembëdhjetë vjetësh nga krijimi i saj, shuma e kapitalit bankar arriu në 5 milionë, dhe cila ishte e ndarë në 500 000 aksione.

Një tjetër bankë, Banka Agrare Turke, e krijuar në vitin 1888, do të inauguroonte filialet e veta në qytetet Shkodër, Kavajë, Tiranë, Elbasan, Berat, Korçë etj.

Ideja fillestare për themelimin e bankës kombëtare i përket njërit prej ideologëve më të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Sami Frashërit. Në veprën e tij madhore “Shqipëria çka qenë, ç'është e ç'do të bëhet”, ai trajton edhe domosdoshmërinë e çeljes së një banke në Shqipëri dhe emetimin e frangut shqiptar si monedha më e përshtatshme për kryerjen e operacioneve të zakonshme monetare.⁵

Më vonë, në prill të vitit 1901, avancohet ideja e ngritjes së një banke italiane në Mal të Zi, e cila do të vepronë edhe në Shqipëri.

Dy vjet më vonë, deputeti italian A. di San Giulianino, do të propozonte zhvendosjen dhe themelimin e saj në Shkodër.

I njëjti propozim do të rimerrej nga italani Batista Pellegrini, i cili në librin e tij “Drejt luftës? Mosmarrëveshjet mes Italisë dhe Austrisë” - “Verso la guerra? Il dissidio fra l’Italia e l’ Austria”, botuar në vitin 1906, iu kërkonte qeverisë dhe sipërmarrësve italiane të investonin për ngritjen e bankave në Shqipëri.

Në vitin 1907, Banca Commerciale d’Oriente hapi në Shkodër filialin e vet me emrin Banca “Tozzi and Company”.

Ekonomisti shkodran, Gaspér Guga do ta konkretizonë më tej idenë e bankës shqiptare, në librin me titull “Shqipëria e dy Vilajeteve të Adriatikut. Çështje të morfollogjisë dhe të antropogeografisë në rajonin shqiptar.

5 Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri, Parathënie, Tiranë, 2003, fq.5

Marrëdhëni e saj me Italinë dhe Austrinë. E ardhmja e saj ekonomike” – “L’Albania dei due Vilajet Adriatici. Appunti di morfologia e d’antropogeografia nella regione albanese. I suoi rapporti con l’ Italia e con l’ Austria. Il suo avvenire economico” botuar në vitin 1909, në Venezia të Italisë.⁶

► Pavarësia shqiptare dhe interesimi i të huajve për bankat.

Interesimi serioz i bankave të huaja për tregun shqiptar nis me shpalljen e pavarësisë dhe krijimin e strukturave të para të shtetit.⁷

Marrëveshja zyrtare për krijimin e të parës bankë kombëtare shqiptare, i takon 4 tetorit të vitit 1913. Atë e nënshkroi Kryeministri i asaj kohe Ismail Qemali, me Karol Pitner e Oskar Pollak, përfaqësuesit e bankës austriake “Vine-Bankë Ferrin”, me seli në Vjenë dhe me Pietro Fenolio e Guido Ansabher, përfaqësuesit e Bankës Tregtare Italiane (Banca Commerciale Italiana), me seli në Milano.

Kapitali i saj do të ishte 10 milionë korona ose 10.5 milionë lireta italiane, i ndarë në pjesë të barabarta aksionesh midis të dy grupave. Bankës i ishte njohur e drejta ekskluzive të emetonte bankënotë dhe të vepronte në fushën e kreditit.⁸

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, qeveria shqiptare, e interesuar për fillimin e menjëhershëm të veprimtarisë së saj, vuri në bankë fondet që dispononte, duke iu kërkuar

6 Po aty, fq.9-10

7 Kjo çështje është trajtuar nga një varg studiuesish shqiptarë e të huaj, ndër të cilët veçojmë botimin e Haxhi Shkozës, “Financat e Shqipërisë (1839-1934)”, Tiranë, 1935, studimet e prof. Iliaz Fishta, “Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri (1925-1944)”, botim i Universitetit të Tiranës, Tiranë, 1971 dhe “Ndërhyrja e kapitalit të huaj dhe pasojat e saj skllavëruuese për Shqipërinë” (1925-1931), botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1979, librin e Veniamin Toçit, “Ndërhyrja e kapitalit të huaj në Shqipëri dhe qëndrimi i qarqeve demokratike (1921-1925)”, botim i Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1974, Giuseppe di Nardi, “Le finanze pubbliche dell’ Albania”, në librin “Principi di economia albanese”, Padova, 1941, Zhivko Avramovski, “Italijanska ekonomika penetracija v Albaniju 1925 do 1939 godina”, në Istorija XX veka, zbornik radova v Institut Druzhestvenih nauka, otdele-nije za istorijske nauke, Beograd, 1963 etj.

8 “Banka Kombëtare e Shqipërisë”, Vlorë, 1914 (broshurë), citohet sipas Iliaz Fishta, “Ndërhyrja e kapitalit të huaj dhe pasojat e saj skllavëruuese për Shqipërinë (1925-1931)”, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1979, fq.13-14.

edhe tregtarëve shqiptarë të depozitonin mijetet e tyre të lira.

Ismail Qemali e vlerëson veçanërisht rolin e bankës, duke e konsideruar themelimin e saj si clirim i dytë të Shqipërisë nga pikëpamja ekonomike dhe politike.⁹

Por, jeta e kësaj banke ishte e shkurtër. Ngjarjet që përshkuan jo vetëm Shqipërinë, por krejt rajonin, krijuan vështirësi që shkaktuan mbylljen e veprimtarisë pas pak muajsh aktivitetit.¹⁰

Më vonë, në vitin 1914, qeveria shqiptare e asaj kohe, e ndodhur në vështirësi të shumta financiare, kërkonte marrjen e një huaje për përballimin e situatës së vendit. Thirrjet së princ Vudit, iu përgjigjën disa qarqe financiare austriake. Kësaj nisme iu kundërvu Franca, nën pretekstin e pjesëmarrjes së barabartë të fuqive kryesore në kapitalin e bankës.

Me projektin e ndërkombëtarizimit të bankës shqiptare u bashkua edhe Italia, çka e detyroi Austrinë të tërhoiqej nga ideja e saj fillestare.

► Bankat në Shqipëri gjatë dështimit të Luftës së Parë Botërore.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, kur Shqipëria u shkel nga ushtritë e palëve ndërluftuese, duke përfituar nga amullia që sundonte në vend, hapën degët e tyre disa banka austriake, siç ishin Vine Bankë Ferrin, pëtë cilën u fol më lartë, Peste Bankë dhe Ungarische Bankë.¹¹

Pas mbarimit të luftës, me ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar, ndërsavazhdonin demarshet për themelimin e një banke shqiptare, qeveritë e asaj kohe e drejtuan vëmendjen edhe në organizimin dhe sistemimin e situatës financiare.

Mbi bazën e ligjit Nr. 41, të datës 6 maj 1920, u emetua huaja e brendshme e shtetit shqiptar me prerje 50 franga ari. Huaja përbëhej nga një radhë me 40 000 pjesë të një shume prej 2 milionë frangash ari.

Në gusht të po atij viti, qeveria e kryesuar nga Sulejman Delvina, nisi negociatat me përfaqësues të qeverisë italiane për çështje me karakter ekonomik e financiar. Duke iu referuar Bankës Kombëtare të Shqipërisë të vitit 1913, përfaqësuesit shqiptarë theksuan se marrëveshja

9 Shih tekstin e Aktit të koncessionit në “Ismail Qemali, përmbledhje dokumentesh (1888-1919)”, Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të shtetit, Tiranë, 1982, fq. 358-366

10 Haxhi Shkoza, “Financat e Shqipërisë (1839-1934)”, Tiranë, 1935, fq. 779-780.

11 Iliaz Fishta, “Ndërhyrja e ..” .vepër e cituar (vep. cit.), fq.15.

e krijimit të saj, e tectorit të vitit 1913, nuk ishte më e përshtatshme për kushtet e asaj kohe. U sugjerua që t'i propozohej ndonjë grapi financiar italian për të themeluar një bankë të shtetit shqiptar, me kapital të përbashkët shqiptaro-italian, si person juridik shqiptar.

Në maj të vitit 1921, Italinë e vizitoi një delegacion shqiptar, i kryesuar nga ministri i financave, për të biseduar me strukturat përkatëse italiane mundësinë e krijimit të bankës kombëtare shqiptare. Qëndrimet e ngurtësuara divergjente të të dyja palëve bënë që negociatat të përfundonin pa sukses.

Ndërkaq, qeveria shqiptare vazhdonte përpjekjet për vendosjen e rregullit dhe stabilizimin e situatës financiare e bankare. Në qershori të vitit 1921 u vendos që nxjerra e të ardhurave shtetërore të bëhej mbi bazën e frangut ar, sipas kurseve që u caktuan për monedhat e tjera që ishin në qarkullim. Disa muaj më pas, Këshilli Kombëtar, duke diskutuar masat në fushën e monedhës, u përqendrua në tre projekte. Mbi bazën e tyre, në mars të vitit 1922, u miratua ligji përkatës për emetimin e kartëmonedhës kombëtare në një shumë prej 3 milionë frangash ar, ligj, i cili për shkaqe të ndryshme, nuk arriti të hynte në fuqi.

Situata kaotike financiare në vitet 1921-1924 Në vitet 1921-1924 financat në Shqipëri karakterizoheshin nga një situatë kaotike. Vazhdonin të qarkullonin "monedha të vlerave nga më të ndryshmet e të prejardhjeve më absurdë, imbetje të monedhave turke, lira italiane, franga zvicerane dhe belge"¹² si dhe korona austriake, dhrahmi greke, dinarë serb, franga franceze, dollarë amerikanë¹³, stërlina angleze etj. „E gjithë kjo shumëlojshmëri monedhash ishte një pengesë e madhe, që sillte shumë konfuzion në vend, si dhe humbje të pasurisë kombëtare në lidhje me zhvlefësimet e kursit në marrëdhëniet e jashtme.“¹⁴

Domosdoshmëria e krijimit të sistemit monetar e të kreditit, ishte evidentuar si imperativ i kohës.¹⁵

12 Indro Montanelli, "Shqipëria një dhe njëmijë, Homeri ka qënë në Shkodër", Shtëpia Botuese Letrat, Tiranë, 2004, fq.106

13 Dollari amerikan filloi të qarkullonte në Shqipëri pas vitit 1919.

14 Sejfi Vllamasi, Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897-1942, (Kujtime dhe vlerësimë historike), Tiranë 1995, fq. 206.

15 Të dhënat e mësipërme janë marrë nga botimi "Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri", Tiranë, 2003, f.14-16 si dhe nga "Historia e Ekonomisë së

Në vijim të përpjekjeve për organizimin dhe përmirësimin e gjendjes ekonomiko-financiare, në qershori të vitit 1922, qeveria shqiptare iu drejtua Lidhjes së Kombeve për të dërguar një ekip ekspertësh me qëllim që të vlerësoheshin mundësitë e vendit për investimet e huaja. Me këtë rast komiteti financiar i Lidhjes dërgoi në Shqipëri si ekspert financiar Albert Calmes, profesor i Universitetit të Luksemburgut.

Në shtator të vitit 1922, ai i paraqiti komitetit në fjalë raportin e hollësishëm mbi situatën financiare.

Sipas tij, në Shqipëri në atë kohë, kishte në qarkullim apo të thesarizuara 50 deri në 100 milionë franga ari, duke përjashtuar bizhuteritë dhe objektet e zbuluar prej ari.¹⁶

Si konkluzion rekomandonte krijimin e një banke emisioni dhe krediti, me kapitale vendase e të huaja. Ajo do të drejtohej nga të huajt dhe do të shërbente si instrument lehtësues për shfrytëzimin e pasurive të shumta që kishte vendi.¹⁷

Një vit më vonë, Lidhja e Kombeve dërgoi holandezin I.D.Hunger për të parashtruar projektin e krijimit të bankës.

Në vijim, nga qershori deri në shtator të atij viti, u paraqitën disa projekte për krijimin e një Banke Kombëtare të Shqipërisë.

Sipas njërit prej tyre, i propozuar prej Lidhjes së Kombeve, sugjerohej që në kapitalin themelues të Bankës, të caktuar në shumën prej 5 milionë fr. ar, të merrnin pjesë si aksionerë Anglia, Franca dhe Italia me nga 25 % secila, Belgjika me 5 %, Shqipëria me 10 % dhe disa shtete të tjera me 10 %.¹⁸

► Projekti për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë

Ideja u vlerësua tërheqëse dhe interesante sidomos nga Italia. Duke iu referuar vendimit të 9 nëntorit të vitit 1921, të Konferencës së Ambasadorëve, të Parisit, i cili i njihte pozita preferenciale në Shqipëri, ajo u mundua të shmangete pjesëmarrjen e Anglisë e të Francës. Për këtë qëllim, drejtori i Credito Italiano, Mario Alberti, u ngarkua nga qeveria italiane të projektonte krijimin e një grapi italo-zvicerano-amerikan ose italo-zvicerano-holandez, i cili

Shqipërisë, 1944-1960", Shtëpia Botuese "Dita", Tiranë, 2004, me autorë Iliaz Fishët dhe Mihal Ziu, fq. 38.

16 Albert Calmes, "La situation économique et financière de l' Albanie ", Geneve, September, 1922.

17 Albert Calmes, Po aty

18 Iliaz Fishët, "Ndërhixja e ..." vep.cit, fq.19-20.

do të sugjerohej në Lidhjen e Kombeve, si alternativa më e përshtatshme për marrjen e koncesionit të themelimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Kapitali i bankës do të financohej nga Instituti Kombëtar Italian për Shkëmbimet me Botën e Jashtme, duke i siguruar kapitalit italian pjesëmarrje të gjerë dhe pothuajse krejt kontrollin e bankës.¹⁹

Idetë e mësipërme nisën të konkretizoheshin, duke u modifikuar me qëllim që synimet italiane të realizoheshin në mënyrën më të mirë të mundshme. Në këto zhvillime bënte pjesë edhe zëvendësimi i partnerëve amerikanë apo holandezë me përfaqësues të një shoqërie belge. Projekti i bankës, i konsideruar si një ndër elementët më të rëndësishëm të politikës ekspansioniste, u përfshi në programin strategik të ndërhyrjes italiane në Shqipëri, që do të kishte si mbështetje juridiko-ndërkombe të vendimin e 9 nëntorit 1921, të konferencës së Ambasadorëve, për të cilin u fol më lartë dhe që "i njihet Italisë de facto një protektorat mbi Shqipërinë".²⁰

Përpjekjet për krijimin e Bankës do të përjetonin zhvillime të cilat implikuan situata të veçanta në marrëdhënet politike të Shqipërisë jo vetëm me Italinë, por edhe me Britaninë e Madhe, Jugosllavinë, Greqinë etj. Edhe ato shfaqën gjithashtu interes për t'u përfshirë në projektet për krijimin e bankës së Shqipërisë.

Pas një odiseje të gjatë trattativash tepër të vështira, në negociata intensive, ku nga njëra anë avancoheshin premtimi të bujshme pa kursim dhe nga ana tjeter formuloheshin kërcënime të ashpra, u arrit që qeveria shqiptare e asaj kohe të pranonte kushtet e imponuara nga Italia.

► Aktet themeluese të Bankës Kombëtare të Shqipërisë

Në mars të vitit 1925, u nënshkrua në Tiranë, një konventë midis qeverisë shqiptare dhe një grupi financiar italian, i quajtur Credito italiano, Genova. Aivendosi kapitalin themeltar, të përbërë nga 100 000 aksione themeluese dhe 15 000 aksione të zakonshme. Përveç atij në themelin e Bankës Kombëtare Shqiptare morrën pjesë edhe disa nga bankat më të fuqishme italiane, si Banca Commerciale Italiana, e Milanos, me 30 000 aksione të zakonshme, Banca Nazionale di Credito, e Milanos, me 30 000 aksione të zakonshme, Banco di Roma, e Romës, me 30

000 aksione të zakonshme, si dhe disa banka të tjera më të vogla, me 20 000 aksione të zakonshme. Në grup përfaqësohen edhe një holding jugosllav, i përbërë nga Banka Zadruga e Beogradit, Banka serbe e Zagrebit, Banka Adriatiko-Danubiane e Beogradit dhe Banka Serbo-Shqiptare e Cetinjës, i cili zotëronte 10 % të kapitalit ose 50 000 aksione të zakonshme, disa holdinge të tjera, si Banka Tregtare e Bazelit, me 50 000 aksione të zakonshme dhe Banka belge me jashtë, Degë e Societe Generale të Belgjikës, me qendër në Bruksel, me 25 000 aksione të zakonshme. Themelues të Bankës Kombëtare Shqiptare ishin edhe disa individë shqiptarë të quajtur Ajet Bej Libohova me 40 000 aksione të zakonshme, Ekrem Bej Vlora, me 58 000 aksione të zakonshme, Nexhet Pasha Vlora, me 52 000 aksione të zakonshme, të cilët zotëronin të gjithë së bashku 30 % të kapitalit.

Krahas tyre ishin edhe italiane Ugo Viali, me 40 000 aksione të zakonshme, Vincenzo Azzolini, me 25 000 aksione të zakonshme dhe Massimo Aurelio me 30 000 aksione të zakonshme, etj.²¹

Kapitali i përgjithshëm i Bankës numëronte 595 000 aksione, të cilët ishin të barabartë me 12 500 000 franga ari.²²

Credito italiane kishte maxhorancën e aksioneve.

Edhe pse ndarja e kapitalit të bankës, sipas konventës, ishte 51 % me 49 % në favor të italianeve, nëpërmjet manovrimeve të shumta, presioneve e premtimeve pala italiane arriti ta zvogëlonë pjesëmarrjen e palës shqiptare në shifra minimale. Sipas analizave dhe vëzhgimeve të studiuesit shqiptar të kësaj fushe, prof. Iliaz Fishta, rezulton se kuota e nënshkruar nga shqiptarët arriti në 15 384 aksione, numëry i barabartë me 3.1 % të krejt shumës së përgjithshme të aksioneve të bankës.²³

Afati i vlefshmërisë të konventës ishte 50 vjet, me të drejtë zgjatjeje. Sipas Konventës, banka do të kishte një kapital nominal prej 12 500 000 franga ari, që ndahej në 495 000 aksione të zakonshme me vlerë prej 25 franga ari secili dhe në 100 000 aksione themelare me vlerë prej 1.25 franga ari secili.

Drejtoria qendrore do të vendosej në kryeqytetin e Shqipërisë. Veprimtaria e saj do të kryhej në

21 Të dhënat e mësipërme janë marrë nga botimi "Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri", Tiranë, 2003, fq.28

22 Alessandro Roselli, Italy and Albania : Financial Relations in the Fascist Period, Botuar në 2006 nga I.B.Tauris & Co.Ltd, London, fq. 36.

23 Iliaz Fishta, "Ndërhyrja e ..." vep.cit., fq.116.

19 Iliaz Fishta, "Ndërhyrja e ..." vep.cit., fq.22.

20 Bernd J. Fischer, "Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri", Çabej MÇM, 1996, fq. 98.

përputhje me ligjet e shtetit shqiptar. Sipas pikës 11 të Konventës, banka duhet të përgatiste një rezervë metalike në ar ose në argjend në shufra ose në monedhë, me vlerë sa një e treta e bankënotave të emetuara.

Më 23 qershor të vitit 1925, parlamenti shqiptar miratoi ligjin për rregullimin e monedhës, i cili i njihte Bankës Kombëtare të Shqipërisë të drejtën ekskluzive të nxjerrjes së kartëmonedhave si dhe për prerjen e monedhave prej ari e argjendi. Ky ligi kaloi edhe në Senat, më 5 korrik 1925. Kurse më 12 korrik 1925, Ahmet Zogu, me cilësinë e kryetarit të shtetit shqiptar firmosi dekretin që urdhëronte ekzekutimin e paketës ligjore të fillimit të veprimtarisë së Bankës Kombëtare të Shqipërisë e përbërë nga akter e mëposhtme:

- a) Konventa e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, e ratifikuar më 15 mars 1925 dhe e shpallur në Fletoren Zyrtare, më 18 prill 1925;
- b) Konventa mbi huan për punët botore të Shqipërisë, prej 50 000 000 franga ari;
- c) Ligji organik i Bankës Kombëtare të Shqipërisë;
- d) Ligji mbi rregullimin e monedhës, me gjithë ndryshimet e bëra prej dy dhomave legislative në Konventën dhe në Ligjin organik të Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Konstituimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë Pas përfundimit të procedurave të nevojshme dhe miratimit të akteve të mësipërme, më 2 shtator 1925, në Romë, në prani të aksionerëve dhe të përfaqësuesve zyrtarë të qeverive italiane, shqiptare e jugosllave (në kapitalin e Bankës merrnin pjesë edhe 4 banka jugosllave me një numër të kufizuar aksionesh - 50 000 aksione të zakonshme), u inaugura konstituimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe u zgjodh Këshilli Administrativ i saj. Ai përbëhej nga këshilltarët administrativë, sindikët efektivë, sindikët plotësues, inspektorët në Romë dhe drejtoret e filialeve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Si këshilltarë administrativë u zgjodhën 8 persona, prej të cilëve 7 ishin të huaj dhe vetëm njëri do të ishte përfaqësues i qeverisë shqiptare.

Banka Kombëtare e Shqipërisë, pavarësisht se në kapitalin e vet themeltar kishte pjesëmarrje edhe nga sipërmarrës të huaj, publikë e privatë, ishte institucion shqiptar.

Prova të pakontestueshme të shtetësisë shqiptare të ish Bankës Kombëtare të Shqipërisë janë një varg elementesh.

Së pari, duhet përmendur emri i saj, Banka Kombëtare Shqiptare;

Së dyti, ishte lloji i aktivitetit, i fokusuar

veçanërisht në emetimin e biletave bankare me një kurs legal dhe pushtet të lirë që është edhe atributi kryesor i sovranitetit të shtetit, i cili i ishte njohur asaj;

Së terti, vendi i zhvillimit të aktivitetit të saj në territorin shqiptar;

Së katërti, vendndodhja e selisë në kryeqytetin e Shqipërisë;

Së pesti, vendosja nën juridikcionin shqiptar për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktreve që mund të kishte me të tretët dhe, lidhur ngushtë me këtë, detyrimi institucional për të zbatuar legislacionin shqiptar;

Së gjashti, njohja e të drejtës për të pranuar fondet e shtetit shqiptar;

Së shratë, misioni për të kryer shërbimin e thesarit shqiptar;

Së teti, pjesëmarrja e shtetit shqiptar në të ardhurat e saj dhe ndërhyrja e tij nëpërmjet caktimit të përfaqësuesve të vet në Këshillin Administrativ;

Së nënti, publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë e të të gjithë operacioneve të saj më të rëndësishme në Gazetën Zyrtare të shtetit shqiptar dhe mbi të gjitha njohja e kësaj banke me dekret të ish Presidentit të shtetit shqiptar.²⁴

► Fillimi i veprimtarisë së Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Më 12 shtator të vitit 1925, Banka nisi veprimtarinë e vet zyrtare.

Sic u tha, në Shqipëri përpëra se të krijohej Banka Kombëtare nuk kishte një sistem monetar kombëtar. Në vend të kartëmonedhave përdorëshin monedha ari ose argjendi. Pagesat pér shitblerjet e ndryshme bëheshin direkt në napolona floriri ose në korona argjendi e jo në kartëmonedha. Për këtë shkak, vështirësitet financiare të shkaktuara nga Lufta e Parë Botërore, Shqipëria nuk i provoi në ato përmasa që i kaloi mbarë Europa. Madje në krahasim me shumë vende të tjera, Shqipëria pati një rezervë ari të konsiderueshme. Ekzistencën e një stoku të madh ari në Shqipëri e ka pohuar, siç u përmend më sipër edhe profesori i Luksemburgut Albert Kalme (Calmes).

Përrjedhojë Banka Kombëtare e Shqipërisë nuk e filloi veprimtarinë në vakum. Përkundrazi, gjeti në vend rezerva të konsiderueshme ari e argjendi, monedhash të huaja etj. Duke vënë në qarkullim

24 Studim për veprimtarinë e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Fondi IARA, D.Nr. 17, v. 1947

kartëmonedha, akumuloi sasi të rëndësishme ari dhe devizash të huaja.

Gjatë periudhës së parë, tremujori i fundit i vitit 1925, 31 dhjetor 1926, kur u mbyll ushtrimi i parë finanziar, ajo emetoi biletat banke kundrejt blerjes së arit në një sasi prej 277.000 fr. ari dhe të devizave të huaja të konvertueshme në ar (dollarë, stërlina dhe franga zvicerane) në një shumë prej 2.962.000 fr. ari.²⁵

Gjatë vitit 1927 duke shtuar më tej emetimin e biletave të bankës, ajo grumbulloi ar dhe deviza të huaja të konvertueshme në ar, në shumën 13.464.000 fr. ari.²⁶

► Hedhja në qarkullim e monedhave të para .

Më 28 shkurt e 10 mars 1926 u hodhën në qarkullim për herë të parë kartëmonedhat dhe monedhat metalike. Kyeprimit duhet të përbente një ngjarje të shënuar në historinë e vendit. Por studiues të ndryshëm, duke e vendosur atë në kontekstin e zhvillimeve të përgjithshme politike e ekonomike të kohës e kanë vlerësuar këtë moment si delikat e problematik.

Studiuesi amerikan Bernd J. Fischer, në analizën e tij të gjithanshme për Shqipërinë e periudhës së Zogut, komenton edhe hedhjen në qarkullim të monedhave nga Banka Kombëtare e Shqipërisë. Ai shprehet se “monedhat e para që u prenë prej Bankës së re ishin një element ogurzi, që paralajmëronin ngjarjet që do të zhvilloheshin në të ardhmen”.²⁷

Nëpërmjet kësaj banke, Italia do të ndërhyninte tashmë në mënyrën më komode e njëkohësisht legale në buxhetin, në sistemin monetar dhe të kreditit dhe përmes tyre në të gjitha zhvillimet e brendshme të Shqipërisë.²⁸

Zhvillimet e ardhshme do të provonin përfat të keq konkluzionin ekstrem të Bernd Fisher, i cili thoshte se Konventa për themelimin e Bankës “ishte aq e pavolitshme për Shqipërinë, sa që tingëllói si rënia e kambanave të vdekjes përfqido synim të mëtejshëm përvavarësi ekonomike”.²⁹

► Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe kreditë financiare.

Ndërkojë, që përgatitej dhe nënshkruhej

marrëveshja përfunduan procedurat ligjore e institucionale edhe përkredinë e Shoqërisë për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë, SVEA - (Societa per lo Sviluppo Economico del' Albania).

Sipas dekretligjit nr.28, dt.15.3.1925 “Mbi pranimin e koncesioneve për themelimin e Bankës Kombëtare Shqiptare dhe operacionet e huas”, Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë - SVEA, do të krijohej prej Bankës, një muaj pas fillimit të aktivitetit të saj, me një kapital prej 15.000.000 lireta italiane.

U themelua më 25 prill 1925, krejtësisht me kapitale shtetërore italiane. Kjo del edhe nga ekspozëja e ministrit italian, La Malfa, para Këshillit të Ministrave të Italisë, më 9.4.1951, i cili në pjesën ku bëhej fjalë përent publike dhe shoqëritë aktivitet ekonomik dhe në të cilat shteti ka marrë pjesë direkt ose indirekt, numëronte midis të tjera edhe SVEA-n, me kapital 15 milionë lireta. Sipas tij, në të ka marrë pjesë thesari italiano, krejtësisht me kapitale të veta.

Veç kësaj, në Dekretin mbretëror Nr. 1699, të 19 shtatorit 1935, thuhet se shteti italiano ka financuar SVEA-n në dhënien e kësaj kredje, e cila do të kontribuojë direkt për interesat ekonomike të kombit italiano (neni 1).³⁰

Edhe ish mëkëmbësi i mbretit italiano në Shqipëri, Francesco Jacomoni, shprehej se “huaja ishte krejtësisht e shtetit italiano.”³¹

Studiuesit kanë arritur në konkluzionin se SVEA, sikurse edhe kredia 10-vjeçare e 26 qershorit 1931, kredia bujqësore e 11 marsit 1936, kredia përvendosjen e monopolit të duhanit e 19 marsit 1936 dhe ajo për ndërtimin e skelës së Durrësit, si produkte të ish Bankës Kombëtare të Shqipërisë, i shërbyen pak zhvillimit ekonomik të Shqipërisë apo përmirësimit të jetës së popullit shqiptar. Ata i kanë stigmatizuar si instrumente që kontribuuin në humbjen e pavarësisë politike e ekonomike, që përgatitën e sollën 7 prillin e 1939-ës.

Në këtë përfundim ka dalë edhe studiuesi Bernd J. Fischer, i cili thotë se marrëveshja e SVEA-s, “e lidhi ekonomikisht Shqipërinë me Italinë gjatë gjithë periudhës midis dy luftërave”.³²

30 Registrato alla Corte dei Conti, Add. 28 Settembre 1935, anno XIII, Atti del Governo registrato, 364, foglio 131, Mancini, sipas AMPJ- Fondi-Traktati i Paqes me Italinë, Dosja A/II/30 v.1955 N/D, nr.4

31 Francesco Jacomoni, *Gjysma ime shqiptare, botimet "Ora"*, Tiranë, 2005, fq. 21.

32 Bernd J. Fischer, “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”, Çabej MCM, 1996, f. 103

Si konfirmim i shprehur i konkluzionit të Fisherit shërben edhe një pohim i Salvatore Kontarini, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë. Duke folur në ato kohë për rolin që i ishte caktuar projektit të bankës ai thoshte se “Banka e shtetit shqiptar, e kontrolluar nga ne do të formonte një bérthamë financiare të një rëndësie të atillë, e aftë për zhvillime të mëtejshme bankare e industriale, që do të na japë praktikisht në të ardhmenin mjetin më praktik dhe të sigurt për t'i rezervuar Italisë një gjendje prioriteti në ekonominë shqiptare.”³³

Ajo do të ishte ndër elementët kryesorë përbërës të një sistemi kredish italiane, që patën si zanafillë dispozitat e “një traktati sekret ushtarak. Nëpërmjet tij Shqipëria angazhohej të vinte në dispozicion të Italisë territorin e saj në rast të ndonjë lufte me Jugosllavinë, në këmbim të lejimit të përdorimit të zonave naftëmbajtëse, koncesioneve bujqësore në zona që do të përcaktohen, krijimit të Bankës së Emetimeve Shqiptare me kapital Italian.”³⁴ Traktati u nënshkrua më 26 gusht të vitit 1925 dhe ishte parakusht i një akti tjetër politik publik, që nijhet me emrin Traktati i Miqësisë dhe i Sigurisë, ose Pakti i Parë i Tiranës. Ai u përfundua në rrethana tepër të vështira politike dhe ekonomike për pushtetin e Ahmet Zogut. “I vetëdijshëm se me këtë veprim po e lidhët veten ndaj politikës italiane, Zogu u përhoq edhe një herë të negacione, me gjithë seriozitetin në rritje të revoltës në veri të vendit.”³⁵ Kur italianët, që po e humbitnin krejt durimin, e kërcënuan se do të dërgonin flotën, Presidenti e kuptoi se loja e gjatë kishte përfunduar. Më 27 nëntor (të vitit 1926) i izoluar diplomatikisht dhe i kërcënuar nga brenda, Zogu u detyrua të vihej nën protektoratin e Musolinit, gjë të cilës i ishteshmangur për aq kohë”.³⁶

Sic u përmend më sipër, pretendimet dhe synimet aneksioniste italiane ndaj Shqipërisë përligjeshin në opinionin dhe politikën ndërkomëtare, natyrisht jo me zë të lartë, si një e drejtë që Italia e kishte fituar me vendimin e 9 nëntorit 1921, të 33 Pietro Pastorelli, “Italia e Albania (1924-1927)”, Firenze, 1967, fq.102-103, citohet sipas Iliaz Fishta, “Ndërryra e kapitalit ...” vep.cit., fq. 53.

34 Francesco Jacomoni, Gjysma ime shqiptare, botimet “Ora”, Tiranë, 2005, fq. 20.

35 Eshtë fjalë për revoltën që shpërtheu më 20 nëntor të vitit 1926, në veri të Shqipërisë, e cila për shkak të përmasave dhe të zhvillimeve që mori përfaqësonte një trezik iminenet dhe tepër serioz për regjin e Zogut.

36 Bernd J. Fischer, “Mbreti Zog dhe ...” vep.cit., fq. 111.

Konferencës së Ambasadorëve, të Parisit. Chamberleni, ministri i punëve të jashtme të Britanisë së Madhe, do ta cilësonë aso kohe Shqipërinë si “Belgjika italiane”, në kuptimin e një vendi të vogël që duhet të mbrohet nga fqinjët agresivë.

Kjo deklaratë u interpretua si drita jeshile për shtrirjen e influencës italiane në Shqipëri.³⁷

Në kuadrin juridiko-ndërkomëtar, politika aneksioniste italiane ndaj Shqipërisë do të konkretizohej nëpërmjet Traktatit të 27 nëntorit 1926, i njohur ndryshe edhe si Pakti i parë i Tiranës, i ndjekur më pas nga Pakti i dytë i Tiranës, nënshkruar një vit më vonë, më 22 nëntor 1927.

► Banka Kombëtare e Shqipërisë instrument kontrolli mbi ekonominë shqiptare.

Se ç'përfaqësonte Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe cili ishte roli që i ishte caktuar asaj në politikën italiane në Shqipëri, mjaftron t'i referohemi vlerësimëve që janë bërë aso kohe nga përfaqësues të lartë të qeverisë italiane dhe të asaj shqiptare.

I ngarkuari me punë i Italisë në Durrës, Ugo Sola, më 19 shkurt 1925, i shkruante Romës se Banka Kombëtare e Shqipërisë do të jetë organizmi “përmes të cilit do të mundemi të sigurojmë kontroll real mbi të gjithë ekonominë shqiptare”. Dhe më tej vazhdonte: “Nuk e fsheh se, ndoshta ky do të ishte rasti i fundit që na ofrohet për të lidhur ekonominë shqiptare me ekonominë tonë dhe se çfarëdo momenti tjetër nuk do të gjente këtu një qeveri të aftë për të përkrahur dhe për të bërë që të aprovojen në parlament të tilla koncesione”.³⁸

Këtë e kuptonte fare mire edhe udhëheqja shqiptare e asaj kohe. I ndërgjegjshëm për çka po ndodhë, Ahmet Zogu, më 19 gusht të vitit 1925, i tha ndër të tjera të dërguarit të posaçëm të Musolinit, Alessandro Lessona, se në qoftë se brenda tre ditëve nuk do të jeni në gjendje të më siguroni një hua, “unë do të humb fuqinë, ndërsa për Italinë do të perëndojojnë shpresat për

37 M.H.H. McCartney and P.Cremona, Italy's Foreign and Colonial Policy, London, Oxford University Press, 1928, p.111- Citar sipas - Alessandro Roselli, Italy and Albania : Financial Relations in the Fascist Period, Botuar në 2006 nga I.B.Tauris & Co.Ltd, London, fq. 42

38 Arkivi Qendror Shqiptar, Fondi Legata Italia, Telegrami i Ugo Sola drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, Nr.81, datë 22.2.1925 - cituar sipas Iliaz Fishta, “Ndërryra e kapitalit të huaj dhe pasojat e saj skllavëruese për Shqipërinë (1925-1931), botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1979, fq.56.

të arritur të vendosë ndikimin e saj në këtë rrip të bregut të Adriatikut".³⁹

Më 13 qershor të vitit 1926, Benito Musolini i shkruante përfaqësuesit italian në Tiranë: "Kërkesa e re financiare e Zogut nuk më çudit, sepse, duke marrë parasysh se është dëshira jonë për ta lidhur pas nesh, është e pashmangshme që përmby ne të bien disa shqetësimë financiare, në të cilat ndodhet kjo qeveri. Por duhet pasur parasysh që të sigurohem, se sakrificat tona financiare, të cilat sa vijnë e bëhen më të mëdha, po të marrim parasysh edhe furnizimin ushtarak, të arrijmë që ne të sigurojmë atë rezultat politik që synojmë. Në qoftë se kjo nuk arrihet, do të jetë rasti që t'i përbahemi vetëm zbatimit të marrëveshjes së SVEA-s, për të arritur menjëherë ose më vonë me vënien në veprim, të mekanizmit të pengjeve dhe t'u përbahemi vetëm atyre...".⁴⁰

Më 21 qershor të po atij viti, Ahmet Zogu, i thoshte përfaqësuesit italian në Tiranë, Pompeo Aloisi: "Shkëlqesia e tij Musolini... ka në dorë provat që unë kam dhënë e do të jap në fushën financiare, ekonomike, ushtarake e politike për ta lidhur ngushtësisht vendin tim me politikën italiane. Ai e di mirë se nga çdo anë vijnë akuza, se unë i jam shitur Italisë, për të cilat unë nuk shqetësohem; ai ka në dorë një marrëveshje të fshehtë shumë më komprometuese se çdo marrëveshje tjeter që mund të bëjmë dhe unë e autorizoju të publikohet kur të dëshirojë ai.".⁴¹

Banka Kombëtare e Shqipërisë për shqiptarët identifikohej me të drejtë me një faktor të rëndësishëm progresi, që duhet të përshtejtonte ritmet e zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe do të ndikonte në prosperitetin dhe mirëqenien e tyre.

Krejt ndryshe e përfytyronin dhe e konstruktonin atë partnerët e huaj.

Grupi financiar italian, që s'ishte gjë tjetër veçse alibia e pafshehur e qeverisë së atëhershme italiane, e mendonte si një instrument tepër komod për të ndërryrë, ndikuar dhe dominuar në të gjithë jetën e shqiptarëve, në ekonominë, politikën dhe në zhvillimin e komanduar të Shqipërisë, në përshtatje me interesat ekspansioniste të Italisë fashiste.

39 Alessandro Lessona, "Memorie", Firenze 1958, fq. 101.

40 DDI, settima serie, Vol. IV, dok. 334, f.243 - citohet sipas Iliaz Fishta, "Ndërrhyra e kapitalit..." vep.cit, fq. 127-128.

41 DDI, settima serie, Vol. IV, dok. 341, fq.248 - citohet sipas Iliaz Fishta, "Ndërrhyra e kapitalit..." vep. cit., fq. 129.

Politika deflacioniste e BKSH.

Veprimitaria e Bankës Kombëtare të Shqipërisë u shoqërua me një ritmkë problematike.

Në dy vjetët e parë të ekzistencës së Bankës ritmet e qarkullimit të kartëmonedhave vazhdonin të shtoheshin gjithmonë e më shumë. Bashkë me të rritheshin edhe rezervat e arit që depozitoheshin në kasafortat e Bankës. Aty inkasoheshin gjithashtu gjithë devizat e huaja që futeshin në Shqipëri, veçanërisht ato që dërgonin emigrantët shqiptarë nga jashtë shtetit, të cilat në atë kohë vlerësohen në 6.000.000 dollarë në vit.⁴²

Të dhënët mbi bilancet e çdo ushtrimi financiar të Bankës Kombëtare Shqiptare, prej vitit 1926 e gjer në vitin 1943 dëshmonin se emetimi i biletave bankare bazohej kryesisht në depozitat e kursimeve të shqiptarëve, në blerjet e arit dhe të devizave të huaja, si edhe në operacionet e kreditit.

Por, këto të fundit ishin të pallogaritshme. Banka nuk përdori për dhënie kredie as pjesën e kursimeve nga populli. Në këtë mënyrë ajo stimuloi krizën në tregun shqiptar, pasojat e së cilës rezultuan katastrofike për ekonominë e vendit.

Me këtë rrugë u arrit, që kohët e fundit të aktivitetit të saj, Banka Kombëtare Shqiptare të kishte në aktivin e bilancit të saj një shumë prej 8.062.826 fr. ari⁴³. Ajo ishte mbulesa e biletave bankare që Banka Kombëtare e Shqipërisë kishte vënë në qarkullim.

Si të gjitha bankat e emisionit edhe Banka Kombëtare e Shqipërisë gjëzonte të drejtën që të emetonte kartëmonedha, të cilat kishin vlerë legale brenda vendit.

Kjo e drejtë do të përdorej duke ruajtur një raport proporcional midis sasisë së kartëmonedhave të emetuara dhe rezervës në ar e argjend. Ashtu si përmjaft shtete edhe në Shqipëri ishte vendosur rregulli që «Banka do të ruante një rezervë në metal (ar dhe argjend, në monedha dhe në shufra) me një vlerë të barabartë me 1/3 e biletave bankare të emetuara».

Ai ishte fiksuar në nenin 11 të Konventës së përfunduar midis grupit financiar italian dhe qeverisë shqiptare, më 15 mars 1925, ratifikuar me ligjin nr.48 të 12 korrikut 1925, por edhe në nenin 22 të Statutit të Bankës.

Veprimitaria dhe ecuria problematike e Bankës do të ndikohet edhe nga ndërthurja e veprimit

42 Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme,Fondi IARA,D.Nr. 17,v. 1947

43 Po aty.

të njëkohshëm të dy elementëve.

Nga njëra anë ishte kriza e përgjithshme botërore e viteve 1929-1933, pasojat e të cilës në Shqipëri vazhduan deri në mesin e vitit 1935.

Nga ana tjetër ishte vetë politika restrikitive e ndjekur me vetëdije nga udhëheqja e Bankës, për të dominuar zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Pasojë direkte e kësaj politike ishte kufizimi i sasisë së kartëmonedhave në qarkullim, që çoi në një deflacion gati permanent. P.sh. nga 14 020 000 franga ar që ishin në qarkullim në prill të vitit 1933, shifra zbriti në 10 529 000 franga ar në fund të vitit 1938.

Në vitin 1927 Amadeo Gambino, anëtar influent në Këshillin Administrativ të Bankës, duke mbajtur parasysh nivelet e varférës, çeqet në qarkullim dhe ritmin e ulët të qarkullimit monetar, dilte në konkluzionin se në Shqipërinë e asaj kohe çdo shqiptari i mjaftonte një qarkullim monetar mesatar në vlerën e 25 franga ar, çka do të thoshte se sasia e përgjithshme e monedhës duhet të ishte rreth 20 milionë franga ar. Kjo sasi, sipas tij, do të vinte duke u rritur bashkë me zhvillimin ekonomik, duke arritur në 45 - 50 franga ar për person, ose një sasi të përgjithshme prej 32 - 40 milionë franga ar, e cila nuk u arrit asnjëherë. Ndërkohë, me politikën e monopolit të tregut të kreditit dhe atë të kreditimit të kufizuar për kapitalin shqiptar, Banka pengoi zhvillimin e shpejtë ekonomik.

Në të njëjtën kohë ra në minimum shkëmbimi i kartëmonedhave në monedha prej ari. Nga 325 000 franga ari në vit që shkëmbeshin mesatarisht në vitet e para, sasia arriti në 8 000 franga ar në vit, në periudhën 1932 -1933 dhe akoma më keq, në 2660 franga ar në periudhën 1934-1936.⁴⁴

Të dhëna të pakontestueshme, dëshmojnë, se përpara Luftës së Dytë Botërore, franga shqiptare ishte ndër monedhat më të forta në Europë.⁴⁵ P.sh. në vitin 1939, qarkullimi monetar kishte një mbulesë në ar dhe në valuta të huaja të forta prej 245.93 %, nga e cila vetëm në ar 71.94 %. Ekspertët e kohës kanë arsyetuar se kjo mbulesë e fortë shpjegohet me politikën deflacioniste artificiale që ndiqte Banka Kombëtare Shqiptare,

⁴⁴ Të dhënat e mësipërme janë marrë nga botimi "Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri", Tiranë, 2003, fq.23, 34, 39, 43, 44.

⁴⁵ Shih për këtë edhe numurin e Korrikut 1977 të "International Currency Review" - Sipas Alessandro Roselli, Italy and Albania : Financial Relations in the Fascist Period, Botuar në 2006 nga I.B.Tauris & Co.Ltd, London, fq. 45.

e cila shprehej ndër të tjera në mbajtjen e monedhës në qarkullim nën nivelin e nevojave të vendit, grabitjen e arit dhe argjendit shqiptar, rritjen artificiale të vlerës së frangut dhe rishpërndarjen e të ardhurave kombëtare.⁴⁶ Duke iu referuar gjuhës së shifrave kjo politikë deflacioniste, shprehej në zvogëlime drastike të sasisë së monedhave në qarkullim. P.sh. nga 14 020 000 franga ari që ishin në qarkullim në prill të vitit 1933, sasia zbriti në 10 529 000 franga ari në vitin 1938. Ose nga rreth 325 000 fr. ari që shkëmbeshin mesatarisht çdo vit, në vitet e para të veprimtarisë së Bankës, u arrit në rreth 8 000 fr. ari në vit në periudhën 1932-1933, për të zbritur në 2 220 fr. ari në vit në periudhën 1934-1935.⁴⁷ Synimi ishte që ta mbante ekominë e Shqipërisë në gjendjen e një krize permanente, për të krijuar kaos ekonomik dhe situatë politike të tenduar e të ndërlikuar. Ky do të ishte një tjetër motiv për të justifikuar si rrugëdalje pushtimin fashist.⁴⁸

Demarshe nga banka të huaja të tjera për depërtim në Shqipëri

Paralel me demarshet për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, gjatë gjithë periudhës 1920 - 1939 dhe me veprimtarinë e saj, pati jo pak përpjekje nga të tjerë institucione bankare të huaja, për të hyrë në Shqipëri.

Duke lënë mënjanë orvatjet e viteve 1920-1925, ndërhyrjet dhe diskutimet e vazdueshme, në të cilat, siç u tha më lartë, u përfshi edhe Lidhja e Kombeve dhe duke u ndalur ne fillimet e vitit 1925, nuk mund të mos të përmenden ofertat e kapitalit britanik, francez, belg, zviceran, holandez, jugosllav, grek etj.

Përfaqësuesit e tyre, me gjithë vështirësitet e shumta me të cilat iu duhej të përballeshin, i vijuan përpjekjet.

Në shkurt të vitit 1925, ndodheshin në Shqipëri një grup sipërmarrësish britanikë, të Grupit Midland, përfaqësuesit e të cilëve përgatiten edhe skemën e një marrëveshjeje për koncesionin e Bankës dhe propozuan krijimin e Bankës me një kapital prej 500 000 stërlinash. Por bisedimet, të cilat tërthorazi fokusoheshin dhe ngecnin tek çështja e shumës që do të jepej si ryshfet për qeveritarët shqiptarë, dështuan.⁴⁹

⁴⁶ Prof. Iliaz Fishta dhe Prof. Ass. Dr. Esmeralda Uruçi, në "Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri", Tiranë, 2003, fq. 43.

⁴⁷ Po aty, fq. 34.

⁴⁸ Po aty, fq. 20-21, 39, 43.

⁴⁹ Sipas Bernd J. Fischer, "Mbreti Zog dhe ..." vep.cit. fq. 101-102.

Një muaj më vonë, në mars - prill të vitit 1925, ishin Banka Serbo-Shqiptare me qendër në Cetinjë dhe Banka e Athinës, që tentuan të vendoseshin në Shqipëri. Banka e Cetinjës e mori autorizimin përkatës më 3 prill 1925, çka u legalizua në maj të po atij viti.⁵⁰

Më 6 maj 1934 nisi punën në Tiranë filiali i Bankës së Eksportit, me qendër në Beograd. Në nentor 1937, mbërriti Banka e Napolit, e cila shumë shpejt do të shndërrrohej në një konkurrente të fuqishme edhe të vetë Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Nga ana tjetër nuk mungojnë përpjekjet e sipërmarrësve shqiptarë për t'u përfshirë së bashku me sipërmarrjen e huaj në iniciativat për krijimin e bankave në Shqipëri.

Nisur nga politika diskriminuese në fushën e kreditit, që ndiqej ndaj kapitalit vendas nga Banka Kombëtare e Shqipërisë, në vitin 1927 sipërmarrës shqiptarë të përqendruar sidomos në rajonin e Korçës, bënë publik propozimin për krijimin e një banke me kapitale të përbashkëta.⁵¹

Në qershor të vitit 1931 vjen propozimi i avancuar nga Mehmet Konica, ish ministër në qeverinë e Ahmet Zogut dhe shkodrani Mark Kakarriqi. Të nxitur edhe nga përfaqësues të sipërmarrësve britanikë ata propozuan krijimin e një banke anglo-shqiptare, të quajtur "Anglo-Albanian Bankë Ltd".⁵²

Por, këto orvatje rezultuan pa sukses.

Deri në kohën e pushtimit fashist të Shqipërisë, në vend ishin vendosur dhe operonin Banka Kombëtare e Shqipërisë, e cila kishte 8 degë dhe agjenci, Banka e Napolit, me 4 të tillë, Banka Bujqësore e Shtetit, gjithashu me 4 degë dhe agjenci dhe filiali i Bankës së Eksportit të Beogradit, e cila kishte vetëm një degë.⁵³

Inaugurimi i selisë së Bankës

Kombëtare të Shqipërisë.

Pas kalimit të rreth 13 vjetëve, në historikun e Bankës Kombëtare të Shqipërisë do të shënohet një ngjarje e veçantë. Më 30 tetor të vitit 1938 u inaugura selia qendrore e Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, ndërtuar në "Skënderbej", sheshin kryesor të kryeqytetit shqiptar, Tiranë, çka solli edhe transferimin e saj nga Durrësi në Tiranë.

50 "Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri", Tiranë, 2003, fq.23.

51 Po aty, fq.32.

52 Po aty, fq.37

53 Po aty, fq.50

Ajo ishte projektuar nga arkitekti italian Vittorio Ballio Morpurgo.⁵⁴ Stili arkitektonik i përket rrjmës së racionalizmit, tipik për gjysmën e parë të shekullit të kaluar në Europë. Ai shquhet përvellimet e mëdha dhe linjat e forta në fasada, çka dallohen me lehtësi edhe aktualisht në ndërtesën e Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Ajo ishte dhe imbetet një vepër arti dhe një vlerë e spikatur për urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Tiranës. Korpusi i saj është ndërtuar në formën e një harku, i detyruar nga pozicioni në hyrje të sheshit kryesor të qytetit. Hyrja kryesore është realizuar me një portal madhështor, të mbështetur në kolona të forta, që përfshin gjithë lartësinë e fasadës dhe është zbuluar me murale në argjilë të pjesëve të një kompleks i jep një paraqitje shumë dinjitoze godinës.⁵⁵

BKSH – në kohën e Luftës

Pas 7 prillit 1939, Banka Kombëtare e Shqipërisë kaloi në ekstremin e kundërt. E shndërruar në bastion të interesave politike e ekonomike të Italisë në Shqipëri ajo u vu hapur e plotësisht në shërbim të pushtuesve italianë e më pas gjermanë. Ndoqi politikën e inflacionit, triti në përpjësëtime të mëdha sasinë e monedhave në qarkullim. Bilanci i 31 dhjetorit 1944 i BKSH, i nënshkruar rregullisht nga drejtori i përgjithshëm i saj Dr. Ettore Melis dhe drejtori i kontabilitetit Rag.Giovani Trapani tregon se kjo shtesë ishte 381 592 000 fr.shq. Domethënë nga 11 939 000 fr.shq. që ishte sasia e monedhës në qarkullim me 6.4.1939, kishte arritur në 393 492 000 fr.shq. më 31.12.1944.⁵⁶

Periudha e pushtimit karakterizohet nga një varg zhvillimesh, disa prej të cilave përbëjnë hapa të rëndësishëm në ekzistencën dhe funksionimin e bankave në Shqipëri dhe si të tillë, mendoj se meritojnë të vihen në dukje.

Duhen përmendur së pari thithja, në majin e vitit 1939, e Bankës Bujqësore të Shtetit nga ana e Bankës së Napolit, e fuqizuar së tepërtmi gjatë kësaj kohe dhe mbyllja në vitin 1939, e filialit të Bankës së Eksportit të Beogradit, që ishte goditur rëndë nga efektet e konkurrencës së imponuar. Zhvillim tjetër ishte hapja në Tiranë e filialit të Bankës Kombëtare të Punës (Banca Nazionale del Lavoro), e cila do të shndërrrohej shumë shpejt në

54 Po aty, fq.50

55 Po aty, fq.50

56 "Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri", Tiranë, 2003, fq.58, 75

një konkurrente të fortë të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të Bankës së Napolit.

Në tetor 1940, në prag të fillimit të operacioneve luftarake kundër Greqisë, udhëheqja e Bankës Kombëtare të Shqipërisë iu vuri në dispozicion autoriteteve italiane një sasi kartëmonedhash të huaja si dollarë, drahimi, dinarë si dhe franga shqiptare për t'i përdorur për financimin e ushtrisë italiane përtrej kufijve të Shqipërisë.

Pas disfatës së ushtrive italiane në frontin e luftës kundër Greqisë, në krahinat shqiptare të Korçës dhe të Gjirokastrës hynë trupat ushtarake greke. Autoritetet greke nxorën urdhëresën sipas së cilës dhrahmia konsiderohej si e vetmja monedhë me kurs ligjor.

Ndërkojë, në fillimin e vitit 1941, u hodh për diskutim shtrirja e veprimtarisë së Bankës Kombëtare të Shqipërisë edhe në territorin e Malit të Zi.

Kjo nismë parashikonte ndër të tjera hapjen e filialeve të saj në Cetinje e në Tivar dhe me pas krijimin e një banke të përbashkët shqiptaro-malazeze, e cila do të emetonte një monedhë të përbashkët të quajtur ALMO, shkurtim i emrave Albania dhe Montenegro.

Projekti nuk u realizua.

Në qershor të vitit 1941, kur mbretëria jugosllave u pushtua nga ushtritë nazi-fashiste, u vendos bashkimi i trojeve shqiptare të Jugosllavisë me Shqipërinë e pushtuar nga Italia. Pasojë direkte e këtij vendimi ishte shtrirja e veprimtarisë së frangut shqiptar në territoret shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi. Ai vepronte krahas dinarit jugosllav.

Në dhjetëditëshin e dytë të shtatorit 1943, pas kapitullimit të Italisë fashiste, autoritetet pushtuese italiane në largim e sipër urdhëruan pezullimin e veprimtarisë së bankave në Shqipëri, me përjashtim të disa operacioneve të kufizuara që mund të kryente Banka Kombëtare e Shqipërisë.

Në 12 shtator 1943 Gjermania naziste që kishte zënë vendin e pushtuesve italianë në Shqipëri, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të saj, urdhëron marrjen e rezervës në ar, rezervës së kartëmonedhave, klisheve të stampimit dhe rezervave në devizë, të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, që ndodheshin të depozituara në Romë.

Kartëmonedhat u nisën me avion pjesë pjesë për në Tiranë, kurse gjithë të tjerat u dërguan në Berlin.

Më 16 shtator 1943 organi drejtues i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, i quajtur Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm, miratoi urdhrin, "Mbi

rregullimin e raporteve midis shtetit shqiptar dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë", sipas të cilit Banka do t'i kalonte shtetit shqiptar gjithë fitimin e saj, kundërvlefëtë e monedhave divizonale në qarkullim deri në 10 shtator 1943, do të derdhë 4 % të shumës së kartëmonedhave në qarkullim deri në 10 shtator 1943, etj.

Më 3 nëntor 1943 u kërkua që rezerva e arit që u mor në Romë, më 16 shtator 1943 dhe u depozitua në Berlin, t'i kthejë Shqipërisë.

Në muajt shtator - nëntor 1943 Banka Kombëtare e Shqipërisë e urdhëruar nga autoritetet pushtuese gjermane iu dha atyre disa dhjetëra milionë franga shqiptare në formë „huaje“.

Në muajt nëntor-dhjetor 1943 zhvillohen bisedime shqiptaro-gjermane për problemet ekonomiko-bankare, në të cilat diskutohet çështja e arit (çështje që u diskutua pa rezultat edhe herë të tjera gjatë gjysmës së parë të vitit 1944), e devizave dhe e klisheve që u morën në Romë, çështja e huave, kursi i shkëmbimit midis frangut shqiptar dhe markës gjermane etj.

Gjatë vitit 1944 Banka vazhdoi financimin e ushtrive gjermane, kurse më 30 tetor 1944 gjermanët grabitën krejtësisht thesarin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë si dhe gjithë rezervat e gjetura në franga ar dhe në franga shqiptare në degët e Bankës në Vlorë (ku ishin edhe rezervat e degëve të Gjirokastrës e të Sarandës), në Korçë, Berat, Elbasan, Prizren, Shkodër, Tiranë etj.

Pas Luftës qeveria shqiptare vendosi abrogimin e Konventës së 15 marsit të vitit 1925, midis shtetit shqiptar dhe grupit finanziar italian, sekuestrimin e akcionave të Bankës Kombëtare dhe kalimin e të gjithë aktivitetit të saj në favor të shtetit Shqiptar.

Vendimet e miratuara u vlerësuan në pajtim me të drejtat sovrane, me interesat dhe me ligjet e shtetit shqiptar. Ndonëse në bazë të nenit 5 të Konventës, grupi finanziar italian ishte angazhuar të respektonte legjislacionin shqiptar, u vërtetua se ai e kishte dhunuar dhe shpërfillur sistematikisht dhe kishte sjellë dëme serioze në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, finanziar, bankar e politik të Shqipërisë.

Autoritetet shqiptare konstatuan se Banka Kombëtare e Shqipërisë, para dhe gjatë pushtimit italian të vendit praktikoi një politikë bankare dhe financiare në kundërshtim me interesat e Shqipërisë. Ajo preferoi dhe favorizoi institucionet dhe firmat italiane, sidomos ato me

karakter shtetëror e politik, duke u shndërruar në instrument që stimuloi dhe lehtësoi ekspansionin ekonomik e politik të Italisë fashiste, që ndihmoi gjërësisht okupatorët italianë e gjermanë.

BKSH nxori jashtë vendit arin dhe devizat e huaja, që ishin pronë e popullit shqiptar.

Për këto arsyet shteti shqiptar, me ligjin e posaçëm të 13 janarit 1945, vendosi nacionalizimin e saj.⁵⁷

Menjëherë pas çlirimit të vendit u morën masa që veprimtaria e Bankës Kombëtare të Shqipërisë të vihej në rrugën e normalizimit, dhe të merrte rolin që i takonte si institucioni qendror bankar i Shqipërisë dhe instrument i rëndësishëm përimëkëmbjen e ekonomisë.

57 Të dhënat e mësipërme janë nxjerrë nga botimi "Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri", Tiranë, 2003, fq.53-76

BANKA QENDRORE EUROPIANE -EUROSISTEMI, SISTEMI EUROPIAN I BANKAVE QENDRORE



Banka Qendrore Europiane

Ideja e parë që të vjen në mendje në lidhje me "një bankë qendrore", ka shumë mundësi të jetë për një institucion që nxjerr monedhën. Monedha është mjeti që ne përdorim si njësi llogaritjeje, mjet pagesë dhe rezervë vlerë. Qëllimi kryesor i çdo bankë qendrore është të mbikëqyrë ruajtjen e vlerës së monedhës në kohë. Por, në ditët tona, veprimitaria kryesore e një banke qendrore mbulon edhe fusha të tjera, më pak të njoitura. Ndër to edhe komunikimi. Një bankë qendrore nuk duhet vetëm të bëjë atë që thotë se bën, por edhe të shpjegojë atë që bën, me qëllim që të përforcojë sensibilitimin e publikut dhe njojjen e politikave që ajo zbaton dhe të shërbimeve që ofron. Ky artikull është një nga instrumentet e komunikimit mbi aktivitetet e Bankës Qendrore Europiane, (BQE) në mes të Sistemit European të Bankave Qendrore (SBEQ) me Bankat Qendrore Kombëtare (BQK) të 27 vendave anëtare të Bashkimit Europian. Për të gjithë shtetet anëtare që nuk e kanë vendosur euron si monedhë, përdoret termi Eurosistem për të treguar njësinë që përbledh BQE dhe bankat qendrore kombëtare të shteteve anëtare që e kanë vendosur Euron, e që aktualisht janë 15. Eurosisetmi kryen shumicën e misioneve që traktati mbi Bashkimin Europian ia cakton SEBQ.

Etapat që çuan në bashkimin ekonomik dhe monetar në BE

► Integrimi europian

Ideja për të krijuar një bashkim ekonomik dhe monetar në Europë e ka fillesën rrëth 50 vjet më parë. Ajo ishte e pranishme në mendjet e udhëheqësve politikë që themeluan në vitin 1952 Komunitetin Europian të Qymyrit dhe Çelikut (CECA), ku bënин pjesë gjashtë vende: Belgika, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda. Integrimi Europian njoftua përparrime të reja gjatë viteve 1950 dhe më tej. Gjashtë vendet e cituara më lart krijuan Komunitetin Ekonomik Europian, (CEE) dhe Komunitetin Europian të Energjisë Atomike (Euroatom) në vitin 1958. Lidhjet u forcuan dhe u thelluan përgjatë viteve edhe përmes krijimit të Komunitetit Europian (KE) dhe më pas të Bashkimit Europian (BE) me adoptimin

e Traktatit të Maastrichtit në vitin 1993. Me kalimin e kohës u rrit numri i vendave anëtare. Danimarka, Irlanda, dhe Mbretëria e Bashkuar u anëtarësuan në vitin 1973, të ndjekur nga Greqia 8 vjet më pas. Portugalia dhe Spanja u bënë anëtarë në vitin 1986 ndërsa Austria, Finlanda, Suedia, u anëtarësuan në vitin 1995. Ky zgjerim u vazhdua edhe më 1 maj 2004, kur Republika Çeke, Estonia, Qipro, Letonia, Lituania, Hungaria, Malta, Polonia, Sllovenia, Sllovakia, u bënë anëtare të Bashkimit Europian. Të fundit që u anëtarësuan ishin Bullgaria dhe Rumania në 1 janar 2007.

Kriteret e Kopenhangenit përcaktojnë kushtet paraprake të nevojshtme për një pranim në BE. Vendet e ardhshme që do të anëtarësohen duhet të tregojnë: një stabilitet institucional që garanton demokracinë, epërsinë e së drejtës, respektin e të drejtave të njeriut si edhe respektin dhe mbrojtjen e pakicave, ekzistencën e ekonomisë së tregut në funksion,

si edhe kapacitet për t'i bërë ballë konkurrencës me qëllim që të jetë i aftë të përballojë detyrimet e anëtarësimit, dhe sidomos të pajtohet me qëllimet e bashkimit politik, ekonomik dhe monetar.

► Integrimi ekonomik

Në vitin 1970, raporti Werner¹ ka qenë përpjekja e parë drejt realizimit me tre etapa, të bashkimit ekonomik dhe monetar, që dukej në horizont në vitet '80. Megjithatë, në një kontekst të shënuar në të njëjtën kohë nga tensione shumë të forta mbi tregjet e shkëmbimit ndërkombëtar, pasojë e shembjes së sistemit të Breton Woods në fillim të viteve '70 dhe nga një rënie e ekonomisë botërore e shkaktuar nga kriza e parë e naftës në vitin 1973, këto projekte që përbën filletat e bashkimit ekonomik, nuk do të realizoheshin. Në vitin 1979, për t'i bërë ballë mungesës së stabilitetit, nëntë shtetet anëtare të Komunitetit Ekonomik të momentit krijuan sistemin monetar europian. Ky karakterizohej kryesisht nga një mekanizëm shkëmbimi i themeluar mbi kurse të njëjtë shkëmbimi, por të rregullueshme, midis monedhave të nëntë shtetave anëtare. Në vitin 1986 Akti unik europian i cili vendosi tregun e përbashkët, i ri-dha jetë idësë së një ekonomie të vetme europiane dhe monetare. Vetëm futja e një monedhe të vetme midis vendeve pjesëmarrës do t'u lejonte të përfitonin plotësisht nga avantazhet e tregut të vetëm. Në vitin 1988, Këshilli Europian i kërkoi komitetit Delors të studionte modalitetet e ndërtimit të një Bashkimi Ekonomik Monetar. Raporti Delors, i paraqitur në vitin 1989, coi në hapjen e negociatave në lidhje me traktatin mbi Bashkimin Europian, që krijoj Bashkimin Europian dhe amendoi traktatin që krijonte Komunitetin Europian. Traktati mbi Bashkimin Europian u nënshkrua në vitin 1992 në Maastricht (prej nga vjen emri që i jepet zakonisht si traktati i Maastrichtit) dhe hyri në fuqi në 1 nëntor të vitit 1993.

Realizimi i Bashkimit Ekonomik dhe Monetar u krye në tre fazë.

Faza e parë, (1990-1993) u karakterizua kryesisht nga realizimi i tregut të vetëm europian falë heqjes së të gjithë pengesave të brendshme dhe qarkullimit të lirë të personave, të mallrave

kapitaleve dhe shërbimeve në Europë.

Faza e dytë, (1994-1998) filloi me krijuimin e Institutit Monetar Europian. Ajo u përqendrua tek përgatitjet teknike të nevojshme për kalimin në monedhën e vetme, u imponoi si detyrim qeverive të shmangin deficitet e tepërtë, dhe përforcoi përputhjen e politikave ekonomike dhe monetare të shtetave anëtare (me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së çmimeve dhe të financave publike të shëndetshme).

Faza e tretë filloi në 1 janar 1999 me fiksimin e pakthyeshëm të kurseve të këmbimit, transferimit të kompetencave në fushën e politikës monetare te BQE dhe futjes së euros si monedhë e vetme. Që prej janarit të vitit 2002, monedhat dhe kartëmonedhat në euro qarkullojnë ligjërisht në të gjitha vendet pjesëmarrëse, duke qenë se monedhat kombëtare dolën ligjërisht nga qarkullimi në shkurt të vitit 2002.

► Kriteret e përputhshmërisë

Vendet që duan të kenë euron si monedhë të përbashkët, duhet të arrijnë një nivel të lartë "përputhshmërie të qëndrueshme". Kjo shkallë përputhshmërie vlerësohet mbi bazën e disa kriterieve, të vendosur nga Traktati i Maastrichtit, sipas të cilëve një vend duhet të ketë:

- Shkallë të lartë qëndrueshmërie të çmimeve.
- Financa publike të shëndetshme.
- Kurse këmbimi të qëndrueshme
- Interesa afat gjatë të ulët dhe të qëndrueshëm

Kriteret janë përcaktuar në mënyrë të tillë që vetëm vendet që ndjekin politika ekonomike të orientuara drejt stabilitetit dhe që kanë arritur rezultate në fushën e qëndrueshmërisë së çmimeve, mund të pranohen në fazën e tretë të Bashkimit Ekonomik Monetar. Traktati kërkon gjithashtu që banka qendrore e çdo vendi të jetë e pavarur. (shih nenin 108 të traktatit)

Në maj të vitit 1998, njësamit i Bashkimit Europian i organizuar në Bruksel konfirmoi se 11 nga 15 vendet anëtare i kishin plotësuar kriteret e fiksuar për adoptimin e monedhës së përbashkët. Në 1 janar të vitit 2000, këto vendi e vendosën euron si monedhë të vetme. Greqia u bashkua me këtë grup vendesh në 1 janar të vitit

¹ Pierre Werner ishte kryeministri i Luksemburgut në atw kohë.

2001, pasi përbushë kriteret. Të tjerë vende i kanë përbushur kriteret e përputhshmërisë që prej asaj kohe dhe kanë hyrë në zonën euro. Slllovenia në 1 janar 2007 dhe Qiproja e Malta në 1 janar 2008. Një vend anëtar, Suedia, nuk i ka plotësuar të gjithë kushtet. Për më tepër, Danimarka dhe Mbretëria e Bashkuar, janë "vende anëtarë që përfitojnë nga një status i veçantë". Protokollet shtojcë të traktatit që themelon Komunitetin Europian, i njohin të drejtën këtyre dy vendeve pér të marrë ose jo pjesë në fazën e tretë të Bashkimit Ekonomik Monetar, (BEM) d.m.th adoptimi i euros. Ata kanë vendosur të dy të përdorin këtë "klauzolë përjashtimi" duke e vënë në dijeni Këshillin e BE-së pér qëllimin e tyre të mos kalimit në fazën e tretë, që do me thënë të mos jenë ende pjesë e zonës euro.

Suedia dhe nëntë nga 12 vendet që janë anëtarësuar që prej vitit 2004, janë shtete anëtarë “objekte të një derogacioni”, për aq sa ata nuk i kanë përbushur të gjithë kriteret që u mundëson anëtarësinë në zonën euro. Fakti që ekziston ky derogacion, do të thotë që një vend anëtarështë i cilituar nga disa dispozita, jo nga të gjitha, që normalisht zbatohen që në fillim të fazës së tretë të BEM. Bëhet fjalë sidomos për tërësinë e dispozitave që lidhen me transferimin e përgjegjësive në fushën e politikës monetare, Këshillitë guvernatorëve të BQE. Ashtusi Suedia, vende të tjera anëtarë të Bashkimit Europian që nuk e kanë vendosur ende euron, nuk disponojnë “klauzola përjashtimi” si ato të negociuara nga Mbretëria e Bashkuar dhe Danimarka. Kjo do të thotë që, duke u anëtarësuar në BE, shtetet e reja do të adoptojnë euron, kur të kenë plotësuar kriteret e përputhshmërisë. BQE dhe Komisioni Europian hartojnë raporte çdo dy vjet - ose me kërkesë të një vendi anëtar që ka përfituar nga derogacioni - mbi progresin e arritur në procesin e plotësimit të kritereve të përputhshmërisë. Këto raporte mbi përputhshmërinë marrin gjithashtu në konsideratë të tjerë faktorë që kanë të ngjarë të ndikojnë procesin e integrimit të vendeve të ndryshme në ekonominë e zonës euro. Vendimi i Këshillit të Bashkimit Europian për të lejuar një vend të ri të marrë pjesë në zonën euro, mbështetet mbi këto raporte.

D) Karakteristikat kryesore të zonës euro.

Vendet e ndryshme që ishin tashmë pjesë e zonës euro ishin ekonomi relativisht të hapura para hyrjes së tyre në zonë. Ata sot formojnë një ekonomi më të gjerë, dhe shumë më autonome. Për nga përmasat, zona Euro mund të krahasohet me ekonomi të mëdha si SHBA dhe Japonia. Zona Euro me një popullsi prej 318 milion banorë në vitin 2006, është një nga ekonomitë më të mëdha të botës. Bashkimi Europian në tërësinë e tij numëron 27 vende anëtarë dhe një popullsi prej 493 milion banorë. Sa për krahasim, SHBA dhe Japonia kanë respektivisht 299 dhe 128 milion banorë.

Për sa i përket Prodhimit të Brendshëm Bruto, (PBB) i shprehur me kursin e fuqisë blerëse, SHBA ishin ekonomia më e madhe në 2006, me 19.7 % të PBB botëror. Zona Euro ishte në vend të dytë (14.3%), e ndjekur nga Japonia (6.3%). Kurse si pjesë të veçanta, vendet e ndryshme të zonës euro janë shumë më modestë, më i madhi ndër ta përfaqëson vetëm 3.9 % të PBB botëror në 2006. Zona Euro mund të preket shumë nga evolucionet e ekonomisë botërore. Karakteri më pak i hapur i ekonomisë së saj do të thotë se variacionet e çmimit të mallrave të importuara, kanë vëçse një efekt të kufizuar mbi çmimet e brendshme. Megjithatë, ekonomia e zonës euro është më i hapur se ajo e SHBA - ve ose e Japonisë. Në vitin 2006, eksportet e mallrave dhe shërbimeve të zonës euro, të shprehur me përqindje të PBB, ishin dukshëm më të larta, rrëth 21.6% , se ato të SHBA- ve (11%) ose të Japonisë (16.8 %).

► Përparësítë e Euros

Falë Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, Bashkimi Europian ka bërë një hap të rëndësishëm në rrugën drejt vendosjes së tregut të brendshëm. Tashmë, konsumatorët dhe ndërmarrjet mund të krahasojnë lehtësisht çmimet dhe të gjejnë furnizues konkurrentë brenda zonës euro. BEM, ndër të tjera, siguron edhe një mjedis ekonomik dhe monetar të qëndrueshëm në Europë, që favorizon një rritje të qëndrueshme dhe krijim vendesh të reja pune. Monedha e përbashkët, u dha fund turbullirave të shkaktuara nga luhatjet e papritura të kurseve të këmbimit të monedhave të vjetra kombëtare. Hedhja në qarkullim e monedhave dhe kartëmonedhave në euro në 1 janar 2007, ka lehtësuar udhëtimet brenda zonës

Euro. Çmimet e mallrave dhe shërbimeve mund të krahasohen për një sekondë, ndërsa pagesat mund të bëhen me të njëjtën monedhë në të gjithë vendet pjesëmarrëse.

Vendosja e Euros ka sjellë si pasojë zhdukjen e kostove lidhur me operacionet e shkëmbimit dhe të rreziqeve të shkëmbimit në zonën Euro. Në të kaluarën, këto rreziqe dhe kosto pengonin konkurrencën midis vendeve. Përkundrazi, përforcimi i konkurrencës, favorizon një shpërndarje më të fryshtme të burimeve. Falë monedhës së vetme, lehtësohen shumë edhe vendimet për investim, sepse ndryshimet e kurseve të këmbimit nuk ndikojnë më në fitimet e investimeve të realizuara në vende të ndryshme të zonës Euro. Para hyrjes së euros, tregjet e kapitaleve kishin gjithashtu një karakter kombëtar. Instrumentet financiare, si obligacionet e shtetit dhe aksionet, ishin të formuluara në monedhat vendase. Vendosja e euros u shoqërua me një përparim të madh në rrugën e integrimit të tregjeve të kapitaleve në zonën Euro. Dhe Euro do të vazhdojë të ndikojë strukturën e ekonomisë europiane. Në shkallë të ndryshme, integrimi verifikohet në çdo segment të sferës financiare :

- Tregu inter-bankar i zonës euro është plotësisht i integruar.
- Tregu i obligacioneve, i formuluar në euro është gjerësisht i integruar, i thellë dhe elastik. Ai ofron një larimi instrumentesh për kursim dhe financim.
- Tregu i aksioneve i zonës euro po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një treg i vetëm.
- Shkrirjet dhe përfimet e realizuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar janë shumëfishuar në sektorin bankar të zonës euro.

Thellësia dhe cilësia e një tregu të integruar kapitalesh, favorizojnë financimin e rritjes ekonomike, pra, krijimin e vendeve të punës. Individët kanë në dispozicion një larimi më të madhe mundësish për vendimet e tyre në lidhje me kursimet ose investimet. Ndërmarrjet mund të kërkojnë që një treg kapitalesh shumë i gjerë, të financojë aktivitetet e tyre dhe të përdorin mijete të reja financiare për t'u mbrojtur nga rreziqet e ndryshme financiare dhe të përmirësojnë

administrimin e investimeve të tyre.

► Struktura dhe misioni

Sistemi European i Bankave Qendrore dhe misioni.

SEBQ u krijuar në përputhje me Traktatin e Mastrihit dhe me Statutet e Sistemit European të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Europiane. Ai përfshin Bankën Qendrore Europiane dhe Banka Qendrore Kombëtare (BQK) të të gjithë vendeve anëtare të BE-së. Eurosistema nga ana e tij, përfshin BQE dhe BQK tëtë gjithë vendevanëtare që kanë pranuar Euron. (aktualisht janë 15). Organet vendimmarrëse të BQE-së janë Këshilli i Guvernatorëve dhe direktorati. Këshilli i Guvernatorëve merr vendimet e politikës monetare. Direktorati zbaton këto vendime dhe është përgjegjës për administrimin e vazhdueshmë të BQE. Organi i tretë vendimmarrës i BQE është Këshilli i Përgjithshëm, që do të vazhdojë të ekzistojë për aq kohë sa të gjithë vendet anëtare të kenë pranuar Euron si monedhë të përbashkët.

► Banka Qendrore Europiane

BQE u vendos në 1998 në Frankfurt mbi Main. Ajo pasoi Institutin Monetar Europian. BQE është një institucion mbi-kombëtar që gjëzon personalitet juridik. BQE ndodhet aktualisht në tre ndërtesa në qendër të Frankfurtit, por në vitin 2011 do të vendoset në selinë e saj të re, që është në ndërtim e sipër, në pjesën lindore të qytetit. Personeli i BQE, rekrutohet nga 27 vendet anëtare, dhe është me të vërtetë europian.

► Misioni i Eurosistemit

Eurosistemit i janë besuar katër misione kryesore. I pari ka të bëjë me zbatimin e politikës monetare të vendosur nga Këshilli i Guvernatorëve i BQE-së, si kur është fjala për vendimet lidhur me përqindjet drejtuese të interesit, (përqindja e soumission minimal që zbatohet ndaj operacioneve kryesore të rifinancimit, ashtu edhe për përqindjet e facilitetit të huasë marxhinale dhe të lehtësisë së depozitimit), ashtu edhe kur është fjala për vendimet që kanë të bëjnë me qëllimet monetare dhe me furnizimin e rezervës.

Direktorati ngarkohet me zbatimin e politikës monetare. Ai e ushtron këtë përgjegjësi me anë të udhëzimeve që u transmeton bankave qendrore kombëtare. Për shembull, direktorati vendos çdo javë për shumën e likuiditetit që do i jepet çdo sektori bankar nëpërmjet operacioneve kryesore të rifinancimit. Misioni i dytë dhe i tretë i Eurosistemit janë drejtimit i operacioneve të këmbimit, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, mbajtja dhe administrimi i rezervave zyrtare të vendeve pjesëmarrëse në Euro.

BQK që i përkasin Eurosistemit, e kanë transferuar gjendjen e rezervës së këmbimit te BQE, që në total përbën 40 miliardë euro. (kjo shumë përbëhet nga 85 % në valutë, dhe 15% në ar). Në këmbim, BQK kanë marrë kredi të paguara mbi BQE të lëshuara në euro. BQK-të e Eurosistemit, marrin pjesë në administrimin e rezervave të këmbimit të BQE. Ato veprojnë si agjentë të BQE, në përputhje me orientimet që lidhen me administrimin e portofolit, të vendosura nga BQE. Pjesa tjetër e gjendjes së rezervës të këmbimit të Eurosistemit, u përket BKQ - ve, të cilat i administrojnë. Operacionet e kryera me këto gjendje të rezervës, rregullohen nga Eurositemi. Në veçanti, operacione që i kapërcejnë disa pragje, duhet të kenë marrë paraprakisht autorizimin e BQE.

Misioni i katërt i Eurosistemit ka të bëjë me promovimin e funksionimit të mirë të sistemeve të pagimit. Eurositemi, ndër të tjera, kontribuon edhe në mbikëqyrjen financiare. Ai këshillon ligjvénësit në fushat e tij të kompetencës dhe ndërton statistika monetare dhe financiare. Traktati i Mastrithit vendos se BQE është i vetmi institucion i autorizuar për hedhjen në qarkullim të kartëmonedhave në Euro.

► Pavarësia

Gjatë kryerjes së misioneve lidhur me Eurositemin, BQE dhe bankat qendrore kombëtare nuk duhet të kërkojnë as të pranojnë udhëzime nga institucione apo nga organe komunitarë, të qeverive të vendeve anëtarë të BE ose nga çdo lloj organizmi tjetër. Në të njëjtën mënyrë, institucionet dhe organet komunitarë si edhe qeveritë e vendeve anëtarë, nuk duhet të kërkojnë të ndikojnë anëtarët e organeve vendimmarrëse të BQE-së ose të BKQ në përbushjen e misionit të tyre.

Statuti i SEBQ dhe i BQE përcaktojnë sigurinë e mandatit të guvernatorëve të BKQ dhe të anëtarëve të direktoratit të BQE si vijon :

- Kohëzgjatja minimale e një mandati për guvernatorët e BQK është pesë vjet.
- Mandati i anëtarëve të direktoratit të BQE është 8 vjet dhe është 8 vjet dhe është parinovueshëm.
- Anëtarët e direktoratit të BQE-së nuk mund të shkarkohen nga funksionet e tyre, me përjashtim të rasteve të paafresës ose të gabimeve të rënda. Nga kjo pikëpamje, Gjykata e Komuniteteve Europiane ka kompetencën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Eurosistemi është gjithashtu i pavarur nga pikëpamja e funksionimit. BQE dhe BKQ kanë të gjithë mjetet dhe të gjithë kompetencat e nevojshme për drejtimin e një politike monetare efikase dhe ato janë të autorizuara të vendosin në mënyrë autonome për përdorimin e tyre. Eurosistemit i ndalohet tu japë hua organeve komunitare ose çdo lloj tjetër entiteti kombëtar ose sektori publik, gjë që rrit pavarësinë e tij duke e mbrojtur atë nga çdo lloj ndikimi të autoriteteve publike. Përveç kësaj, Këshilli i Guvernatorëve, ka të drejtë të adoptojë rregulla detyruese me qëllim realizimin e misioneve të SEBQ si edhe në disa fusha të shprehura në aktet specifikë të Këshillit të Bashkimit Europian.

► Bankat qendrore kombëtare

Bankat qendrore kombëtare që i përkasin eurosistemit, janë të pajisura, në përputhje me legjislacionin e vendeve të tyre respektive, me personalitet juridik të dallueshëm nga ai i BQE. Në të njëjtën kohë, ato janë pjesë e plotë e Eurosistemit, që ka për detyrë ruajtjen e stabilitetit të çmimave në zonën Euro. BQK veprojnë në përputhje me orientimet dhe udhëzimet e BQE për sa i përket detyrave të Eurosistemit. BQK marrin pjesë në drejtimin e politikës së vetme monetare të zonës euro. Ato zbatojnë operacionet e politikës monetare, duke siguruar sidomos monedhën e bankës qendrore për institucionet e kreditit, dhe kryejnë gjithashtu, kryerjen e pagesave scripturaux, kombëtare dhe ndërkufitarë. Veç të tjerash, ato kryejnë operacione të administrimit të rezervave

të këmbimit, për llogarinë e tyre si agjentë të BQE.

Nga ana tjetër, BKQ luajnë një rol të rëndësishëm në mbledhjen e të dhënave statistikore kombëtare dhe në nxjerrjen dhe trajtimin e kartëmonedhave në euro në vendet e tyre. BQK përmbrashin gjithashtu funksione që tejkalojnë statusin e tyre, me përjashtim të rasteve kur Këshilli i Guvernatorëve gjykon se këto të fundit nuk janë në përputhje me objektivat dhe qëllimet e misionit dhe Eurosistemit. Ligjet kombëtare respektive parashikojnë se funksione të tjera, pa lidhje me politikën monetare, mund t'u besohen BQK. Disa BQK marrin pjesë në mbikëqyrjen bankare dhe/ose ndërhyjnë si arkëtar kryesor i shtetit.

Organet vendimmarrëse të Bankave Këndore Kombëtare.

Këshilli i Guvernatorëve i BQK përbëhet nga anëtarë të direktoratit të BQE dhe nga guvernatorë të BQK të vendeve pjesëmarrëse në zonën Euro. Statutet e SEBQ shprehen se Këshilli i Guvernatorëve mblidhet të paktën 10 herë në vit. Këshilli i vendos vetë datat e mbledhjeve, në bazë të propozimeve të direktoratit. Mbledhjet mund të organizohen edhe në formën e video konferencave, me përjashtim të rasteve kur kundërshtojnë të paktën tre guvernatorë. Në ditët e sotme, Këshilli mblidhet dy herë në muaj, përgjithësisht të enjten e parë dhe të tretë të çdo muaji. Në parim, çështjet e politikës monetare diskutohen gjatë mbledhjes së parë mujore.

Presidenti i Këshillit të Bashkimit European dhe një anëtar i Komisionit European, mund të marrin pjesë në mbledhje, por vetëm anëtarët e Këshillit të Guvernatorëve kanë të drejtë vote. Çdo anëtar i Këshillit të Guvernatorëve ka vetëm një votë dhe, me përjashtim të disa vendimeve që kanë të bëjnë me çështjet financiare të BQE, Këshilli vendos me shumicë të thjeshtë votash. Në rast barazimi të votave, vota e presidentit është vendimtare. Për sa u përket çështjeve financiare, për shembull të qenit pjesë e kapitalit të BQE, transferimit të rezervave të këmbimit ose shpërndarjes së të ardhurës monetare, votat ponderohen në përputhje me pjesë të kapitalit të ndarë midis BQE dhe BQK. Traktati mbi Bashkimin European si edhe statutet e SEBQ dhe të BQE i jepin Këshillit të

Guvernatorëve pushtetin për të marrë vendimet më të rëndësishme në planin strategjik, për Eurosistem.

Përgjegjësiti kryesore të Këshillit të Guvernatorëve janë :

- Përcaktimi i politikës monetare të zonës Euro, d.m.th marrja e vendimeve në lidhje me normat drejtuese të interesit të BQE.
- Përcaktimi i orientimeve dhe marrja e vendimeve të nevojshme për kryerjen e misioneve që i janë besuar Eurosistemit.

Kur merr vendime të politikës monetare ose në lidhje me misione të tjera të Eurosistemit, Këshilli i guvernatorëve merr parasysh zhvillimet brenda zonës euro në tërësinë e saj.

Direktorati përbëhet nga presidenti dhe zëvendës presidenti i BQE si edhe nga katër anëtarë të tjera të zgjedhur për autoritetin dhe eksperiencën e tyre profesionale në fushën monetare ose bankare. Anëtarët e direktoratit emërohen me një akord të përbashkët nga qeveritë e vendeve të tyre të zonës euro, në nivelin e Kryetarëve të shtetit ose të qeverisë, mbi bazën e një rekomandimi të Këshillit të Bashkimit European pas këshillimit me Parlamentin European dhe Këshillin e Guvernatorëve të BQE. Normalisht direktorati mblidhet çdo të martë. Presidenti i BQE, ose në mungesë të tij, zëvendës presidenti, drejton mbledhjet e këshillit të guvernatorëve të direktoratit dhe të këshillit të përgjithshëm të BQE. Presidenti i BQE ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e Eurogrupit, instance informale që bashkon ministrat e ekonomisë dhe të financave të vendeve pjesëmarrëse në zonën euro. Ai mund të marrë pjesë edhe në mbledhjet e Këshillit European kur ky i fundit diskuton për çështjet që lidhen me qëllimet dhe misionin e Eurosistemit.

Përgjegjësiti kryesore të direktoratit janë :

- Përgatitja e mbledhjeve të Këshillit të guvernatorëve
- Zbatimi i politikës monetare brenda zonës Euro në përputhje me orientimet dhe vendimet e marra nga këshilli i guvernatorëve dhe për të bërë këtë,

t'u japë udhëzime Bankave Qendrore Kombëtare.

- Të sigurojë administrimin e vazhdueshëm të BQE.
- Të ushtrojë disa pushtete, kryesisht të tipit rregullator, të deleguara nga Këshilli i guvernatorëve.

Këshilli i përgjithshëm përbëhet nga presidenti dhe zëvendës-presidenti i BQE si edhe nga guvernatorët e bankave qendrore kombëtare të të gjithë shteteve anëtarë të BE. Anëtarët e tjerë të direktoratit, presidenti i Këshillit të BE dhe një anëtar i Komisionit European mund të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të përgjithshëm, por pa të drejtë vote. Presidenti i BQE mund të thëtrësë mbledhje të Këshillit të përgjithshëm sa herë që e gjykon të nevojshme ose nëse të paktën tre anëtarë të Këshillit të përgjithshëm bëjnë kërkesë. Këshilli i përgjithshëm mblidhet përgjithësisht një herë në tre muaj në Frankfurt. Këshilli i përgjithshëm nuk ka asnjë përgjegjësi në fushën e politikës monetare të zonës euro. Ai ka marrë disa misione të Institutit Monetar European që BQE duhet të kryejë gjatë fazës së tretë të Bashkimit Ekonomik Monetar, për aq kohë sa euro nuk është futur nga të gjithë vendet anëtarë të BE. Kjo do të thotë se Këshilli i përgjithshëm ka kryesisht përfunduar në bëjë raportet e progresit drejt përputhshmërisë të kryer nga vendet anëtarë që nuk e kanë futur ende euron dhe të japë mendimin e tij në kuadrin e përgatitjeve të nevojshme përfunduar në euros si monedhë. Ai kontribuon në funksionet këshilluese të SEBQ dhe në mbledhjen e informacioneve statistikorë.

► Komitetet e SEBQ

Organet vendimmarrëse të BQE ndihmohen në punën e tyre nga komitetet e SEBQ. Këto komitete luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në kooperimin midis pjesëve përbërëse të SEBQ. Ata përbëhen nga anëtarë të personelit të BQE dhe të bankave qendrore kombëtare të Eurosistemit, si edhe nga instanca të tjera kompetente si autoritetet kombëtare të mbikëqyrjes përsëri përkthimtëmbikëqyrjes bankare. BKQ të vendeve që nuk marrin pjesë në zonën euro caktojnë secila ekspertë që marrin pjesë në mbledhjet e komiteteve të SEBQ kur këto të fundit trajtojnë çështje që kanë të bëjnë

me kompetencën e Këshillit të përgjithshëm. Mandatet e komiteteve fiksohen nga këshilli i guvernatorëve, të cilat komitetet i dorëzojnë raporte, nëpërmjet direktoratit.

SEBQ numëron aktualisht këto komitete: komitetin e kontabilitetit dhe të të ardhurës monetare, komitetin e mbikëqyrjes bankare, komitetin e kartëmonedhave, komitetin e metodologjisë së kostove, komitetin e komunikimi midis Eurosistemit dhe SEBQ, komitetin e pilotazhit të sistemit të informimit, komitetin e auditëve të brendshëm, komitetin e marrëdhënive ndërkombëtare, komitetin juridik, komitetin e operacioneve të tregut, komitetin e politikave monetare, komitetin e sistemit të pagesave dhe të rregullores, dhe komitetin e statistikave. Këshilli i guvernatorëve ka krijuar gjithashtu në vitin 1998 një komitet buxhetor që përfshin përfaqësues të BQE dhe të BQK të Eurosistemit. Komiteti buxhetor ndihmon Këshillin e guvernatorëve për çështjet që kanë lidhje me buxhetin e BQE. Së fundi, në 2005 u ndërtua edhe Konferenca e Burimeve Njerëzore, e përbërë nga përfaqësues të SBEQ. Kjo konferencë ka përfshin përfaqësues të SEBQ në fushën e administrimit të burimeve njerëzore.

► Stabiliteti i çmimeve

Qëllimi kryesor i Eurosistemit është të ruajë stabilitetin e çmimeve. Pa cenuar objektivin e stabilitetit të çmimeve, ai duhet të sigurojë mbështetje përfunduar për politikat ekonomie të përgjithshme të Komunitetit. Neni dy i traktatit mbi Bashkimin European shprehet se Bashkimi European ka si qëllim të nxisë «progresin ekonomik dhe social, si edhe nivel punësimi të lartë, dhe të arrijë në një zhvillim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm». Eurosistemi kontribuon në realizimin e këtyre objektivave duke ruajtur stabilitetin e çmimeve. Ndërsa t'ë tjetra, në kuadrin e ndjekjes së qëllimit të stabilitetit të çmimeve, ai ka parasysh edhe këto objektiva. Nëse ndodh çfarëdo lloj konflikti midis objektivave, BQE duhet t'i japë gjithmonë përparësi ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Eurosistemi veptron në përputhje me parimin e një ekonomie tregut të hapur ku konkurrenca është e lirë, duke favorizuar një shpërndarje efikase të burimeve.

► Strategjia e politikës monetare të BQE.

BQE duhet të veprojë në bazë të kushteve të tregut monetar dhe për pasojë, në bazë të nivelit të normave të interesit afat shkurtër me qëllim sigurimin e stabilitetit të çmimeve.

BQE ka bërë të vetën një strategji që ka për qëllim të sigurojë zbatimin e një qasjeje koherente dhe sistematike ndaj vendimeve të politikës monetare. Kjo koherencë kontribuojnë stabilizimin e parakohshmërisë së inflacionit dhe në sigurimin e besueshmërisë së BQE.

Një element qendror i strategjisë së politikës monetare të Këshillit të Guvernatorëve të BQE është përcaktimi i kuantifikuar i stabilitetit të çmimeve, që do të thotë « progresion në vit i treguesit të çmimeve të konsumit të harmonizuar (IPCH) më i ulët se 2% në zonën euro ». Stabiliteti i çmimeve duhet të ruhet në afat të mesëm, gjë që e bën të nevojshme për politikën monetare adoptimin e një orientimi parashikues apo të parakohshëm. Në kuadrin e ndjekjes së qëllimit të stabilitetit të çmimeve, BQE ka si synim të ruajë norma inflacioni në një nivel më të ulët por të afërt me 2% në afat mesëm. Ajo vë në dukje gjithashtu angazhimin për të vendosur një hapësirë sigurie të mjaftueshme për t'u pajisur kundër rreziqeve të deflacionit. Duke pasur parasysh afatet e rëndësishme që përbën mekanizmi i transmetimit, politika monetare duhet të vishet me një karakter parashikues. Ajo duhet gjithashtu të përbajë parashikimet anticipation e inflacionit dhe të kontribuojë në pakësimin e paqëndrueshmërisë së evoluimeve ekonomike. Përveç përcaktimit të stabilitetit të çmimeve, strategjia e politikës monetare ka të bëjë me një vlerësim të thelluar të rreziqeve që rëndojnë mbi stabilitetin e çmimeve dhe artikulohen rreth një analize ekonomike dhe një analize monetare. Çdo vendim lidhur me politikën monetare mbështetet mbi një grupim të plotë të të gjithë informacioneve të nxjerra nga të dy analizat.

► Instrumentet e politikës monetare

Mekanizmi i transmetimit të politikës monetare mbështetet mbi administrimin e likuiditetit dhe të pilotazhit të normave të interesit afat shkurtra nga banka qendrore.

Pjesë përbërëse e tregut të kapitaleve, tregu monetar luan një rol thelbësor në transmetimin e vendimeve politike monetare, në masën ku ai pëson i pari efektet e ndryshimeve të politikës monetare. Një treg monetar i thellë dhe i integruar është i domosdoshëm për të vënë në zbatim një politikë monetare efikase, sepse ai lejon shpërndarjen e ekuilibruar të monedhës së bankës qendrore dhe mbajtjen në një nivel homogen të normave të interesit afat shkurtër në të gjithë zonën me monedhë të përbashkët. Ky kusht paraprak u përmblush nga pothuaj menjëherë në fillim të fazës së tretë të BEM, me integrimin e suksesshëm të tregjeve monetarë kombëtarë në një treg monetar efikas të zonës euro.

► Politika monetare

Për të komanduar normat e interesit në afat shkurtër, Eurosistemi zoteron një sërë instrumentesh të politikës monetare : operacionet e market, lehtësítë e përhershme, dhe rezervat e detyrueshme.

Operacionet e open market mund të ndahen në katër kategori :

- Operacionet kryesore të rifinancimit që janë të paracaktuara të sigurojnë likuiditetë në mënyrë të rregullt, sipas një frekuencë javore dhe me afat një favor.
- Operacionet e rifinancimit me afat më të gjatë që marrin formën e operacioneve të prurjeve të likuiditeteve me një frekuencë mujore dhe një afat tre mujor.
- Operacionet e rregullimit të imët që kryen rregullisht me qëllim administrimin e një situate likuiditeti në treg dhe sigurimin e komandimit të normave të interesit, sidomos për të zbutur ndikimin mbi normat e interesit të luhatjeve të paparashikuara të likuiditetit bankar.
- Operacionet strukturelle që Eurosistemi mund të realizojë duke nxjerrë certifikata borxhi dhe duke përdorur operacione të ndërprerjes së përkohshme ose operacione të qëndrueshme. Përveç kësaj, Eurosistemi ofron dy lehtësi të përhershme që shërbejnë për të siguruar dhe tërhequr likuiditetet ditë pas dite dhe për të përcaktuar limitet e epërme dhe të poshtme për normat e interesit së tregut ditë pas dite.
- Lehtësia e huasë marxhinale që u lejon institucioneve të kredisë të marrin nga bankat qendrore kombëtare likuiditetet ditë pas dite,

përkundrejt aktivëve të zgjedhshëm, etj.

- Lehtësia e depozitës që institucionet e kredisë mund të përdorin për të kryer depozitime në 24 orë pranë bankave qendrore kombëtare të Eurosistemit.

Së fundi, Eurosistemi u imponon institucioneve të kredisë ndërtimin e rezervave të detyrueshme mbi llogaritë e hapura mbi librezat e bankave qendrore kombëtare. Çdo institucion i ndërvarur duhet të mbajë një përqindje të përcaktuar të shumës të disa depozitave të kryera nga klientela e tij mbi një llogari rezervash pranë bankës qendrore kombëtare. Këto rezerva të detyrueshme, mesatarisht krijohen për një periudhë një mujore. Eurosistemi i paguan këto llogari rezervash mbi bazën e normës së interesit afat shkurtër. Sistemi i rezervave të detyrueshme ka për qëllim stabilizimin e normave të interesit në tregjet e brendshme dhe krijimin (ose mbështetjen) e deficitit struktural të likuiditetev brenda sistemit bankar.

► Politika e komunikimit.

Një komunikim i jashtëm efikas përbën një nga aspektet thelbësore të misionit të një banke qendrore. Ai kontribuon në efikasitetin dhe besueshmërinë e politikës monetare. Me qëllim përmirësimin e të kuptuarit nga publiku të politikës monetare dhe të aktivitetave të tjera të një banke qendrore, BQE duhet të jetë e hapur dhe transparente. Ky parim udhëheq komunikimin e jashtëm të Eurosistemit, që do të thotë një bashkëpunim më i ngushtë midis BQE dhe BQK.

Me qëllim që komunikimi i tyre të jetë efikas, BQE dhe BQK përdorin një gamë të gjërë instrumentesh komunikimi, më kryesorët ndër të cilët janë :

- Konferenca e shtypit që mbahet në fund të çdo mbledhjeje mujore të Këshillit të Guvernatorëve.
- Publikimi i një butlletini mujor që përmban në mënyrë të detajuar zhvillimet ekonomike në zonën euro si edhe artikuj mbi çështje që lidhen me aktivitete të BQE.
- Audicione publike të presidentit dhe anëtarëve të tjerë të direktoratit të BQE para parlamentit europian.
- Fjalimet e mbajtura dhe intervistat e dhëna nga anëtarë të organeve vendimmarrëse të BQE.

- Deklaratat për shtyp që shpjegojnë vendimet dhe vlerësimet e këshillit të guvernatorëve.
- Sitet internet të BQE dhe BQK që mundësojnë konsultimin e të gjithë dokumenteve të publikuar si edhe një data bazë e madhe të dhënash statiskore.
- Dokumente pune
- Studime në lidhje me tema të veçanta.

► Politika monetare.

Statistika monetare dhe financiare

BQE përpunon dhe publikon statistika monetare dhe financiare duke bashkëpunuar ngushtësisht me BQK. Këto informacione statistikë mblidhetin politikën monetare të zonës euro dhe procesin e vendimmarrjes në BQE. BQK (dhe në disa raste, autoritete të tjera kombëtare) mbledhin të dhëna pranë institucioneve të tjera financiare dhe burimeve të tjera në vendet përkatëse dhe llogaritin aggregatet në nivel kombëtar, të cilat ia transmetojnë BQE-së. Kjo e fundit përpunon aggregatet për zonën euro.

Statutet e sistemit european të bankave qendrore dhe të Bankës Qendrore Europiane të vendosura si shjojcë e traktatit, përbëjnë themelin juridik të zhvillimit, të mbledhjes, të përpunimit dhe shpërndarjes së statistikave të BQE. Duke pasur parasysh të sigurojë që popullata e deklaruar të përbushë kërkuesat në fushën e statistikës, BQE përpipet të pakësojë ne minimum pasojat që këto deklarata statistikore u imponojnë institucioneve të kredisë dhe agjentëve të tjerë të deklaruar.

Në nivelin e Bashkimit European, statistikat janë përgjegjësi e përbashkët e BQE dhe Komisionit European (me ndërmjetësinë e Eurostat, Zyra e statistikave e Bashkimit European). BQE ka për detyrë ose është bashkëpërgjegjëse për përpunimin e statistikave monetare, të institucioneve financiare dhe të tregjeve të kapitaleve të zonës euro, të statistikave të jashtme, (ku futen edhe ato të balancës së pagesave) të llogarive financiare dhe të vendosjes së llogarive tremujore jo financiare të sektorëve institucionalë (familje, ndërmarrje dhe administratë publike). Përgjegjësia e infrastrukturës në lidhje me statistikat, si korrigimi i ndryshimeve sezionale, konceptimi i një kuadri statistik me cilësi të lartë dhe normat në fushën e transmetimit të të dhënavë, ndahet gjithashtu në të dy institucionet, në nivel europian. Për aq sa është e mundur, statistikat e SEBQ, janë në përputhje me normat

ndërkomëtare.

Sistemi target 2

Sistemi target 2 (Transfertë ekspresa automatizuar transeuropeiane me pagesë shlyerje bruto në kohë reale), zëvendëson sistemin Target të brezit të parë, që u përdor që në vitin 1999 deri në futjen e euros.

Duke nisur që nga viti 2008, sistemi i ri do të jetë në funksionim për të gjitha operacionet në euro në dhe midis vendeve të zonës euro dhe shumë vendeve të tjera të Bashkimit Europian.

Ashtu si edhe sistemi që zëvendëson, Target 2 përdoret për kryerjen e operacioneve të bankës qendrore, kalimet ndërbankare me shumë të lartë dhe të tjera pagesa në euro. Ai siguron një trajtim të pagesave në kohë reale, finalitet të menjëherëshëm dhe një shlyerje në monedhën qendrore.

Në të kundërt nga Target 1 në të cilin të gjitha pagesat kryheshin në mënyrë të decentralizuar nga bankat qendrore kombëtare, sistemi i ri mbështetet mbi një platformë të përbashkët të vetme, që nuk kërkon asnjë ndërhyrje prej tyre. Kjo platformë bën të mundur një shërbim më të mirë dhe të harmonizuar, me kosto më të vogël, dhe një raport më të mirë kosto-efikasitet, ndër të tjera, edhe falë ekonomive për shkallë.

Pagesat e kryera nëpërmjet Target 2 nuk kufizohen nga shumat tavan apo dysheme.

Operatorët e tregut, duke përdorur Target 2 për të gjitha pagesat në shuma të mëdha, sidomos ato të lidhura me operacionet ndërbankare, përfitojnë një shërbim të shkëlqyer dhe kontribuojnë për uljen e rrezikut sistematik në të gjithë bashkimin europian, d.m.th. rrezikun e përhapjes në zona të tjera lidhur me numrin e madh dhe vlerën e rëndësishme të operacioneve midis bankave.

Lancimi në 2008 i SEPA (hapësirë e vetme e pagesave në Euro) në të cilën të gjithë të pagesat skripturale në euro, janë trajtuar si transaksione të brendshme, edhe nga kjo pikëpamje, përbëjnë një progres.

Dallimi midis operacioneve kombëtare dhe ndërkufitarë, do të zhduket. Target 2 dhe SEPA do ta shndërrojnë tregun e pagesave të zonës euro, duke e bërë më dinamik dhe duke rritur efikasitetin e tij për sa i përket kostove.

► Kartëmonedhat dhe monedhat në euro

Kartëmonedhat

Kartëmonedhat në euro u hodhën në qarkullim më 1 janar 2002. Gama përmban 7 prerje prej 5, 10, 20, 50, 100, 200 dhe 500 euro. Përmasa e kartëmonedhës rritet sipas vlerës së saj. Kartëmonedhat në euro përfaqësojnë stilet arkitekturale që kanë karakterizuar shtatë periudhat e historisë kulturore të Europës - klasiken, romaken, gotiken, Rilindjen, baroken dhe rokoko, arkitekturë me « qelq dhe çelik » dhe arkitekturën moderne të shekullit XX. - dhe nxjerrin në pah tre elementë arkitekturalë që janë dritaret, portikët dhe urat. Motivet e tyre nuk mund t'i lidhim me asnjë ndërtës apo monument ekzistues. Dritaret dhe portikët që ilustrojnë pjesën e pasme të çdo biletë, simbolizojnë shpirtin e hapjes dhe të bashkëpunimit që mbretëron në Europë. Ana tjeter përfaqëson një urë. Si metaforë, ura simbolizon lidhjen që bashkon popujt europianë midis tyre, si edhe ata me pjesën tjeter të botës. Një sërë masash sigurie, (filigran, hologramë, fill sigurie, bojë me ngjyrë të ndryshueshme për shembull) janë përfshirë në grafizmin e biletave për t'i mbrojtur kundër falsifikimit dhe t'i lejojë publikut që të njohë monedhën e vërtetë. Disa shenja të veçanta (shtypja në relief dhe shifrat e përmasave të mëdha, për shembull) janë vendosur gjithashtu për të ndihmuar personat me aftesi të kufizuar në shikim dhe në dégjim. Falë masave të repta të kontrollit të prodhimit, cilësia dhe karakteristikat pamore të të gjitha monedhave, janë të njëjta. Ato nuk përbajnë asnjë shenjë dalluese kombëtare. Një seri e re kartëmonedhash në euro, është duke u përgatitur aktualisht. Kartëmonedhat e ardhshme do të kenë shenja sigurie, por duke vazhduar në të njëjtën kohë në serinë aktuale. Kështu, dallimet në prerje do të ruhen (nga 5 në 500) dhe grafizmi i tyre do të frysëzohet nga seritë e tanishme, gjë që do të bëjë që kartëmonedhat e ardhshme të njihen menjëherë si kartëmonedha në euro.

Monedhat

Euro ndahet në 100 nënndarje (cent). Seria e monedhave përmban 8 vlera prej 1 cent, 2, 5, 10, 20, dhe 50 cent, 1 euro dhe 2 euro. Çdo monedhë ka një anë «europiane» dhe një anë kombëtarë.

Motivet që ilustrojnë njëren anë të monedhës janë të njëjta për të gjithë vendet e zonës euro. Ana tjeter përmban elementë kombëtarë

dallues. Natyrisht, monedhat mund tē pērdoren pa dallim nē tē gjithë vendet. Tē tetë monedhat nē euro, dallohen nga pērmasat, pesha, materiali pērbërës, ngjyra dhe trashësia. Janë futur gjithashtu disa karakteristika rinojuese pēr tē ndihmuar gjithashtu pērdoruesit me aftesi tē kufizuara nē shikim dhe dëgjim që tē njohin vlerat e ndryshme tē monedhave. Pēr shembull, dy monedha që vijnë njëra pas tjetrës nē seri, kanë trashësi tē ndryshme. Një sistem i ngritur pēr kontrollin e cilësisë, siguron që monedhat nē euro tē jenë tē shkëmbyeshme nē tē gjithë zonën euro dhe tē plotësojnë kriteret e vendosura pēr pērdorimin e tyre nē shpérndarësit automatikë. Një kujdes i veçantë i është kushtuar pērpunimit tē monedhave me vlerë tē lartë (1 dhe 2 euro) me qëllim pēr t'i mbrojtur nga falsifikimi. Konceptimi i tyre modern që kombinon dy ngjyra dhe gravura mbi pjesën anësore tē monedhës dy euro, e bën falsifikimin e tyre më tē vështirë.

Mbikëqyrja bankare

Përgjegjësia edrejtpérdrejtë e mbikëqyrjes bankare dhe e stabilitetit financiar i takon autoriteteve kompetente nē çdo shtet anëtar tē Bashkimit European, por traktati i jep SBEQ misionin e « kontributit nē drejtimin e duhur tē politikave tē ndërmarra nga autoritetet kompetente pēr sa i përket kontrollit tē kujdesshëm tē institucioneve tē kreditit dhe stabilitetit tē institucioneve financiarë ».

Misioni i SBEQ përmban tre elementë

Së pari, SBEQ mbikëqyr dhe vlerëson stabilitetin financiar nē nivelin e zonës euro dhe tē Bashkimit European. Ky aktivitet plotëson dhe mbështet veprimin e ndërmarrë paralelisht nē nivel kombëtar nga bankat qendrore kombëtare dhe autoritetet e mbikëqyrjes, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar nē vendet e tyre.

Së dyti, SBEQ jep mendime lidhur me përcaktimin dhe analizimin e kërkësave nē lidhje me rregullimin (reglementation) dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiarë. Këto mendime jepen kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes së SBEQ në organet ndërkombëtarë dhe europianë që kanë pēr detyrë rregullimin dhe mbikëqyrjen e kujdeshme, tē tillë si Komiteti i Balit mbi

kontrollin bankar, komitetit bankar europian, dhe komiteti europian i kontrollit bankar.

Së terti SBEQ përkrah bashkëpunimin midis bankave qendrore dhe autoriteteve tē mbikëqyrjes mbi çeshtje tē interesit tē përbashkët (p.sh. Mbikëqyrja e sistemeve tē pagesave, menaxhimi i krizave financiare). Këto veprimitari kryhen me ndihmën e Komitetit tē mbikëqyrjes bankare (një nga komitetet e SBEQ e përmendura më parë) që bashkon ekspertë tē bankave qendrore dhe autoritetet e mbikëqyrjes së Bashkimit European.

Përktheu: Blerta Hyska

GLOBALIZIMI DUHET MENAXHUAR

JOSEPH E. STIGLITZ



Çmimi Nobel për ekonominë në vitin 2001.

Globalizimi si çelës i integrimit. Rregulla të qarta loje për të gjithë, për t'i dhënë ekonomisë një fytyrë humane. Emergjencia ushqimore? Pjellë e një politike të gabuar çmimesh. Është pikërisht ky alfabeti i Joseph Stiglitz për një të ardhme të qëndrueshme.

Joseph E. Stiglitz, këshilltar ekonomik i ish-presidentit Clinton nga viti 1993 deri në vitin 1997, numri dy i Bankës Botërore, nga viti 1997 deri në vitin 2000, Çmimi Nobel për ekonominë në vitin 2001. Një njeri i sistemit? Thellësisht i rrënjosur në establishment? Krejt e kundërtë. Ekonomist i apasionuar, radikal dhe karizmatik, Stiglitz është një nga ata që thotë pa u mëdyshur se "mbreti paska dalë lakuriq...!", që kritikon ashpër zgjedhjet e bëra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, është armik i politikave të cilat nuk arrijnë të çrrënjosin varférinë, por përkundrazi e agravojnë edhe më tej atë, që dobësojnë demokracitë në vend që t'i përforcojnë ato, është kundër atyre politikave që i bëjnë të pasurit edhe më të pasur e të varfrit edhe më të varfër.

Ai është një profesor ndryshe, që s'mund të kuptohet pa sportivitetin e tij të admirueshëm, është nga ata që buzëqesh shpesh e me gjithë shpirt, e që ka një sens shumë original humor. "Në Bankën Botërore - ka thënë - kam verifikuar në personin e parë, efektin shkretues që globalizmi mund të ketë mbi vendet në zhvillim e sipër, e sidomos mbi ato më të varfrat".

Stiglitz është nga ata që flet dhe shkruan qartë.

Është nga ata që mund ta kuptojnë fare lehtë edhe jo-specialistët. Pikërisht për këtë librat e tij, midis të cilëve "Globalizimi dhe protestuesit e tij" dhe "Vitet e zhurmshme '90", janë kthyer tashmë në best-seller, ndërsa ai vetë, në një pikë referimi për të gjithë ata që nuk duan t'i dorëzohen ekstra-forcës së ekonomive më të fuqishme, verbërisë së Darwinizmit, prej së cilës peshqit e mëdhenj duhet t'i hanë të vegjlit. Ai është tritur në një qytezë ku papunësia e madhe ulërinte, dhe qysh prej atëherë ka kërkuar të kuptojë se çfarë realisht nuk funksionon në sistemin ekonomik, e se si e gjithë kjo mund të rregullohej. Duke punuar me Clinton ai madje edhe ëndërrroi ta bënte më eficiente administratën publike, duke përdorur një rrugë të mesme midis tregut të lirë dhe rregullave shumë të ashpra

Por është e vështirë të ecësh kundër interesave të grupeve të mëdha financiare dhe industrialiste, që kanë lobingje të fuqishme. E pastaj, shumë ekonomistë e shohin botën nëpërmjet prizmit të ideologjive apo recetave teorike që aplikohen në situata shumë të ndryshme. Përtej gjithë kësaj Stiglitz thotë: "Ekonomia mund të duket si një disiplinë e thatë, por mund të ndryshojë jetën e të varfërve. E di, po them diçka që është më

se e qartë, por është nevojshme të përsëritet gjithmonë, pa pushuar kurrë".

Ekonomisti amerikan Joseph Eugene Stiglitz lindi më 9 shkurt 1943. Ai është sot anëtar i Universitetit të Kolumbis. Është nderuar me medaljen John Bates Clark (1979), si dhe me çmimin e Sveriges Risbank në Shkenca Ekonomike, në kujtim të Alfred Nobel (2001). Në karrierën e tij të gjatë ai ka qenë zëvendës President dhe Ekonomisti kryesor i Bankës Botërore. Është i njohur për pikëpamjet e tij kritike lidhur me globalizimin, ekonomistët e tregut të lirë (të cilët ai i quan "fondamentalistët e tregut të lirë") dhe disa institucione ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Në vitin 2000, Stiglitz themeloi iniciativën për Dialogun Politik, IDP, një "think tank" për zhvillimin ndërkombëtar e vendosur në Universitetin Kolumbia. Anëtar i Universitetit Kolumbia që prej vitit 2003, ai mban gjithashtu titullin Profesor i Universitetit që prej këtij viti. Ndërkohë drejtton Institutin Brooks World Poverty dhe është anëtar i Pontifical Academy në Shkencat Sociale. Duke pasur parasysh statistikat e vitit 2008, Stiglitz është ekonomisti i dytë më shumë i cituar në botë.

Biografia

Stiglitz u lind në Gary Indiana, më 9 shkurt 1943, nga prindër hebre, Charlotte dhe Nathaniel Stiglitz. Nga viti 1960 deri në 1963, ai studioi në Amherst College, ku ra në sy si një nga anëtarët më aktiv të grupit të debatit dhe shumë shpejt u bë edhe President i Qeverisë Studentore. Vitin e katërt të studimeve ai e ndoqi në Massachusetts Institute of Technology (MIT), ku, pasi u diplomua, vazhdoi më pas edhe studimet pasuniversitare. Diploma e tij e parë i është dhënë nga Amherst College (undergraduated). Pas kësaj, nga viti 1965 deri në vitin 1966, Stiglitz shkoi në Universitetin

e Çikagos për të bërë kërkime shkencore nën drejtimin e Hirofumi Uzawa, i cili kishte fituar një NSF grant. Ai studioi për doktoraturën në vitet 1966 - 1967 duke i qëndruar edhe kësaj here besnik dashurisë së tij të vjetër për *Massachusetts Institute of Technology* (MIT). Në të njëjtën kohë punoi në këtë institut si asistent profesor. Në ambientet e tij Stiglitz u dallua menjëherë për një stil të veçantë të ekonomiksit, ashtu sikurse në të gjitha format e komunikimit të tij spontan. - Modele të thjeshta dhe konkrete, përgjigje direkte për pyetje të rëndësishme.

Njëkohësisht është për tu përmendur fakti që në vitet 1960 - 1970, Stiglitz ishte fitues i programit *Fullbright*, si studiuves i ri pranë Universitetit të Kembrixhit. Në vitet në vijim ai kë qenë profesor në *Yale University*, *Duke University*, *Stanford University*, *Oxford University* dhe *Princeton University*. Aktualisht, Stiglitz është profesor në *Columbia University*, dhe ka gjithashtu emërim në *Business School*, Departamenti i Ekonomiks dhe Shkolla e Çështjeve Publike dhe Ndërkombëtare. Stiglitz është gjithashtu dhe botues i *The Economist's voice*.

Përgjithësisht, Stiglitz konsiderohet si një ekonomist neo-kensian.

Përveç kontributave të shumta në mikro-ekonomiks, Stiglitz ka pasur edhe një sërë rolesh politike. Ai ka shërbyer në administratën e Presidentit Clinton si Kryetar i Këshillit të Këshilltarëve Ekonomikë të Presidentit (1995-1997). Ai shërbeu si Zëvendës President dhe Ekonomist Chief në Bankën Botërore (1997-2000), pikërisht në kohën kur filluan revolta pa precedent kundër organizatave ndërkombëtare të tregtisë, sidomos gjatë mbledhjes së OBT-së në vitin 1999. Ai ishte autor i udhëheqës për Panelin Ndërqeveritar të Ndryshimit Klimatik.

Disa nga kontributet më të rëndësishme të Stiglitz në ekonomi

Asimetritë e informacionit

Studimi më i famshëm i Stiglitz është ai mbi përzgjedhjen; një teknikë e përdorur nga agjentë ekonomikë për të nxjerrë një informacion privat nga një tjetër. Për këtë kontribut në teorinë e asimetrisë së informacionit, ai ndau çmimin e madh Nobel Memorial Prize në Ekonomiks në vitin 2002 për «Mbështetjen e themelive të teorisë së tregjeve më informacion asimetrik» së

bashku me G. Akerlof dhe A. Michael Spence. Literaturam bie kominë neoklasike tradicionale po hën se tregjet janë gjithmonë eficentë, me përfashim të disa dështimeve të kufizuarë dhe të përcaktuara mirë, por punimet e mëvonshme të Stiglitz dhe bashkëpunëtorëve të tij, e rrëzuan këtë pretendim. Sipas tyre, tregjet janë eficentë vetëm në rrëthana të jashtëzakonshme. Stiglitz (dhe Greenwald) tregoi se «sa herë tregjet janë të paplotë dhe/ose informacioni është jo perfekt (gjë që virtualisht është e vërtetë për të gjitha ekonomitë), edhe vetë shpërndarja kompetitive e tregut, nuk është medoemos Pareto eficent. Me fjalë të tjera, pothuaj gjithmonë ekzistojnë skema të ndërhyrjes qeveritare, që mund të shkaktojnë rezultatin Pareto superior, duke bërë në këtë mënyrë që secili të jetë më mirë. Megjithëse këto përfundime dhe përhapja e dështimeve të tregut, nuk e autorizojnë aspak një ndërhyrje më të madhe të shtetur në çdo ekonomi, është e qarrë se niveli «optimal», i rekomandueshëm për ndërhyrjen qeveritare, është përfundimi shumë më i gjerë nga sa pranon shkolla tradicionale e «dështimeve të tregut». Për Stiglitz, nuk bëhet fjalë për një «dorë të padukshme». Kur ndodhin «eksternalitetet» - pra, kur veprimet e një individu kanë pasoja mbi të tjerët, për të cilët këta të fundit nuk paguajnë, ose për të cilët nuk kompensohen, - tregjet nuk do të punojnë mirë. Por kërkimet më të fundit kanë treguar se këto eksternalitete janë të përhapura, sa herë informacioni ose rreziqet e tregut janë jo-perfekt, - gjë që ndodh gjithmonë.

Debati i vërtetë sot është në lidhje më gjetjen e balancës së duhur midis tregut dhe qeverisë (dhe sektorit të tretë - organizatave joqeveritare, jo fitimprurëse). Të dyja nevojiten. Ata mund të plotësojnë njëri-tjetrin. Kjo balancë do të ndryshojë në varësi të kohës dhe vendeve të ndryshme.

Në fjalën e tij, kur mori çmimin «Aula Magna» Stiglitz tha: «Shpresoj të tregoj se Ekonomiksi i Informacionit përsaqëson një ndryshim themelor të paradigmës mbizotëruese brenda ekonomiksit. Problemet e informimit janë thelbësore në të kuptuarin jo vetëm të ekonomiksit të tregjeve, por edhe të politikave ekonomike; dhe në pjesën e fundit të këtij studimit, unë studioj disa nga implikimet që ka informacioni jo perfekt për procesin politik». Stiglitz, *Aula Magna*.

► Eficiencia e pagave: modeli Shapiro-Stiglitz

Stiglitz kreu gjithashtu disa studime në lidhje me pagat e eficencës, dhe ndihmoi në krijimin e asaj që tanë quhet «modeli Shapiro-Stiglitz» për të shpjeguar se për se ka papunësi, përsë pagat nuk propozohen nga ata që kërkijnë punë, (në mungesë të pagës minimale) me qëllim që ai që kërkon punë të gjejë, dhe të shtrojë pyetjen nëse paradigmë neoklasike mund të shpjegojë punësimin jo-vullnetar. Përgjigja për këtë puzzle u propozua nga Shapiro dhe Stiglitz në vitin 1984: «papunësia drejtobet nga struktura e informacionit të punësimit». Dy vëzhgime kryesore mbështetën analizën e tyre:

1. Ndryshe nga forma të tjera të kapitalit, njerëzit mund të zgjedhin nivelin e tyre të përpjekjes.
2. Është e kushtueshme për firmat që të përcaktojnë se sa përpjekje po ushtrojnë punëtorët.

Analiza matematike e «modelit Shapiro-Stiglitz» është përtej qëllimit të këtij artikulli. Një model i plotë i përshkrimit të saj mund të gjendet në adresat e shënuara. Disa nga implikimet kryesore të këtij modeli janë :

1. Gjatë recessionit, pagat nuk bien aq sa të parandalojnë rritjen e papunësisë. Nëse kërkesa e punës zhvendoset së brendshmi, kjo do të ulë pagat. Por ngaqë pagat kanë rënë, probabiliteti i «abstenimit» (punëtorët nuk po ushtrojnë përpjekje) është rritur. Nëse duhet të ruhen nivelet e punësimit, nëpërmjet një uljeje pagash eficiente, punëtorët do të jenë më pak produktivë se më parë me anë të efektit të abstenimit. Si pasojë, në model, pagat nuk bien aq sa të mbajnë nivelet e punësimit në gjendjen e mëparshme, sepse firmat duan të shëmangin abstenimin e tepërt nga punëtorët e tyre. Pra, papunësia duhet të rritet gjatë recensionit sepse pagat nuk janë mbajtur «shumë lart».
2. Logjika e mundshme: Apati e pagave. Të lëvizësh nga një kosto private e punësimit « w^* » në kosto tjetër private punësimi « w^{**} » do të kërkojë që çdo firmë të ri-optimizpjë vazhdëmisht pagat, në përgjigje të ndryshimit të nivelit të papunësisë. Firmat nuk mund të shkurtojnë pagat derisa papunësia të rritet mjaftueshëm. (një problem koordinimi).

Rezultati nuk është asnjëherë Pareto eficent.

1. Çdo firmë përdor shumë pak punëtorë, sepse përballet me koston e punësimit « w^* » më tepër se me koston sociale, e cila është e barabartë me « e » dhe ($w^* > e$) në të gjitha rastet.

2. Ka gjithashtu eksternalitete negative. Çdo firmë rrit vlerën e asetit të papunësisë < V_u > për të gjithë firmat e tjera duke punëuar. Por problemi i parë mbizoteron dukshëm që kurse « niveli natyror i papunësisë » është gjithmonë shumë i lartë.

► Disa implikime të mundshme praktike të teoremës së Stiglitz

Ndërsa nuk mund të ketë pyetje të mundshme lidhur me vlefshmërinë matematike të teoremës së Stiglitz, implikimi i tyre praktik në ekonominë politike, dhe zbatimi i tyre në jetën e vërtetë të politikave ekonomike, ka qenë subjekt i debateve dhe mosmarrëveshjeve të shumta. Vetë Stiglitz duket se po e përshtat vazhdimisht ligjërimin e tij politiko-ekonomik, siç mund ta shohim nga evoluimi i pozicionit të tij, që fillimisht ishte • Whither Socialism? (“Ku është socializmi?” 1994) në pozicionin e tij të ri të shfaqur në publikimet e tij të fundit.

Me t'u futur informacioni jo perfekt dhe jo i plotë, mbrojtësit e sistemit të tregut të shkollës së Çikagos nuk mund të mbëshëtesin pretendimet e Efiçenës Pareto për botën reale. Në këtë mënyrë, përdorimi nga Stiglitz i tezave të ekuilibrit të pritshmërive racionale, për të arritur në një të kuptuar më realist të kapitalizmit nga sa është bërë zakon ndër teoricienët e pritshmërisë racionale, çon në mënyrë paradoxale në konkluzionin se kapitalizmi devijon nga modeli, në mënyrë të tillë, që veprimi i shtetit - socializmi - justifikohet si i mjet shpëtimi.

Efekti i ndikimit të Stiglitz është ta bëjë ekonominë edhe më ndërryrëse sesa e preferonte Samuelson. Ky i fundit, i trajtoi dështimet e tregut si përgjashtime nga rregulli i përgjithshëm i tregjeve efiçente. Por teorema e Greenwald-Stiglitz i tregon dështimet e tregut si një normë, duke deklaruar se « qeveria pothuajse gjithmonë mund të përmirësojë shpërndarjen e burimeve të tregut ». Ndërsa teorema Sappington-Stiglitz « tregon se një qeveri ideale mund të mbajë më mirë një ndërmarrje vetë, sesa mund ta bëjë me privatizimin » (Stiglitz, 1994).

Kundërshtitë lidhur me pranimin e gjerë të

këtyre dy pozicioneve të sugjeruar nga zbulimet e Stiglitz, nuk vijnë nga ekonomiki, por më së shumti nga shkencat politike, dhe janë të fushës së sociologjisë. Ashtu si D.L. Prychitko ë ka treguar në « kritikën » e tij të Whither Socialism? Edhe pse ideja kryesore ekonomike e Stiglitz duket përgjithësisht korrekt, ai lë ende të hapur për pyetje çështjen se si institucionet e forcës së shtetit duhet të bëhen detyruarës dhe cila është marrëdhënia midis shtetit dhe shoqërisë civile.

► Politika

Stiglitz në Washington (1992-2000)

Stiglitz shkoi në Washington në Mars të vitit 1992 për t'u bërë pjesë e Administratës Klinton, fillimisht si anëtar dhe më pas si Kryetar i Këshillit të Këshilltarëve ekonomikë, duke shërbyer gjithashtu edhe si anëtar i kabinetit. Ai u përfshi shumë në çështjet e mjedisit, ku futet edhe shërbimi në Panelin Ndërqeveritar të Ndryshimit Klimatik dhe ndihma për hartimin e draftit të ligjit për imbetjet toksike (që nuk u miratua kurrë). Disa nga idetë që formuloi Stiglitz, si përzgjedhja kontradiktore dhe rreziku moral janë tashmë pjesë e gjuhës së përditshme në debatin politik për kujdesin shëndetësor. Kontributi më i rëndësishëm i Stiglitz në këtë periudhë, është ndihma në përcaktimin e një filozofie të re në ekonomi, « një rrugë e tretë » e cila i njeh rol rëndësishëm, por të kufizuar qeverisë, gjë që tregjet pa pengesa nuk e bënë dot, por që jo gjithmonë qeveria ishte e aftë të korrigjonte kufizimet e tregjeve. Kërkimi akademik që ai udhëhoqi gjatë 25 viteve të fundit siguroi themellet intelektuale të « rrugës së tretë ».

Kur Presidenti Clinton u rizgjodh përsëri, ai i kërkoi Stiglitz të vazhdonte të shërbente si Kryetar i Këshillit të Këshilltarëve ekonomikë edhe për një mandat tjetër. Por tashmë ai ishte afruar nga Banka Botërore për t'u bërë zëvendës president për politikat e zhvillimit dhe ekonomist kryesor i saj.

Kur Banka Botërore filloi rishikimin e 10 viteve të tranzpcionit të ish vendeve komuniste drejt ekonomisë së tregut, ajo zbuloi dështime të vendeve që kishin përdorur terapinë e shock-ut të FMN-së, si në uljen e GDP-së, ashtu edhe në rritjen e varfërisë. Gjendja ishte me keq se sa e kishte parashikuar ai edhe në kritikat e tij më negative në fillim të tranzpcionit. Ekzistojnë

lidhje të qarta midis performancave të ulëta, dhe politikave tw rekondanuara nga FMN, si skemat e bonove të privatizimit dhe shtrëngesat eksesive monetare. Ndërsa, suksesi i atyre pak vendeve që kishin ndjekur strategji të ndryshme, sugeron se mund të ishin ndjekur edhe alternativa të tjera. Thesari i SHBA ushtroi presion të madh mbi Bankën Botërore për të hequr dorë nga kriticizmi ndaj politikave që ata dhe FMN kishin mbështetur.

Stiglitz gjithmonë pati marrëdhënie jo të mira me Sekretarin e Shtetit për thesarin, Lawrence Summers. Në vitin 2000 Summer ia doli të hartonte një petition për heqjen e Stiglitz. Mendohet se e bëri në këmbim të riemërimit të presidentit të Bankës Botërore J. Wolfensohn, gjë që ky i fundit e mohon.

Stiglitz dha dorëheqje një muaj para se të mbaronte mandati i tij në Bankën Botërore, dhe e la Bankën në Janar 2000. Presidenti i Bankës, Wolfensohn e shpalli dorëheqjen e Stiglitz në nëntor 1999 dhe tha gjithashtu se Stiglitz do të ishte «këshilltar special i presidentit» dhe do të drejtonte komitetin për përgjedhjen e pasardhësit të tij.

«Joseph Stiglitz tha sot (24 nëntor 1999) se do të hiqte dorë nga pozicioni i tij si krye-ekonomist i Bankës Botërore, pasi e përdori pozicionin e tij për afro tre vjet për të ngritur çështje të rëndësishme lidhur me efikasitetin dhe qasjet e përshtatshme për të ndihmuar vendet e varfra»

Në këtë rol, ai vazhdoi kriticizmin e tij për FMN-në dhe me implikimin e tij në Departamentin e Thesarit. Në prill të vitit 2000, në një artikull për New Republic, ai u shpreh për FMN-në.

«Të gjithë thonë se FMN është arrogante.

Ata thonë se FMN në të vërtetë nuk dëgjon vendet në zhvillim që supozohet t'i ndihmojë. Të gjithë thonë se FMN punon fshehtas, dhe i shmanget llogaridhënia demokratike. Të gjithë thonë se zgjidhet që propozon FMN, vetëm sa i përkeqësojnë gjérat, duke i shndërruar ngadalësimet në recessione dhe recessionet në depresion. Dhe ata kanë të drejtë. Isha krye ekonomist në Bankën Botërore që nga viti 1996 deri nëntorin e kaluar, gjatë kriçës më të rëndë ekonomike globale të 50 viteve të fundit. E pashë se si FMN, së bashku me Departamentin e Thesarit, u përgjigjen, dhe ngela i shokuar».

Artikulli u botua një javë para takimit të përvitshëm të Bankës Botërore me FMN dhe provokoi një përgjigje me të vërtetë të fortë. Wolfensohn, privatishët ishte dakord me pikëpamjet e Stiglitz, dhe Wolfensohnit i vinte keq për mandatin e dytë të Stiglitz, që Summers e kishte kërcënuar me veto. Stanley Fisher, zëvendës drejtori menaxhues i FMN, thirri një takim special me stafin dhe informoi se Wolfensohn kishte rënë dakord për të pushuar Stiglitz. Ndërsa, Departamenti i Punëve të Jashtme të Bankës i tha shtypit se Stiglitz nuk ishte pushuar, por vendi i tij ishte mbyllur.

► Iniciativa për Dialogun mbi Politikat

Në korrik të viti 2000, Stiglitz themeloi Iniciativën për Dialogun mbi politikat (IPD) me mbështetjen e Ford, Rockefeller, McArthur, të qeverive kanadeze dhe suedeze, për të nxitur procesin demokratik të vendimarrjes në vendet në zhvillim, për të siguruar se një numër i madh alternativash janë të mundshme dhe shumë aktorë janë në lojë.

► Mbi librat kryesorë të Stiglitz

Së bashku me publikimet e tij teknike ekonomike (ai ka publikuar më shumë se 300 artikuj), Stiglitz është autor i disa librave në të cilët ai përdori zotërimin e tij të logjikës ekonomike për qëllim të mirë, duke ofruar një diskutim të qartë për rrëth 12 çështje komplekse, nga ligji për patentën (të drejtën e mbi autorësinë) tek tregu ndërkombëtar.

► Stabiliteti me rritjen: makroekonomia, liberalizmi dhe zhvillimi

Në këtë libër, Stiglitz dhe autorë të tjerë diskutuan mbi çështje aktuale në makroekonomi, liberalizimin e tregut të kapitaleve dhe zhvillimin, si dhe përpunimin e një kuadri të ri brenda të cilit të mund të vlerësohen politikat alternative. Ata shpjegojnë besimin e tyre se, konsensusi i Washingtonit, ka përkrahur qëllime të ngushta për zhvillimin (me një përqendrim në stabilitetin e çmimeve), ka rekomanduar shumë pak instrumenta politikë (duke i mëshuar politikave monetare dhe fiskale) dhe ka pasur besim pa baza, në rolin e tregjeve. Kuadri i ri përqendrohet në stabilitetin e vërtetë dhe rritjen e qëndrueshme

dhe afatgjatë, ofron një shumëllojshmëri rrugësh, jo standarde për të stabilizuar ekonominë dhe promovuar rritjen, dhe pranon se defekter e tregut kërkojnë ndërhyrjen e qeverisë. Hartuesit e politikave i kanë ndjekur qëllimet e stabilizimit pa u shqetësuar shumë për pasojat e rritjes, ndërsa përpiken të ndihmojnë rritjen nëpërmjet reformave strukturore të përqendruara në përmirësimin e efikasitetit ekonomik. Megjithatë, politikat strukturore si për shembull liberalizimi i tregjeve të kapitaleve, kanë pasur pasoja të mëdha për stabilitetin ekonomik. Ky libër i sfidon këto politika, duke argumentuar se politikat e stabilitetit kanë pasoja për rritjen afatgjatë, dhe shpesh zbatimi i tyre ka sjellë pasoja të kundërtë. Pjesa e parë e librit trajton çështjet kyç dhe i sheh objektivat e politikave ekonomike nga një perspektivë e ndryshme. Pjesa e dytë shqyrton çështje qendrore të makroekonomisë, duke paraqitur një analizë të modeleve ekonomikë dhe politikave për gjendjen e tranzicionit nga perspektiva Nekoklasike, Keinsiane dhe heterodokse. Pjesa e tretë paraqet një analizë të ngashme për liberalizimin e tregut të kapitaleve.

► Të bësh.të funksionojë globalizmi (*Making Globalisation Work*, 2006)

Ky libër merret me imoralitetet e ekonomisë globale dhe mekanizmat me të cilët vendet e zhvilluara ushtrojnë një ndikim të madh mbi vendet në zhvillim. Dr. Stiglitz argumenton se duke përdorur masa të ndryshme, - si tarifa të dukshme mbi tregtinë, subsidiaritetë më fine, një sistem evident që vendet e zhvilluara janë më mirë të përgatitura për ta përballuar, ose démi i shkaktuar ndaj vendeve të varfra nga ndotja globale - bota po destabilizohet si nga ana ekonomike ashtu edhe nga ana politike, dhe nga kjo do të vuajmë të gjithë. *Making globalisation work* ekspozon problemin se si globalizimi po menaxhohet për momentin, interesat e veçanta që qëndrojnë pas vendimeve dhe tendencat për të negociar në mënyra më të ndershme nga ata që janë më të prekur. Dr. Stiglitz merret menjëherë me problemet me të cilat bota po ndeshet tanë, duke argumentuar se institucione të forta dhe transparente nevojiten për të kthyer globalizimin në favor të më të varfërve dhe për të kompensuar deficitin demokratik që ndihet kaq shumë në të gjithë botën. Ai tregon se si një ekzaminim i

tregjeve të paplotë mund të bëjë të dëshirueshmë korrigjimin e politikave të qeverisë.

Stiglitz argumenton se mundësitet ekonomike nuk janë të mundshme për të gjithë, kriyat financiare janë shumë të kushtueshme dhe të shpeshta, dhe vendet e pasura kanë bërë shumë pak për të zgjidhur këto probleme. "Making globalisation work" është një libër optimist, që jep shpresën se shoqëria globale ka vullnetin ose aftësinë për të zgjidhur probleme globale dhe integrimi ekonomik ndërkombëtar do të jetë një provë force. Ky libër është shitur më shumë se dy milionë kopje.

The roaring Nineties (Vitet e zhurmshme '90)

Në vitin 2003, Stiglitz publikoi *The roaring Nineties*, analizën e tij për zhvillimin dhe rënien e viteve '90. Në vitin 2004, Stiglitz publikoi «Paradigma e re për ekonomiksin monetar» (Cambridge University Press) dhe në vitin 2005, Oxford University Press botoi librin e tij «Tregti e ndershme për të gjithë». (Free Trade for all)

► Globalizmi dhe protestuesit e tij (*Globalisation and its discontents*)

Stiglitz trajton një nga problemet më shqetësuese të kohës sonë kur argumenton se ato çka ne zakonisht i quajmë «vende në zhvillim», në fakt nuk janë të zhvilluara fare. Stiglitz, në *Globalisation and Its Discontents*, jep pikëpamjet e tij në lidhje me gabimet që janë bërë dhe atë se çfarë duhet bërë ndryshe. Por libri gjithashtu fokusohet te fajtorët. Sipas Stiglitz, historia e zhvillimit të dështuar e ka një përgjegjës, dhe ky përgjegjës ka qenë FMN.

Në këtë libër, Stiglitz i bazon argumentet e tij për politika të ndryshme ekonomike, në tema që ka theksuar edhe në punën teorike të tij gjatë dekadave të mëparshme: sidomos, çfarë ndodh kur njerëzve u mungon informacioni kyç, i cili është në thelb të vendimit që duhet të marrin, ose kur tregjet, për lloje të rëndësishme transaksionesh, nuk janë të përshtatshëm, ose nuk ekzistojnë, ose kur institucionë të tjera që mendimi ekonomik standard i merr si të mirëqenë, nuk ekzistojnë ose janë difektozë. Implikimi i se cilës prej këtyre mungesave ose defekteve, është se tregu i lirë nëse lihet të funksionojë vetë, nuk jep patjetër rezultatet pozitive të lavdëruara nga tekstet e ekonomisë. Stiglitz i mëshon kësaj pike: «kërkimet më të

fundit në teoritë ekonomike (që pjesërisht i referohen vetë punës së tij), tregojnë se sa herë informacioni është joperfekt dhe tregjet e paplotë, gjë që ndodh gjithmonë, sidomos në vendet në zhvillim, një dorë e padukshme vepron atëherë në mënyrën më jo perfekte të mundshme». Si rezultat, vazhdon Stiglitz, qeveria mund të përmirësojë rezultatin me ndërhyrje të zgjedhura si duhet. Në nivelin e ekonomive ndërkombëtare, ku familjet dhe firmat blejnë shumë më pas se sa prodhon ekonomia, qeveria mund të luftojë rënien dhe depresionin duke përdorur politika fiskale dhe monetare zgjeruese për të rritur kërkasen përmallra dhe shërbime. Në nivelin mikroekonomik, qeveria mund të tregullojë banka dhe institucione të tjera financiare për t'i mbajtur ata të shëndetshëm. Ata gjithashtu mund të përdorin politika taksore për të orientuar investimet në industri më produktive, dhe politika tregtare për t'u lejuar industrive të reja të rriten deri në atë pikë, sa të mund të përballojnë konkurrencën e huaj. Dhe qeveritë mund të përdorin një shumëlojshmëri mijetesh duke nisur që nga krijimi i vendeve të punës, trajnimi i krahut të punës, deri te asistenca sociale, për të kthyer të papunët në punë, duke amortizuar kundërshtimin njerëzor që të mos rrëshqasë drejt asaj se - sipas teorisë së informacionit të paplotë, ose tregjeve, ose institucioneve, - nuk është faji i askujt.

Stiglitz ankohet hidhur se FMN ka shkaktuar një dëm të madh me politikat ekonomike që ka rekomanduar dhe që vendet duhet të ndjekin me qëllim që të përfitojnë nga huatë e FMN, ose nga huatë nga banka dhe sektorë të tjerë privatë, që marrin nga FMN mendimin, nëse një huamarrës e meriton huanë apo jo. Ai argumenton se organizata dhe zyrtarët e saj e kanë injoruar rolin e informacionit jo të plotë, tregjeve të papërshtatshëm dhe institucionë që nuk funksionojnë - të gjitha këto janë karakteristika të vendeve në zhvillim. Si rezultat, ai argumenton se përsëri FMN bën thirrje për politika që përpushten me librat e ekonomisë, por nuk kanë kuptim përvendet të cilëve FMN ua rekomandon këto politika. Stiglitz përpinqet të tregojë se pasojat e këtyre politikave të keq-drejtuara janë katastrofike, jo vetëm po t'u referohesh të dhënavë statistikore por, duke iu referuar vuajtjes njerëzore të vendeve që i kanë ndjekur ato.

Whither socialism? (Ku është socializmi?)

Ky libër është bazuar në leximin nga Stiglitz të Wicksell, të prezantuar në Stockholms School of Economics në vitin 1990, dhe paraqet një përbledhje të shkruar mirë dhe të përshtatshme të temës qendrore të ekonomiksit të informimit dhe është një material baze për teorinë e tregjeve me informacion jo perfekt dhe konkurrencë joperfekte, gjithashtu është edhe një kritikë si e tregjeve të lirë ashtu edhe qasjes së tregjeve socialistë. Stiglitz shpjegon se si modeli neoklasik ose modeli Walrasian i referohet rezultatit të procesit gjë që i ka dhënë jetë një paraqitje formale të nocionit dorë e padukshme e Smithit së bashku me rreshat e formuluar nga Walras dhe të përbledhur në modelin e përgjithshëm të ekuilibrit Arrow-Debreu që ka dominua mendimin ekonomik të gjysmës së shekullit të kaluar, dhe gabimisht mund të ketë inkurajuar besimin se tregu socialist mund të funksionojë. Stiglitz, propozon një model alternativ, të bazuar në ekonomiksin e informacionit të ngritur nga teoremat e Greenwald-Stiglitz, që siguron një penetrim më të madh teorik mbi kërkimet në ekonominë e tregut dhe ofron një udhëheqje më të mirë për politikat në vendet në tranzicion ekonomik.

Një nga arsyet që sheh Stiglitz në dështimin e modelit standard neoklasik mbi të cilin ngritet tregu socialist, është supozimi i tij në lidhje me informacionin dhe sidomos dështimi i tij përvendet konsideruar problemet që ngriten nga mungesa e informacionit jo perfekt dhe nga kostoja e marries së informacionit. Ai gjithashtu identifikon probleme që ngriten nga supozimi i tij në lidhje me paplotësinë.

► Kritika.

“Whither socialism?” ka qenë subjekt i disa kritikave si p.sh. ato të profesorit të Yale University John E. Roemer (An Anti-Hayekian Manifesto - 1995), ajo e shkruar nga Peter Boettke, zëvendës drejtor i Qendrës Për Politikat ekonomike, si edhe i kritikës së D. Prychitko, profesor ekonomist në Northern Michigan University, e cila është publikuar në Cato Journal. Pruchitko thotë : «libri shpreson të shkojë përtëj të kufijve të teorisë së pastër ekonomike, ashtu si lë të nënkopuhet nga titulli. Stiglitz bën përpjekje të bashkohet me dialogun në politikën ekonomike

dhe do të dijë nëse «idetë e teorisë ekonomike moderne dhe idealet utopike të viteve '90 mund të sillen sa më afër». është pikërisht ky koment që nxit kriticizmin, jo aq shumë nga që kërkon të shpëtojë disa ideale socialistë, por më tepër për shkak të presupozimeve të tij të paekzaminuara në lidhje me si të bëhet kjo». Stiglitz këmbëngul se nuk duhet të shtrojmë pyetjen nëse shteti duhet të luajë një rol në ekonomi, por se sa i madh duhet të jetë ky rol dhe në cilat detyra specifike». Për Stiglitz, problemi shtrohet në mënyrën e duhur vetëm kur kërkojmë «balancën e duhur midis tregut dhe qeverisë» por ai nuk tregon dot se kush është kjo «balance e duhur». «Stiglitz tregon në mënyrë formale aftësitë e mundshme të shtetit për të rritur eficencën të bazuar në teoremat e Greenwald-Stiglitz dhe beson se zgjidhja e problemeve botërorë mund të ndriçohet nga ky grup i ri teoremash matematike, që do të zëvendësojnë teoremat e vjetra të Arrow-Debreu dhe Lange-Lerner :

Stiglitz mendon se ekonomksi duhet të konsiderohet si diçka më shumë se një problem i ngshtë maksimizimi, dhe propozon alternativën e tij - një teoremë matematike që përfshin vektorë jolinearë më kompleksë. «Idea kryesore e Stiglitz është në përgjithësi korrekte - ajo se shtetit nuk mund të përashtohet, ose se duhet të përfshihet - por lë të hapura çështjet e mëdha konstitucionale: si mund të bëhen shtrëngohen institucionet e forcës se një shteti? Cila është marrëdhënia midis shtetit dhe shoqërisë civile? Libri i tij dështon në këto aspekte politike sepse nuk shtron çështje më të mëdha kushtetuese si kanë ngritur James McGill Buchanan J.R. dhe ekonomistë të tjera kanë ngritur.

D Punime dhe konferenca

Dr. Stiglitz shkroi një seri punimesh dhe mbajti shumë konferenca për të shpjeguar se si pasiguritë për informacionin mund të ndikojnë në çdo gjë, që nga papunësia deri në uljen e huave. Në pozicionin e kryerarit të Këshillit të Këshilltarëve ekonomikë gjatë administratës Clinton dhe si ish ekonomist i Bankës Botërore, Dr. Stiglitz ishte i aftë të vendoste disa nga pikëpamjet e tij në veprim. Për shembull ai ishte një kritik i drejtpërdrejtë i hapjes së shpejtë të tregjeve financiare në vendet në zhvillim. Këto tregje

mbështeten në aksesin ndaj të dhënave të mira financiare dhe *sound* ligjet e falimentimit, por ai argumenton se shumë nga këto vende nuk kanë institucionë të rregullta të nevojshme përtigjishme të siguruar se tregjet do të veprojnë si duhet.

D Kritikat e Stiglitz

Disa ekonomistë të tregut të lirë dhe të *laissez-faire* ngrenë pyetje mbi linjat e arsyetimit të Stiglitz të cilat janë bazuar në ekonomiksin e informacionit dhe asimetrinë e informacionit dhe i shtohen argumentit ekonomik përnjë ndërhyrje më të madhe të qeverisë dhe rregullim. Këta ekonomistë më tepër mbështesin faktin se informacioni jo perfekt ndonjëherë i shformon tregjet, sesa faktin se qeveritë duhet të trajtojnë këto shformime të fshehura me një proces transparent, rregulla më të thjeshta dhe ndërhyrje më pak direkte në treg.

Libri i Stiglitz *Whither Socialism*, ishte kritikuar nga D. Prychitko i Cato Institute. Prychitko kritikoi faktin që libri nuk arriti të trajtonte «çështjet konstitucionale» të ngritura nga J.M. Buchanan, evidencia historike dhe konteksti janë trajtuar në mënyrë të pamjaftueshme dhe puna nuk u është referuar figurave si Hayek, Claus Offe dhe Jurgen Habermas. Së fundmi, Prychitko e sheh librin si një hyrje të mirë joformale në ekonomiksin modern të informacionit, por «me gjithë meritën e tij të madhe, mendoj se libri nuk ka trajtuar deri në fund çështjet historike, politike dhe filozofike, që nënkopuntonte titulli i tij provokativ»

D Publikime

- 2008, *The Three Trillion Dollar War* ISBN 978-0-393-30670-1; (Lufta tri trilion dollarë) by Joseph Stiglitz and Linda Bilmes, W. W. Norton.
- 2006, *Making Globalization Work* ISBN 0-393-06122-1, (Të bësh të funksionojë globalizimi) Penguin Books, August 2006.
- 2006, *Stability with Growth: Macroeconomics, Liberalization, and Development* (Stabiliteti me rritje: Makroekonomi, Liberalizmi dhe Zhvillimi) ISBN 0-19-928814-3 (Initiative for Policy Dialogue Series C); by Joseph E. Stiglitz, Jose Antonio Ocampo, Shari Spiegel, Ricardo Ffrench-Davis, and Deepak Nayyar; Oxford University Press 2006

- 1996, *Whither Socialism?* (Ku është socializmi?) STIGLITZ, Joseph E., (Wicksell Lectures), MIT Press, January 1996.
- 2000, *Frontiers of Development Economics: The Future in Perspective*, (Kufijtë e zhvillimit ekonomik: e ardhmja në perspektivë) edited with Gerald M. Meier, World Bank, May 2000.
- 2002, *Principles of Macroeconomics*, third edition, (Parimet e makroekonomisë, botimi i tretë) with Carl E. Walsh, W.W. Norton & Company, March 2002.
- 2002, *Economics*, (Ekonomiks, botimi i tretë) Third Edition, with Carl E. Walsh, W.W. Norton & Company, April 2002.
- 2002, *Peasants Versus City-Dwellers: Taxation and the Burden of Economic Development*, (Fshatarwt kundër qyetatrëve: taksimi dhe pesha e zhvillimit ekonomik) with Raaj K. Sah, Oxford University Press, April 2002.
- 2002, *Globalization and Its Discontents*, (Globalizimi dhe të pakënaqurit prej tij) W.W. Norton & Company, June 2002.
- *Towards a New Paradigm in Monetary Economics*, (Drejt një paradigmë të re në Ekonomiksin Monetar) with Bruce Greenwald, Cambridge University Press.
- 2003, *The Roaring Nineties*, (Vitet e zhurmshme '90) W.W. Norton & Company, forthcoming in October 2003.
- *Fair Trade for All: How Trade Can Promote Development* (Tregëti e ndershme për të gjithë: si tregu mund të nxisë zhvillimin) (Initiative for Policy Dialogue Series C) ~ by Joseph E. Stiglitz, Andrew Charlton; Hardcover
- *Economics of the Public Sector*, (Ekonomiks i sektorit publik) by Joseph E. Stiglitz
- 2002, *The Rebel Within: Joseph Stiglitz and the World Bank* (Rebeli brenda: Joseph Stiglitz dhe Banka Botwrore) by Joseph E. Stiglitz (Editor), Ha-Joon Chang (Editor), ISBN 1-898855-91-9, Anthem Press, Wimbledon Publishing Company (Paperback - February 25, 2002)
- 2005, *The Development Round Of Trade Negotiations In The Aftermath Of Cancun* (Raundi mbi zhvillimin i negociatave për tregëtinë pas Kankunit) by Joseph E. Stiglitz, Andrew Charlton (Paperback - January 30, 2005)
- 2005, *A Chance For The World Bank* (Një mundësi për Bankën botërore) by Joseph P. Stiglitz (Foreword), Jozef Ritzen, ISBN 1-84331-162-3, Anthem Press, Wimbledon Publishing Company (Paperback - May 30, 2005)
- 1986, 'Economics of the Public Sector' (Ekonomiksi i sektorit publik) by J.E. Stiglitz ISBN 0-393-96651-8, W.W. Norton, New York. (Re-printed 1988, 2000)
- 1981, 'Theory of Commodity Price Stabilization' (Teoria e stabilitetit komod të çmimeve) by David M.G. Newbery and Joseph E. Stiglitz ISBN-10: 0198284179 ISBN-13: 978-0198284178, Oxford University Press [Hardcover: 512 pages]
- *Readings in the Modern Theory of Economic Growth* b (Lexime mbi teorinë moderne të rritjes ekonomike) Joseph E. Stiglitz (Editor), Hirofumi Uzawa (Editor)

Përgatiti Gladiola Bendaj



Besnik ALIAJ

Bashkia Kamerz. Titulli "Fisnickeria Tiranase" Shoqata Tirana. Kualifikime profesionale dhe/ose konsulencje ne Danimarke, Norvegji, Holande, Itali, SHBA, Kosove, Peru, Egjipt, Gjermani, etj. Autor botimesh profesionale.

Dr. Besnik Aliaj – Ka lindur ne Gjirokaster 1966. Diplomuar ne arkitekture-urbanistike, Universiteti i Tiranës, 1990. Ka mbrojtur graden "Master", Universiteti "Erasmus" dhe IHS-Rotterdam Holande, 1996. "Doktor i Shkencave", FIN, Universiteti Politeknik Tirane, 2007. Dy vite eksperience pune ne qeverisjen vendore, dhe 17 vjet eksperience akademike prane Universitetit Politeknik, Akademise se Arteve te Bukura, Universitetit "Polis" Tirane; dhe Universitetit Teknik te Darmstadt Gjermani. Eksperience 10 vjecare me shoqerine civile. Bashke-themelues dhe ish-drejtues i Co-PLAN, Institut per Zhvillimin e Habitatit. Sekretar i Pergjithshem i Shoqates se Arkitekteve te Shqiperise. Bashkethemelues i Platforma-IDR, Institut per Demokraci e Reforma. Keshilltar i Kryeministrat per territorin 2005/7. Bashkethemelues dhe Rektor i Universitetit "Polis". "Qytetar Nderi"

BESNIK ALIAJ

Misteri i Pgjashtë

Gili është kurdi që mbani peng
zhvillimin dhe integrimin
e ekonomisë shqiptare
me botën moderne?



Co-PLAN

MISTERI I GJASHTË

Si liberalizmi e “vë në punë” ekonominë gri

Nga idetë e mëdha mund të zgresë tek aplikimi i tyre, nga një rast konkret mund të ngrihen deri tek idetë e mëdha. Besnik Aliaj, në librin e tij “Misteri i gjashtë”, duke u nisur njëkohësisht nga teoria e Hernando de Soto dhe nga rasti shqiptar, sjell në librin e tij jo thjesht një studim për rastin shqiptar të legalizimeve dhe kontrollit të territorit, por më shumë se kaq: na jep një alternativë për ngërçin e informalitetit.

Nga HENRI ÇILI

Libri “Misteri i gjashtë”, botim i Universitetit Polis dhe Co-plan është një kontribut në tregun e ideve aplikative në Shqipëri, pasi përmbush të gjitha kriteret shkencore. Por jo vetëm kaq; ai nuk është një libër i mërzitshëm që flet për “seksin e engjëjve”, pra nuk merret me ndonjë problem periferik të shoqërisë shqiptare, por godet në shenjë në atë që është ndoshta problemi më i madh që pengon zhvillimin e Shqipërisë: ekonomia dhe pasuritë gri, ndërtimet pa leje dhe kontrolli i territorit në këtë vend.

Besnik Aliaj, në fakt, ka qenë me kohë kurioz rreth asaj që po ndodhë me informalitetin imobiliar në këtë vend. Të paktën që prej mesit të viteve '90, me një përvjohje të dorës së parë mbi këtë problem, nisur nga angazhimi i tij si një arkitekt i ri në kuadrin e organizatës Co-plan, si dhe në kuadrin e organizimit të shumë projekteve të Bankës Botërore apo organizmave të tjera shqiptarë dhe ndërkombëtarë, ai e ka prekur problemin vetë, atje, në terren, atje ku njerëzit kanë ndërtuar, me një energji të pabesueshme, ëndrrën e jetë së tyre: afrimin me qytetin dhe përpjekjen për të prosperuar për vendin e tyre.

Në fakt, si kudo tjetër, historia e ekonomisë informale në përgjithësi, por në veçanti ajo e ndërtimëve pa leje rreth periferive të Tiranës, si dhe e gjithë qyteteve të mëdha të ultësirës perëndimore të vendit, është një nga historitë më të pabesueshme dhe më komplekse.

Nëse shumë e shumë vende të tjera e kapërcyen

problemin e urbanizimit në disa epoka dhe rrrethana të tjera historike, Shqipëria pati rastin ta shihet këtë fenomen në kohën e një tranzicioni të trefishtë: nga njëra anë tranzicioni politik i kalimit të sistemit nga diktatura në demokraci, nga ana tjetër tranzicioni ekonomik, efekti i kalimit nga ekonomia e planifikuar drejt asaj të tregut. Shumë shpejt, këtij binomi iu shtua edhe një tjetër proces, jo më pak i rëndësishëm, procesi i urbanizimit. Ndoshta asnjë vend tjetër nuk mund t'i ketë pasur të tria këto bashkë, pasi zakonisht urbanizimi ka qenë i lidhur - përgjithësisht në shoqëritë perëndimore - me procesin e industrializimit, kurse në Shqipëri, në kohën e zbritjeve të mëdha rrëth qyteteve, në fakt, ishim në kohën e de-industrializimit socialist, pra në epokën e mbylljes së uzinave dhe fabrikave në qytete. Por kjo nuk është e vetmja rrëthanë kontroveze e procesit të urbanizimit të këtij vendi. Regjimi i pronësisë dhe kuadri rregullator i territorit, kanë qenë gjatë viteve '90 në një paqartësi dhe in-eficënsë të plotë, gjë që e ka lënë përfundimisht këtë problem në rangun e atyre problemeve që të gjithë kanë frikë t'iu afrohen.

Pikërisht këtu kanë vlerë idetë e mëdha dhe njerëzit e guximshëm. Frymëzuar nga idetë e mëdha të ekonomistit Hernando de Soto, të sistemuara në librin “Misteri i kapitalit”, i cili dukshëm është një lloj udhëheqësi shpirtëror dhe ideor i profesionistit Besnik Aliaj, ky i fundit, tek “Misteri i gjashtë” ofron një qasje të plotë sistemime të asaj se si duhet të zgjidhet problemi i legalizimeve dhe ai i ekonomisë gri në Shqipëri. Është pikërisht kjo ekonomi që mban jashtë tregut afro 10 miliardë dollarë pasuri të paluajtshme,

të cilat ngaqë janë pa letra, janë efektivisht jashtë përdorimit, dhe për pasojë, i rëndojnë zhvillimit të vendit, i dalin kundër-pedal atij.

Deri më tani askush nuk i është qasur në një mënyrë kaq të plotë, shkencore dhe të guximshme këtij problemi, po të përjashtojmë programin elektoral të partisë demokratike në zgjedhjet e vitit 2005, në të cilin kishte "dorë" po vetë Besnik Aliaj, në funksionin e anëtarit të Komitetit për Orientimin e Politikave. Por, këto ide dhe ky program u sakrifikuancë në sjelljen e interesave politike të kryeministrit Berisha dhe mënyrës së tij të mirënjojur të marrjes së ideve të mëdha dhe futjes së tyre nëpër skema të vogla të ditës. Kësosoj, rasti i ALUZINI-t, agjensia për legalizimin e zonave informale, është një nga karikaturat më të mëdha të tranzicionit, pa llogaritur këtu një kuadër ligjor për legalizimet, i cili përvëçse antikushtetues, është pa sens, ose përfundimisht i pazbatueshëm.

Besnik Aliaj në librin e tij Misteri i Gjashtë, në fakt i përbahet alternativës liberale në çështjen e ekonomisë gri, e cila, nisur nga parimi i eficensës, kërkon t'i japë një zgjidhje këtij problemi tmerrësish të komplikuar që kanë ekonomitë në zhvillim.

Jashtë moralizimit për pronarë dhe ish-pronarë, jashtë teknikaliteteve juridike për legalitetin e pronësisë dhe të ndërtimit, ofrohet një zgjidhje makro, e cila kënaq në mënyrën më të mirë të mundshme të gjitha palët: këto prona legalizohen, futen në treg, dhe me impaktin që merr tregu nga kjo, autoriteti publik bën të gjitha kompensimet, apo të gjitha ato zgjidhje që lidhen me urbanizimin, kompensimin e ish-pronarëve etj.

Jap se alternativa liberale është e vetmja alternativë për të aktivizuar në tregun vendas këtë pasuri kolosale, që nuk ka arsyë ta mbajmë më jashtë tregut dhe kaq afër poleve të mëdha të zhvillimit të vendit. Të tjera alternativa nuk ka. E majta nuk ka mundur të thotë dot gjë të re në këtë drejtim, kurse të gjithë ata që bëjnë moralizime për të drejtën dhe për legalitetin, jo vetëm nuk zgjidhin gjë, por zgjasin agoninë e të gjithëve.

Libri i Besnik Aliajt është një doracak pune dhe idesh për të gjitha ata që merren me politikën dhe çështjet e zhvillimit të këtij vendi. I qartë, konciz, i këndshëm, ai na nxjerr nga izolimi i ideve dhe pikëpamjeve tona ndaj këtij problemi. Na jep shpresë, duke na dhënë gjithaq kënaqësinë e një punimi shkencor dhe të një kontributi intelektual të dorës së parë.

Shtypi u realizua në shtypshkronjën
“KRISTALINA-KF”
Rr. “Lord Bajron”
Tel.: ++ 355 4 356928;
Cel.: 068 20 38373, Cel.: 069 20 38373
Tiranë / Albania